

PËRGJEGJËSIA CIVILE, QË RRJEDH NGA DËMI EKZISTENCIAL. VËSHTRIM NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

Velisjana SHERIFI

Dorëzuar: Universiteti European i Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të shkollës së Doktoratës në
shkenca juridike, me profilin e së drejtës civile, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof.Dr. Ilir MUSTAJ**

Numri i fjalëve: 55 527

Tiranë, Dhjetor 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara, të vendosura sipas një bibliografie të mirëpërcaktuar.

© *Velisjana Sherifi*

Abstrakti

Qëllimi i parë i këtij punimi është të identifikojë kornizën ligjore aktuale për përgjegjësinë juridiko-civile, që lind në rast të shkaktimit të një dëmi ekzistencial. Për të përcaktuar këtë është e nevojshme të kuptojmë se si lidhet përgjegjësia, që rrjedh në këtë rast me elementët e vlefshmërisë së saj: veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm, fajin, dëmin dhe lidhjen shkaksore, duke bërë bashkë në këtë mënyrë analizën ligjore dhe doktrinare të problemit.

Figura e dëmit ekzistencial, që hyri në diskutimet e jursiprudencës shqiptare me Vendimin Unifikues nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka paraqitur interes jo vetëm për studiuesit por, edhe përdoruesit e ligjit. Megjithëse, deri më tani ka pasur përpjekje për të sjellë interpretime dhe qëndrime mbi këtë figurë, nuk ka pasur një studim të plotë të saj.

Nëpërmjet këtij punimi është synuar të jepet një pasqyrë dinamike dhe evolutive e konceptit, duke ndërthurur qëndrimin e doktrinës me atë të ligjit, duke pasqyruar rrugën e tij në legjislacionin shqiptar nga Kodi i parë Civil i vitit 1929 deri në Kodin Civil, që është në fuqi dhe refleksionet mbi ndryshimet e vitit 2012, që pësoi ky Kod në kuadër të risive të dëmit jopasuror e deri tek mangësitë dhe nevoja për t'i plotësuar ato duke marrë në konsideratë përjasjen e legjislacionit të brendshëm me atë të BE dhe jurisprudencën e GJEDNJ.

Nga qëndrimi që ka mbajtur ligjvënësi, dëmi ekzistencial duket sikur ka mbushur boshllëkun e lënë nga dëmi moral (për shkak të kufizimeve që rrjedhin nga neni 625 i K.C) dhe dëmi biologjik, që duhet të konsiderohet si i lidhur ngushtë me aspektin shëndetsor dhe mjekësor. Megjithatë, nga shqyrtimi i plotë dhe multidimensional i rëndësisë juridike të kësaj figure rezulton se ajo duhet të ketë një përfaqësim individual në radhën e figurës së dëmit jopasuror, duke zënë një vend të veçantë në legjislacionin civil, me qëllimin që, të shmangen konfondimet në rastet konkrete, ku cilësohet si delikate çështja e klasifikimi të së drejtës së shkelur dhe duke i siguruar mbrojtje maksimale juridike palës së dëmtuar për rivendojen e gjendjes, që ajo kishte përpara se ngjarja e dëmshme të ndodhte.

Abstract

The primary aim of this thesis is to identify the actual legal framework of civil responsibility caused by existential damage. In order to do this, it is necessary to understand how the responsibility, caused in this case, relates with its elements of validity: illegal actions or non-actions, fault, damage and causal connection, so the thesis addresses both the legal and doctrinal analysis.

The figure of existential damage, which made part of discussions in the Albanian jurisprudence by Unifying Decision No.12, dated 14.09.2007 of United Colleges of the Albanian Supreme Court have attracted not only the interest of researchers but, also of the users of the law. Even though, up to now there has had efforts in order to bring performances and views about it, but there was no a full study of it. Through this thesis, it is intended to give a dynamic and evolutionary overview of the concept, by combining the doctrine and law reaction by reflecting its way into the Albanian legislation from the first Civil Code of 1929 to the actual Civil Code and reflections in the law changes of year 2012, which, took place on this Code in the context of the innovations of non-pecuniary damage and up to lacks and needs of their implementation taking into account the approach of internal laws with EU ones and the jurisprudence of ECHR.

By position of the legislator, existential damage seems to have fulfill the gap left by moral damage (due to limitations arising from article 625 of C..C) and biological damage which should be considered as closely linked to health and medical aspects. However this, from the full and multidimensional examination of legal importance of this figure it turns out that it must have an individual representation in the line of non-pecuniary damage being positioned in a special place in the civil legislation, with the intention to avoid confusion in concret cases, where it is evaluated as delicate the issue of classification of the violated right providing a maximum legal protection of the injured party reestablishing the situation which it had before the harmful event occurred.

*Sepse të jesh e përgjegjshme për mirënjohjen ndaj njerëzve që të
edukojnë përgjegjësi dhe dinjitet nuk është vetëm detyrë*

PRINDËRVE!

FALENDERIME

Përgatitja dhe finalizimi i një projekti të tillë, domethënës në jetën profesionale dhe akademike është bërë i mundur edhe falë mbështetjes së disa personave, të cilët edhe pse nuk mjafton do të dëshiroja t'u shprehja mirënjohjen time në pak rreshta.

Së pari, dëshiroj të falenderoj udhëheqësin tim, *Prof.Dr.Ilir Mustafaj*, për të gjithë ndihmën dhe mbështetjen e tij përgjatë kohës së kërkimit shkencor dhe përgatitjes së këtij punimi.

Përzemërsisht falenderoj studentët e mi, të cilët nisur nga dëshira për të njohur dhe eksploruar të drejtën në këtë drejtim relativisht të ri në Shqipëri, nxitën me besim interesin tim për këtë fushë kërkimi. Një falenderim tjetër shkon për Shkollën Doktorale e Departamentin e së Drejtës Civile pranë Universitetit European të Tiranës si dhe gjithë stafin akademik e administrativ të tij, të cilët kanë qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit doksoral.

Së fundi, dashuri, mirënjohje dhe falenderim për *FAMILJEN*, e cila pandërprerë më ka dhënë besim, mbështetje dhe inkurajim përgjatë gjithë rrugës sime akademike dhe jo vetëm. Ajo është për mua frymëzim dhe asgjë nuk do të ishte bërë e mundur pa të.

*Singerisht ,
Velisjana Sherifi!*

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Deklarata e Autorësisë

Abstrakti

Falenderime

Lista e Shkurtimeve

KAPITULLI I: HYRJJE

| | | |
|-------|--|----|
| 1.1 | Objekti i studimit | 11 |
| 1.2 | Pyetja kërkimore dhe hipoteza | 15 |
| 1.3 | Metodat e kërkimit | 16 |
| 1.3.1 | Metoda fundamentale e orientuar..... | 16 |
| 1.3.2 | Metoda e kërkimit shkencor vëzhgues..... | 17 |
| 1.3.3 | Metoda analitike | 17 |
| 1.3.4 | Metoda përshkruese | 18 |
| 1.3.5 | Metoda e krahasimit..... | 18 |
| 1.4 | Aspektet strukturore të punimit | 19 |
| 1.5 | Kufizimet dhe vështirësitë e punimit | 22 |

KAPITULLI II: VËSHTRIM DOKTRINAR MBI PËRGJEGJËSINË CIVILE DHE INSTITUTIN E SHKAKTIMIT TË DËMIT

| | | |
|-------|--|----|
| 2.1 | Reflektime teorike mbi kuptimin e përgjithshëm të përgjegjësisë civile | 25 |
| 2.1.1 | Funksionet e përgjegjësisë civile | 32 |
| 2.1.2 | Teoritë mbi përgjegjësinë civile | 34 |
| 2.2 | Identifikimi i përgjegjësisë jashtëkontraktore në doktrinën e së drejtës së detyrimeve | 35 |
| 2.3 | Evolucioni i rrugës jashtëkontraktore: intolerancat në drejtim të zbatimit të nenit 608 K.C'94 dhe zbatimi i rregullave të tjera në fushën e dëmit | 39 |
| 2.4 | Paqartësi tradicionale dhe çështje të reja mbi dallimin midis përgjegjësisë kontraktore dhe përgjegjësisë jashtëkontraktore | 42 |
| 2.5 | Përgjegjësia kontraktore dhe jashtëkontraktore drejt një kocepti unitar të përgjegjësisë civile | 52 |

| | | |
|-----|---|----|
| 2.6 | Përgjegjësia kontraktore nuk përjashton përgjegjësinë jashtëkontraktore | 58 |
|-----|---|----|

KAPITULLI III: KUADRI HISTORIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË CIVILE QË RRJEDH NGA DËMI EKZISTENCIAL

| | | |
|------|--|----|
| 3.1 | Kodi Civil i vitit 1929 | 64 |
| 3.2. | Përgjegjësia juridiko-civile për dëmin ekzistencial sipas ligjit Nr.2359, datë 15.11.1956 ‘Mbi veprimet juridike dhe detyrimet’ | 69 |
| 3.3 | Ligji nr.6240, datë 26.08.1981 “Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” | 71 |

KAPITULLI IV: PËRGJEGJËSIA CIVILE PËR DËMIN EKZISTENCIAL NË DRITËN E KODIT CIVIL 1994

| | | |
|----------|---|-----|
| 4.1 | Aplikimet fillestare të nenit 608 të KC’94 | 73 |
| 4.2 | Kushtet për lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për shpërblimin e dëmit sipas K.C’94..... | 85 |
| 4.2.1 | Veprimi /mosveprimi i kundraligjshëm | 86 |
| 4.2.2 | Faji | 90 |
| 4.2.2.1 | – Kufijtë e rregullave të përgjithshme të përgjegjësisë me faj | 101 |
| 4.2.2.2 | – Objektiviteti (mishërimi) i fajit | 102 |
| 4.2.2.3 | – (Parimi) Presumimi i fajit | 102 |
| 4.2.3 | Dëmi | 104 |
| 4.2.3.1 | - Kriteret e përzgjedhjes së dëmit sipas nenit 608 e 625 të K.C’94 .. | 105 |
| 4.2.3.2 | -Dëmi si veprim/fakt juridik dhe dëmi si pasojë në mbrojtje të interesave të ligjshme | 110 |
| 4.2.3.3 | – Parimi <i>neminem laedere</i> | 113 |
| 4.2.3.4 | –Pika kritike të dëmit akuilian për mbrojtjen e të drejtave personale | 115 |
| 4.2.3.5 | - Prova e dëmit | 116 |
| 4.2.3.6 | – <i>Il quantum</i> | 118 |
| 4.2.3.7 | – Analiza e llojeve të dëmit jopasuror | 120 |
| 4.2.3.8 | – Teoria e dyfishtë e dëmit | 123 |
| 4.2.4 | Lidhja shkakore | 126 |
| 4.2.4.1- | Teoritë mbi lidhjen shkakore | 129 |

| | |
|---|-----|
| 4.2.4.2- Teoritë funksionale mbi lidhjen shkaksore..... | 133 |
|---|-----|

KAPITULLI V: DËMI EKZISTENCIAL NË DRITËN E DOKTRINËS DHE VENDIMIT UNIFIKUES NR.12, DATË 14.09.2007 TË KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

| | |
|--|-----|
| 5.1 Një përmbledhje e shkurtër historike mbi dëmin ekzistencial | 136 |
| 5.2 Kuptimi i dëmit ekzistencial dhe identifikimi i kategorive të dëmit jopasuror | 140 |
| 5.3 Koncepti i dëmit ekzistencial sipas Vendimit Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë | 145 |
| 5.4 Konfirmi i interpretimit kushtetues të nenit 625 të K.C'94, sistemi i kompesimit të dyfishtë të përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe dëmi jopasuror si kategori e përgjithshme dhe unitare e ndarë në disa nënkategori vetëm për qëllime përshkruese..... | 150 |
| 5.5 Rëndësia juridike e dëmit ekzistencial dhe kuadri doktrinor i figurës | 155 |
| 5.6 Ndryshimi i Kodit Civil dhe mosreflektimi i dëmit ekzistencial si figurë e posaçme e dëmit jopasuror brenda nenit 625 të K.C'94 | 163 |
| 5.7 Këndvështrim kritik mbi figurën e dëmit ekzistencial | 169 |
| 5.8 Autonomia e figurës së dëmit ekzistencial | 175 |
| 5.9 Shpërblimi i dëmit ekzistencial | 178 |

KAPITULLI VI: LEGJISLACIONI MBI DËMIN EKZISTENCIAL NËN NJË PROFIL KRAHASUES ME VENDE TË SISTEMIT TË CIVIL LAW DHE TË COMMON LAW

6.1 Karakteristika të përgjithshme të dëmit ekzistencial në disa vende të civil law

| | |
|--------------------|-----|
| 6.1.1 Italia | 186 |
|--------------------|-----|

| | | |
|-------|--|------------|
| 6.1.2 | Franca | 189 |
| 6.1.3 | Gjermania | 190 |
| 6.2 | Karakteristika të përgjithshme të dëmit ekzistencial në disa vende të common law | |
| 6.2.1 | Anglia | 196 |
| 6.2.3 | Sh.B.A | 198 |
| | KONKLUSIONE | 200 |
| | REKOMANDIME | 204 |
| | Analiza e statistikave të vendimeve..... | 206 |
| | Bibliografia | 208 |

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AMF –Autoriteti i Mbykqyrjes Financiare

BE - Bashkimi European

BGB- Kodi Civil Gjerman

GJED - Gjykata Europiane e Drejtësisë

GJEDNJ - Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

GJRGJD - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

GJRGJT - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

GJRGJV - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

KBGJL - Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë

KC ‘94 - Kodi Civil i vitit 1994

KC ‘82 - Kodi Civil i vitit 1982

KEDNJ - Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

KE - Komuniteti European

KOMEDNJ - Komisioni European për të Drejtat e Njeriut

KPC - Kodi i Proçedurës Civile

KP- Kodi i Punës

KPRSH –Kodi Penal

KSH - Kushtetuta Shqiptare

KCZ- Kodi Civil i Zogut

LVJD- Ligji nr.2359, datë 15.11.1956 “*Për veprimet juridike dhe detyrimet*”

RSH - Republika e Shqipërisë

TR - Termat e Referencës

VU 12- Vendimi Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

VGJEDNJ - Vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

KAPITULLI I- HYRJE

Koncepti i përgjegjësisë [...] Nuk mund të marrë një formë për të cilat të gjitha konceptet e tjera duhet të përshtaten. Ndodh gati e kundërta: është një virtutë e kritereve të përgjithshme të vlerave morale dhe praktike- koncepti i përgjegjësisë morale aktualisht merr formën që shoqëria i jep.
(A. Ë. H. Adkins, *La morale dei Greci*, f.31)

1.1 OBJEKTI I STUDIMIT

Statistikat e Eurostat¹ mbi treguesit e Cilësisë së jetës, (Komisioni European, October 2013:5) rendisin si elementë kyç qeverisjen dhe të drejtat themelore të njeriut. Respektimi i të drejtave të njeriut, sundimi i ligjit, qeverisja e përgjegjeshme dhe shoqëria e civilizuar janë shenjat dalluese të demokracisë moderne, që ndikojnë thellësisht cilësinë e jetës së qytetarëve european, megjithëse të drejtat e njeriut i përkasin të gjithëve, pavarësisht nga kombësia e përkatësia racore, gjinore, fetare, kulturore, politike, etj. Shqipëria si një vend, që gjeografikisht është i shtrirë në Europë e që aspirojnë edhe integrimin politik, social e ekonomik në të, është ndër të paktat vende të saj, që ka një mungesë të theksuar në drejtim të parametrave të përmendur më lart.

Edhe pse ky është një studim në të drejtën civile është nisur me një analizë në fushën e të drejtave të njeriut mbështetur në lidhjen e drejtëpërdrejtë që, cilësia e jetës së individit

¹ Është zyra përgjegjëse për hartimin e statistikave në BE, me bazë në Luksemburg. Ajo publikon statistikën e harmonizuar zyrtare të Bashkimit European dhe të zonës së Euro-s duke dhënë një portret të krahasueshëm, besueshëm dhe objektiv të shoqërisë dhe ekonomisë europiane. Një gamë e gjerë e të dhënave është e aksesueshme për vendet anëtare dhe në disa raste edhe për vendet kandidatë për në BE. Të gjithë të tjerët mund të aksesojnë falas të dhëna të përpunuara nga kjo zyrë edhe nëpërmjet faqes në internet të saj në adresën www.ec.europa.eu/eurostat

si pjesë e të drejtave të tij ka me dëmin ekzistencial, i cili është objekti kryesor i këtij punimi. Duke marrë në konsideratë faktin që dëmi, jo vetëm koncepti i tij, është shumë prezent në jetën tonë të përditshme mendojmë se do të përbëjë interes një studim i thelluar teorik i konceptit të përgjithshëm të dëmit dhe trajtimi në mënyrë të veçantë, i konceptit të dëmit ekzistencial. Ky punim është një kërkim shkencor individual, i cili përfaqëson një përpjekje profesionale autentike, i cili angazhohet të sjellë për të gjithë individët, si gëzues të të drejtës për të pasur një jetë një qetë e normale në rrjedhën e saj, si një vlerë ekzistencialiste nga e cila rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera, një qasje shkencore të bazuar mbi analizë qoftë ligjore, qoftë doktrinare, që i siguron atyre të gjithë informacionin e nevojshëm për një mbrojtje juridike maksimale në rastin kur pësojnë një dëm ekzistencial.

Prej disa vitesh praktika gjyqësore në Shqipëri ka zgjeruar fushën e dëmit jopasuror duke konfirmuar një figurë “të re” juridike, të njohur si dëmi ekzistencial, e cila në fakt, nuk përbën një risi në planin doktrinor ndërkombëtar dhe më pak në atë shqiptar. Pra, është një lloj dëmi, që lindi nga konfirmimi i jurisprudencës, pavarësisht nga kriteret kualifikuese, të cilat kanë ekzistuar edhe më parë. Vendosja e respektimit të të drejtave të njeriut në kushtetutë dhe ligje nuk mjafton, nëse zbatimi efektiv i tyre mungon. Aspirata për të mbrojtur dinjitetin njerëzor të të gjitha qënieve njerëzore, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë e vë qënien njerëzore në qendër të interesit (Vieira, 2003: 1).

Në këto kushte i drejtohem studimit të autonomisë konceptuale të figurës së dëmit ekzistencial duke u mbështetur në disa reflektime jo vetëm në planin e doktrinës dhe jurisprudencës por, edhe të ligjit. Objektivi i këtij punimi është të analizojë problematikën e veçantë të trajtuar në legjislacionin aktual shqiptar me të cilin ndeshen si palët që pësojnë

një dëm ekzistencial (kreditori) ashtu edhe subjektet që mbajnë përgjegjësi juridike (debitori) në këtë rast, e cila mund të jetë civile ose penale, civile dhe penale njëkohësisht, e nëse është civile klasifikimi i saj në kontraktore apo jashtëkontraktore. Saktësimi i kriterëve që e klasifikon një veprim të dëmshëm brenda rastit të përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe dallimet e të përbashkëtat mes dy rasteve të përgjegjësisë. Nga ana tjetër, merita e jurisprudencës për t'i dhënë mbrojtje juridike personave që pësojnë një dëm është realizuar duke interpretuar nenin 625 të K.C (ndryshuar në mars të vitit 2012) në pajtim dhe harmoni me parimet themelore kushtetuese mbi të drejtat e njeriut, duke mbajtur parasysh dhe reflektuar edhe vet procesin dinamik të ndërgjegjësimit dhe emancipimit të shtetit e të shoqërisë në njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore. Në këtë kuptim, edhe neni 608 e vijues i K.Civil synojnë riparimin e plotë të çdo dëmi të pësuar në mënyrë të paligjshme, pra jo vetëm pasurinë në kuptimin e ngushtë ekonomik, por edhe të mirat jopasurore që mëshirojnë vlerat e vet njeriut. Sikurse është trajtuar më sipër me vendimin nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë sipas neneve 3 , 15 e vijues të Kushtetutës parashikohet mbrojtje e posaçme dhe e barabartë e të mirave pasurore dhe atyre jopasurore të njeriut.

Pra, me qëllimin për të sjell një studim të plotë të kësaj figure dëmi, shumë pak të eksploruar deri më tani, del si detyrë përcaktimi i saktë i vendit që ajo zë në përgjegjësinë civile, e cila lind nga shkaktimi i dëmit. Së dyti, evidentimi i të gjithë problematikës ligjore dhe hapësirave të pambuluara nga ligji në lidhje me të drejtat, që shkelen në rastin e shkakimit të një dëmi ekzistencial, procedurat që ndërmerren nga palët në këtë rast dhe sa ligji aktual plotëson qëllimin për të kompesuar tërësisht palën e dëmtuar, qoftë në aspektin juridik, qoftë në aspektin e ekonomik të vlerave ekzistenciale të cënuara përbëjnë

objektivin kryesor të këtij studimi. Në përfundim, studimi arrin në disa konkluzione dhe jep disa rekomandime të vlefshme, jo vetëm për studiuesit e së drejtës, por edhe aktorët e përfshirë në procesin e hartimit apo propozimit të akteve ligjore, me qëllim përfshirjen e tyre në ndryshimet e ardhshme të Kodit Civil.

1.2 PYETJA KËRKIMORE DHE HIPOTEZA

Në themel të çdo hulumtimi shkencor qëndron rritja e njohurive, të kuptuarit drejtë dukuritë e hulumtuara dhe të demonstruarit se, përvojat që pasqyrohen në të lejojnë mbërritjen përfundimtare në konkluzione të caktuara, të cilat fillojnë tek pyetja kërkimore dhe përfundojnë tek vërtetimi i hipotezës së ngritur.

Pasi përcaktuar objektivat e këtij studimi pyetjet bazë kërkimore, që janë ngritur për diskutim në këtë punim janë:

1. Çfarë përfaqëson dëmi ekzistencial në fushën e dëmit jopasuror?
2. A ka të dhëna empirike, që konfirmojnë apo kundërshtojnë qasjen teorike se dëmi ekzistencial përbën një kategori dëmi autonome nga dëmi moral?
3. Si duhet t'i gjykojmë ndryshimet e Kodit Civil në vitin 2012, gati 5 vjet pas vendimit unifikues nr.12, datë 14.09.2007 qoftë nga këndvështrimi kufizues që riefroi neni 625 i K.C, qoftë nga klauzola e përgjithshme e nenit 608 të K.C ?
4. A i korrespondon dinamikës së zhvillimit të marrëdhënieve juridiko-civile konfirmimi i jurisprudencës se dëmi ekzistencial është një kategori e posaçme dëmi?

Hipoteza bazë parashtrohet :

- *Ndryshimet e nenit 625 të K.C janë të pamjaftueshme për të plotësuar hapësirat boshe që ka ligji në drejtim të sigurisë juridike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile që lindin nga shkaktimi i dëmit ekzistencial.*

Brenda këtyre pikave projekti hulumtues do të përpiqet të jap shpjegime dhe argumenta mbi faktorët kyç që çojnë drejt zgjidhjes së problemit. Prandaj, në përfundim të studimit do të kemi një panoramë të plotë argumentuese të problemit mbështetur në teori dhe analizë të plotë juridike, duke dhënë një kontribut real në përditësimin e trajtimit të kësaj çështjeje në Shqipëri në përputhje me nevojat e kohës dhe legjislacionet më të përparuara.

1.3 METODAT E KËRKIMIT

Për shkak të natyrës së këtij studimi metodat e aplikuara ndërthurin kërkimin shkencor fondamentalist të orientuar me kërkimin shkencor vëzhgues nga njëra anë dhe kërkimin analitik, përshkrues e krahasimor nga ana tjetër dhe, pothuajse të gjitha këto metoda mund të gjenden të kombinuara me njëra-tjetrën gjatë gjithë punimit. Në funksion të pyetjeve kërkimore dhe vërtetimit të hipotezave të punimit konceptet teorike dhe teoritë mbi përgjegjësinë civile, që rrjedh nga dëmi ekzistencial do të pasqyrohen në mënyrë më të detajuar në atë pjesë të punimit që ka në fokus vëzhgimin dhe analizën mbi konceptin e dëmit ekzistencial në aspektin ligjor e doktrinor dhe interpretimet që rrjedhin në këtë rast. Kryesisht punimi është bazuar në doktrinë, botime, studime, botime on-line, publikime, artikuj shkencor dhe konferenca lidhur me dëmin ekzistencial, vendime të gjykatave të brendshme ose të huaja dhe legjislacionin e brendshëm e ndërkombëtar të fushës së dëmit.

Pas mbledhjes së të dhënave nga burimet bibliografike shqiptare e të huaja, shkrimi i punimit ka ndjekur metodologjinë sipas hapave të përshkruara më mëposhtë.

1.3.1 Metoda fundamentale e orientuar

Me anë të kërkimit fundamental është synuar të paraqitet i gjithë informacioni i pastër dhe teorik mbi konceptin e përgjegjësisë juridiko-civile dhe institutit të dëmit. Ndërsa nëpërmjet orientimit të kërkimit është përcaktuar drejtimi i interesit brenda fushës së dëmit jopasuror dhe lidhjes që ekziston midis lindjes së përgjegjësisë dhe elementëve të vlefshmërisë (veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm, fajit, dëmit dhe lidhjes shkaksores) në rastin e dëmit ekzistencial. E gjithë kjo është e nevojshme për avancimin e njohurive, që zbatohen për analizën e rastit kur ndodh një dëm ekzistencial.

1.3.2 Metoda e kërkimit shkencor vëzhgues

Me anë të kësaj metode janë kryer vëzhgime mbi literaturën ekzistuese për dëmin ekzistencial në disa vende, por në mënyrë të veçantë në Shqipëri, praktikën gjyqësore në lidhje me dëmin ekzistencial dhe çfarë qëndrimesh janë mbajtur nga gjykatat para dhe pas Vendimit Unifikues nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryesisht kjo metodë është përdorur në pjesën e parë të studimit sepse përfshin procesin e mbledhjes së materialeve dhe sistemimit të tyre në punim.

1.3.3 Metoda analitike

Kjo metodë ka pasur si qëllim të jap një pasqyrë të plotë të analizës ligjore shqiptare nga miratimi i Kodit Civil i vitit 1929 e në vijim, me ndryshimet, që ndodhën në sistemin politik, të cilat u reflektuan edhe në rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile,

përkatësisht në ligjin nr.2359, datë 15.11.1956 “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*” e më pas në Kodin Civil të vitit 1982 deri në Kodin Civil aktual, që ka hyrë në fuqi në vitin 1994, nëpërmjet interpretimit se si këto norma kanë ndikuar në zgjidhjen e pasojave që rrjedhin nga përgjegjësia që lind nga dëmi ekzistencial. Pjesa origjinale e këtij punimi në këtë aspekt qëndron në përcaktimin e problematikës, që ekziston qoftë në interpretimin e konceptit të parë në dritën e një interpretimi kushtetues, qoftë në vendin që dëmi ekzistencial zë brenda fushës së dëmit jopasuror, e rëndësisë juridike të tij.

Gjithashtu, i gjithë punimi është përshkruar nga një analizë e plotë e argumentave dhe koncepteve teorike mbi dëmin, elementët e tij e problemet e jurisprudencës.

1.3.4 Metoda përshkruese

Metoda përshkruese ka synuar të: identifikojë qëndrimet doktrimore të autorëve kryesisht atyre italianë në lidhje me objektin e studimit, rrugën evolutive të përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe intolerancat në drejtim të zbatimit të dispozitës së përgjithshme (neni 608 i K.C’94), zbatimin e rregullave të tjera në fushën e dëmit, paqartësitë tradicionale dhe çështjet e reja në dallimin midis përgjegjësisë kontraktore dhe asaj jashtëkontraktore, rrugën drejt një koncepti unitar të përgjegjësisë civile, karakteristikat kryesore të elementëve të vlefshmërisë së përgjegjësisë juridiko-civile, konfirmojë interpretimin kushtetues të nenit 625 të K.C, të sistemit të kompesimit të dyfishtë të përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe dëmit jopasuror si kategori e përgjithshme dhe unitare e ndarë në disa nënkategori vetëm për qëllime përshkruese dhe të japë një përshkrim të plotë të rëndësisë juridike të figurës së dëmit ekzistencial.

1.3.5 Metoda e krahasimit

Në përpjekje për të dhënë një pasqyrë sa më të plotë të figurës së dëmit ekzistencial në rrafshin e së drejtës ndërkombëtare, punimi ka përfshirë edhe një pasqyrim të disa legjislacioneve të huaja që i përkasin sistemit të *civil law* dhe *common law*. Duke qenë se dëmi jopasuror përbën edhe në sistemet e tjera të së drejtës një nga pjesët më produktive të zhvillimit të doktrinės dhe jurisprudencës, janë përshkruar në pikat më kryesore qëndrimet e disa vendeve në lidhje me këtë çështje si Italia, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara si dhe për të parë stadin e përjasjes së legjisalcionit shqiptar me të drejtat e tjera.

1.4 ASPEKTET STRUKTURORE TË PUNIMIT

Për të dhënë një pasqyrim të plotë juridik të përgjegjësisë civile që rrjedh nga dëmi ekzistencial, parë në vështirimin e legjislacionit shqiptar punimi është strukturuar në katër pjesë të përbëra nga gjashtë kapituj, në të cilat pjesa e parë jep një informacion të përgjithshëm teorik mbi objektin e studimit, në pjesën e dytë jepet një analizë doktrimore e dy koncepteve të këtij punimi përgjegjësisë civile nga njëra anë dhe dëmit nga ana tjetër, në pjesën e tretë paraqitet analiza e kuadrit ligjor, historiku dhe perspektivat në drejtim të dëmit ekzistencial, ndërsa në pjesën e fundit analizohen disa nga qëndrimet e legjislacioneve të huaja në lidhje me dëmin ekzistencial si dhe rekomandimet e konkluzionet përfundimtare, për sa vijon :

PJESA E PARË. Kapitulli i parë, përbën një paraqitje të bazës teorike të punimit, shtrimit të problemit, qëllimit të studimit, burimeve të referimit, pyetjeve kërkimore dhe hipotezave e ngritura për t’u vërtetuar dhe metodave shkencore të përdorura gjatë kërkimit.

PJESA E DYTË. Kapitulli i dytë, paraqet një analizë doktrinare të përgjegjesisë civile nga njëra anë dhe institutit të shkaktimit të dëmit nga ana tjetër. Ndarja e përgjegjesisë juridiko-civile në varësi të shkakut nga lind, kategorizohet në *përgjegjësinë kontraktore* dhe *përgjegjësinë jashtëkontraktore*, evidentohet se është ndarje e përgjithshme, që haset në të dyja sistemet e së drejtës së civil law dhe common law. Problemi i klasifikimit të detyrimit të mbrojtjes nën përgjegjësinë kontraktore apo jashtëkontraktore ka rëndësi për mjetet juridike që vihen në dispozicion, mund të ndodh që e njëjta e drejtë të ketë mbrojtje nga të dyja sistemet, duke shkaktuar mbrojtje të dyfishtë. Aktualisht thelbi i përgjegjesisë jashtëkontraktore nuk ka natyrë ndëshkimore, por është i paracaktuar për të riparuar dëmin e shkaktuar. Me kalimin e viteve, teza e mbrojtjes jashtëkontraktore të marrëdhënieve të detyrimit është konfirmuar gradualisht e po shkon drejt konsolidimit. Qëllimi është që, nëpërmjet shpërblimit të bëhet e mundur që dëmi i pësuar nga pala e dëmtuar, qoftë ai i përhershëm dhe i pariparueshëm, qoftë një dëm i përkohshëm të jetë i kompesueshëm.

Një drejtim tjetër i zhvillimit të përgjegjesisë civile është manifestuar në rritje nga shuarja e dallimit midis përgjegjesisë për shkelje të detyrimeve dhe përgjegjesisë deliktore, e cila ka ardhur si pasojë e bashkëpunimit të doktrinës dhe jurisprudencës, të cilat ose kanë tendencën për të reduktuar tiparet dalluese të çdo lloj detyrimi ose janë frymëzuar nga dëshira për të vendosur në dispozicion të palës së dëmtuar instrumentet më të përshtatshëm. Përgjegjësia civile zë vend të parë në të gjithë kufijtë realë ose potencialë të së drejtës dhe rinovimi i tanishëm, aktualisht më pak i kalueshëm ose më pak i vrullshëm shkon drejt reduktimit të dallimit midis përgjegjesisë kontraktore me përgjegjësinë jashtëkontraktore.

PJESA E TRETË. Kapitulli i tretë, analizon sfondin historik të përgjegjesisë për dëmin ekzistencial në legjislacionin shqiptar. Në fillim trajtohet përgjegjësia juridiko-civile, që

rrjedh nga shkaktimi i dëmit sipas Kodit Civil të Zogut. Karakteristikë e këtij legjislacioni ishte se rregullimi i marrëdhënieve të detyrimeve ashtu si edhe pjesa më e madhe e dispozitave të kodit ishte e huazuar nga legjislacioni civil bashkëkohës italian dhe francez. Gjithashtu, ky kapitull trajton përgjegjësinë civile për dëmin sipas ligjit nr.2359, datë 15.11.1956 *“Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”* dhe në pjesën e fundit flet për parashikimet e Kodit Civil të vitit 1982 në lidhje me dëmin jopasuror.

Kapitulli i katërt, merr në analizë të thelluar trajtimin që Kodi Civil i vitit 1994 i ka bërë përgjegjësisë civile për dëmin ekzistencial duke nisur me zbatimin fillestar të nenit 608 të tij, kushtet që duhet të plotësojë një veprim apo mosveprim që të konsiderohet si shkak për lindjen e përgjegjësisë nga dëmi ekzistencial, që përfshin elementët e vlefshmërisë, të cilët paraqiten të detajuar në karakteristika.

Kapitulli i pestë, i kushtohet dëmit ekzistencial në dritën e doktrinës dhe vendimit unifikues nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në fillim jepet një përmbledhje e shkurtër mbi dëmin ekzistencial. Më pas jepet kuptimi i dëmit ekzistencial sipas doktrinës dhe V.U 12 dhe identifikimi i kategorive të dëmit jopasuror. Në vijim trajtohet interpretimi kushtetues i nenit 625 të K.C, sistemi i kompesimit të dyfishtë të përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe dëmi jopasuror si kategori e përgjithshme dhe unitare e ndarë në disa nënkategori vetëm për qëllime përshkruese si dhe interpretime në lidhje me ndryshimet e Kodit Civil dhe mosreflektimit të dëmit ekzistencial si figurë e posaçme e dëmit jopasuror brenda nenit 625 të K.C. Në një nga pikat në vazhdim, që përbën risi është analiza e anëve negative, që rëndojnë mbi dëmin ekzistencial dhe vërtetimi nëse kritikën qëndrojnë si dhe qëndrimet personale por, jo vetëm mbi autonominë e figurës së dëmit

ekzistencial. Kapitulli mbyllet me një trajtim teorik mbi shpërblimin e dëmit ekzistencial dhe format në të cilat ai realizohet.

PJESA E KATËRT. Kapitulli gjashtë, ka për objekt të tij një vështrim të legjislacionit tej kufijve, me anë të të cilit synohet, që të japë një kontribut në rrugën e harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me atë ndërkombëtar, konncretisht të Italisë, Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe ShBA. Evidentohet se në doktrinën e vendeve europiane, në teorinë e dyfishtë, të përqëndruar në vullnetin e palëve është vendosur përballë tezës individuale, e cila ka gjetur në ligj burimin e unitetit të dy përgjegjësive. Vërtetohet se mbi dëmin ekzistencial ka një përputhje themelore midis sistemit të common law dhe civil law, i cili konsiderohet si aspekt negativ i së drejtës mbi cilësinë e jetës, që nuk i referohet kuptimit fizik por, që i referohet mirëqënies psiko-fizike.

Në përfundim të punimit janë dhënë konkluzionet dhe rekomandimet mbi problematikën e trajtuar. Në të pasqyrohet gjendja aktuale e legjislacionit shqiptar lidhur me përgjegjësinë, që rrjedh nga dëmi ekzistencial, vakumin ligjor dhe pasojat që shkaktohen prej tij dhe si rrjedhojë domosdoshmëria për ndryshimin ligjor dhe reflektimin e figurës së dëmit ekzistencial në Kodin Civil si një figurë e posaçme dëmi.

Gjithashtu, në fund përfshihet edhe bibliografia, që është shfrytëzuar gjatë hartimit të këtij studimi, e cila paraqitet e strukturuar sipas llojit të burimit të referuar e renditur sipas një rregulli alfabetik.

1.5 KUFIZIMET DHE VËSHTIRËSITË E PUNIMIT

Për shkak të natyrës së punimit, kërkimi për realizimin e tij është zhvilluar në tre drejtime: në analizën e doktrinës së brendshme e ndërkombëtare, në interpretimin e legjislacionit

shqiptar dhe të huaj si dhe në vëzhgimin e jurisprudencës. Duke i marrë në shqyrtimin secilin prej këtyre drejtimeve vërejmë se kërkimi është saktësisht i orientuar, ndërsa fokusi mbi çështjen kryesore të tij është i gjerë, por që është shoqëruar nga disa kufizime. Nisur nga fakti se koncepti i dëmit ekzistencial është relativisht i ri, gjatë gjithë studimit të tij jam shoqëruar nga “mungesat” e burimeve të cilat e kanë vështirësuar punën gjatë këtij kërkimi, më poshtë po rendis disa prej tyre:

Së pari, në Shqipëri studimet në këtë fushë janë të pakta, por edhe ato që ekzistojnë nuk përbëjnë studime të thella dhe të mirfillta shkencore, duke bërë që gjatë kohës së hartimit të këtij punimi të shkel në terrene të paprekura më parë. Në këtë mënyrë, ky punim i hap rrugën punimeve të tjera në të ardhmen për të plotësuar gjithmonë edhe më shumë kuadrin doktrinor mbi këtë figurë të posaçme dëmi.

Së dyti, një tjetër kufizim përbën fakti që, punimi është fokusuar vetëm në rastin e dëmit ekzistencial, pavarësisht se në ligj dhe në jurisprudencë kjo figurë nuk shihet e ndarë nga dy figurat e tjera të dëmit jopasuror dëmit moral dhe biologjik, po të marrim në konsideratë interpretimin e nenit 625 të K.C, të bërë nga Gjykata e Lartë në V.U 12.

Së treti, jurisprudenca shqiptare pas vitit 2007, pas daljes së V.U 12 është tërësisht e orientuar për të trajtuar vetëm rastet e dëmit ekzistencial, që shkaktohet në rastin e aksidenteve rrugore. Duke i qëndruar modelit të përcjellë nëpërmjet vendimit unifikues të lartpërmendur, bëhet e vështirë në aspektin studimor analiza e karakterit të gjerë e shumëpërfshirës të këtij dëmi.

Edhe pse ky studim ka në fokus analizën e legjislacionit shqiptar në lidhje me figurën e dëmit ekzistencial, me qëllimin që studimi të jetë sa më i plotë, ai përbën një analizë të shtrirë në disa drejtime dhe kontekste argumentuese.

KAPITULLI II:
VËSHTRIM DOKTRINAR MBI PËRGJEGJËSINË CIVILE
DHE
INSTITUTIN E SHKAKTIMIT TË DËMIT

Shkaktimi i dëmit dhe detyrimi që rrjedh prej tij për shpërblim përbën një burim të rëndësishëm të krijimit të detyrimit, përveç kontratës. Nëse, në rastin e kontratës detyrimi lind për shkak të përputhjes së ndërsjelltë të vullneteve të palëve kontraktuese, në rastin e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit detyrimi krijohet në bazë të vet faktit se një person ka shkaktuar një dëm ndaj një personi tjetër, ku ky i fundit ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin përkatës. Detyrimi për shpërblimin e dëmit passjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile, qëllimi i së cilës është mbrojtja e subjektit dhe pasurisë së tij nga pasojat që vijnë prej veprimeve të paligjishme dhe të dëmshme, të personave që kryejnë një veprim të tillë (Nuni, A., 2012: 94-95).

Përgjegjësia nënkupton se një subjekt duhet të jetë përgjegjës në planin njerëzor, moral, ose juridik për fakte, veprime apo ngjarje të kryera nga ai vet ose që është pjesmarrës në to dhe t'i përgjigjet pasojave që rrjedhin prej tyre. Instituti juridik i përgjegjësisë civile vendos rregullat për të disiplinuar rrethanat në të cilat dikush ka shkaktuar një dëm dhe dikush tjetër është i detyruar ta riparojë atë si në rastin e një detyrimi që rrjedh nga shkaktimi i dëmit ashtu edhe për rastet e përgjegjësisë që rrjedh nga mospërmbushja ose shkelja e detyrimeve.

E drejta civile shqiptare i përket familjes së civil law (Roman law), që si karakteristë kryesore të saj ka mbështetjen në rregulla të shkruara dhe që në lidhje me përgjegjësinë që

rrjedh nga shkaktimi i dëmit këto norma konkretizohen në Kodin Civil, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1994.

Në Kodin Civil shqiptar përgjegjësia për shkaktimin e dëmit rregullohet nga nenet 608-647/a, përgjegjësia, që rrjedh emërtohet si përgjegjësi jashtëkontraktore ose nga shkaktimi i dëmit ose akuiliane. Thelbësore për të gjithë sistemin e përgjegjësisë nga fakti i paligjshëm është klasuzola e përgjithshme e nenit 608 të K.C, sipas së cilës *“cildo që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin apo pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar”*. Klauzola e përgjithshme është një teknikë ligjore jo e plotë, që i lë në çmuarje gjykatës identifikimin dhe vlerësimin e të drejtës që është e denjë për të pasur një mbrojtje juridike, në varësi të rastit konkret të paraqitur (Cassano, G.,2012:4).

2.1 REFLEKTIME TEORIKE MBI KUPTIMIN E PËRGJITHSHËM TË PËRGJEGJËSISË CIVILE

Instituti juridik i përgjegjësisë civile përfaqëson thelbin e sistemit të së drejtës civile dhe për më tepër të shtetit të së drejtës, për sa kohë lidh sjelljen njerëzore me ndëshkimin, duke e bërë efikase normën e vendosur nga sistemi juridik, si në formë të drejtëpërdrejtë (lejon palën e dëmtuar të shpërblehet për dëme të padrejta dhe/ose të paligjshme) ashtu dhe në formë jo të drejtëpërdrejtë (që rrjedhin nga funksioni parandalues i ndëshkimit që nxit qytetarët të mos shkaktojnë dëme me qëllim që të evitojnë të qenët të detyruar për t'i shpërblyer ato, ndonjëherë edhe në masë më të madhe se sa është dëmi real, prej ku përcaktohet norma e dëmshpërblimit) (Viola,L., 2006: 17). Përgjegjësia civile është një pozicion juridik i paracaktuar për të justifikuar shpërblimin e dëmit (neni 421 i K.C). Përgjegjësia juridiko civile lejon një lidhje me çdo normë të Kodit Civil dhe përfaqëson

përmbledhje zbatuese të sjelljes njerëzore: nëse një normë shkelet, autori i shkeljes është përgjegjës për të, me detyrimin ligjor për të shpërblyer dëmin e shkaktuar (ose presupozohen *iuris* dhe *de jure*, si në hipotezën e dëmeve të *re ipsa*).

Fjala përgjegjësi rrjedh nga fjala latine *respondere* (Maiorka, 1990:11), që konceptohet si ‘*lëvizje drejt foljes besoj*’, e cila tregon krijimin e një ekuilibri, të një rregulli të karakterizuar nga një solemnitet i caktuar i foljes besoj.

Origjina e fjalës përgjegjësi duhet të kërkohet në formulat e shenjta të të drejtës romake të pandara nga stipulimi² (Mandro, 2004:250). Ky institut është karakterizuar nga shkëmbimi verbal i formulave ‘*spondesne spondeo*’ (Padelletti, 2003: 364), të cilat përcaktonin lindjen e detyrimit për subjektin e pyetur.

Juristët antik me fjalën *respondere* nënkuptonin të tregonin reagimin ndaj një urdhri ose një rregulli të shkelur (Franzoni, 2010:5). Kjo folje jep idenë e një përgjigjeje që lidhet me dëmshpërblimin, por edhe në përgjigje duhet të përmbahet karakteri i solemnitetit, i ritualit, që jepet në kuptimin antik të *sponsio* (Majorka, 1990: 13).

Në gjuhën e zakonshme termi përgjegjësi pasqyrohet në detyrimet e secilit partner për të përcaktuar sjelljen e tyre në përputhje me rregullat dhe porositë. Duke lënë mënjane këtë këndvështrim të parë të shkeljes së rregullave të sjelljes dhe konsiderohet sjellja e subjektit të vetëm përballë rrezikut të ndodhjes së ngjarjes (Pellegrini, 1939: 438).

Detyrimi për t’ju përgjigjur pasojave të sjelljeve të veta (që është kuptimi konkret i përgjegjësisë) e bën përgjegjësinë rrugën për t’u ndjekur dhe për të orientuar sjelljen (Sicchiero, 2011: 439). Kur thuhet zakonisht se një person është përgjegjës i referohemi

² Cedimi që të kishte fuqi duhej të lidhej me pëlqimin e kreditorit. Si formë për të dyja cedimet shërbente stipulimi (marrëveshja), që shkarkonte debitorin nga detyrimi ndaj kreditorit të vjetër ose cedonte detyrimin e debitorit të vjetër debitorit të ri.

kushteve për të cilat secili paraprakisht duhet të masë veprimet e tij në lidhje me pasojat që mund ta shoqërojnë atë (Sicchiero, 2011: 439).

Për këtë arsye, përgjegjësia përfaqëson lirinë për të vepruar, si një kusht thelbësor sepse në mungesë të lirisë së të vepruarit njeriu kalon në arbitraritet (Scognamiglio, 1957: 633) .

Pranë këtij kuptimi të zakonshëm të përgjegjësisë vendoset një kuptim më tipik. Bëhet fjalë për përgjegjësinë të kuptuar si *''duhet të përgjigjesh përpara çdo personi, për një shkelje të mëparshme, të tashme apo të mundshme për të ndodhur, të kryer me faj, ndaj çdo lloj norme duke iu nënshtruar sanksioneve të paracaktuara''*.

Përgjegjësia mund të ketë përmbajtje dhe kuptime të ndryshme në varësi të rregullave dhe ligjeve që merren në konsideratë. Nëse shkelet një normë morale ose fetare do të ketë një përgjegjësi përpara Zotit ose të dërguarve të tij në tokë ose përballë opinionit publik (Sicchiero, 2011: 439). Përgjegjësia që rrjedh nga shkelja e një norme morale përbën rastin më të ndjeshëm të një shkeljeje.

Në fushën morale veprimet vlerësohen mbi bazën e ndërgjegjes së përgjithshme dhe rregullat janë shprehje e kategorive urdhëruese, që detyrojnë zbatimin e tyre në çdo lloj situatë.

Në këtë kuptim është me rëndësi të theksohet si në planin juridik ashtu edhe në atë social se ekzistenca e normës prezupozon mundësinë për ta shkelur atë (Bagolini, 1958: 596). Në bazat e ligjit dhe të ndëshkimit është e njohur kjo mundësi. Në hipotezat në të cilat kjo nuk pranohet humbet kuptimin e një norme juridike (Bagolini, 1958: 596).

Liria e zgjedhjes midis të respektuarit ose jo të normës përkatëse, në fakt është një supozim i funksionimit të sistemit juridik. Funksionimi i normave juridike dhe etiko-sociale

supozon lirinë e zgjedhjes së individit që nuk mund të përkufizohet si kufizim i pastër (Bagolini, 1958:596). Liria e zgjedhjes nuk mund të vlerësohet në nivelin shkencor dhe teorik mbi raportin shkak-pasojë (Bagolini, 1958:596).

Duke ndjekur këtë linjë hapet një diskutim filozofik mbi përgjegjësinë, që e shikon atë si ‘*dogma apriore*’ norma-urdhër, shkelja e së cilës ngarkon me përgjegjësi subjektin që e kryen (Majorka, 1990:22).

Në një kuptim të përgjithshëm përgjegjësia civile nënkategorizohet në dy grupe apo figura të mëdha: në përgjegjësinë kontraktore dhe në përgjegjësinë jashtëkontraktore.

Kategoria e parë nënkupton përgjegjësinë që lind nga çdo lloj shkeljeje e parashikimeve të normave të një kontrate sipas nenit 476 të KC’94 ku thuhet ‘*Çdo mangësi në ekzekutimin e detyrimeve e detyron debitorin të shpërblejë dëmin që ka pësuar debitori, përveç kur ai provon se mospërmbytja nuk ka ndodhur për shkak të tij*’. Ndërsa, përgjegjësia jashtëkontraktore ose siç njihet ndryshe përgjegjësia nga shkaktimi i dëmit (neni 608 i K.C) lind nga shkelja e një parimi të përgjithshëm që i ndalon subjektit t’i shkaktojë dëme personave të tretë apo pasurisë së tyre; K.C parashikon se personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkakton tjetrit një dëm në personin apo pasurinë e tij detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar, ky ndryshe njihet si parimi ‘*neminem laedere*’³, në bazë të të cilit çdo subjekt është i lirë të kryejë çdo veprim (në bazë të së drejtës kushtetuese mbi lirinë e veprimit- *favor libertatis*) në masën që nuk i shkakton dëme (të padrejta) palëve të treta (Alpa, 2010: 220).

Nëse një person nuk i përmbahet një kontrate (ose në mënyrë më të përgjithshme, një detyrimi të përgjithshëm) do të ketë përgjegjësi kontraktore, ndërsa nëse nuk i përmbahet

³ Ose thënë më saktë *alterum non laedere* përbën në vetvete një përshkrim të përgjithshëm të klasuzolës së nenit 608 të K.C që ka të bëjë me një rregull sjelljeje më shumë se sa me një parim që mbart një dënim

një parimi të përgjithshëm të sjelljes së mirë ose abuzon me të drejtën për të cilën është përgjegjës do të jetë përgjegjës për përgjegjësinë jashtëkontraktore; thuhet se shkelja e një detyrimi nënkupton përgjegjësi jashtëkontraktore, ndërsa shkelja e një detyre që rrjedh nga ligji ose nga zakonet e mira ka të bëjë me përgjegjësinë nga fakti i paligjshëm ose përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit: në rastin e parë detyrimi lind si pasojë e vullnetit të palëve për të qenë në një marrëdhënie, përkundrazi në rastin e dytë, detyrimi (për dëmshpërblim) e ka origjinën ose burimin nga ligji (neni 420 K.C). Ky konceptim në vitet e fundit i është nënshtruar shqyrtimeve kritike. Veçanërisht, vëmendja kritike është përqëndruar mbi konceptin e mbrojtjes së detyrueshme: ka detyrime që rrjedhin nga ligji, por që zëvendësohen nga përgjegjësia kontraktore dhe jashtëkontraktore bazuar në burimin e detyrimit (Mazzola, 2007: 17).

Thënë më qartë ka disa detyrime plotësuese të kontratës që rrjedhin nga ligji si ato të lidhura me mirëbesimin dhe korrektësinë në funksion të zbatimit të kontratës, që përkthehen në detyrim për informacion të plotë dhe të saktë si edhe në mbrojtje të pozicionit juridik të kontraktorit tjetër (si p.sh në rastin e kontratës së transportit, ku sigurimi i personit, edhe pse jo nuk është objekt direkt i zbatimit të kontratës, megjithatë detyron debitorin ta mbrojë); këto detyrime e kanë bazën e tyre në ligj, por megjithatë , do të ndikojë në strukturën komplekse të kontratës. Pra, nëse besohet se ka detyrime të ndryshme që rrjedhin nga ligji dhe nuk janë objekt i një kontrate dhe që bëjnë pjesë në lidhjen reciproke kontraktuale⁴, atëherë nuk është më e mundur, që përgjegjësia kontraktore të krijohet mbi objektin e kontratës, sepse ka norma të ligjit që nuk janë objekt i kontratës

⁴ **Synallagma kontraktore**- nga greqishtja synallatto ose synallagma, njohur ndryshe edhe si lidhje reciproke është një element thelbësor i nënkuptuar i kontratës dhe detyrimeve përkatëse, në të cilën secila palë merr përsipër kryerjen e një detyrimi, për të dhënë ose marrë, në favor të palës tjetër siç edhe pala tjetër reciprokisht merr përsipër me vullnet të lirë të kryejë një shërbim në favor të saj

dhe përfshihen në mekanizmin shkakësor duke justifikuar një përgjegjësi kontraktore eventuale ose për shkak mospërbushje (Golecki, 2013 :250).

Në terma të tjerë ekzistojnë disa detyrime specifike që rrjedhin nga ligji dhe integrohen në kontratë, duke u ligjëruar si pjesë *unicum* (e pandashme) e detyrimeve shprehimisht të vendosura nga palët (si pjesë e lirisë kontraktore) dhe të detyrimeve që rrjedhin nga ligji, këto të fundit bëhen pjesë integrale e kontratës, me pasojën që çdo shkelje e tyre shkakton detyrimin për shpërbtim kontraktor dhe jashtëkontraktor.

Ky përfundim identifikon një koncept të rëndësishëm *vulnus*⁵ (plagë nga latinishtja) të termit klasik të përgjegjësisë kontraktore, që arrihet në përfundimin që detyrimet jashtë kontratës i japin jetë përgjegjësisë kontraktuale, për këtë bëhej fjalë më lart kur shpjegonim se ka përgjegjësi edhe kur një detyrim nuk është i parashikuar shprehimisht në kontratë; kategoria e detyrimeve të mbrojtjes, përgjithësisht, si në rastin e detyrimeve jashtë kontratës, evidentojnë qartësisht që bëhet gjithmonë e më e pamundur të identifikohet dallimi midis dy llojeve të përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore sepse ekzistojnë detyrime të përgjithshme që nuk bazohen në një kontratë, që megjithatë shkaktojnë përgjegjësi kontraktore (Viola, 2009: 4). Përgjegjësia kontraktore, nuk është e tillë vetëm sepse bazohet mbi një detyrim kontraktual por, është e tillë sepse i referohet një raporti që ekziston midis palëve që kanë hyrë në një ‘marrëdhënie të posaçme vullneti’.

Në lidhje me sa u shpjegua më lart i përmbledhim me arsyetimin : nuk ka sistem pa rregulla, nuk ka rregulla nëse nuk ka shkelje të tyre, nëse nuk ka shkelje nuk ka rregulla dhe pa rregulla nuk ka sisteme (Majorka, 1990:22).

⁵ Përkthimi nga latinishtja është plagë dhe i referohet cënimit ose shkeljes së detyrimeve kontraktore

Sipas një teorie tjetër, përgjegjësia civile do të thotë nënshtrim i pasurisë së një personi ndaj pretendimit të një tjetri (Franzoni,2010:6). Ekziston një lidhje e drejtëpërdrejtë midis përgjegjësisë, e cila duhet kuptuar si një fakt që rrjedh nga detyrimet dhe pasojave mbi pasurinë e një subjekti të veçantë (Franzoni,2010:6).

Këtij kuptimi të përgjegjësisë i refrohet legjislatori në rastin e nenit 608 të Kodit Civil në fuqi për veprimet/mosveprimet e kundraligjshme ashtu edhe në rastin e përgjegjësisë nga mospërbushja e detyrimeve.

Në të dyja teoritë ka gjithmonë një subjekt të detyruar për shpërblimin e dëmit, ajo që ndryshon është dyshimi mbi përgjegjësinë. Në mënyrë të veçantë, në rastin e parë verifikohet ekzistenca e ardhjes së pasojave nga dëmi, që përkon me rritjen e përgjegjësisë dhe në rastin e dytë, përgjegjësia është pasojë e mospërbushjes së detyrimit (Franzoni,2010:6).

Lidhja që ekziston midis përgjegjësisë dhe pasurisë mund të mendohet si analogji midis përgjegjësisë civile dhe përgjegjësisë pasurore të parashikuar nga neni 419 e vijues i Kodit Civil aktual. Përgjegjësia pasurore, në fakt, duket si një situatë krejtësisht e pavarur në raport me të drejtën e detyrimeve prej së cilës ka origjinën. Kjo nuk është një fazë e nevojshme dhe aktuale e detyrimeve. Ndërsa, në rastin e përmendur në nenin 419 e vijues të K.C përgjegjësia është thelbësore dhe identifikohet mbi dy cilësime: në identifikimin e personit përgjegjës dhe në bërjen efektive të saj (Franzoni,2010:6). Ndryshimi midis dy formave të përgjegjësisë konsiston në faktin që mund të ekzistojnë të dyja nën të njëjtën çështje. Në fakt, dallimi më specifik ka të bëjë me funksionin. Përgjegjësia civile është një teknikë për t'i ngarkuar një subjekti përgjegjësinë për një dëm kur ekziston fajësia dhe lidhja shkakësore. Përkundër kësaj, përgjegjësia pasurore ka si qëllim të kënaq kreditorin.

Shpërblimi i dëmit, vendoset në një raport shkak-pasojë, e cila sipas përgjegjësisë civile duhet të jetë qartësisht e ndarë. Në fakt me anë të kompesimit bëhet e mundur identifikimi i shkallës së dëmit të pësuar nga ana e palës së dëmtuar dhe individualizimi i procedurës së ndjekur për riparimin e tij.

Përgjithësisht, reflektimi mbi përgjegjësinë diskutohet mbi dy plane, përgjegjësia civile si një detyrim dhe përgjegjësia si një kosto. Kjo ndarje në teorinë e së drejtës ka vendosur përgjegjësinë në një diskutim kualifikimi midis teorive morale të ligjit dhe teorive ekonomike të ligjit. Të dyja teoritë si ajo e detyrimit dhe ajo e kostove tregojnë mënyrën se si përgjegjësia lidh paditësin me të paditurin me njëri-tjetrin duke zbehur rolin e përgjegjësisë civile në sistemin e politikës liberale. Nën këtë kuptim del një diskutim tjetër që e klasifikon përgjegjësinë civile si një lloj e mete drejt sulmit personal (Fortino, 2009: 22). Pa dyshim, përgjegjësia civile ngushton mjaftueshëm hapësirën e të dyjave, dobësinë e mbrojtjes së të paditurit dhe linjat e sulmit të paditësit. Paditësi nuk mund të fajësojë të paditurin deri në shpalljen e fajësisë së këtij të fundit nga ana e gjykatës si përgjegjës për rastin në fjalë.

2.1.1 Funksionet e përgjegjësisë civile

Në kulturën e vjetër dhe në traditën juridike shprehja përgjegjësi civile ka sjellë idenë e fajit: parimi tradicional ishte i lidhur ngushtë me idenë se nuk mund të ketë përgjegjësi pa pasur faj. Por, kjo kishte të bënte me një këndvështrim të gabuar, që në doktrinën aktuale është korrigjuar, e cila synon të shpjegojë se qëllimi i përgjegjësisë civile është i ndryshëm nga ai penal, ka natyrë riparuese dhe jo ndëshkuese dhe jo domosdoshmërisht dhe jo gjithmonë është i lidhur me antivlerat dhe dënueshmërinë e

sjelljes. Prirja duhet të jetë për të zhvendosur theksin nga padrejtësia e sjelljes në padrejtësinë e dëmit (Bocchini, 2006:3,5).

Jo çdo veprim i paligjshëm përbën raste që shkaktojnë përgjegjësi civile. Në fakt, elementi i saj kryesor është jo vetëm veprimi i kundraligjshëm (contra jus), por edhe shkaktimi i dëmit ndaj të tjerëve dhe përgjegjësia civile shqetësohet që ky dëm të shpërblehet. Përgjegjësia, në bazë të së drejtës civile ndahet në përgjegjësi kontraktore dhe jashtëkontraktore. Ndarja, fillimisht e qartë, shfaqet sot e paqartë, në fakt siç do të shohim ligji aktual nuk e konsideron të nevojshme që të lidhë ekzistencën e përgjegjësisë kontraktore me ekzistencën e një kontrate në kuptimin e ngushtë të saj, në kuptimin e gjerë jepet në K.C' 94, kontratat faktike dhe më tepër domethënëse në përgjegjësinë nga 'kontakti social' (si p.sh në fushën mjekësore). Pasojë e kësaj premise është paqartësia e vijës ndarëse midis përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore (Labonia, 2006: 4).

Përgjegjësia kontraktore bie mbi subjektin sa herë që ai kryen shkelje të një detyrimi të veçantë të marrë paraprakisht dhe vullnetarisht ndaj një subjekti tjetër duke shkaktuar shkeljen e një të drejte relative. Shkelja e kontratës ose mospërmbushja e saj, në fakt ndodh kur shkelja i referohet një marrëdhënieje të mëparshme detyrimi çfarëdo qoftë burimi këtij detyrimi.

Përgjegjësia jashtëkontraktore konsiston në një sjellje njerëzore (në formën e veprimit ose mosveprimit) të paligjshme që i shkakton një të treti një dëm të padrejtë duke vendosur në një marrëdhënie të caktuar juridike dëmtuesin dhe palën e dëmtuar, kjo rrjedh nga shkelja e një detyrimi të përgjithshëm *neminem laedere* (për të mos i shkaktuar dëm të tjerëve), e cila rezulton në shkeljen e një të drejte absolute të mbrojtur nga ligji (Alpa, 2009: 218). Prandaj bashkë me dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja e detyrimit (K.C

dëmi kontraktor) ligji merr në konsideratë edhe dëmin e shkaktuar nga një veprim i paligjshëm i njohur ndryshe si dëmi jashtëkontraktor.

Sistemi i përgjegjësisë civile është i bazuar në një shumëllojshmëri nevojash:

- a) Ndëshkuese, ndaj sjelljeve të personave për ato që quhen sjellje të dëmshme;
- b) Parandaluese ndaj përsëritjes së fakteve të caktuara. Detyrimi për të shpërbyer dëmin, në fakt, luan indirekt funksionin, që nxit subjektin që kryen veprimin për të marrë masat e nevojshme për ta shmangur atë;
- c) Riparimin e dëmeve nga subjekti që e ka shkaktuar atë;
- d) Ndarjen përpjestimore të përgjegjësisë midis shkaktuesve të dëmit.

Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme që kanë mbajtur civilistë, që i përkasin sistemeve të ndryshme të së drejtës, mbi çështjen se cili prej funksioneve duhet të konsiderohet si më i rëndësishmi mes tyre, vlen për t'u theksuar se përgjegjësia civile ka si funksion kryesor përmbushjen e të gjitha funksioneve të listuara më lart (Bacache-Gibeili, 2012: 46).

2.1.2 Teoritë mbi përgjegjësinë civile

Neni 640 i KC'94 parashtroi një parim bazë, sipas të cilit përgjegjësi përgjigjet për një dëm të padrejtë kur ky është kryer me faj ose me mashtrim. Në pamje të parë duket se në sistemin tonë juridik kriteri i përgjithshëm i përgjegjësisë është faji. Në kod, por edhe në ligje të tjera që i përkasin kësaj fushe janë parashikuar figura të veçanta të përgjegjësisë, në të cilat dëmtuesi përgjigjet pa faj (ku kemi të bëjmë me përgjegjësinë objektive) ose në kushte më të rënda se sa ato normale.

Ndonjëherë përgjigjet për çdo gjë, si për dëmet nga veprimtari bërthamore, ashtu edhe për dëme të shkaktuara nga rastet fatore, kur nuk e provon këtë ose përgjigjet nëse nuk

provon se nuk ka mundur të parandalojë dëmin ose të shmang ardhjen e tij (Hetemi, 1998:78).

Pyetja që parashtron doktrina dhe që do të përqipemi t'i japim një përgjigje në paragrafët e ardhshëm, është: rregulli i përgjithshëm i sistemit juridik është ende ai i fajit (dhe hipotezat që e përjashtojnë atë përbëjnë përjashtim nga rregulli) ? Dhe nëse rregulli nuk është faji, cila është baza e përgjegjësisë? Dhe për më tepër, kjo bazë është e njëjtë për të gjitha rastet e përgjegjësisë apo ekzistojnë kritere të përgjegjësisë në varësi të llojeve të tyre?

Problemi është me rëndësi të madhe për të kuptuar të gjitha çështjet e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit, veçanërisht në varësi të tezës së pranuar që kanë pasoja të ndryshme sipas dy problemeve bazë:

- Kuptimit të nocionit të përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit;
- Zbatimi për analogji (ose moszbatimi) i normave për përgjegjësinë objektive dhe për rastet e përgjegjësisë që nuk parashikohen shprehimisht nga Kodi (Alpa, 2009: 138).

2.2 IDENTIFIKIMI I PËRGJEGJËSISË JASHTËKONTRAKTORE NË DOKTRINËN E SË DREJTËS SË DETYRIMEVE

Përgjegjësia jashtëkontraktore konsiston në një sjellje njerëzore të paligjshme që shkakton një dëm të padrejtë ndaj një të treti, ajo vijon me shkeljen e një detyrimi të përgjithshëm *neminem laedere* (Basso, 2015: 14).

Rastet e diktura me objekt përgjegjësinë civile bëjnë të mundur që nëpërmjet dëshmisë së fakteve dhe supozimeve konkrete një sjellje ta klasifikojnë si ligjshme ose të paligjshme. Klasifikimi i saktë i natyrës juridike të sjelljes njerëzore si burim i përgjegjësisë është

rezultat i një vlerësimi *ad hoc*, që kryhet rast pas rasti. Veprimi i paligjshëm dhe dëmi zbulojnë juridikisht dhe janë civilisht të sanksionuar me detyrimin për dëmshpërblim, në përputhje me profilet formale proceduriale të legjitimitetit (Basso, 2015: 11).

Përgjegjësia jashtëkontraktore e emërtuar ndryshe si përgjegjësia ‘akuiliane’ (nga emri i ligjit të parë që rregullonte përgjegjësinë deliktore) konsiston në një sjellje të paligjshme që rezulton në shkaktimin e një dëmi të padrejtë një pale të tretë, kjo vjen si pasojë e shkeljes së një detyrimi të përgjithshëm siç është *neminem laedere* (pra detyrimi për të mos u shkaktuar të tjerëve dëme) (Bianca, 1994: 69).

Norma juridike kryesore që duhet t’i referohemi është neni 608 i K.C, në bazë të të cilit ‘*Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin apo pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar*’. Duke pasur parasysh kuptimin e përgjithshëm të shprehjes ‘i shkakton tjetrit një dëm në personin apo pasurinë e tij’, dispozita e cituar është konsideruar nga doktrina si një klauzolë e përgjithshme e rendit juridik e realizuar nëpërmjet Kodit Civil në formën atipike të marrëdhënieve të detyrimit (Gjata, 2010: 24). Autoriteti i posaçëm që do të vendosë, duke marrë parasysh evoluimin e shoqërisë me ndryshimin e shkallëve të vlerave dhe kërkesave, nëse, një sjellje e dhënë mund të konsiderohet e dëmshme apo jo në bazë të rregullave të bashkëjetesës paqësore, duke verifikuar ekzistencën e të gjithë elementëve përbërës të përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit të individualizuar është neni 608 i K.C. Është karakteristike e çdo kërkesë ligjore që gjykatat të llogarisin shumën e duhur siç parashikohet edhe në nenin 625 të K.C, që legjitimon personin që ka pësuar dëm në shëndetin, integritetin fizik ose psikik të tij, është cënuar në nderin, personalitetin ose reputacionin e tij, është cënuar e drejta e emrit apo

është fyer kujtimi i një të vdekuri të kërkojë kompesimin e pasojave negative, duke përfshirë dëmin jopasuror, e drejtë e cila është e patrashëgueshme (Semini, 2003: 3).

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit klasifikohet në përgjegjësinë civile sepse *së pari*, shkakton përgjegjësi për një të drejtë apo interes juridikisht të mbrojtur dhe *së dyti*, civile sepse ndryshon nga përgjegjësia penale, e para i përket atij që ka kryer një akt të paligjshëm që e detyron të dëmshpërblejë palën, ndërsa e dyta i përket atij që ka kryer një dëm të parashikuar nga Kodi Penal si krim (janë dy përgjegjësi të ndryshme por nuk përjashtojnë njëra-tjetrën) (Galgano 2006:419). Ajo është jashtëkontraktore për t'u dalluar nga përgjegjësia kontraktore, nuk ka një detyrim paraprak, e drejta për t'u dëmshpërblyer bazohet në shkaktimin e dëmit të padrejtë (Alpa, 2003:189). Përgjegjësia civile rregullon pasojat që lindin nga shkaktimi i një dëmi të padrejtë i shkaktuar nga një veprim i paligjshëm ose rastet e përgjegjësisë për shkak të ligjit (Franzoni, 2010: 7).

Në të kaluarën, në sistemin tonë juridik përgjegjësia akuiliane ishte ngushtësisht e lidhur me personin, i cili përmes sjelljes personale, e karakterizuar nga një shkallë më e madhe ose më e vogël faji, ka shkaktuar shkelje të të drejtave juridike të të tjerëve. Në këtë kuptim ekziston një ngjashmëri e qartë midis parimeve personale karakteristike të së drejtës penale dhe institutit të shkaktimit të dëmit për të ndëshkuar dhe shtypur sjelljen e dëmtuesit (Sallabanda, 1962: 172).

Thelbi i përgjegjësisë jashtëkontraktore sot ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme (Castronovo, 2006:3). Qëllimi final në fakt nuk ka natyrë ndëshkimore, por është i paracaktuar për të riparuar dëmin e shkaktuar në përputhje me detyrat e solidaritetit të vendosur nga Kushtetuta: subjekti që është dëmtuar duhet të rifitojë të

drejtat që gëzonte përpara se të ndodhte dëmtimi, duke marrë në konsideratë dëmin e pësuar, pas një vlerësimi të drejtë të këtij të fundit.(Basso, 2015: 16)

Parë në këndvështrimin riparues, legjislatori ka ofruar pranë traditës, përgjegjësinë e krijuar mbi bazën e fajit (neni 608 K.C) figura të tjera janë karakterizuar nga e njëjta fushë e mbrojtjes së palës së dëmtuar me qëllim realizimin e bashkëjetesës paqësore. Siç do të shohim në vijim, sistemi ligjor aktual nga njëra anë ka parashikuar përgjegjësinë indirekte (ose për faj të tjetrit) për çdo herë që një individ do të kompesojë (qoftë edhe i vetëm) edhe pse nuk e ka konsumuar personalisht veprimin e kundraligjshëm dhe nga ana tjetër përgjegjësinë objektive atëherë kur individ i është detyruar të kompesojë dëmin pa qenë i fajshëm.

Përgjegjësia jashtëkontraktore zhvillohet më shpejt se ajo kontraktore sepse kjo ndihmohet nga formulimi fleksibël i nenit 608 të K.C, (Gjata 2010: 20) së paku praktika gjyqësore e njeh tashmë si ‘klauzolë të përgjithshme’, ndërsa doktrina është e ndarë mes atyre që janë të dyshimtë më pak ndaj ndryshueshmërisë, që e klasifikojnë si ‘normë të përgjithshme’, me një nomenklaturë ndryshe që korrespondon me konceptin e dëmshpërblimit të dëmit thjesht pasuror sipas K.C (Castronovo, 2006: 12). Megjithatë zgjerimi i përgjegjësisë akuiliane është shoqëruar me një hezitim të vazhdueshëm në funksionet e tij dhe kjo prodhon një lloj krize të institutit (Cendon, 2009:274).

Por edhe përgjegjësia kontraktore ka përfshirë hapësira të reja sepse kërkesa për shkelje të një detyrimi paraprak është shpesh i kënaqur me teorinë mbi strukturën komplekse të detyrimit dhe më së fundi mbi ‘detyrimin pa sigurim’ (Gjata 2010: 23).

2.3 EVOLUCIONI I RRUGËS JASHTËKONTRAKTORE: INTOLERANCAT NË DREJTIM TË ZBATIMIT TË NENIT 608 TË K.C'94 DHE APLIKIMI I RREGULLAVE TË TJERA NË FUSHËN E DËMIT

Në Kodin Civil objektivizmi për fushat e referencës të kriterit të fajit nuk i përket vetëm temës së dëmit ekzistencial por, është karakteristikë për një listë rastesh në përgjegjësinë civile. Në analizë të dispozitës së përgjithshme të K.C mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore përmbledhen në mënyrë përgjithësuese problematikat që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit (Nuni 2012: 107). Përgjegjësia jashtëkontraktore synon që të mbrojtë personin ose pasurinë e tij në rastet kur u shkaktohet një dëm dhe nëpërmjet shpërblimit synohet të ruhet e njëjta *status quo*, që ai gëzonte përpara se dëmi të shkaktohej. Në fakt, ky nuk është funksioni i vetëm dhe kryesor i përgjegjësisë akuiliane, i njëjti funksion përmbushet edhe nga përgjegjësia kontraktore, por duke përdorur metoda të ndryshme (Triolo, 2015: 9). Kalimi në një formë tjetër të përgjegjësisë ndikohet nga kriteret e ndryshme të përdorura për të dalluar përgjegjësinë nga shkaktimi i dëmit me përgjegjësinë nga mospërmbushja e një detyrimi. Duke shqyrtuar teoritë e zhvilluara më parë dhe ato që zbatohen sot, vëmë re që përgjegjësia merr një karakter përcaktues nisur nga të drejtat që mbrohen (Alpa,2010:19). Në rastin e të drejtave absolute riparimi mbështetet në veprimin e së drejtës jashtëkontraktore, ndërsa në rastin e të drejtave relative mbështetja është mbi përgjegjësinë e debitorit (Alexy,2012:8). Ky kriter zbatohet deri në hyrjen në fuqi të nenit 608 të K.C, i cili lidhet me shkeljen e të drejtave subjektive absolute.

Me kalimin e viteve, teza e mbrojtjes jashtëkontraktore të marrëdhënieve të detyrimit është konfirmuar gradualisht e po shkon drejt konsolidimit. Qëllimi është që nëpërmjet shpërblimit të bëhet e mundur që dëmi i pësuar nga pala e dëmtuar, qoftë ai i përhershëm

dhe i pariparueshëm, qoftë një dëm i përkohshëm të jetë i kompesueshëm (Bocchini Luigi, 1961:493). Doktrina është e unifikuar në qëndrimin se veprimi i kundraligjshëm që ka shkaktuar shkeljen e një të drejte subjektive nuk përjashton lindjen e përgjegjësisë edhe për raste kur fakti i paligjshëm rezulton me një ngjarje të dëmshme (Alpa, 2008:12). Kjo bën të mundur faktin që përgjegjësia jashtëkontraktore shërben si garanci për mbrojtjen e çdo të drejte që është ligjërisht e mbrojtur (Triolo 2015:10). Në to bëjnë pjesë jo vetëm të drejtat (absolute ose relative), por edhe pritshmëritë dhe interesat ligjore civile të cilat nën interpretimin e gjerë të nenit 608 të K.C mund të përfshijë çdo shkelje të drejte .

Përgjatë viteve kjo tezë është tejkaluar. Aktualisht, teza më e përdorshme në doktrinë dhe jurisprudencë dallon dy format e përgjegjësisë, duke ananlizuar strukturën formuese të tyre, pra nëse nisur nga fakti se paraprakisht ekziston apo jo një marrëdhënie detyrimi (Bacache-Gibeili, 2012: 51). Në këtë strukturë të ndërsjelltë, përgjegjësia kontraktore lind nga mospërbushja e një detyrimi ekzistues, ndërsa përgjegjësia jashtëkontraktore ka një detyrim që lind me ndodhjen e dëmit (Bordon, 2010: 7).

Dallimi mes detyrimit, nga njëra anë dhe detyrës për të mos cënuar të tjerët në të drejtat apo interesat e tyre, nga ana tjetër është e nevojshme për të përcaktuar se në cilën prej rasteve të përgjegjësisë kategorizohet shkelja e ndodhur (Corsaro, 2001: 212). Përgjigja tradicionale do të ishte që përgjegjësia është kontraktore ose jashtëkontraktore, varësisht nga fakti nëse detyrimi i shkelur nga dëmtuesi përbën një të drejtë të kreditorit, që garantohet nga marrëdhënia e detyrimit ose nga parashikimet e klauzolës së përgjithshme të nenit 608 të K.C.

Detyrimet e mbrojtjes priren të jenë reciproke dhe karakterizohen nga funksioni i zgjerimit të fushës së mbrojtjes së të drejtave kontraktore për të drejta që nuk janë objekt i

detyrimeve në kuptimin e ngushtë, këto të drejta, në mungesë të një lidhjeje me marrëdhënien e detyrimit mbrohen nga sistemi i përgjegjësisë jashtëkontraktore (Dauti 2004: 145). Por, duhet të vërtetojmë nëse teoria e detyrimit të mbrojtjes gjen zbatim konkret në sistemin tonë juridik: e para mbështetet mbi strukturën e përgjegjësisë civile, ndërsa e dyta mbi konceptin e detyrimeve (Luarasi,1998:9).

Disa autorë mbështesin interpretimin se neni 422 i K.C si shprehje e një detyrimi të përgjithshëm të mbrojtjes rrezikon të shndërrohet në një përsëritje të dyfishtë të asaj që parashikohet nga neni 608 i K.C. Ky përfundim rezulton nga arsyetimi se të gjitha hipotezat që ndiqen në përgjithësi për qëllim të mbrojtjes mund të kenë si bazë shpërblimin sipas nenit 608 të K.C. Sipas këtij orientimi, në nevojën e përgjithshme për mbrojtjen nga debitori duket se përmbushet qëllimi i *neminem laedere*, që siç e përmendëm është në themel të përgjegjësisë akuiliane (European Group of tort Law, 2015:2). Në vijim të këtij supozimi është edhe neni 32 i K.P, që përbën një përjashtim në panorëm ligjore, përderisa nuk ka dispozita të tjera analoge. Ky nen detyron punëdhënësin, që përveç parashikimeve në kontratë, të mbrojë sigurinë fizike dhe morale të punëmarrësit. Qëllimi i kësaj dispozite është të shpjegojë vullnetin e ligjvënësit për të mbrojtur në mënyrë më të plotë personalitetin e një subjekti më të dobët në një marrëdhënie të veçantë, siç është ajo e punës me një rëndësi themelore në shoqëri. Disa qëndrime të tjera mbrojnë epërsinë e përgjegjësisë jashtëkontraktore në raport me mbrojtjen më të lartë të siguruar ndaj individit (Ponzanelli, 2004:169). Ato argumentojnë se, nëse marim në konsideratë detyrimin e debitorit për të respektuar të drejtat kontraktore dhe tejkontraktore mund të ekzistojë mundësia për përgjegjësinë jashtëkontraktore (Gjata 2010:27). Si rrjedhim, shkelja e këtyre

të drejtave lind përgjegjësinë akuiliane , duke pasur parasysh që kjo nuk e përjashton përgjegjësinë kontraktore.

Problemi i klasifikimit të detyrimit të mbrojtjes nën përgjegjësinë kontraktore apo jashtëkontraktore ka rëndësi për mjetet juridike që vihen në dispozicion, mund të ndodh që e njëjta e drejtë të ketë mbrojtje nga të dyjat sistemet, duke shkaktuar mbrojtje të dyfishtë (Ziviz, 2012:200). Në mënyrë të veçantë, çështja ka përbërë diskutim për përkrahësit e idesë se përgjegjësia jashtëkontraktore është një riparim tipik për mbrojtjen nga shkelja e njeriut në personion apo pasurinë e tij. Në mbrojtje të këtyre të drejtave plotësuese i del detyra mbajtësve të tyre t'i respektojnë ato dhe të shmangin ardhjen e pasojave të dëmshme nga rreziqe të mundshme. (Gjata 2010:29) Këto detyra nuk përbëjnë automatikisht një detyrim, deri në momentin që shkelen dhe prej tyre lind përgjegjësia jashtëkontraktore. Ky qëndrim lidhet me faktin se ekzistojnë të drejta me rëndësi primare që gëzojnë mbrojtje të veçantë (jeta, shëndeti, pasuria) dhe për mbrojtjen e të cilave nuk është e nevojshme ekzistenca e një marrëdhënieje specifike (Alexy, 2012: 16). Kur flitet për përgjegjësi, kriteri i kujdesit, si në fushën kontraktore dhe në atë jashtëkontraktore nuk mund të përmirësohet në lidhje me natyrën e marrëdhënies dhe sjelljes së të dëmtuarit (Viola, 2007:54).

2.4 PAQARTËSI TRADICIONALE DHE ÇËSHTJE TË REJA MBI DALLIMIN MIDIS PËRGJEGJËSISË KONTRAKTORE DHE PËRGJEGJËSISË JASHTËKONTRAKTORE

Çështja e përgjegjësisë ka qenë gjithmonë në qendër të studimit të ligjit. Origjina e këtij fenomeni, problemi civil konfondohet me atë penal, kur vija ndarëse midis të drejtës civile dhe të drejtës penale është e padallueshme. Ky profil gjendet në fillimet e normave të fushave të ndryshme si gjeografike, kulturore dhe juridike me karakteristikat e tyre dalluese sipas familjeve ligjore që i përkisnin të së drejtës romane apo asaj anglo-saksone (Rodotà 1964: 45). Ajo që vlen të theksohet është se fenomeni evoluon në mënyrë të pavarur me një paralelizëm të njëjtë në të dy sistemet juridike, ndërkohë që përgjegjësia civile veçohet nga ajo penale. Në këtë kuptim problemi i ndarjes bëhet një problem i brendshëm i përgjegjësisë civile, ku ndarja në dy pjesë zgjidhet instiktivisht duke bërë dallimin midis burimit të ligjshëm ose kontratës dhe të paligjshëm ose deliktit civil (Darbellay, 1955:86). Megjithatë, në këtë çështje civil law dhe common law mbajnë dy qëndrime të ndryshme, të cilat më tej kushtëzojnë zhvillimin në drejtim të përgjegjësisë. Në sistemin roman është zhvilluar koncepti i detyrimit, burimi i të cilit mund të jetë kontrata ose një marrëdhënie jashtëkontraktore (Maiorca 1990:9). Ky koncept mbetet i panjohur në sistemin anglo-sakson, që nuk zhvillon një teori të përgjithshme të detyrimeve, por që mbetet e lidhur me riparimin e veprimeve për të mbrojtur situatën specifike. Evoluimi i common law përkon me zhvillimin e të drejtës procedurale më shumë se sa me drejtën materiale (Fromont 2009: 103). Pavarësisht, ndryshimeve të përmendura të dy sistemet kanë një element të përbashkët : përgjegjësia lind si rezultat i një burimi të dyfishtë: kontratës ose dëmit (Darbelley, 1955:17).

Sipas qasjes tradicionale, siç u përmend tashmë, dallimi thelbësor midis përgjegjësisë kontraktore dhe asaj jashtëkontraktore bazohet në praninë ose mungesën e një detyrimi paraprak (Franzoni, 2010 a: 17). Gjykatës së Lartë në shumë raste i është dashur të vendos

mbi marrëdhënien mbi të cilën të zgjidh konfliktet, kontraktore ose jashtëkontraktore, duke përsëritur që ‘dallimi midis përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore qëndron në faktin që kjo e fundit shkaktohet nga shkelja e një detyrimi kryesor, duke mos dëmtuar interesat e palëve të treta, kështu që kjo lind me të njëjtin detyrim për dëmshpërblim, prej nga ajo kontraktore presupozon mospërbushjen e një detyrimi specifik juridik ekzistues dhe vullnetar të ndërmarrë kundrejt një subjekti tjetër ose një rrethi të caktuar subjektsh’. Pra, nga mospërbushja e një detyrimi paraprak nga njëra anë dhe veprimi që shkakton një dëm, nga ana tjetër, varet dhe ndarja midis dy formave të përgjegjësisë. Në fakt, nuk do të ishte korrekt arsyetimi i kundërt që, nga shumëllojshmëria e normave ligjore që rregullojnë kontratën dhe përgjegjësinë nga shkaktimi i dëmit bëhet dallimi midis burimeve të përgjegjësisë (Giardina, 1993:6). Nga ana tjetër, nëse ndryshimet janë shumë që ekzistojnë në fushën e përgjegjësisë nga mospërbushja e detyrimeve të kontratës apo të shkaktimeve të dëmit nuk mungojnë dhe ‘përjashtimet’, në këto dallime ka edhe shumë rregulla të përbashkëta për të dyja përgjegjësitë dhe mbi të gjitha një rol kyç është luajtur nga jurisprudenca në aspektin e qasjes së dy figurave (Monateri, 2001:21).

Në mënyrë të veçantë, në aspektin e interesave të mbrojtura duhet të veçohet ndarja tradicionale brenda përgjegjësisë civile që qëndron në karakterin absolut ose relativ të së drejtës së shkelur (Alexy, 2012: 58). Veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm, që kuptohet si një klauzolë e përgjithshme ose si kualifikim i rëndësishëm dhe mospërbushja e një detyrimi përcaktojnë sëbashku shkeljen e një situate të rëndësishme juridikisht, por fillimisht, përjashtohet fakti që të drejtat e kreditorit mund të merren në mbrojtje nën përgjegjësinë akuiliane me pasojën që nëse një shkelje e një të drejte absolute shkakton

përgjegjësi jashtëkontraktore, shkelja e një të drejte relative passjell përgjegjësi kontraktore (Bianca, 2012: 531).

Me veprim të kundërligjshëm nënkuptohet një sjellje jo ligjore ose e kundërligjshme, jo ligjore në kuptimin që fakti që shkakton dëmin nuk justifikohet ndryshe nga sistemi juridik, ndërsa i kundërligjshëm nënkupton që veprimi shkakton një dëm në një situatë subjektive të mbrojtur nga sistemi juridik në formën e së drejtës subjektive (Franzoni, 2010:46). Interpretim, i cili hedh dritë, nga ana tjetër, arbitrariteti i çdo diskriminimi midis kategorive me njëra-tjetrën të së drejtës subjektive, deri në njohjen ose përjashtimin e mbrojtjes akuiliane (Rosello 1996: 658).

Doktrina ka vënë në dukje në këtë drejtim se mbrojtja akuiliane e së drejtës së kreditorit përbën në të vërtetë një ‘pseudo-problem’ sepse nuk ka përjashtime në nivel ligji (Visintini, 2005: 205). Mbi të gjitha duhet bërë dallimi midis zbatimit dhe moszbatimit të raportit: relativiteti i të drejtës së kreditorit ka të bëjë vetëm me implementimin e raportit, ndërsa mosimplementimi mund të jetë atribut i mospërbushjes së debitorit, por mund të karakterizohet edhe nga pamundësia e përmbushjes për shkaqe që nuk varen prej tij (neni 476 i K.Civil) ndaj një pale të tretë në një marrëdhënie detyrimi. ‘Zbulimi’ i ‘mbrojtjes akuiliane të kreditorit’ nga ana e jurisprudencës, që shumë pak pajtohet me identifikimin klasik të mbrojtjes së kreditorit për shkak të mospërbushjes së një detyrimi dhe me përjashtimin e çdo sjelljeje të rëndësishme ndaj një pale të tretë, shpjegon të dhënat ligjore. (Franzoni, 2010 b: 775)

Përtej këtyre konsideratave paraprake, del e nevojshme për të marrë në konsideratë parashikimet e Kodit Civil në fuqi në lidhje me formimin e dy kategorive. Ato përcaktojnë elementet strukturore, që e bëjnë të dallueshëm çdo model të përgjegjësisë dhe pjesëmarrja

në sistemin kontraktor ose jashtëkontraktor ka pasoja të rëndësishme në lidhje me mbrojtjen (Gjata, 2010: 89). Në vend të parë, është elementi subjektiv i ndryshueshëm që kërkohet sepse në fushën kontraktore përgjegjësia është objektive, pra, do të vlejë vetëm për rastin kur verifikohet mospërmbushja, ndërsa në fushën jashtëkontraktore kërkohet dashja ose pakujdesia e atij që shkakton dëmin (Nuni, 2004: 108-109). E lidhur ngushtësisht me këtë çështje është barra e provës. Neni 476 i K.C supozon prezumimin e fajësisë për debitorin, që provon që mospërmbushja ka qenë pasojë e veprimeve që nuk varen prej tij, në mënyrë që debitori të provojë vetëm elementin objektiv. Ndërsa, në përgjegjësinë jashtëkontraktore faji i autorit të shkakimit të dëmit duhet të provohet nga i dëmtuari. Siç dihet barra e provës në procesin civil ndahet mbi bazën se cila palë do të humbas gjyqin kur një fakt mbetet i paprovuar.⁶ Në rastin e padisë për shpërblimin e dëmit barra e provës fillon me të dëmtuarin paditës, i cili duhet të provojë ekzistencën e dëmit dhe masën e tij si dhe ekzistencën e veprimit të kundraligjshëm dhe të lidhjes shkaksore. Në rastin e padisë për shpërblimin e dëmit i padituri ka barrën e provës për të provuar që dëmi nuk ka ardhur për fajin e tij dhe për rrjedhojë, ai nuk ka përgjegjësi. Pra, kjo barrë rëndon si detyrim, vetëm pasi është ushtruar paraprakisht barra e provës e të dëmtuarit/paditës (Tafaj, 2003: 95).

Një element i rëndësishëm në lidhje me zbatimin ka të bëjë me afatet e parashkrimit. Parashkrimi dhjetëvjeçar për përgjegjësinë kontraktore (ose afateve të ndryshme në varësi të objektit të kontraktës sipas nenit 115 të K.C) kundrejt atij trevjeçar për paditë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor është elementi që sipas nesh ka pasur më shumë ndikim në zgjedhjen e ligjit. Në fakt, shpesh zgjedhja për të klasifikuar problemin në

⁶ Neni 12 i K.Pr.C parashikon “*Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazo pretendimin e saj*”

regjimin kontraktor lidhet me qëllimin për të shmangur afatin më të shkurtër të parashkrimit, atë trevjeçar (Serio, 1988: 50).

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm ka të bëjë me kualifikimin e dëmeve. Në bazë të nenit 482 të K.C debitori që është me vonesë nuk çlirohet nga pamundësia e papritur e përmbushjes së detyrimit edhe sikur kjo të jetë shkaktuar pa fajin e tij e të kreditorit, përveç kur provon se objekti i detyrimit do të ishte shkatërruar ose dëmtuar edhe nëse do të ishte nën kujdesin e kreditorit (Serio, 1988: 52). Ky kufizim, që i lejon debitorit të vlerësojë paraprakisht rreziqet e lidhura me çdo kontratë dhe eventualitet të saj nuk aplikohet në fushën e përgjegjësisë jashtëkontraktore (Di Majo, 2003: 201). I ndryshëm është edhe regjimi në fushën e solidaritetit në përgjegjësinë kontraktore ajo supozohet në pjesë të barabarta siç parashikon edhe neni 423 i K.C, ndërsa në përgjegjësinë jashtëkontraktore sipas nenit 627 të K.C ajo shpërndahet në përpjestim me shkallën e fajësisë të secilit dhe në tërësinë e pasojave të rrjedhura, kur kjo nuk mund të përcaktohet prezumohet shkalla e fajësisë është e barabartë.

Në dallim nga përgjegjësia jashtëkontraktore në atë kontraktore legjislatori vë në dispozicion të kreditorëve mjete për përmbushjen e tyre që janë kushti penal parashikuar nga neni 541, pengu, parashikuar nga neni 546, hipoteka parashikuar nga neni 560, dorëzania parashikuar nga neni 585, kapari dhe privilegjet parashikuar nga neni 601 e 603. Aspekte të tjera të nevojshme për të bërë dallimin midis dy llojeve të përgjegjësive ka të bëjë me mospërcaktimin qartë të të drejtës të një prej dy regjimeve të objektit. Referenca është papërgjegjshmëria e personit të zotë për të vepruar dhe dëshiruar ardhjen e pasojave siç parashikohet në nenin 613 i K.C, ndërkohë ky supozim është i dyshimtë për përgjegjësinë kontraktore. I njëjti diskutim vlen edhe për dispozitat e përjashtimit nga

përgjegjësia, në të cilën përfshirja e përgjegjësisë jashtëkontraktore është e dyshimtë (Di Majo, 2003: 202). Korniza ligjore duket sikur nuk i ka lënë rrugë shumë dyshimeve mbi karakteristikat dalluese të dy sistemeve. Megjithatë nuk është kështu sepse në praktikë dallimi nuk është i lehtë dhe gjithmonë edhe më tepër kufijtë mes tyre bëhen të ndryshueshëm.

Në fakt, në dekadat e fundit kemi qenë dëshmitarë të zgjerimit të fushës së përgjegjësisë jashtëkontraktore për të drejta që historikisht janë mohuar (Bordon, 2010: 37). Aktualisht, gjendet një hapsirë drejt kontraktimit të dëmit me përfshirjen e tij në territorin e çështjeve që më parë kanë qenë fushë e përgjegjësisë akuiliane (Castronovo, 2006:262). Arsyeja për këto luhatje mund të na kthejë te teoritë e përgjithshme të detyrimeve dhe në mënyrë të veçantë në burimet e saj (Darbellay, 2003:27). Neni 420 i K.C⁷ na jep degëzimin e burimeve që ofron alternativën midis përgjegjësisë kontraktore dhe asaj jashtëkontraktore. E konceptuar në mënyrë tradicionale kjo ndarje mund të jetë e pamjaftueshme për disiplinimin e marrëdhënieve shoqërore moderne. Numri i madh dhe shumëllojshmëria e detyrimeve që karakterizojnë shoqërinë bashkëkohore nxjerr si të nevojshëm përdorimin e mjeteve të reja ose modernizimin e atyre aktuale (Ponzanelli, 2004: 51). Zgjedhja e bërë nga sistemi juridik shqiptar duket se është kjo e fundit: në mënyrë të përgjithshme nuk është krijuar një lloj i tretë përgjegjësie, por është punuar mbi konceptet aktuale të detyrimeve kontraktore dhe jashtëkontraktore për të ofruar zgjidhje konkrete për kërkesat e paraqitura pranë gjykatave (Friedman, 1977: 515).

Ekzistenca e regjimit që e ndan përgjegjësinë civile në dy lloje është element i përbashkët edhe me common law, ku përgjegjësia ndahet midis kontratës dhe tort

⁷ Parashikon: “Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji”

(Fromont,2009:90). Tradicionalisht kultura e ligjit anglo-sakson nuk e njeh teorinë e përgjithshme të detyrimeve, prandaj dy sistemet e përgjegjësisë nuk janë gjë tjetër veçse rezultat i mjeteve juridike tipike dëshmuese për shkeljen e detyrimeve që konsiderohen të denja për t'u mbrojtur. Këto të fundit janë subjekt i rregullave kontraktore kur është vullnet i palëve ose rregullohen nga *tort*⁸ nëse përcaktohen nga ligji (Légier, 2008: 182). Në kuadër të këtij dallimi ku u përqëndrua dhe kjo pjesë e kërkimit, që sigurisht nuk ka për qëllim të zgjidh probleme të së shkuarës dhe të përgjithshme, vuri në dukje mekanizmat e dallimit mes përgjegjësisë kontraktore me atë jashtëkontraktore, aktualisht e parë në këndvështrim krahasues mes civil law dhe common law.

Një drejtim tjetër i zhvillimit të përgjegjësisë civile është manifestuar në rritje nga shuarja e dallimit midis përgjegjësisë për shkelje të detyrimeve dhe përgjegjësisë deliktore, e cila ka ardhur si pasojë e bashkëpunimit të doktrinës dhe jurisprudencës, të cilat ose kanë tendencën për të reduktuar tiparet dalluese të çdo lloj detyrimi ose janë frymëzuar nga dëshira për të vendosur në dispozicion të palës së dëmtuar instrumentet më të përshtatshëm (Franceschetti,2008: 80). Rindërtimi i marrëdhënies midis përgjegjësisë kontraktore dhe asaj jashtëkontraktore mund të krijojë struktura sistematike të ndryshme. Njëri prej tyre ndjek opsionin interpretativ të bazuar në mohimin e çdo depërtimi qoftë edhe në mënyrë abstrakte midis regjimeve të përgjegjësisë sepse nëse ka një logjikë reflektuese dhe mundësia e ndërhyrjes së tyre duket irracionale. Dy llojet e përgjegjësisë do të mbahen të përputhura në mënyrë që midis njërës dhe tjetrës për shkak të një kufiri formal kanë mbetur

⁸ Është një tërësi të drejtash, detyrimesh dhe mjeteve që përdoren nga Gjykata në proceset civile për të dhënë mbrojtje personave, që u është shkaktuar një dëm nga shkelja e një të drejte nga një person i tretë (marrë nga Fjalor i termave ligjor, gjendet në www.legal-dictionary.com parë më 04.03.2015)

‘boshllëqe’, të cilat nuk mund të plotësohen as nga përmbushja e përgjegjësisë që rrjedh nga shkelja as nga mosekzekutimi i një detyrimi (Markesisnis, 1987: 103).

Nëse regjimet e përgjegjësisë përjashtohen reciprokisht qëllimi i favorizimit të palës së dëmtuar është të përgjigjet vetëm në fazën e individualizimit të regjimit që do të aplikohet duke ndjekur mbrojtjen maksimalisht të interesave të të dëmtuarit pavarësisht, nëse kjo mbrojtje realizohet duke kaluar nga përgjegjësia kontraktore në atë jashtëkontraktore apo e anasjellta (Franzoni, 2004: 14). Një strukturë e mundur sistematike, në mospranimin e çdo konceptimi ‘mekanik’ i hap rrugën një mbivendosjeje të pjesshme të regjimit të dy përgjegjësive. Në këtë të fundit pala e dëmtuar mund të përfitojë të paktën në mënyrë abstrakte një mbrojtje të dyfishtë, që rrjedh nga instrumentet si të përgjegjësisë kontraktore dhe të asaj jashtëkontraktore (Rodotà, 2015: 21). Si drejtimit e ndryshme të zhvillimit ashtu edhe strukturat alternative, të cilat sapo përmenden përballen me fenomenin e ‘konkurimit të përgjegjësive’ dhe të ‘përgjegjësisë nga kontakti social i kualifikuar’, që synojnë të nxisin idenë e dallimit mbi baza të forta midis përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore (Rosello, 1996: 661).

Në fakt, ky dallim mund të ketë humbur kuptimin tradicional duke pasur nevojë për kritere të reja. Është e nevojshme të sqarohet nëse strukturat e mospërmbushjes ose shkeljes së një detyrimi, që përbëjnë burimin klasik të dy llojeve të ndryshme të përgjegjësive kanë tipare të ngjashme për të pasur të njëjtat rregulla apo kanë tipare të ndryshme për t’u aplikuar mbi këto rregulla të ndryshme. Analiza duhet të përqëndrohet si në drejtën pozitive dhe në rastet e praktikës sepse shpesh ekzistenca e një instituti krijohet nga jurisprudenca dhe jo nga ligjvënësi. (Franzoni, 2004: 15)

Disiplina e lidhjes shkaksore materiale është huazuar nga përgjegjësia e parashikuar në nenet 13 e 14 të Kodit Penal, por mbetet dyshimi nëse sjellja e dëmshme duhet të klasifikohet nga fajësia ose për shkak të një sjellje të kundraligjshme sipas kuptimit të nenit 608 të K.C ose për shkak se përmbushet një prej elementëve të parashikuar në nenin 476 të K.C, kjo është dilema mbi baza subjektive ose objektive të përgjegjësisë kontraktore (Giardina, 1993: 79).

Ndërsa, përsa i përket lidhjes shkaksore juridike dhe shpërblimit të dëmit, neni 640 parashikon se dëmi që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar, kjo dispozitë bën të njëjtin rregullim si në rastin e përgjegjësisë për mospërmbushje të detyrimit (neni 486 i K.C) dhe për përgjegjësinë nga shkaktimi i dëmit.

Neni 640⁹, në pikën e dytë të tij parashikon në shpërblimin për riparimin e dëmit bëjnë pjesë edhe shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të parandaluar ose për të pakësuar dëmin, që kanë lidhje me rrethanat mbi të cilat bazohet përgjegjësia e palës, shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të caktuar dëmin dhe përgjegjësinë si dhe ato që janë nevojitur për të gjetur një zgjidhje jashtëgjyqësore të përmbushjes së detyrimit .

Disa institute janë subjekt i rregullave, të cilat mund të rezultojnë të papërshtatshme (p.sh në lidhje me parashkrimin) dhe kjo ngre pyetjen nëse mospërputhjet në disiplina janë të përshtatshme apo të papërshtatshme. Një përgjigje në kuptimin e dytë do të akuzonte interpretuesin e detyrave plotësuese me qëllimin e përshtatjes *de iure* ose propozimet më pak *de iure*. Së fundi, është e qartë se lidhjen midis elementëve bazë të detyrimit dëmshpërblimi i bën shpesh të zëvendësueshme (Franzoni, 2010b: 56).

⁹ Neni 640 i Kodit Civil'94 :*"Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar i munguar. Shpërblehen gjithashtu për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore"*.

Në kompleksitetin e diskutimeve të sotme, ndërsa një kërkim që ushqen ambiciet shkencore duhet të ketë parasysh se si rregullohet çështja në sistemet e vendeve të tjera, jo vetëm në nivelin kombëtar ose mbikombëtar: jashtë kufijve të çdo shteti, që korrespondojnë gjithmonë e më pak me kufijtë e një përvoje juridike, në fakt janë mbetje të së resë (Visintini, 2005: 228). Duke analizuar *Modernisierung des Schuldrecht* të nisur në Gjermani dhe ligjin francez të 17 qershorit 2008, nr.561 '*Portant reforme de la prescription en materie civile*', i cili ka parashikuar në projekt- ligj për një reformë më të thellë të Kodit Civil, pra të ngjarjeve që i përkasin historikisht traditës juridike të ndërthurura në sistemin tonë, por edhe në Parimet e Kontratave Tregtare Ndërkombëtare, në Parimet e Ligjit European të Kontratave, në Parimet e Ligjit European të Delikteve dhe në projektin paraprak të Kodit European të Kontratave, dmth në tekstet normative në të cilat, pas studimeve të thelluara dhe debateve, redaktorët kanë tentuar me vështirësi të arrijnë një sintezë të balancuar të eksperiencave të ndryshme, parë në harmoni me sistemet e së drejtës private kombëtare (Viney, 2008 : 162).

Përgjegjësia civile zë vend të parë në të gjithë kufijtë realë ose potencialë të së drejtës dhe rinovimi i tanishëm, aktualisht më pak i kalueshëm ose më pak i vrullshëm, shkon drejt reduktimit të dallimit midis përgjegjesisë kontraktore me përgjegjësinë jashtëkontraktore. Deri sa dy llojet e përgjegjësive do të jenë më pak të dallueshme, do të jetë e nevojshme të caktohet se në cilat kushte rregullat e njërës mund të gjejnë zbatim në fushën e rregulluar nga tjetra (Alpa, 1982: 20).

Evoluimi i institutit të përgjegjesisë civile ka mundësuar një konotacion shumëqëllimësh që në të njëjtën kohë mbulon, duke lehtësuar funksionet e njërës ose tjetrës në varësi të sektorëve të veprimtarisë, një rol sanksionues, riparues (rikthim në gjendjen e mëparshme

të situatës siç ishte para se të ndodhte dëmi), parandalues (i natyrës individuale dhe kolektive, ose sepse subjekti i vetëm nuk do të përsërisë më një sjellje të paligjshme ndodh sepse në të njëjtën kohë, reagimi i sistemit është një paralajmërim deri sa të tjerët nuk kanë kryer veprime të të njëjtës natyrë) dhe shpërndarjes së riskut dhe humbjes pasurore (duke ju referuar në mënyrë të veçantë nevojës kolektive me rrezik të veçantë, në të cilin risku për dëmet, për shkak të dobisë kërkon zgjidhjen e zgjedhjes së personit të cilit t'i ngarkojë humbjen e pësuar) (Serio, 1988: 28).

2.5 PËRGJEGJËSIA KONTRAKTORE DHE JASHTËKONTRAKTORE

DREJT NJË KONCEPTI UNITAR TË PËRGJEGJËSISË CIVILE

E drejta ‘civile’, përgjegjësia ‘kontraktore’ dhe përgjegjësia ‘jashtëkontraktore’ janë kategori, që nuk kanë gjetur ende një klasifikim përfundimtar sipas së drejtës private. Në fakt, nëse është i sigurt pozicioni i kundërt i përgjegjësisë civile ndaj asaj penale dhe administrative, në teori dhe në praktikë mbeten të pasigurta, të paqarta dhe konfuze kuptimi, përmbatja dhe kufijtë e përgjegjësisë civile (Labonia, 2015: 5) . Përgjegjësia (e drejta) civile, para së gjithash duhet të paraqesë kategorinë e përgjithshme dhe të përfshijë si përgjegjësinë kontraktore ashtu edhe atë jashtëkontraktore (Maiorca, 1990: 18). Në praktikë është i zakonshëm përdorimi i emërimit ‘përgjegjësi civile’ për nënkategorinë ‘përgjegjësi jashtëkontraktore’ për ta vendosur përballë përgjegjësië që rrjedh nga kontrata. Kjo praktikë duket sikur kufizohet duke i atribuar një kuptim të ndryshëm fjalës ‘përgjegjësi civile’ duke nxjerrë në këtë mënyrë të pavlefshme kategorinë e përgjithshme

dhe zgjeron kuptimin e përgjegjësisë civile, që rrjedh nga shkelja e kontratës ose nga shkaktimi i dëmit si dy modele të ndryshme të përgjegjësisë (Monateri, 1998: 4).

Tradicionalisht, përgjegjësia kontraktore ka dalluar nga ajo jashtëkontraktore si në hipoteza ashtu edhe në mjete juridike që vendosen në dispozicion të secilës (Rosello, 1996: 13). Një ndarje e qartë midis dy figurave të përgjegjësisë duke pasur në konsideratë interesat e mbrojtura dhe dëmet e kompesueshme, megjithatë nuk duket aq e përshtatshme, aspektet e përbashkëta duhet të vlerësohen në dallim nga disiplina, të cilat gjithashtu do të mund të tejkalohen, megjithatë mbetet për t'u sqaruar çështja në lidhje me origjinën e përgjegjësisë (Alpa, 2003: 68). Duke iu referuar burimeve të detyrimeve nuk duhet të harrojmë se përgjegjësia 'kontraktore' dhe ajo 'jashtëkontraktore' përbëjnë nënkategori kryesore, por me to nuk ezaurohet përgjegjësia në të drejtën civile, që nënkupton të gjitha normat mbi bazën e të cilave autori i një dëmi është i detyruar ta shpërblejë atë (Bianca, 1994: 69).

Sistemi i common law, i cili nuk njeh të drejtën e detyrimeve, por ka kontratat, torts, begatimin pa shkak, në sistemin e civil law, përkundrazi, problemi që lidhet me përmbajtjen dhe kufijtë e përgjegjësisë civile mund të fokusohet në fushën e marrëdhënieve të detyrimeve (Ewan McK., 2005:15).

Kodi civil në fuqi në nenin 420 identifikon si burime të lindjes së detyrimeve kontratën ose ligjin dhe një pjesë e përgjithshme në të drejtën e detyrimeve paraprin disiplinën në lidhje me burimet e veçanta. Edhe pse është e njohur larmia e burimeve të saj kontrata ose dëmi nga njëra anë dhe veprimi/mosveprimi i kundraligjshëm dhe i dëmshëm (neni 608 K.C) nga ana tjetër justifikojnë pikëpamjen tradicionale të diversitetit të regjimit të dy përgjegjësive. Prej nga rrjedh neni 476 i K.C mbi 'përgjegjësinë e debitorit' për mospërmbyllje të detyrimit duhet të lidhet vetëm me kontratat.

Nga ana tjetër, është vërejtur se shprehja ‘përgjegjësi kontraktore’ e përdorur në kuptimin e gjerë të së drejtës klasike identifikon ‘të gjitha detyrimet e ndryshme nga përgjegjësia *ex deliktore*¹⁰’. Quhet kontraktore përgjegjësia për mospërbushje të një detyrimi paraprak, çfarëdo qoftë burimi i tij, kjo është edhe përgjegjësia për shkaktimin e një dëmi, për sa kohë që nuk është kompesuar dëmi i ndodhur në këtë rast (Galgano, 1987: 445).

Kuptimi i përgjegjësisë civile lind si një detyrim për kompesim, ndërsa përgjegjësia kontraktore lind nga një marrëdhënie detyrimi e ‘ligjëruar’ , me pasojën që një detyrim shpërblimi lind (ose zëvendëson) si detyrë primare e ekzekutimit, ndërsa përgjegjësia jashtëkontraktore është një detyrim i krijuar rishtazi (Castronovo, 2007:218). Sipas pjesës më të madhe të doktrinës kjo përmban minimumin thelbësor të dallimit mes përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore për të kthyer një diversitet strukturor të sfondit, që nuk do të preket nga evolucioni mbi menyrën e të kuptuarit të elementëve përbërës të të dy përgjegjësisë duke justifikuar disa ndryshime në disiplinën pozitive (Giardina, 1993: 72-73).

Në të dyja rastet hipotezat ose në çdo rast vendoset një marrëdhënie detyrimi, e rregulluar nga e drejta e detyrimeve dhe në mënyrë të veçantë nga një detyrim për shpërblim, i vendosur për të korrigjuar dëmtimin e një situate të rëndësishme juridikisht (Castronovo, 2007:220).

Ndërsa, tradicionalisht ndarja mes përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore është një faktor i përbashkët për të gjitha praktikat juridike, së fundi dallimi mes dy fushave të përgjegjësisë ka hyrë ‘në krizë’ nga tendenca është për të kapërcyer ndryshimet (Behrends, 2003: 8). Në të vërtetë ka përpjekje të ndryshme për unifikimin, që në shumë sisteme

¹⁰ Përgjegjësia jashtëkontraktore emërtohet ndryshe si *ex deliktore*

ligjore janë bërë pjesë e reformave dhe projekteve të reformave në vitet e fundit (Collins, 2008: 46).

Kështu, në sistemin francez, i cili është përqëndruar në figurën e pronës dhe të kontratës në përgjithësi po dëshmohet një rikonceptim i mjedisit tradicional. Në të vërtetë, projekt-reforma e së drejtës së detyrimeve të 2005 duket se kërkon të zhvendos vëmendjen nga figura e kontratës në atë të përgjithshme të detyrimeve dhe ka bashkuar në një titull tre burimet kryesore të detyrimeve 'Kontratat, kuazi-kontratat dhe përgjegjësinë civile'. (Jourdain, 2010: 3)

Edhe sistemi gjerman, tradicionalisht ka pasur të njohur të drejtën në marrëdhëniet e detyrimit, i cili në vitin 2002 me Schuldrechtsmodernisierung ka rivlerësuar figurat e përgjithshme të detyrimeve dhe ka kontribuar në një 'unifikim gradual të konceptit të përgjegjësisë civile' (Zekoll, 2005: 371). Në kuadër të një koncepti unitar të përgjegjësisë civile sistemi riparues i të drejtës së Leistungsstorungen dhe rregulli i 280 BGB¹¹, që rregullon kriteret dhe parakushtet e shpërblimit të dëmit për shkelje të një detyrimi marrin rëndësi qendrore në kontekstin e një koncepti të përgjithshëm të marrëdhënies së detyrimit (Rrolland, 2002: 12).

Në kuptim të shkeljes së interesave të palëve të treta, gjatë zbatimit të kontratës preket më konkretisht parimi i relativitetit të efekteve kontraktore dhe kjo çon në rikonceptimin e kategorisë së përgjithshme të marrëdhënies së detyrimit si strukturë komplekse, jo vetëm nga pikëpamja objektive e detyrimeve (primare dhe sekondare), por edhe nga pikëpamja subjektive e një ose më shumë debitorëve dhe të një ose më shumë kreditorëve duke braktisur kështu rrugën e kontratës dhe të palëve kontraktore si kategori

¹¹ Bürgerliches Gesetzbuch –Kdodi Civil gjerman ka hyrë në fuqi në i Janar 1990

referuese (Markesinis, 1987: 41). Prandaj, mbeten për t'u qartësuar kufijtë e vështirë të kësaj hipoteze të dëmit që, në mungesë të një disipline të përshtatshme janë përfshirë nga jurisprudenca dhe doktrina, në sisteme të ndryshme kombëtare të fushës së përgjegjësisë kontraktore ose të përgjegjësisë jashtëkontraktore ose akoma më tej në një kategori të tretë të përgjegjësisë (Fridman, 1977: 423).

Në mënyrë të përgjithshme mund të vërehet luhatja mes një modeli dhe një tjetri të përgjegjësisë për të zgjidhur disa çështje të kufirit ndarës mbi ngurtësinë dhe ndarjen artificiale kur elementët e *tort* dhe kontratave janë bashkëprezent në një situatë faktike (Serio, 1988: 622).

Ndërveprimi ekzistues midis përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore në situata të caktuara anulohet nga lindja e nevojës për të ndarë të dy fushat e përgjegjësisë civile (Markesins, 1987: 354).

Mbizotërimi i njërit ose tjetrit model të përgjegjësisë ndryshon nga sistemi në sistem: kështu në sistemin anglez ngurtësia e ligjit të kontratave çon në një zgjerim të zonës së torts, ndërsa në sistemin gjerman veçantia e *unerlaubte handlungen* përcakton një zgjerim të fushës së kontratave, në mënyrë të ngjashme sistemi italian, pavarësisht pranisë së një rregulli atipik të përgjegjësisë nga dëmi karakterizohet nga një zgjerim i përgjegjësisë kontraktore në zonat, të cilat tradicionalisht i janë nënshtruar fushës jashtëkontraktore, ndërsa sistemi francez përveç parimit jo-bashkues me ndihmën e një klauzole të përgjithshme të përgjegjësisë objektive tenton të çkontrakttojë detyrimet e kujdesit, sa herë që zbatimi i normave të përgjegjësisë jashtëkontraktore dëshmon se është më i dobishëm për viktimën (Procida, 2008: 16).

Nga hulumtimi i këtyre figurave të kufijve dhe të ndihmës për të kuptuar më mirë marrëdhënien mes përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore dhe formimin e një kategorie të përgjithshme dhe unitare të përgjegjësisë civile, një përgjegjësi civile ‘të re’, jo vetëm për të drejtat e veçanta kombëtare, por në perspektivën e një të drejte private të përbashkët europiane (Koziol, 1998: 17).

Në fakt, çështja që lidhet me krijimin dhe marrëdhëniet midis burimeve të ndryshme të përgjegjësisë është e para e një liste të gjatë me ‘50 pyetje të natyrës politike në fushën e ligjit europian të kontratave’ që janë prodhuar nga prof.M.Ë.Hesselink dhe që i janë drejtuar institucioneve politike dhe komunitetit të shkencës, pyetja nr.1 : marrëdhëniet kontraktore duhet të trajtohen vetëm nga përgjegjësia kontraktore apo mund t’u lejohet forma e konkurrencës të përgjegjësisë (kontraktore, jashtëkontraktore, restitucioni)? Te pyetja thirren ‘marrëdhëniet kontraktore’, përgjegjësia ‘kontraktore’, ajo ‘jashtëkontraktore’ dhe ‘restitucioni’ duke mos u shfaqur koncepti i detyrimeve (Ciani, 2002: 503).

Në këtë aspekt është e nevojshme të kujtojmë që në nivel të së drejtës private europiane dhe deri në miratimin e Kornizës së Përbashkët të Referencave, prirja ka qenë të vendos në qendër jo detyrimin në përgjithësi, por kontratën, projektet kryesore të unifikimit, si Parimet Unidroit¹² të Kontratave Tregtare Ndërkombëtare, Parimet e të drejtës Europiane të Kontratave të Komisionit Lando dhe Kodi Europian i Kontratave (ose i njohur si Kodi Gandolfi) kanë në objekt veçanërisht çështjet kontraktore (Boele-Woelki, 2003: 126). Arsyeja kryesore e kësaj zgjedhjeje është dashur fillimisht të kufizohet në tentativën e

¹² Është një dokument i hartuar nga UNIDROIT që ka si qëllim harmonizimin e ligjit të kontratave tregtare ndërkombetare. Publikimi i parë është bërë në vitin 1994, një publikim i dytë, më i madh është bërë në 2004. Botimi i tretë është publikuar në 2010, i cili përveç të tjerave ka një kapitull mbi veprimet e paligjshme.

unifikimit të të drejtave të ndryshme kombëtare vetëm për kontratat për shkak të rëndësisë thelbësore të saj në marrëdhëniet juridike dhe tregtare (Hondius, 2004: 8-9).

Projekti më i madh i krijimit të një Kodi Civil European, aktualisht i sanksionuar me Kornizën e Përbashkët të Referencës (Common Frame of reference -CFR), që nënkupton përveç përgjegjësisë kontraktore edhe atë jashtëkontraktore, gjerimin e punëve të të tjerëve dhe begatimin pa shkak, duket se ka ndryshuar perspektivën duke i dhënë një rol kyç figurës së detyrimeve në procesin e unifikimit të së drejtës private (Hondius, 2002: 27).

2.6 PËRGJEGJËSIA KONTRAKTORE NUK PËRJASHTON PËRGJEGJËSINË JASHTËKONTRAKTORE

Mbështetur në parashikimin e Kodit Civil se burimi i një detyrimi është edhe kontrata edhe ligji, ne vendosemi përpara një diskutimi dyshues: kur një kërkesë për shpërblim dëmi vjen për shkak të mospërbushjes së një detyrimi të marrë përsëri vullnetarisht nëpërmjet një kontrate apo të një detyrimi që rrjedh nga ligji për shkak të kësaj kontrate, nënkupton gjithmonë një përgjegjësi kontraktore?

Së pari, mbi këtë dyshim duhet të shpjegojmë një pikë, e cila qëndron në thelb të diskutimit, sistemi jonë juridik nuk e përjashton përgjegjësinë jashtëkontraktore, në rast të ekzistencës së përgjegjësisë kontraktore, çfarë do të thotë se nga ekzistenca e një marrëdhënieje kontraktore mund të lind përgjegjësia jashtëkontraktore, duke lindur një përgjegjësi akumulative, me kusht që një bashkim i tillë nuk cënon ndonjë ligj apo standart në fuqi (Castronovo, 2006:567).

Ky rregull është i zbatueshëm edhe nëpërmjet formulës që pranon konkurimin mes dy llojeve të përgjegjësisë kur njëkohësisht shkelen të drejta të pavarura nga kontrata dhe

një marrëdhënie juridike ekzistuese ose të drejta të rrjedhura nga kontrata ose nga një lidhje që ekziston për shkak të ligjit (*vinculum juris*)¹³.

Si rezultat, plotësisht në kundërshtim me sa më lart u tha, mund të jetë rasti i përgjegjësisë mjekësore, si një rast i konkurrencës ose bashkimit të përgjegjësive, në rastin e parë rrjedh detyrimi nga shkelja e detyrimeve kontraktore dhe në të dytin nga shkaktimi i dëmit, pra është e qartë njëkohshmëria e ekzistencës së dy përgjegjësive (Magliona, 2005:3).

Së dyti, duhet nxjerr në pah se bashkimi i dy veprimeve të ndryshme në pikën ku ato kanë kufijtë ndarës, për çështjen në fjalë, p.sh në fushën e përgjegjësisë mjekësore, jo vetëm është e saktë, por ruan të paprekur dobinë e saj në praktikë (Busnelli, 2006: 445). Ndryshe nga common law, ende sot ka mjaft dallime mes dy llojeve të përgjegjësisë, p.sh në fushën e kompesimit të dëmeve (Widner, 2005:12).

Në këtë drejtim është vërejtur se, ende vazhdohet të përcaktohet çështja e shpërblimit të dëmeve jopasurore, që rrjedhin nga shkelja e kontratës jashtë hipotezave kumulative, profil i cili nuk është reflektuar në ndryshimet ligjore të nenit 625 të K.C. Gjykata e Lartë ka nënvizuar që ky nen nuk përcakton një formë të veçantë të faktit të kundraligjshëm dhe të pasojës së tij, verifikimi i ekzistencës së elementëve të vlefshmërisë së përgjegjësisë jashtëkontraktore bëhet mbi bazën e përcaktimeve të nenit 608 të K.C, i cili vërtetohet nga neni 625 i K.C dhe fakti i paligjshëm jashtëkontraktor, prandaj, ose përgjegjësia kontraktore përmban instrumenta të pavarur për njohjen e shpërblimit të dëmit jopasuror ose është e nevojshme të zbatohet rregulli i bashkimit të përgjegjësive duke e vendosur përgjegjësinë kontraktore në kuadër të parashikimeve të reja të nenit 625 të K.C

¹³ Kështu emërtoheshin detyrimet në të drejtën romake, një lidhje e ligjit, ku njëra palë detyrohet të kryejë për shkak të ligjit diçka në favor të palës tjetër.

ose duke u kthyer mbrapsht dhe aplikuar rastin e dëmit jopasuror për mospërbushje të detyrimeve kontraktore.

Ndërsa, përsa i përket dallimeve të tjera që ekzisitojnë midis dy sistemeve të përgjegjësisë duhet theksuar se duke këmbëngulur për rastet e mospërbushjes së detyrimeve, duke injoruar kufirin ndarës mes përgjegjësive, në momentin që verifikohet dëmi dhe pasojat e tij, rritet, jo pak, ndryshimi midis veprimit kontraktor dhe veprimit deliktor, duke ndikuar arsyet praktike për zbatimin e rregullit të bashkimit (Monateri, 2001: 19).

Siç do të vërejmë, më pas, duke vazhduar me përgjegjësinë kontraktore që lind nga neglizhenca mjekësore deri te rastet e vdekjes, rezulton se viktimat, e cila nuk kishte asnjë lloj marrëdhënie me dëmtuesin përpara se ngjarja e dëmshme të ndodhte, është maksimalisht e mbrojtur, ndërsa, atje ku detyrimet e mbrojtjes kanë qenë subjekt i një marrëveshjeje të veçantë (ose i një marrëdhëniejeje kontraktore), në të cilën kufiri i parandalimit i përket një shkalle më të lartë parashikueshmërie të dëmit, i dëmtuari është shumë më pak i mbrojtur (nëse marrim rastin e transfuzionit të gjakut të infektuar ose rastin e sëmundjeve profesionale të shkaktuara nga ekzistenca e një marrëdhëniejeje të posaçme, siç është ajo e punës) (Viola, 2009:152). Për këto arsye, një qasje e tillë mbi përjashtimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore nga ekzistenca e përgjegjësisë kontraktore mund të themi se nuk ka vend.

KAPITULLI III

KUADRI HISTORIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË CIVILE QË RRJEDH NGA DËMI EKZISTENCIAL

Në bazë të koncepteve të përgjithshme të dhëna më lart do të analizojmë më afër figurën e dëmit jopasuror e në mënyrë më të veçantë të dëmit jopasuror, që konsiston në dëmtimin e aktivitetit realizues të individit në legjislacionin shqiptar. Duke iu referuar shkollës, sipas së cilës hetimi i një fenomeni juridik nuk mund të jetë i plotë nëse nuk njohim paraprakisht rrugën e tij historike, është parë e nevojshme që në këtë kapitull të jepet një ilustrim i shkurtër i evolucionit historik të përgjegjësisë juridiko-civile, që lind nga dëmi ekzistencial, parë nga Kodi i Parë Civil i vitit 1929, i njohur si Kodi Civil i Zogut deri te Kodi, që është aktualisht në fuqi ose kodi modern civil.

Duke nisur nga momenti i shpalljes së pavarësisë deri në nxjerrjen e legjislacionit kombëtar, nga ana e shtetit të ri të krijuar në Shqipëri vazhduan të zbatoheshin të njëjtat norma ligjore si edhe para shpalljes së saj (Fischer, 2004: 35). Kjo nënkuptonte që, e drejta osmane do të rregullonte çdo marrëdhënie juridike duke përfshirë edhe të drejtën e detyrimeve, e rrjedhimisht edhe fushën e dëmit (Omari, 2001: 304-306). Kodi Civil Osman i njohur ndryshe si Mexheleja ishte një përshtatje e rregullave të së drejtës romake, zbatimi i të cilave përse i përket komunitetit ortodoks administrohej prej krerëve të Kishës, që përveç të tjerave zgjidhnin të gjitha mosmarrëveshjet e natyrës civile dhe vërtetonin akte të ndryshe, siç mund të ishin testamentet, martesat, etj (Molla, 2015: 2).

Situata politike që u krijua brenda vendit, turbullimet e shpeshta, lufta e përgjithshme dhe okupacionet e huaja nuk premtuan krijimin e një legjislature kombëtare. Edhe austro-hungarezët në një raport të detajuar mbi organizmin e shtetit shqiptar të hartuar më 16 tetor

1913 ishin të mendimit se sistemi ligjor duhej transformuar në mënyrë graduale. Sipas këtij raporti, e drejta islame mbi familjen dhe trashëgiminë, e drejta private, institucionet eseciale, në të cilat e drejta ekzistuese në Shqipëri devijonte prej asaj europiane duhej që të ruheshin medoemos (Bello, 2013:3).

Në këto kushte por edhe për shkak të zhvillimit të ulët e mungesës së marrëdhënieve të ndërsjellta me vendet e zhvilluara një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë përshtaste jetën e saj sipas normave zakonore duke bërë që krijimi dhe rrënjësja e një filozofie kombëtare nëpërmjet kulturës së ligjit të ishte në nivele më të ulta nga ato që kërkoheshin (Molla, 2015:1).

Mbi politikën e ndjekur atëherë në procesin e transformimit dhe modernizimit të legjislacionit shqiptar nga ai osman në atë perëndimor duhej që të metat në këtë aspekt t'i plotësonte shkallë-shkallë dhe të përparonte në mënyrë evolutive duke mos imituar verbërisht, pa caktuar dhe pa fiksuar me logjikë një burim të huaj, duke mos i tronditur veprimet e përhershme të popullit, duke i lënë ato në rrjedhën e tyre, duke ndjekur natyrën dhe rregullat e evolucionit se veprimi në të kundërt nuk sjell veçse dëm (Dervishi, 2006:18).

Nga ana e saj, e drejta civile nuk zbatohet në mënyrë të njëjtë në gjithë territorin e vendit. Kështu në veri ushtronte veprimtarinë e saj Kisha Katolike, e cila zbatonte të drejtën kanonike, nga ana tjetër në bashkëti të tjera fetare, të vogla për nga numri vepronte e drejta zakonore siç ishte bashkësia ortodokse e ritit sllav (Floqi, 1913:2). Përsa i përket së drejtës zakonore në veri ajo mbizotërohej nga Kanuni i Lekë Dukagjinit (Gjeçovi, 1933:1). Ky Kanun përveç rrënjësjes në ndërgjegjen dhe psikologjinë e shqiptarëve të atyre zonave, nuk mund të mos bëhej më i njohur dhe të fitonte epërsi edhe për arsye se në vitin 1933 u

botua i përmbledhur si vepër postmortum e At Shtjefën Gjeçovit, i cili ndërkaq kishte vdekur në vitin 1929 (Molla, 2015: 2).

Me autoritet të dukshëm ishin dhe Kanuni i Skënderbeut, i Dibrës, i Bendës, etj. Ndërkohë në veri zbatimi i së drejtës zakonore lejohej edhe prej administartës turke, nëpërmjet veprimit të të ashtuquajturave zyra të Xhibalit. Ndërsa në jug, në fuqi ishte Kanuni i Labërisë, zbatimi i të cilit ishte zbehur ndjeshëm (Elezi, 2006: 13). Pavarësisht ndikimit të fortë të normave zakonore si e drejtë pozitive e detyrueshme për zbatim njihej Mexheleja (Bello, 2013:4).

Nevoja për të krijuar një të drejtë civile të brendshme të unifikuar, duke shmangur partikularizmin e së drejtës, zgjedhjen e një modeli legjislativ perëndimor modern e të përshatshëm me kushtet e vendit dhe qëndresën ndaj ndërhyrjeve të shteteve të huaja për të ndikuar në hartimin e legjislacionit, gjithmonë duke vlerësuar dhe pasur në konsideratë traditën, gjendjen juridike dhe mendësinë shqiptare në themelimin e institucioneve të ndryshme me natyrë civile, ishte urgjente (Rrahmani, 2012: 3).

Ideja e krijimit dhe e veprimit të një kodi civil modern në Shqipëri, për herë të parë është hedhur në vitin 1920. Kristo Floqi¹⁴, ndër juristët më të shquar të kohës botërisht kërkoi miratimin sa më të shpejtë të kësaj vepre shumë të nevojshme për popullin. Kjo ide ka qenë e bisedueshme në gjithë periudhën pasuese, deri në miratimin e hyrjen në fuqi të një legjislacioni modern, që do të përfshinte edhe kodet, ndër të cilët më kryesori ishte Kodi Civil (Molla, 2015: 6).

¹⁴ Kryetar i Gjykatës Penale dhe Politike të Vlorës

3.1 **KODI CIVIL I VITIT 1929**

Kodi Civil i vitit 1928 hyri në fuqi në kohën kur Shqipëria sapo kishte filluar të konsolidonte shtetin e saj pas një periudhe sundimi 5-shekullor nga Perandoria osmane. Kodi Civil i Shqipërisë u nxor në vitin 1929, kohë që i përket Mbretërisë së Ahmet Zogut, dhe është i inspiruar nga kodi civil francez, italian dhe ai zviceran. Ky kod mundësoi të rregullohen marrëdhëniet juridike-civile në mënyrë më të hollësishme (Gjilani, 2001:398). Mirëpo ndryshimet në sistemin juridik të Shqipërisë krijuan një legjislacion tjetër të pavarur të Shqipërisë pas vitit 1945, për të ndalur në një sistem juridik të pas viteve 1990 dhe të nxirret një Kod i ri Civil që konsiderohet modern.

Në këtë kod, instituti i shkaktimit të dëmit është trajtuar në Librin e Katërt *“Mënyrat e fitimit dhe të transmetimit të zotënimit dhe të të drejtave të tjera mbi sendet”*, Titulli II, Kaptina I midis neneve 1149-1160 të Seksionit VI.

Seksioni VI, me titull *“Veprimet e paligjshme”* hapet me klauzolën e përgjithshme mbi dëmin dhe mbyllet me detyrimin për shpërblimin e dëmit dhe disa llojeve të tij të njohura nga ligji. Në nenin 1149 parashikohet se: ***“Çdo faj që i shkakton tjetrit një dam, obigon damtuesin me shpërblye këtë. Këtë detyrim e ka dhe ai, që duke kapërcye në ushtrimin e një të drejte të vet, kufijtë e caktuem prej mirëbesimit ose prej qëllimit për të cilin i asht njoftë ajo e drejtë, i shkakton tjetrit një dam”***.

Siç del e qartë në pjesën e parë të kësaj dispozite, në të përcaktohet si i shpërblyeshëm çdo faj që sjell si pasojë shkaktimin e një dëmi, i cili përbën një kusht të përgjithshëm të përputhshëm me parimin e njohur si *neminem laedere*. Për lindjen e përgjegjësisë dhe rrjedhimisht detyrimit për shpërblimin e saj, në këtë kod kërkohet vlefshmëria e katër elementëve, kundërligjshmëria e veprimit, kryerja me faj e veprimit, shkaktimi dëmit dhe

vërtetimi i lidhjes shkaksore, që ekziston midis veprimit të kryer me faj, pavarësisht formës në të cilën shfaqet faji dhe pasojës së rrjedhur. Qëllimi i nenit 1149 të K.C.Z është caktimi i përgjegjësisë dhe rregullimi i marrëdhënies së re të krijuar nga fakti i dëmshëm.

Nisur nga kjo elementët përbërës të përgjegjësisë juridiko-civile paraqiten jo vetëm në elementë objektiv (fakti, dëmi, marrëdhënia shkaksore), por edhe elementë subjektiv (faji i shfaqur në formën e dashjes ose pakujdesisë). Por, ajo që konstatohet është që ligjvënësi nuk e përcakton se çfarë e bën një fakt të paligjshëm, që nënkupton se i lihet në çmuarje gjykatës për të vendosur rast pas rasti në qoftë se interesi çënuar është i denjë për t'u mbrojtur sipas rendit juridik dhe nëse cënimi krijon një dëm, që duhet të zhdëmtohet (Benussi,2012:39).

Përgjegjës mund të jetë subjekti si shkaktues dëmi ose një subjekt tjetër, që është në marrëdhënie të veçantë me shkaktuesin e dëmit, këto raste janë të përcaktuara nga nenet 1150-1158 K.C.Z, ku përfshihen veprime nga persona të pazotë për të vepruar, veprime të kryera nga persona në mbikqyre, veprime të kryera nga shërbëtorët dhe të prepozuarit, veprime të kryera nga kafshët në kujdesje, përgjegjësi kanë edhe pronarët e sendeve për dëmet e ardhura prej tyre. Në të gjitha këto raste mund të lind përgjegjësia që sot njihet me emrin përgjegjësi, që rrjedh nga dëmi ekzistencial.

Në dy raste, ligji përjashton subjektin nga përgjegjësia, kur dëmi është shkaktuar nga një person që nuk ka pasur mudësinë mendore çmuese në momentin e kryerjes së veprimit dhe i dëmtuari nuk ka mundur të shpërblehet prej atij që ka detyrimin për këtë (neni 1151 K.C.Z) dhe kur dëmi është shkaktuar në kushtet e mbrojtjes së nevojshmerr të vetes ose një tjetri (neni 1152 K.C.Z).

Në vijim të modeleve mbi bazën e të cilave është hartuar ky kod, ai nuk ka asnjë referencë të drejtëpërdrejtë të dëmit ekzistencial, por limitohet në figurën e dëmit moral dhe disa grupeve të tjera të drejtash, që më vonë janë konfiguruar brenda figurës së dëmit jopasuror, të cilat jepen në nenin 1160 të K.C.Z, si vijon: “ *Obligimi i shpërblimit përfshin gjithë damet materiale dhe **morale** që janë shkaktue prej faktit të paligjshëm. Veçanërisht gjyqtari mundet me caktue një shpërblim për flinë (viktimën), në rast **lëndimi trupor, cënimi në nderin ose në famën e tij ose të familjes së tij, dhunimi të lirisë personale ose të banesës** ose **të një të fshehte që i përket anës së lëndueme**. Gjithashtu, gjyqtari në rast vdekje të flisë mund të caktojë një shpërblim për gjinitë, krushqit ose bashkëshortin e tij si riparim për hidhërimin e pësuem”.*

Ajo që rezulton është që legjislacioni njeh për kompesim disa figura të dëmit të shkaktuara nga fakti i paligjshëm, që siç do të shohim më vonë nuk njihen dhe pranohen nga legjislacionet e mëpasshme deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil në vitin 1994. Për qëllim të analizës doktrimore dëmi moral i trajtuar në këtë dispozitë mund të përcaktohet si pjesë e dëmit ndaj personit dhe si pjesë e plotë ndaj një personi të dëmtuar .

Ndërkohë, doktrinat bashkëkohëse civile, italiane dhe franceze, prej legjislacioneve të të cilave është huazuar një pjesë e mirë e dispozitave të këtij kodi, përfshirë edhe rregullimi i përgjegjësisë nga fakti i paligjshëm, ishin përfshirë në një diskutim shkencor të shtrirë në dy drejtime: *së pari*, mbi pranueshmërinë ose jo të vlerës ekonomike të dëmit moral dhe *së dyti*, në ekzistencën ose jo të kufijve, brenda të cilëve gjykatat mund të ushtronin kompetencat e tyre (Costantini, 1873: 6).

Çështja e parë lidhej me parimin e prezumuar të vlerës financiare të shpërblimit, sipas të cilit kusht i vlefshmërisë së çdo detyrimi është kërkesa për shpërblimin financiar të

tij. Kriteri i vlerës financiare të shpërblimit ose material ose i interesit të konkluduar në një detyrim themelor, sipas orientimit dominues është elementi që mundëson përjashtimin e dëmit moral nga kompesimi. Në këtë kuadër konkludohet se dëmi moral nuk mund të shpërblehet sepse nuk mund të vlerësohet me kritere objektive në një shumë me para.

Sipas këtij orientimi të shprehësh në një shumë me para vuajtjen, ndjenjat e dhimbshme dhe në përgjithësi shkeljen e atyre vlerave që përbëjnë tërësinë morale të një njeriu, nuk është e mundur (Bonini, 1980:21). Natyra jopasurore e interesit të shkelur dhe mungesa e kritereve objektive të vlerësimit ekonomik të dëmit përbënin pengesë të çdo forme të kompesimit. Rrjedhimisht, shkaktimi i një dëmi jopasuror, në rast se parashikohet nga ligji, mund të ligjëronte shpërblimin e një të drejte.

Nga përcaktimi llojeve të figurave të dëmit që njihen nga neni 1160 të K.C.Z del se mund të shmanget lënia në dorë të gjyqtarëve caktimi i interesit të shkelur, spekulimi i tyre në këtë drejtim, gjë që është kundërshtuar nga studiuesit, të cilët në bazë të një kriteri të drejtësisë formale konsiderohet në kundërshtim me logjikën juridike konfigurimi i një mbrojtjeje kompesuese vetëm për shkeljen e të drejtave pasurore jo edhe për cënimet morale. Në këtë kontekst nuk mungonin ata që përkrahin idenë se shpërblimi i dëmeve jopasurore është më tepër një lloj kompesimi ose riparimi (Benussi, 2012: 52).

Ndërsa, nga ana tjetër qëndronin kundërshtuesit e këtij qëndrimi, të cilët ishin për zgjerimin e kompetencave të gjyqtarëve. Dyshimet i përkisnin kritereve të përdorur për të përcaktuar masën e kompesimit dhe riparimit, në mungesë të parashikimeve ligjore, që ligjërojnë gjykatësit të ushtrojnë një funksion të tillë. Më dësia e likuidimit të dëmit ndikonte mbi natyrën juridike të kompesimit, që kthehej në një lloj ndëshkimi ose

ndëshkim personal, ku zbatimi konkret i gjykatësit nuk rezulton i investuar nga ana e ligjvënësit, fuqisë së tij.

Në mungesë të dispozitave të posaçme ligjore rreziku i parashikuar nga doktrina mbi lirinë e pakushtëzuar të gjykatësit, vërtetohet. Megjithatë, kur jurisprudenza dominuese përkrah shpërblimin e dëmit moral dhe të shqetësimeve shpirtërore është një tregues që teoritë, të cilat kundërshtojnë zgjerimin e kompetencave të gjykatësve nuk janë të drejta. Pamundësia abstrakte e një vlerësimi objektiv finaciari të dëmeve morale nuk konsiderohej nga të tjerët si një pengesë e pakapërcyeshme për një shpërblim të mundshëm.

Një pjesë e jurisprudencës dhe doktrinës besonte se natyra e dëmeve të kompesueshme duhet të analizohet nën një optikë që vendos në qendër të rendit juridik më shumë se pasurinë, individin (Cendon, 2009 : 430). Në këtë periudhë historike, mud të lexohen vendime ose dhe studime, revolucionare për idetë e kofirmuara, që në një logjikë riinterpretimi të normave ligjore kanë konfirmuar se e drejta duhet të mbrojë njeriun në të gjitha dimensionet e tij, qoftë ideale, qoftë materiale. Në përfundim mund të themi se tema e shpërblimit të dëmit jopasuror, brenda së cilit është përfshirë edhe figura e dëmit ekzistencial ndërthuret me çështjen e përgjithsme të sistemit juridik në raportin mes individit dhe pasurisë, vlera e drejtësisë, shtrirja e kompetencave të rezervuara të gjykatësve (Benussi, 2012:168).

3.2 PËRGJEGJËSIA JURIDIKO-CIVILE PËR DËMIN EKZISTENCIAL SIPAS

LIGJIT NR.2359, DATË 15.11.1956 ‘MBI VEPRIMET JURIDIKE DHE DETYRIMET’

Kalimi drejt një sistemi socialist pas vitit 1944 u shoqërua me një numër të madh ndryshimesh, jo vetëm për sa i përket rolit që luante ideologjia tek e drejta, por edhe në

lidhje me konceptimin dhe zbatimin e së drejtës private në përgjithësi. Deri në fillimin e vitit 1957 legjislacioni civil shqiptar ka qenë krejtësisht i pasistemuar (Nathanaili, 1948:1). Pas kësaj periudhe, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.2359, datë 15.11.1956 *“Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”* në legjislacionin shqiptar të pasluftës së dytë botërore, për herë të parë trajtohet instituti i shkaktimit të dëmit si një nga burimet e detyrimeve (Gjika, 1960: 4-5) .

Legjislacioni civil i kohës si edhe ai në tërësi përmbante elementë të modelit sovjetik që nga legjislacioni, praktika gjyqësore dhe literatura juridike respektive, që pasqyronte rregullimin e marrëdhënieve brenda karakterit socialist të ekonomisë në interes të ngritjes ekonomike dhe kulture dhe të shtimit të mirëqënies së masave dhe punonjësve (Çela, 1957:2). Si një sistem i karakterizuar nga dy elementë thelbësor, individualizmi¹⁵ dhe shoqërizimi¹⁶, sistemi totalitar e shndërroi në një element të vetëm, në një shoqërizim të dhunshëm. Duke krijuar një fasadë të rreme duke ngritur në vlerë barazimtarinë dhe mohimin e vlerës individuale ose konstituimin e anti-individualizmit, duke e bërë më të vështirë ekzistencën dhe akoma më tepër mbrojtjen e të drejtave të qënësishme të individit (Nathanaili, 1957:4). Duke qenë se në këto të drejta përfshihet edhe mbrojtja nga dëmet jopasurore, brenda së cilit është konfiguruar figura e dëmit ekzistencial po analizojmë më poshtë qëndrimin që ka mbajtur ligji nr.2359, datë 15.11.1956 *“Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”* mbi këtë çështje (Sallabanda, 1957: 1) .

¹⁵ si tipar themelor i njeriut, që shpreh lirinë e tij natyrore dhe të drejtën e pakufizuar mbi gjithçka që e tndon dhe që ai mund ta arrijë

¹⁶ që është tipar i fituar, me vullnet ose pa vullnet, i njeriut të shoqërizuar, i cili teorikisht përmes tij fiton lirinë civile dhe pronësinë e gjithë asaj që zotëron

Instituti i shkaktimit të dëmit ligji i mësipërm e trajton në Kapitullin XXVIII, në nenet 472- 500. Neni 472 parashikon se “*Personi që me faj (me dashje ose nga pakujdesia) i shkakton tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar....*”. Nëse do t’i referohemi një interpretimi të gjerë të kësaj dispozite, atëherë do të kemi lindjen e detyrimit për shpërblimin e dëmit, që i është shkaktuar tjetrit në personin apo pasurinë e tij (Gjika, 1960: 2).

Në të gjithë dispozitat e mëtejshme legjislatori nuk ka përcaktuar se cilat janë rastet kur konsiderohet se një individ i është shkaktuar dëm në personin e tij. Pra, dëmi në dritën e një interpretimi të tillë është gjithëpërfshirës, pasuror dhe jopasuror . Dëmi pasuror, i cili shkakton pakësimin e të mirave të palës së dëmtuar mund të shpërblehet në të holla, rasti i nenit 488 të LVJD parashikon : “*Kur shkaktohet dëmtimi i shëndetit, personi që ka shkaktuar dëmin detyrohet të shpërblejë dëmin që ka ardhur nga humbja ose pakësimi i aftësisë për punë si dhe të shpërblejë shpenzimet e bëra përmjekimin dhe shpenzimet e tjera të bëra në lidhje me dëmtimin e shëndetit*” dhe rasti i nenit 489 të LVJD parashikon se “*Kur shkaktohet vdekja shpërblehet dëmi që kanë pësuar personat e mitur dhe të paaftë për punë, të cilët kanë qenë në ngarkim të të vdekurit plotësisht ose pjesërisht si edhe personat që kishin të drejtën e ushqimit prej tij.*” Çfarë nënkuptojnë të dyja dispozitat është që, në këto ngjarje kompesohen vetëm pasojat materiale të faktit të paligjshëm) , ndërsa dëmi që mund t’i shkaktohet personit në jetën, shëndetin, nderin dhe dinjitetin e tij sipas LVJD nuk kompesohen (Sallabanda, 1957:7).

Në ndryshim nga K.C.Z kushtet e vlefshmërisë për lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile të shpërblimit të dëmit, në rastin e LVJD janë të përfshira në dispozitën e përgjithshme të nenit 472 dhe lidhen me fajin (me dashje ose pakujdesi), dëmin, paligjshmërinë e kryerjes

së veprimit dhe lidhjen shkaksore që ekziston mes veprimit të kryer me faj dhe pasojës së ardhur .

Nëse marrim në konsideratë përkufizimin aktual që i bëhet dëmit jopasuror dhe i mbështetemi intepretimit të gjerë të nenit 472 të ligjit nr.2359/15.11.1956 deduktojmë përfundimin se dëmi ekzistencial ka qenë i njohur, edhe pse në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga legjislatori i atëhershëm (Floqi, 1951:2). Megjithatë duke njohur qëndrimet e jurisprudencës, të cilat ishin në zbatim të plotë dhe të përpiktë të orientimit të përgjithshëm të vijës së partisë, njohja e figurës së dëmit jopasuror nuk është bërë dhe mangësi në qëndrimet lidhur me këtë fakt ka edhe doktrina e kohës (Lole, 1979: 1).

3.3 LIGJI NR.6240, DATË 26.06.1981 “KODI CIVIL I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”

Me ndryshimin e Kushtetutës, që hyri në fuqi në 28.12.1976, me të cilën u ligjërua heqja e së drejtës së pronës private dhe kufizimi i një numri të madh të drejtash të tjera të njeriut nisi një periudhë e re qeverisjeje, e lidhur me formën e re të saj, atë të diktaturës së proletariatit. Me zhvillimet e reja ligjore në lidhje me sistemin e qeverisjes u ndie nevoja që ndryshimet e ndodhura të reflekttoheshin dhe në legjislacionin civil. Për këtë arsye u abroguan ligjet e mëparshme civile, të cilat njihnin dhe rregullonin edhe pronën private, të paktën formalisht, dhe u hartua një Kod Civil i mirfilltë, që u miratua me ligjin nr.6340, datë 26.06.1981 (Koçi,1981:1).

Në nenin 1 të K.C’81 legjislatori shprehet se : ”.... *Legjislacioni civil rregullon marrëdhëniet pasurore si edhe **marrëdhëniet personale jopasurore** ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave bujqësore, organizatave shoqërore, ndërmjet këtyre e*

shtetasve si edhe ndërmjet shtetasve”, pra një nga objektet e këtij ligji është rregullimi i marrëdhënieve personale jopasurore edhe pse në dispozitat vijuese të Kreu-t VIII të tij, që trajtojnë detyrimet që lindin nga shkaktimi dëmit, nuk parashikohet në asnjë rast shpërblimi i dëmeve më natyrë jopasurore. Kjo mesa duket është një gabim drejtshkrimor, më shumë se sa një harresë e përfshirjes së rregullimit të marrëdhënieve, që lindin në rastin e dëmeve personale jopasurore, siç është edhe rasti i dëmit ekzistencial, që mund të shkaktohet si në marrëdhëniet ndërmjet individëve ashtu edhe në marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe njërit prej subjekteve të përmendura në nenin 1 të LVJD (Kondi, 1989: 2).

Në përfundim, arrijmë në konkluzionin se nga përjashtimi që bëhet në pjesën e posaçme të K.C’81 mbi figurën e dëmit jopasuror nuk mund të flasim për dëmin ekzistencial si kategori përbërëse e tij.

KAPITULLI IV

PËRGJEGJËSIA CIVILE PËR DËMIN EKZISTENCIAL NË DRITËN

E KODIT CIVIL 1994

4.1 APLIKIMET FILLESTARE TË NENIT 608 TË K.C

Duke filluar nga vitet nëntëdhjetë, me hyrjen në fuqi të Kodit Civil instituti i përgjegjësisë civile është rindërtuar, por jo duke u mbështetur mbi sjelljet e paligjshme, por në lidhje me faktin e paligjshëm, duke bërë kështu jo vetëm një ndryshim të perspektivës (nga dëmtuesi – te i dëmtuari), por edhe kalimin nga një model në të cilin shpërblimi konceptohet si një sanksion për një sjellje të ndaluar, në një model që vendos në qendër funksionin riparues (Ponzanelli, 2004: 53). Pra, përgjegjësia civile, nga një instrument i përgjithshëm për mbrojtjen e interesave private, me objektiv ndëshkimin e fajtorëve të shkelësve të *neminem laedere*, merr rolin e një prej teknikave të mbrojtjes civile, me detyrë kryesore vendosjen e rregullave për të ndarë dëmin midis përgjegjësve (Alpa, 2010:3).

Ky konceptim i ri mbi sistemin bën të mundur interpretimin e risive kryesore ligjore me pasojë kryesore zgjerimin e fushës së veprimit të përgjegjësisë civile duke marrë në konsideratë elementët e gjykimit të përgjegjësisë fajin, dëmin e shkaktuar, paligjshmërinë e veprimit/mosveprimit dhe lidhjen shkaksore. Formulimi i nenit 608 të Kodit në fuqi përbën një përkthim pothuajse të njëjtë me formulimin e nenit 1382 të kodit të Napoleonit, në të cilin gjendet i shprehur, në aspektin e gjerë, parimi i përgjegjësisë për çdo akt të vullnetshëm dhe të dëmshëm ku thuhet “Çdo veprim i njeriut, që i shkakton dëme të tjerëve e detyron atë për shkak të pasojës së ardhur, të shpërblejë dëmin” (Nonini, 1980:2). Faji këtu jepet në kuptimin e gjerë, që nënkupton një veprim të kryer me paramendim për të

cënuar të drejtat e ligjshme të të tjerëve si edhe faktin e kryer me neglizhencë ose pakujdesi. Prandaj, kjo synon jo vetëm fajin në kuptimin teknik dhe shpreh rregullin e përgjegjësisë subjektive të autorit, por edhe ekzistencën e përgjegjësisë civile në rastin e përgjegjësisë për dëme të shkaktuara nga të tjerët (Gjata, 2010: 34).

Neni 625 parashikon se: *“Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetin e tij ose është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë”*. Përpara se të hyjmë në brendësi të kësaj çështje le të përqipemi të zgjidhim nyjen e interpretimit të tij duke shpjeguar kushtet e përgjegjësisë siç del e qartë nga kjo dispozitë, në një mënyrë ose në një tjetër për të zgjidhur dyshimet interpretative mbi zbatimin e nenit 625 ndaj çdo dëmi ose vetëm atyre pasurore .

Kodi Civil i vitit 1994 ka bërë dallimin midis përgjegjësisë civile që rrjedh nga mospërmbyllja e një detyrimi kontraktor dhe përgjegjësisë civile që rrjedh nga shkaktimi i dëmit (Semini, 2006a :153).

E para gjen zbatim në nenet 476-495, që i përket dëmit për shkak të mospërmbylljes së kontratës, në kapitullin që lidhet me detyrimet e përgjithshme, ndërsa e dyta rregullohet nga nenet 608-647 të K.C të titullit IV, Kreu I, titulluar *“Përgjegjësia nga shkaktimi i dëmit”*, në pjesën kushtuar detyrimeve që lindin nga shkaktimi i dëmit. Kjo bashkërenditje sistematike, shpjegohet me faktin se akti i paligjshëm në kuptim të nenit 419 është një burim i

deëtyrimeve së bashku me kontratën dhe çdo tjetër fakt ose veprim që mund të kualifikohet si i tillë sipas ligjit.

Sipas të kaluarës, disiplina e veprës civile është më e gjerë dhe e mirëartikulluar (Bianca , 1994:7). Hipotezat e ndryshme të përgjegjësisë indirekte, para se të përfshihen të gjitha në kuadër të nenit 168 të K.C janë të fragmentuara në: nenin 613 të tij, që përfshin dëmin nga të miturit dhe personat e pazotë për të vepruar; në nenin 615, që përfshin dëmin nga personat në mbikqyrje; në nenet 618,620,621,622 e 624 që bëjnë fjalë për përgjegjësinë për veprime të tjerëve.

Ka nene të reja, të cilat parashikojnë përgjegjësinë mbi veprimet e kundraligjshme në rastin kur gjykata mund të marrë parasysh në masën e uljes së dënimit për personin që në çastin e shkaktimit të dëmit nuk ka pasur ndërgjegjen e veprimeve të tij (neni 616 i K.C), shkakët e justifikimit të mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme, të reja parashikuar në nenin 612 ku parashikohet përjashtimi i plotë ose pjesshëm i një personi nga detyrimi për shpërblimin e dëmit kur provohet se dëmi ka ardhur si pasojë e veprimeve të kryera në kushtet e nevojës për të shpëtuar veten ose të tjerët nga një rrezik i çastit për një dëm të rëndë, rrezik i cili nuk ka qenë shkaktuar dhe as nuk mund të mënjanohej prej tij, përgjegjësinë e veçantë të personit që angazhohet në veprimtari të rrezikshme (neni 622), një nen i posaçëm për dëmin pasuror (neni 625) dhe disa parashikime në lidhje me shumën e dëmeve që do të analizohen më poshtë.

Por, tashmë me përdorimin e terminologjisë mund të shihet një ndryshim i parë përsa i përket kalimit të përcaktimit: përveç braktisjes së termit ‘delikt’ dhe dallimit të dukshëm me ‘kuazi-deliktin’, dallim që është konsideruar si i parëndësishëm në kuadër të kodit të mëparshëm, në kodin e ri nuk bëhet më fjalë për ‘veprim të paligjshëm’ por, për ‘fakt të

paligjshëm'(Nuni, 2004:107). Kjo risi, që nuk ka kaluar pa u vënë re ose gjykuar, madje edhe një gabim i legjislacionit, evidenton një ndryshim në të ardhmen.

Vlen të theksohet se në optikën aktuale, individualizimi i Kodit të vitit 1929 tërhiqte vëmendjen mbi sjelljen e autorit, të faktit të ndodhur e në mënyrë të veçantë mbi sjelljen e vullnetshme që në respekt të një ndjenje subjektive të fajit, vlerësohej në terma të përgjegjësisë morale, në sistemin aktual vëmendja është zhvendosur mbi faktin e dëmshëm (Benussi,2012: 52).

Kodi aktual thekson braktisjen e konceptit etik të përgjegjësisë civile që dallon në të sanksionin kundër ndërgjegjes dhe shkeljes vullnetare të një urdhërese ligjore dhe në të njëjtën kohë të një detyrimi moral (Semini, 2003: 2).

Qëllimi i legjislatorit vendos në vend të parë atë të përshkrimit të një sistemi përgjegjësie objektive dhe subjektive të faktit të dëmshëm ndaj personit duke vendosur kriteret për ngarkimin e faktit një personi (nenet 608-639). Këto kritere përfshijnë edhe veprimin e drejtëpërdrejtë që synon të përcaktojë ngjarjen e dëmshme ose të paktën mundësinë për ta shkaktuar atë ashtu edhe supozimin për një pozicionim material ose juridik që është me rëndësi sipas ligjit, për shkakun e ngjarjes (Hetemi,1998: 36).

Sistemi i vënë në zbatim nga kodi aktual vijon në linjën e vazhdimësisë së të kaluarës në lidhje me kriterin e përgjithshëm të përgjegjësisë subjektive të faktit të paligjshëm, që mbetet ajo e fajit siç parashikohet edhe nga neni 608 (Meka, 1949: 7). Çfarë ndryshon është domethënia e fajit në kuptimin që një nocion kryesisht subjektiv i fajit zëvendësohet gradualisht falë punës së jurisprudencës, nga një nocion i tipit objektiv, që identifikon fajin nga mosrespektimi i rregullave të kujdesit, që ballafaqojnë shoqërinë në mbrojtje të një

bashkëjetese paqësore përtej çdo hetimi mbi përgjegjësinë morale të autorit për faktin e dëmshëm të ndodhur (Kondili, 2008: 186).

Për shkak të kësaj nevojë ka rënë dakort ligjvënësi i 1994 që, përveç se të diktojë një parashikim të veçantë mbi përgjegjësinë për riskun në tregti¹⁷, ka parashikuar disa prezumime të fajit , detyrimin për t'u përgjigjur për veprime të tjerëve dhe disa hipoteza të përgjegjësisë për shkak të lidhjes shkaksore që ekziston në rastin në fjalë.

Në këtë ndryshim mund të shihet si shenjë e një evolucioni drejt një përmase kolektive të problemit të përgjegjësisë civile: riparimi i shkeljes së integritetit të situatave të njohura nga ligji bëhen një çështje me interes të përgjithshëm (Dauti, 2004: 167).

Megjithatë, këto konsiderata nuk mund të çojnë në pranimin e konceptit teknik të përgjegjësisë jashtëkontraktore, me të cilin me anë të një analize ekonomike të së drejtës provohet racionalizimi i disiplinës sipas kriterëve efikase. Në fakt, nuk është e mundur të të reduktohet problemi i përgjegjësisë civile në një problem të alokimit të burimeve ekonomike mbi bazën e llogaritjeve kosto/përfitim (Luarasi, 1998: 132).

Këto studime mund të jenë të dobishme për qëllim të politikës ligjore në kërkim të kriterëve të shpërndarjes të humbjeve ekonomike më të dobishme individualisht ose shoqërisht më pak të dëmshme për komunitetin, por që janë larg nga të dhënat pozitive. Këtu vazhdohet ende të lidhet ideja e përgjegjësisë civile me një formë të mbrojtjes civile të të dëmtuarit kundrejt një sjelljeje antiligjore të dëmtuesit (Bacache-Gibeilli, 2012: 51). Përgjegjësia presupozon shkeljen e paligjshme të një urdhërimi që detyron respektimin e

¹⁷ Neni 622 i K.C në bazë të të cilit “*Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin , përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme dhe të nevojshme për mënjanimin e dëmit*”

ligjit (*alterum non laedere*) dhe ky detyrim për respektim është i sanksionuar nga norma e përgjithshme e nenit 608 të K.C.

Nenet 613-615 dhe 618-624 të K.C bëjnë fjalë për përgjegjësinë indirekte, ajo që rrjedh jo prej veprimeve të subjektit që është përgjegjës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, por prej veprimeve të personave të tjerë për të cilët ai ka përgjegjësi ligjore. Për të marrë përsipër përgjegjësnë civile dhe shpërblimin e dëmit nuk mjafton vetëm kryerja e një veprimi sipas kuptimit të mësipërm, por duhet gjithashtu edhe të vërtetohet ekzistenca e një dëmi në kuptimin juridik (Skrame, 2011: 523).

Dëmi si element i veprës civile parashikuar në Kodin Civil mund të gjendet në dy kuptime : dëmi si shkelje e të drejtave të mbrojtura nga ligji dhe dëmi, pasojat e të cilit janë të matshme në terma ekonomik. Në fakt, më shumë se një koncept i dyfishtë i dëmit, kemi të bëjmë me dy momente të ndryshme të gjykimit akuilian, ndërtimi i ambjentit të përshtatshëm për të përcaktuar përgjegjësinë dhe përcaktimin e dëmit të shkaktuar që do të jetë objekt i kërkesave për kompesim (Cendon, 2009b: 784). Në mënyrë të veçantë, në kuptimin e parë dëmi përkon me ngjarjen ligjore të dëmshme dhe bazuar në këtë moment ngrihen çështje të përgjegjësisë, si objektive dhe subjektive (kjo për problemet mbi shkaqe të ngjashme me ato penale), ndërsa kjo e fundit presupozon zgjidhjen e problemit të atribuimit të përgjegjësisë dhe përcakton elementët mbi bazën e të cilëve bëhet përlllogaritja e dëmit (Cendon, 2009a:43).

Pra, duke u kthyer në analizën e normave themelore të mbrojtjes në rast të përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit në kodin në fuqi nga interpretimi i nenit 608 kemi që, çdo dëm që rrjedh nga një veprim i fajshëm duhet të dëmshpërblehet.

Interpretimi tradicional i nenit 608 të K.C jep cilësimin e ‘fakt i paligjshëm i kryer me faj’ vetëm për rastin e një shkeljeje të një të drejte subjektive. Ky është proces konceptues që paligjshmërinë e veprimit ose mosveprimit, siç thuhet edhe në nenin 608, e sheh si përbërës kryesor të përgjegjësisë civile dhe që duhet marrë në të dy kuptimet e dëmit si një produkt i një veprimi/mosveprimi ‘jo sipas ligjit’ ose ‘në kundërshtim me ligjin’ që do të thotë se ajo që mbrohet është ajo që paraqitet në formën e të drejtës subjektive të përsosur (Semini, 2003:6). Kërkesat e reja të mbrojtjes konkrete dhe të përbashkët të marrëdhënieve sociale e kanë çuar jurisprudencën të jetë e ndjeshme në lidhje me temën e shkeljes së interesave duke përparuar në zgjerimin e konceptit të kompesimit në rastin e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit (Corsaro, 2001:154). Një hap i parë i rëndësishëm në këtë drejtim është hedhur nga njohja e shpërblimit jo vetëm si e drejtë absolute, por siç besohet tradicionalisht edhe si e drejtë relative (Busnelli, 2010: 6).

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit është identifikuar, në fakt, jo vetëm për shkelje të të drejtave absolute por edhe në rastin e shkeljes së të drejtave relative, atëherë kur dëmi ndaj të tretëve ndikon në të drejtën e kreditorit sipas kritereve që rregullojnë lidhjen që ekziston midis veprimit/mosveprimit të kundraligjshëm dhe dëmit (Ferri, 1990: 17). Kjo u pasua nga njohja e shpërblimit nga pozicione të ndryshme juridike, të cilat në të drejtën subjektive nuk kanë pasur qëndrueshmëri, por që në jurisprudencë herë pas here është trajtuar dhe mbrojtur edhe e drejta e integritetit të pronës.

Hapi tjetër i kulturës juridike ka qenë njohja e kompesimit për shkelje të të drejtave me natyrë pasurore në marrëdhëniet familjare dhe si pjesë përbërëse e fakteve, në të cilin dallimi midis kërkesave dhe aspiratave që mund të cilësohen si ‘legjitime’ dhe pritshmërisë për të

drejtat e pambrojtura, gjendet i pasqyruar brenda parimeve etiko-sociale për solidaritet familjar dhe zakonor (Favilli, 2004: 41).

Në thelb, statusi i së drejtës subjektive ka shërbyer si vello justifikuese për situatat heterogjene, të pambuluara, në këtë kuptim, dilema interpretuese rreth normës primare apo sekondare të nenit 608 të K.C, primare si normë me funksion ndalimin dhe sekondare si normë me funksion sanksionin. Mund të themi se për argumentin e parë interpretues, neni në fjalë mishëron një klauzolë të përgjithshme të shprehur si ‘dëm’, nga e cila nënkuptojmë se është i dëmshpërblyeshëm vetëm dëmi i kryer me faj dhe në mënyrë të paligjshme duke marrë në konsideratë dëmin që ka ndodhur në personin apo pasurinë e tij, gjë e cila shkon përtej çështjeve të kompesimit (Zaka, 2006:317). E njëjta qasje logjike, më parë e përmendur duke ju referuar të drejtës subjektive ka ‘filtruar’ kërkesat për dëmshpërblim të interesave të mbrojtura tradicionalisht nga neni 608 i K.C (Dauti, 2004: 167).

Nga shqyrtimi mbi konsistencën e interesit material të bazuar në interesin legjitim, që nuk lind vetëm duke u kërkuar nëpërmjet një procesi gjyqësor, por që ka dhe një natyrë bazike, në kuptimin që lidhet me një interes material të titullarit të një të drejte shkelja e së cilës mund të pasojë lindjen e një dëmi ku edhe pse merret në konsideratë mbrojtja e një interesi të ligjshëm dhe dallimi nga e drejta subjektive është vetëm mënyra ose masa me të cilën interesi material merr mbrojtje (Hetemi, 1998:41).

Ndikim të veçantë praktik ka ndryshimi midis ‘interesave të kundërt’ dhe ‘interesave të pretenduar’, sipas këtij të fundit mbrojtja jepet në mënyrë që të evitojë një parandalim të pafavorshëm ose favorshëm; duke marrë parasysh se në rastin e parë përmbushen kërkesat ligjore në fushën e të drejtave personale dhe pasurore të subjektit, kërkesat e fundit të zhvillimit të fushës së të drejtave personale dhe pasurore të të njëjtit subjekt, jurisprudenca

ka zgjedhur një mënyrë interpretimi, i cili përfaqëson edhe një mundësi të vlerave duke i dhënë hapsirë kompesimi interesave të kundërta dhe hipotezave në të cilat autoritetet kanë dështuar për të kryer mbikqyrjen ose informimin ose kryerjen gabimisht të çertifikimit duke çuar në dëmtimin e palëve të treta, për të rikonfirmuar në kuadër të parimit të moskompesueshmërinë së interesave të ligjshme: e gjithë kjo e parë në optikën tradicionale të nenit 608 të K.C ku tendenca në rritje është për zgjerimin e fushës së kompesimit (Gjata, 2010:45). Kjo konfirmohet dhe shpjegohet teorikisht duke argumentuar se masat e instrumentave shtetërore do të ndikojnë të drejtat individuale “te zbehura”, kështu që, duke anuluar normën që ushtronte të ashtuquajturin presion, e drejta subjektive ringjallte edhe pse me mangësi, në këtë lloj dëmi freskim të së drejtës (Fiandaca, 2009:167).

Pranohet se, dëmshpërblimi i të drejtës së *‘dobësuar-zbehur’* dhe se gjendja e vërtetë e të drejtës origjinale, e të drejtës subjektive krijuar nga një masë e kundraligjshme është anuluar më pas nga gjykata me fuqi prapavepruese (Fiandaca, 2009:168).

Siç shihet, teknika e pranimit të veprimeve të përgjegjesisë, edhe pse me mënyrat e veçanta janë shumë të ngjashme, është përdorur për të zgjeruar fushën e dëmshpërblimit të parashikuar në nenin 608 të K.C në marrëdhënien midis palëve dhe ngritjen e figurave të caktuara që mbrojnë interesat ligjore (të larmishme për përmbajtjen dhe formën e mbrojtjes) të të drejtave subjektive.

Zgjerimi i mëtejshëm i parimit përfshin abuzimin me kompetencat e lirisë së të vepruarit (më konkretisht Gjykata e Lartë flet për shkelje të të ashtuquajturve kufij të jashtëm të gjykimit) abuzimet e supozuara në të cilat instrumentat institucionalë kanë dështuar në drejtim të mbikqyrjes ose të dhënies së informacionit në lidhje me to ose gabimisht kanë kryer veprimtarinë e ligjërimit të tyre duke i shkaktuar dëme palëve të treta

(V.U.Gj.L nr.6, 2011:7). Nevoja për të njohur një të drejtë personale që lind, siç e shohim, diktohet qartazi nga dëshira për të mos dalë nga fusha e disiplinës tradicionale të nenit 608. Një përjasje analoge bëhet edhe në lidhje me hipotezën e Kodit Civil për të ashtuquajturin ri-zgjerim, nga e cila rrjedh edhe e drejta personale e mbrojtur nga një vendim i gjykatës, që ka anuluar aktin e mëvonshëm, i cili ka pasur në objekt favorizimin e pozitës së palës së dëmtuar (Alpa, 2010: 103).

Në historinë e jurisprudencës së Gjykatës së Lartë është e mundur për të gjetur edhe raste në të cilat është njohur kompesimi i interesave të ligjshëm të pretenduar, sidomos në rastet në të cilat është kryer edhe një vepër penale. Nga rastet e jurisprudencës në lidhje me situatat e dëshpërblimit, Gjykata e Lartë në vendimin nr.04, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara argumenton se nuk mund të neglizhohet më, sepse nga leximi korrekt i nenit 608 të K.C rezulton qartë rëndësia e dëmit, që parashikohet për kompesim kur dëmi shkaktohet në personin ose pasurinë e tij, ndërsa faji i sjelljes i përket personit që e ka shkaktuar atë.

Fusha e dëmshpërblimit nuk është përcaktuar, konfirmohet edhe rregullat e tjera, prandaj ligjëron të drejtat (që rezulton në përgjegjësi për shkaktimin e dëmit për situata shumë specifike që konsiderohen nga legjislatori si të denja për t'u mbrojtur) e një klauzole të përgjithshme e shprehur nga termi 'dëm i padrejtë' me anë të të cilit është i kompesueshëm dëmi që ka karakteristikat e të padrejtit dhe dëmi i kryer 'kundra ligjit' dallohet nga dëmi i shkaktuar në mungesë të një lidhjeje të arsyeshme ('jo ligjore'), që rezulton në shkelje të një interesi të caktuar . Nuk mund të kundërshtohet më, ritheksojmë se norma mbi përgjegjësisë akuiliane nuk është normë (sekondare) që sanksionon një sjellje të ndaluar nga norma të tjera (primare). Norma primare bën riparimin e dëmit padrejtësisht të

shpërblyer nga një person për veprime të shkaktuara nga të tjerët (Alpa, 2010:327).. Pra, në përmbledhje të karakteristikave të përgjegjësisë akuiliane mund të themi:

- Nuk kërkon lehtësim përfundimtar klasifikimi formal i pozitës juridike të pëlqyer të subjektit;
- Padia për dëmshpërblim ngrihet vetëm për dëme në lidhje me personin ose pasurinë e tij, e cila përbën një rast të veçantë, që karakterizohet nga shkelja e një interesi të mbrojtur ligjërisht;
- Interesat e mbrojtura identifikohen me një dinamikë të ponderuar ‘*aposteriori*’ karakteristike e veprimit të kundraligjshëm për të cilin flet neni 608 i K.C, e cila konsiderohet si normë primare për mbrojtjen.

Për Gjykatën e Lartë si detyrë e gjykatësve (në pjesën përshkruese të vendimit, ajo që dikur quhej si ‘dekalog’ e vendimit në fjalë) për të aktualizuar mbrojtjen e nenit 608 të K.C, del si e nevojshme të bëhet një përzgjedhje e interesave ligjore sepse vetëm shkelja e një të drejte që rezulton nga një procedim i tillë mund të rezultojë në një dëm ‘të panevojshëm’ dhe kjo do të mundësojë krijimin e një gjykimi që krahason interesat në konflikt, pra, interesin efektiv të personit që është dëmtuar dhe të interesit që sjellja e dëmshme e autorit synon të konfirmojë se sakrifica e interesit të të dëmtuarit e justifikon në realizimin e interesit të kundërt të personit që ka shkaktuar dëmin, për shkak të mbizotërimit të tij (Corsaro,2001: 143).

Krahasimi dhe vlerësimi nuk duhet të vihet në diskrecion të gjykatës, por të përfshihet në të drejtën pozitive në mënyrë që të konstatojë nëse, me këtë qëndrueshmëri dhe intesitet, ligji i siguron mbrojtje interesit të të dëmtuarit me dispozita të veçanta (duke e zgjidhur nga themeli konfliktin në rastin e interesit të mbrojtur nga forma e së drejtës

subjektive veçanërsiht kur bëhet fjalë për të drejta të garantuara nga Kushtetuta ose të drejta të personalitetit) ose me ndonjë mënyrë tjetër (të ndryshme nga mbrojtja kompesuese) duke demonstruar kështu nevojën për mbrojtje (në këtë rast zgjidhja e konfliktit të interesit me atë të kundërinteredit i është besuar për zgjidhje gjykatës, e cila do të përcaktojë nëse ka pasur një prishje ‘të drejtë’ të ekuilibrit ndërpersonal duke e rivendosur nëpërmjet kompesimit).

Në mënyrë të veçantë, në rastin e konfliktit midis interesit personal të ndjekur nga interesi privat dhe interesit ultrapersonal të ndjekur nga administrata publike, zgjidhja jo domosdoshmërisht përcaktohet nga cilësimi i interesave konfliktuale të ndryshme, prej nga, mbizotërimi i interesit ultrapersonal, në lidhje me sakrifikimin e atij individual, mund të ndodh vetëm nëse veprimet administrative janë në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe mirëadministrimit dhe jo kur vjen në kundërshtim me to (Fiandaca, 2009:451).

Nëse normativa mbi përgjegjësinë akuiliane ka sanksion të riparimit të dëmit dhe është i padrejtë, dëmi që nuk mund të tolerohet mbetet në ngarkim të viktimës, por që transferohet mbi kryerësin e dëmit sepse cënon interesat ligjore, pavarësisht kualifikimit të tyre formal, asgjë nuk mund të përjashtojë kompesimin edhe të interesit të ligjshëm (Alishani, 2008: 16).

Gjykata e Lartë ka përcaktuar kushtet e mundësisë së një kërkesë për dëmshpërblim sipas nenit 608 të K.C duke kodifikuar procesin vlerësues-motivues të gjykatësit, kjo duhet në fakt të qartësojë çështjen konkrete nëse janë shkak për skemën e rregulluar nga neni 608 të K.C dhe për këtë arsye duhet të vazhdojë të kryejë hetimet e mëposhtme:

- Duhet të sigurohemi nëse ka një ngjarje të rrezikshme’
- Të vazhdohet të konstatohet nëse dëmi kualifikohet si dëm i padrejtë i shkaktuar në personin apo pasurinë e të dëmtuarit, që përbën një interes të mbrojtur nga e drejta

subjektive (absolute ose relative), ose në formën e një interesi legjitim ose një interesi tjetër të mbrojtur ligjërisht

- Duhet të pranohet patjetër, nën profilin shkaksor, duke aplikuar njohjen e kriterëve të përgjithshme, nëse ngjarja e dëmshme i referohet mosveprimit të administratës publike.

Duke iu referuar veprimtarisë së administratës publike duhet të vlerësojmë se nëse kjo kryen shkelje të parimit të paanshmërisë, të drejtësisë dhe të mirëadministrimit mbi të cilat duhet të bazohet veprimtaria e saj dhe që gjykata e çmon, mund të rezultojnë si kufij të jashtëm të gjykimit.

4.2 KUSHTET PËR LINDJEN E PËRGJEGJËSISË JURIDIKO-CIVILE PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT SIPAS K.C

Pjesa më e madhe e evoluimit të sistemit të përgjegjësisë jashtëkontraktore bazohet mbi interpretimin gjuhësor të nenit 608 të K.C (Bagolini, 1958:6). Në përfundim, problematikat kryesore të çështjes mbështeten mbi pikat në vijim:

- Si strukturohet veprimi i paligjshëm në fjalë në përbërësit e tij ose mundësia dhe dobia e një ndarjeje të tillë para çdo njësie të secilit fakt.;
- Nëse norma në fjalë ka karakter primar ose është përjashtim nga rregulli edhe pse ka karakter të përgjithshëm, një rast i shkeljes ose duke marrë rolin e një norme sekondare, kërkon integrimin në një sistem integrimi, me norma që, në specifikën e çdo sektori të rregulluar ndalojnë sjellje të caktuara të dëmshme duke e klasifikuar atë si ‘*contra legem*’ (të kundraligjshme);
- Funksioni i vet normës dhe roli i fajit;
- Mbi cilat kriteret klasifikohet ‘kundërligjshmëria’ e faktit.

Ndërsa, në pikën e parë të analizës thuhet se analiza e ardhshme e përgjegjësisë civile zbatohet duke identifikuar elementët e dëmit mbi teknikën, e cila nuk është përjashtuar qoftë edhe në eksperiencën që vjen nga e drejta e krahasuar: kjo sepse parë nga një këndvështrim sistematik, epistemologjik dhe jo më pak didaktik, një shpërbërje e çështjes në elementë e shpjegon situatën, ndërsa në këndvështrimin praktik kontribuon në qartësinë e të drejtës (Alpa, 2008:373).

Pra, për këto arsye të analizës dhe për të kuptuar rastin në fjalë përgjithësisht, shpërbëjmë çështjen në elementë në bazë të kriterëve të paracaktuara ose në bazë të kërkesave (Maiorca, 1990:468).

Struktura që del më e qartë përcakton si elementë : faktin ose veprimin; elementin e fajit, i përbërë nga dashja dhe neglizhenca, edhe pse në disa rrethana ligji i përjashton këto elementë, dëmin e padrejtë. Meqë disave u janë shtuar faktorët identifikues të ligjshmërisë dhe kundraligjshmërisë, duket shumë analitik ky shtim i elementëve përbërës të përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit, duke mënjanuar aspekte që është më mirë për t'i lidhur me subjektin përgjegjës ose në mënyrë të nënkuptuar të përfshijë vetëm tre elementët përbërës të mësipërm (kundërligjshmëria është një konotacion i veçantë i faktit dhe dëmit). Integruese është edhe teoria që vendos krahas elementëve të mësipërme edhe elementin specifik të lidhjes shkaksore (Nuni, 2012:98).

4.2.1 Veprimi /Mosveprimi i kundraligjshëm

Evolucioni historik i kundërligjshmërisë së veprimit ose mosveprimit të kundraligjshëm prej dekadash konsiderohet duke u shkëputur nga e shkuara dhe nga

kërkimet e lodhshme në fushën e dëmit (Barcellona, 2011: 13). Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.12, datë 14.09.2007 mbi interesat legjitime qëndron në këtë linjë të vazhdimësisë, me shumë merita dhe disa mospërputhje. Ajo që kërkohet edhe nga neni 608 ka të bëjë me kufijtë e sjelljes të cilat duhet të jenë deri në kufirin që të mos kualifikohen si të paligjshme. Ajo paraqet në rastin e detyrimit të përgjithshëm të përgjegjësisë kërkesën për kundërligjshmërinë. Debati mbi kundërligjshmërinë në përgjegjësinë civile është në harmoni me qëndrimet e Rudolf von Jhering një nga përfaqësuesit e dëgjuar të shkollës historike. Në konceptin e Jhering kundërligjshmëria dhe shkelja e një norme të sjelljes, është rezultat i shkeljes së të drejtës së tjetrit e kryer me faj (Jhering, 1990:12).

Elementi i parë i përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit është fakti, i cili nënkupton ngjarjen që shkaktohet nga personi përgjegjës për dëmin, siç deklarohet edhe në nenin 608 në lidhje me ngjarjen e ndodhur, duke e emërtuar jo me këtë term, por duke përdorur termin veprim ose mosveprim (që nënkupton një sjellje të njeriut) sepse për disa forma të përgjegjësisë, dëmi i padrejtë është i lidhur me një ngjarje natyrore (p.sh dëme të shkaktuara nga gjëra në kujdestari) ajo që ka rëndësi është që, ajo shihet e lidhur me personin që e ka shkaktuar atë ose që kishte për detyrë për ta parandaluar atë (Nuni, 2012: 99).

Kur dëmi është i lidhur me një sjellje të njeriut ai mund të jetë si në formën e veprimit ashtu edhe në formën e mosveprimit (në këtë të fundit personi është i detyruar të kryejë një veprim të caktuar ose të parandalojë një ngjarje specifike) të kryer me vullnet të lirë dhe në mungesë, të nevojës për kryerjen e tij (prezenca e këtyre dy elementëve të cilat teknikisht kualifikohen si arsyetime ose justifikime parashikohen shprehimisht nga neni

608, paragrafi 2 dhe neni 609); referimi në bazë të justifikimit flet për një supozim mohues apo se sjellja që ka shkaktuar detyrimin dhe sjellja që ka shkaktuar lindjen e përgjegjësisë duhet të jetë e paligjshme, jo e ndaluar dhe të jetë e padrejtë, atëherë nuk ka vend mbrojtja e interesave të njohura ose në ushtrimin e pushtetit legjitim (vihet theksi mbi shkaqet e tjera justifikuese si përmbushje e një detyrimi ose ushtrimi i një të drejte, sipas kuptimit të dhënë më sipër).

Në doktrinën gjermane kanë qenë të ndryshme kuptimet mbi kundërligjshmërinë. G.Wagner e identifikon kundërligjshmërinë me shkeljen e së drejtës së të tjerëve (Wagner, 2005: 42) siç parashikohet në nenet 823 e 826 të BGB dhe nenin 608 të K.C duke iu referuar të drejtës civile shqiptare, në këtë mënyrë mbetet e pashpejguar ndajfolja *widerrechtlich*, që nënkupton se kundërligjshmëria ekziston kur mungojnë arsyet ose shkaqet e ndodhjes së veprimit/mosveprimit.

Duke u pajtuar me kundërligjshmërinë në brendësi të çështjes së përgjegjësisë përfundon në një *superfetazione*¹⁸ ose edhe në një përfundim kontradiktor në raport me kuptimin në të cilin përkthehet kundërligjshmëria (Bell, 2006 :9).

Kundërligjshmëria tregon dhe përkon me mungesën e arsyetimeve, e cila paraqet mungesën e autorizimit të gjykimit të mbrojtjes së shkeljes së të drejtave të të tjerëve duke shprehur kështu një nga elementët përbërës së përgjegjësisë civile jashtëkontraktore (Basso, 2015:9).

Mbrojtjes së të drejtave të tjetrit nuk i nevojiten elementë shtesë përtej kritereve për ekzistencën e përgjegjësisë (kjo përfundon me njohjen kur konfirmohet se për shkak të ligjit përgjegjësia dhe kundërligjshmëria janë në raportin shkak-pasojë dhe bëhet fjalë për

¹⁸ nga latinishtja *Super*-shumë, mbi dhe *foetus* nga *foetus*, fetus: produkt dhe zhvillim i një fetusit të dytë pas ekzistencës së një fetusit të parë, shtesë e panevojshme, përsëritje e panevojshme, shtesë e një pjese mbi një ndërtesë tashmë të përfunduar e bërë për të rregulluar vijën fillestare të ndërtimit

një efekt të ndërmjetëm kualifikimi, veprimi i kryer me dashje ose nga pakujdesia që lind shkaktimin e një dëmi si pasojë e shkeljes së një të drejte është i kundërligjshëm pasoja finale për të ekzistuar përgjegjësia) : njëri ose tjetri janë të mjaftueshëm për të klasifikuar sjelljen si të kundërligjshme (Franzoni, 2010:877).

Në fakt, prania e një shkakut të arsyeshëm që përjashton autorin nga përgjegjësia e mënjanon sjelljen nga kundërligjshmëria. Më saktë është jo-kundërligjshmëria që del si kërkesë autonome dhe si element parandalues i përgjegjësisë. Prej nga, konfirmimi i disiplinës së arsytimit, përdorimi i një prej tyre nënkupton mungesën e kundërligjshmërisë dhe prej aty bara e provës përse i përket elementëve parandalues të përgjegjësisë rëndon mbi dëmtuesin (Corsaro, 2001:66).

Kundërligjshmëria bëhet element thelbësor i përgjegjësisë jashtëkontraktore kur problemi përmban midis të tjerave shkeljen e një norme (Monateri, 1998:406).

Shpjegimi për këtë, që për ne tingëllon e çuditshme është i tipit historik: paragrafi parë i nenit 823 të K.C rezulton nga shkelja e paragrafit të parë të nenit 704 të K.C të projektit të parë, që adoptonte një model të ashtuquajtur francez, sipas të cilit përgjegjësia lind nga një veprim ose mosveprim i kundërligjshëm i kryer me dashje ose nga pakujdesia që i shkakton të tjerëve një dëm (Sandrock, 2009: 201). Në këtë normë kundërligjshmëria konfirmohet si tipar i përgjithshëm i përgjegjësisë jashtëkontraktore duke zënë vend si tregues i të drejtave personale për shkeljen e të cilave flet neni 608 i K.C.

Pas miratimit të kësaj të fundit, parashikimi i kundërligjshmërisë mbetet ndërkaq në tekstin e normës, del e tepërt pjesa e shkeljes së të drejtave të tjetrit, që nëse është e vërtetë nuk ka si të mos jetë e kundërligjshme edhe nëse kundërligjshmëria nuk ekziston kur shoqëron një element shtesë për ta justifikuar atë.

Edhe Kodi zvicerian i detyrimeve i vitit '41 e rregullon çështjen e dëmit sipas mënyrës që e rregullon Kodi francez në të njëjtë mënyrë me nenin 823 të BGB (Bürgerliches Gesetzbuch- Kodin Civil Gjerman) dhe në të njëjtën rrjedhë me nenin 1294 të ABGB (Allgemeines bürgerliches Gesetzbuch – Kodi Civil i Austrisë) që përdor formulën e 'widerrechtliche Beschädigung', që duke e përkthyer do të thotë 'dëm i padrejtë', por Beschädigung nuk nënkupton fjalën dëm, por shkak i dëmit, pra të shkaktuarit e dëmit është një sjellje e kualifikuar si widerrechtliche, pra e kundërligjshme ose kualifikimi si i kundraligjshëm i dëmit (Serio, 2007:40-42).

Në mënyrë analoge neni 914 i Kodit Civil grek, bashkëkohës me Kodin Civil italian të vitit 1942 parashikon detyrimin për shpërblimin e dëmit që është shkaktuar në mënyrë të kundraligjshme dhe lidhja me kundërligjshmërinë komentohet si shkak për të shtuar një kërkesë më tepër në lidhjen midis dëmit dhe fajit (Sandrock, 2009:125). Në mënyrë më të qartë Kodi Civil i vitit 1966 në nenin 483, paragrafi 1 detyron për shpërblimin e dëmit atë që me faj dhe në mënyrë të kundërligjshme shkel një të drejtë të tretëve ose një normë juridike që mbron një interes të personave të tjerë.

Në fund Kodi Civil hollandez i vitit 1992 e përkufizon veprimin e kundraligjshëm si shkelje të një të drejte të tjetrit dhe veprimin ose mosveprimin që bie në kundërshtim me një detyrim ligjor ose me një rregull të pashkruar në marrëdhëniet shoqërore përveç kur i jepet një shkak i arsyeshëm (Schwenzer, 2006: 36).

Ky përkufizim është i njëjtë me atë që legjislacioni shqiptar jep në nenin 608 të Kodit Civil në fuqi, që e konsideron paligjshmërinë si një nga elementët përbërës të ekzistencës së përgjegjësisë jashtëkontraktore.

4.2.2 Faji

Për të dhënë një shpjegim të shkurtër mbi elementët e fajit, si paraqiten në përgjegjësinë jashtëkontraktore, dashja tregon qëllimin e veprimit të shkaktuar dhe ndahet në moment vullneti dhe në moment ndërgjegjësimi dhe vetdijeje (Chironi, 2012: 16). Veprimi ose mosveprimi duhet të jetë vullnetar e të kryhet nga personi përgjegjës, ndërsa ndërgjegjësimi dhe vetdija duhet të tregojnë karakteristikat e dëmit të padrejtë, i cili, gjithashtu duhet të dijë se sjellja duhet të jetë e pranuar (kur ngjarja e dëmshme nuk është dëshiruar, por rreziku i ndodhjes së saj është i mundur për t'u parashikuar). Veprimi i kryer me faj është pasojë e një sjelljeje nga pakujdesia (p.sh kur shkelen rregullat e një profesioni të caktuar), një veprimi të kryer me neglizhencë (i kryer pa kujdes dhe i kryer nga inercia dhe mungesa e kujdesit) ose i kryer jo në përputhje me normat sociale dhe ligjore (Alpa, 2010: 257).

Konfirmohet se përgjegjësia civile i njeh llojet e përgjegjësive civile, të përkufizuara si objektive (një shembull që vlen të theksohet është marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës) që e kapërcen qëllimin dhe subjektive ose fajin. Në kuadër të hipotezave të hedhura në lidhje me natyrën e lidhjes shkaksores është hedhur poshtë parimi i përkufizuar më parë si '*conditio sine qua non*' (shkak pa të cilin – çdo veprim është element shkakësor nëse, pa të, rindërtohet edhe njëherë rasti, pasoja nuk do të verifikohej, për t'u klasifikuar në kategorinë arsyetuese të 'shkakut të ligjshëm' është përfundimisht i lidhur me një akt fakti që sipas standarteve të normave objektive dhe sociale sjell si rezultat pasojën) dhe të 'rrezikut specifik' të një situate dëmi lidhet me një veprim të caktuar dhe që krijon të njëjtën pasojë në mënyrë krejt të veçantë, në thelb koncepti dhe karakteristikat personale të lidhjes shkaksores variojnë midis aktit dhe ngjarjes, e cila ka si pasojë një dëm pasuror ose

jopasuror, përkundrazi në normën në fjalë çështja merr karakteristika parësore duke nënvizuar një sistem të pazakontë në të cilin vendoset jo vetëm dënimi, por edhe detyrimi, edhe pse jo në mënyrë shumë të qartë bazuar në teknikën e ‘klauzolës së hapur’ ose duke e kthyer zgjidhjen e rastit konkret në një balancë të kujdesshme të shkallës së ndikimit dhe rëndësisë ligjore të interesave në fjalë pa u vënë në kundërshti me kriteret sociale të vendosura për këtë rast (Bacache, 2012: 702).

Siç do të verifikohet dhe në rastin e faktit të kundërligjshëm del e qartë se formulimi i nenit 608 të K.C shpreh drejtëpërdrejtë dhe në mënyrë të cilësuar rastin e përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit, pa pasur nevojën për të ekzistuar dispozita të tjera që shprehin ndalimin e një sjelljeje të caktuar. Pra, bëhet fjalë, në të njëjtën mënyrë siç u tha më lart për të gjetur, brenda gjykimit, si në rastin e interesave të mbrojtur, prej nga rrjedh detyrimi për dëmshpërblim dhe në rastin e konfliktit të interesit, të dyja të drejtat konkurojnë (liria ekonomike e një sipërmarrjeje edhe në rastin kur iu duhet të përdorin makineri që mbartin një shkallë rrezikshmërie nga njëra anë dhe detyrimi për mbrojtje të shëndetit të punonjësve nga ana tjetër, në shembullin e marrë, me përjashtim të qëndrimeve tradicionale, ajo që është më e zakonshme është mbrojtja e të drejtës për shëndetin). Çfarë duhet të përkufizojmë është funksioni i veprës së kundraligjshme dhe dënimi që pason atë.

Një qasje tradicionale i dha rëndësi momentit të kontrollit dhe dënueshmërisë kundrejt sjelljes duke vënë theksin në aspektet parandaluese dhe ndëshkuese të llojit dhe veprave të kundraligjshme; pasi kjo mori formën e një gjykimi qortues, që zgjidhjen e zhvendos në drejtim të caktimit të personit përgjegjës duke u bazuar kryesisht në parimin e fajit duke mos përjashtuar dhe duke u fokusuar te nevoja për kompesimin e të dëmtuarit (Bonini, 1980: 56).

Dispozita e përgjithshme që parashikohet në nenin 608 të K.C ka si kriter përcaktimin e përgjegjësisë në ekzistencën e dëmit, të fajit të kryer me dashje ose pakujdesi, e cila na bën të besojmë se vet faji mund të jetë elementi i njohjes së vlerës së përgjithshme, kjo në shqyrtimin e mëtejshëm, që edhe në ndryshim të barrës së provës, e cila identifikohet në mënyrë specifike në kushtet që detyrojnë të verifikohet që nuk ka mundur të ndalojë faktin të ndodh, në përfundim, raste të sjelljeve të tilla duhet të kthehen duke tejkaluar hipotezat përjashtuese të përgjegjësisë objektive ose të përgjithshme (Dauti,2004:168). Në thelb, interpretimi i kësaj hipoteze flet për parimin ‘nuk ka përgjegjësi, nëse nuk ka faj’.

Në thelb të saj ekziston një nocion mbi fajin si qëndrim psikologjik mbi sjelljen, një qëndrim i brendshëm për të kontrolluar dhe për të kryer një reagim të shpejtë ndaj sistemit; aspekti i dënimit moral dhe juridik thekson qartë profilet punitive të sistemit të përgjegjësisë. Mungesa e qasjes tradicionale vendos në pozitë më pak të favorshme të dëmtuarin, kjo njihet ndryshe si parimi ‘monist’ (Ihering, 1990: 124). Kjo hipotezë, e përgjegjësisë për dëmin e padrejtë, që është vënë në dukje ndaj qortimit të veprimit të kryer me faj ka shfaqur pazotësi për t’i atribuar një vlerë gjithpërfshirëse, përballë jo vetëm hipotezave numeroze të përgjegjësisë objektive të kërkuara nga ligji, por mbi të gjitha duke pasur parasysh rëndësinë ekonomike dhe sociale të tyre.

Një qëllim më i kujdesshëm i institutit të përgjegjësisë civile jashtëkontraktore nuk mund të mënjanojë rastet sociale, që kanë për qëllim rritjen e rolin riparues të tyre duke i përputhur me kriteret riparuese të dëmit jo domosdoshmërisht të lidhur me fajin, por duke u karakterizuar nga solidariteti shoqëror e duke pasur parasysh bashkëpunimin me institutin e përgjegjësisë së mekanizmave të mbrojtjes dhe rregulloreve në fushën e siguracionit. Ajo pason, gjithashtu, një zgjerim të të drejtave në lidhje me dëmin dhe mbrojtje më të madhe

për të dëmtuarin. Një drejtim interpretues është përpjekur për ta vendosur në një pozitë të barabartë fajin dhe përgjegjësinë objektive, duke e vendosur problemin e llogaridhënies duke u nisur nga kjo e dyta (Rodota, 2015:7).

Suksesi i kësaj qasjeje, që mund të emërtohet si ‘bipolare’ rrjedh nga një teori interpretative që e vendos sistemin e përgjegjësisë nga njëra anë nën kontrollin etik të sjelljes së kryer me faj dhe nga ana tjetër (për përgjegjësinë objektive) mbi mundësinë e një rreziku të papritur si psh. në rastin e një veprimtarie tregtare. Në këtë kuptim, në bazë të funksionimit kontrollues për veprime që paslindin përgjegjësinë nga shkaktimi i dëmit janë bashkuar, duke krijuar kështu të ashtuquajturin binomin teoriko-shpjegues, në përgjigje të ndarjes së dëmit në funksion të rreziqeve shoqërore, të cilat janë të pashmangshme në bashkëveprimet e përditshme, që përcaktojnë shfaqjen (bëhet fjalë për rreziqe që ne vet mund t’i kryejmë ose të jemi objekt i tyre) e riskut reciprok. Në bashkëjetesën me rreziqe të tillë shoqëria, që rregullohet nga norma ligjore ose gjysmë-ligjore, ka vendosur norma të sjelljes së arsyeshme, shkelja e të cilave sjell si pasojë ekzistencën e dëmit dhe përfshin marrjen e përgjegjësisë nga ana e personit përgjegjës (Viola L., 2007:259).

Kur norma të tilla shkelen dhe si pasojë shkaktohet një dëm, kostot e tij duhet të përballohen nga dikush. Binomi faj-risk shikohet nën optikën e një vizioni korrigjues ose shpërblyes të dëmit dhe të një teknike ligjore të zgjidhjes për të cilën legjislatori ose gjykata duhet të vendosë procedurat e identifikimit të pasojave të riskut dhe masës së dëmit (Viney, 2008: 472). Mbi këtë diskutim flitet për parimin e solidaritetit shoqëror dhe ‘favorizimin’ e viktimës, që është më e dobët, duke u mënjanuar në përgjegjësinë objektive nga parimi i fajit për t’i lënë vend vetëm lidhjes shkaksore midis sjelljes së subjektit, mbi të cilin bie barra e efekteve të rrezikshme të ngjarjes dhe dëmit (Darbellay, 1955:413). Nuk

mund të anashkalohen disa interpretime të paqarta të kësaj teorie, megjithatë, në praktikë, rezulton mungesa e një lidhjeje të fortë në ligjin aktual që premtun rastin e përgjegjësisë objektive, e cila nuk jep të dhëna për zbatimin e kriterit urdhërues dhe unifikues.

Një pasqyrë e funksioneve dhe teknikave interpretative pasuese në aspektin e përgjegjësisë civile nuk mund të mos llogarisë antitezat e saj radikale, për shkak të kategorive konceptuale të përmendura më lart, me udhëzimet që i japin përparësi, në mbështetje të kanuneve juridike, në analizën ekonomike të së drejtës, që synon krijimin e një sistemi që stimulon sjellje efikase. Nga kjo pikëpamje përgjegjësia civile shërben për të ndikuar akt-kryesit të marrin parasysh dëmet nga veprimet ose nga mosveprimet e tyre që i shkaktojnë të tjerëve. Këto dëme në gjuhën e ekonomisë njihen si ‘kosto të jashtme’ (Fortino,2009:61).

Për të integruar rastet e mbuluara nga neni 608 i K.C legjislatori kërkon eksistencën e elementëve të atribuimit të dashjes ose pakujdesisë të përcaktuar në bazë të intepretimt literal të dispozitave ekuivalente ligjore (parimi ose të ekuivalencës mes dashjes ose të ashtuquajturës mungesës së lidhjes së pakujdesisë). Sipas këtij parimi, tradicionalisht, është argumentuar se brenda sistemit tonë të së drejtës çdo dëm i rimbursueshëm do të ishte prezent edhe në prani të një pakujdesie të të dëmtuarit (Gjika, 1960:2).

Duke qenë se në Kodin Civil nuk ka një përkufizim mbi fajit, të shfaqur në dy format e tij (dashje ose pakujdesi) do t’i referohemi Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë në nenet 14,15 e 16 të tij sipas të cilit quhet me faj personi që kryen veprën me dashje ose me pakujdesi. Faji i parashikuar nga neni 608 i K.C përkon me fajin e përgjithshëm të dhënë në nenin 14 të K.P (Elezi, 2004: 111).

Në këtë pikpamje sjellja do të jetë e kryer me faj kur kryhet me ndërgjegje dhe vetdije për të pasqyruar lindjen e një dëmi, duke pasur si qëllim kryerjen e një veprimi të kundraligjshëm dhe dëshiruar shkeljen e të drejtave të një personi tjetër. Në përputhje me nenin 14 të K.P faji ekziston edhe kur ngjarja edhe pse parashikohet nuk dëshirohet nga autori dhe rrjedh si rezultat neglizhenca, pakujdesia ose vetbesimi i tepruar ose dështimi në zbatimin e ligjeve, rregulloreve ose urdhrave . Në këtë rast subjekti reagon duke përjashtuar masat paraprake për të shmangur shkeljen e të drejtave të të tjerëve. Në kundërshtim me këtë neni 608 K.C kërkon ekzistencën e dashjes ose pakujdesisë pa dhënë shpjegime të tjera. Megjithatë, ekziston një kategori e veprimeve të kundraligjshme që lindin përgjegjësinë jashtëkontraktore, që përfaqësohen vetëm nga një sjellje e kryer me faj. Në këto raste pakujdesia, dëmi nuk mund të konsiderohet si i kundraligjshëm dhe si rrjedhojë nuk do të jetë një fakt i kundraligjshëm burim i detyrimit për kompesim. Elementi i fajit, në fakt, do të ndikonte në vlerësimin e paligjshmërisë duke rezultuar në një ndërhyrje neto midis elementëve të ndryshëm strukturor, të domosdoshëm për ta bërë të kompesueshme sjelljen e kundraligjshme (Elezi, 2004:112).

Në këtë këndvështrim, pakujdesia përveç se është një element për atribuimin e përgjegjësisë civile është edhe një element për matjen e shkallës së përgjegjësisë. Nga ana e ligjit janë disa rastet që konsiderohen si ‘domosdoshmërisht pakujdesi’ sepse si të tilla janë parashikuar nga ligji, kështu p.sh përgjegjësia e pronarit. Ndonjëherë nuk është legjislatori që parashikon kryerjen domosdoshmërisht me faj të veprës, por është jurisprudenca që e merr në konsideratë këtë (këtu është integruar analizë e vendimit 1210, datë 23.05.2013 i Gj. Së Apelit Tiranë)

Ky fenomen është hasur edhe në disa çështje, dënimi i të cilave është bërë mbi bazën e normave penale, si p.sh është rasti i premtimit për lidhjen në martesë mes një çifti dhe pastaj shfrytëzimi për prostitucion i bashkëshortes, duke i shkaktuar edhe dëm ekzistencial. Në këto raste, në thelb gjykohet ekzistenca e fajit të përgjithshëm, që nënkupton atë që dëshirohet dhe dihen se me anë të sjelljes së kundraligjshme plotësoshen kushtet e parashikuara për lindjen e përgjegjësisë jashtëkontraktore, por jo më pak, në disa raste, kjo nuk do të ishte e mjaftueshme, duke e vlerësuar si të nevojshme një faj specifik, që konsiston në një qëllim apo një objektiv final të veçantë dhe të mëtejshëm që subjekti veprues synon të arrijë, duke mos vënë në dukje faktin që kjo me të vërtetë ka ndodhur: mes tyre përfshihen veprimet që rrjedhin nga konkurrenca e pandershme, që si qëllim kryesor ka shkaktimin e dëmit të subjektet konkurruese për rastet e parashikuara nga neni 638 i K.C.

Reflektimet në lidhje me veprimet domosdoshmërisht të shkaktuara nga pakujdesia janë të rëndësishme për sa i përket temës me objekt sa më lart shpjeguar, sipas atyre që i shkaktojnë një dëm familjarëve do të përfshiheshin në kategorinë e përmendur më lart, fillimisht marrim në shqyrtim një vendim të gjykatës së Apelit të Milanos, Itali që ka ngarkuar me detyrimin për shpërblimin e dëmit një grua, e cila i kishte fshehur atësinë e vërtetë të fëmijës bashkëshortit me qëllim ndarjen nga e fejuara e asaj kohe. Gjykata ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke e konsideruar të nevojshëm prezencën e elementit psikologjik të fajit duke theksuar se bashkëshorti që ka ndërmarrë zgjidhjen e martesës, që nuk është konsumuar mund të kërkojë nga tjetri shpërblimin e dëmeve vetëm nëse provon fajin e palës tjetër. Megjithatë duket se pjesa më e madhe e rasteve në praktikën gjyqësore nuk e merr në konsideratë këtë kërkesë të nevojshme. Për të kuptuar nëse vepra brenda

familjes përfshihet apo jo në kategorinë e mësipërme duhet marrë parasysh fakti se sipas disave, domosdoshmëria e ekzistencës së fajit, larg nga përcaktimi i një mbrojtjeje të reduktuar të të dëmtuarit, do të sillte në vend të kësaj një mbrojtje më intensive (Alpa, 2003: 259).

Thënë me fjalë të tjera është e nevojshme shmangia e vendosjes përballë të zgjedhjes së riparimit të një dëmi vetëm të kryer me faj, me atë që e pranon këtë mundësi edhe në prezencë të një sjellje të fajshme, duke qenë e dukshme në këtë rast, mbrojtja minimale që i është njohur të dëmtuarit në hipotezën e parë. Duhet të marrim në konsideratë një këndvështrim tjetër: në ato fusha në kufijtë e të cilave ndërgjegja juridike nuk është akoma gati për përgjegjësi e bazë faji, është e preferueshme që t'i ngarkohet përgjegjësia personit që ka vepruar me dashje dhe papërgjegjshmëri në çfarëdo lloj kostoje (Castronovo, 2006:386).

Figura e veprës së kundraligjshme e kryer me faj është përdorur me objekt kryerjen e veprës me faj dhe në mënyrë të papërgjegjshme me çfarëdo lloj kostoje në të shkuarën, për të tërhequr në fushën e asaj që është e rëndësishme në planin akuilian në raste të ndryshme të rëndësishme nga ky këndvështrim. Kështu p.sh, veprimet e kryera në kuadër të konkurrencës së pandershme, në të shkuarën konsideroheshin si të ligjshme në kuadër të iniciativës së lirë ekonomike, sot përfshihen në zonën, që juridikisht konsiderohet si veprim i kryer me dashje për shkeljen e të drejtave të konkurrentit (Cassano, 2012:585).

Kjo zgjedhje lejon futjen në fushën juridike të sjelljeve të caktuara, që ndryshe nuk do të kishin humbur rëndësinë për mbrojtjen e interesave të të dëmtuarit. Kjo lejon zgjerimin e fushës së dëmit të kompesueshëm duke pasur në qendër mbrojtjen e të dëmtuarit (Fortino, 2009:). Zgjedhja relative e kriterit për përgjegjësinë bazohet në fakt, në

elementin e fajit kur mbi bazën e hierarkisë së vlerave të nxjerra nga sistemi juridik do të vendosej në krye të të drejtave që është titullar dëmtuesi përballë atyre që është titulluar i dëmtuari ose ku të drejtat e ushtruara nga dëmtuesi përfshihen mes atyre të drejtave që, kur i nënshtrohen kontrollit të parametrave të kujdesit përfundojnë duke humbur pjesërisht ose plotësisht vlerën e tyre. Në këtë të fundit bie në një lloj “imuniteti” ndaj subjektit që shkakton dëmin, duke u justifikuar me rëndësinë e njohur të veprimit të kryer, që konsiderohet si thelbësore për individin ose shoqërinë (Franzoni b,2009:103).

Në raste të tjera, kur qëndrimi gjyqësor është bllokuar duke u çmuar si i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave absolute të individit për të integruar kërkesat e kundërligjshmërisë, elementi psikologjik i fajit i kombinuar me pasojën e dëmshme zëvendëson mungesën e të parit. Rrallë ka ndodhur që për veprimet e paligjshme që kërkojnë ekzistencën e elementit të fajit të kërkohej domosdoshmëria e elementit të dashjes (Mazzola, 2007:150).

Prandaj, sipas disa qëndrimeve falë kësaj teknike do të zgjerohet fusha e veprimit të veprës së kompesueshme të sjelljeve në fushën e moskompesimit, ndërkohë, sipas disa të tjerave, në këtë mënyrë do të vërtetohej në të njëjtën kohë, nga njëra anë, një tërheqje në fushën e veprimeve të kundërligjshmërisë së sjelljeve, që në të kundërt do të ishin të ligjshme dhe nga ana tjetër një reduktim i fushës së veprimeve të kundërligjshme duke përjashtuar ato fakte që nënkuptojnë veprime të kryera me faj (Mancini, 2015: 35). Përtej këtyre konsideratave nuk është e pranueshme që të konsiderohen shkeljet e të drejtave mes familjarëve domosdoshmërisht të kryera me dashje, duke njohur në këtë rast rëndësinë e sjelljeve vetëm nëse karakteristikat e elementit psikologjik të dashjes do të shkaktonin zhvendosjen e vëmendjes nga i dëmtuari tek dëmtuesi (Maiorca, 1990: 209).

Në këto kushte, së pari do të humbiste kuptimi i funksionit të parë të riparimit zhdëmtues, që synon riparimin e dëmeve që ka pësuar viktimja duke përfunduar duke i dhënë rëndësi të madhe rasteve të tipit ndëshkues me një qëndrim të kundërt, duke iu referuar praktikës ligjore për mungesën e funksionit dënues të përgjegjësisë civile. Së dyti, del e nevojshme për një supozim të sjelljes, domosdoshmërisht të kryer me dashje në kundërshtim me disiplinën e përgjithshme dhe që nuk mbështetet në një bazë ligjore që ta justifikojë, çfarë nxit hipotezën në të cilën i dëmtuari mund të kërkojë mbrojtje (Giardina, 1993:155-156).

Nëse kjo ndahet me qëllimin që të sigurojë një mbrojtje më të madhe të të dëmtuarit konsiderojmë se deri në këtë moment interesi i të dëmtuarit dhe ai i dëmtuesit duhet të kenë të njëjtën peshë në bilancin vërtetues, përpara një veprimi të kryer me dashje ana e peshores do të jetë në favor të të parit duke përcaktuar në këtë mënyrë kundërligjshmërinë e veprimit. Megjithatë, përkundër dhe në vijim, do të konsiderohej vepra domosdoshmërisht e kryer me dashje jashtë rasteve të paparashikuara nga ligji, duke u shprehur se në çdo rast edhe kur interesat e shkelur të kenë humbur dominimin në krahasim me dëmin, ky nuk mund të konsiderohet si i kundraligjshëm sepse mungon elementi psikologjik i dashjes (Visintini, 2005:94).

Dëmi i shkaktuar nga sjellja e njeriut nëpërmjet një veprimi të kryer me faj parë në këtë optik mbetet në ngarkim të dëmtuesit më një dallim të dukshëm përse i përket veprimeve të kundraligjshme që i shkaktojnë një dëm palëve të treta. Pa marrë në konsideratë që, edhe në rastet kur veprimet janë kryer me pakujdesi ka vështirësi në të provuarin dhe rindërtimin e këtij elementi për shkak të delikatesës dhe veçantisë së

kontekstit në të cilin sjelljet kryhen për të bërë të mundur kundërshtimin e pretendimeve të të dëmtuarit (Perlingieri, 2007:667).

Duke kërkuar elementin psikologjik të fajit për shkelje të shkaktuara një familjari do të pasqyronte tendencën sipas të cilës bëhet thirrje për të ashtuquajturën mashtrim për të dalë nga fusha juridikisht të parëndësishme, duke u dukur si një ndryshim orientimi i tepruar duke kaluar nga marrja në konsideratë e paragjytimeve të tilla, të parëndësishme juridikisht, në njohjen e tij si burim i një detyrimi kompesues në prani të një sjelljeje të kryer vetëm me faj.

Megjithatë, duke përfshirë faktin që nuk ekziston asnjë imunitet mes familjarëve dhe duke mos e cilësuar siç bëjnë disa, që është pikërisht nevoja për veprimin me natyrë dashjeje, që përfaqëson imunitetin e vërtetë në fushën e marrëdhënieve familjare, duhet mbajtur parasysh që, duke kaluar të gjitha pengesat që ndalonin në mbrojtjen kompesuese që të jap kontribut në familje, nuk është më e nevojshme të krijohet hapësirë deri në kufijtë e papërshtatshmërisë juridike deri në manovrat e lartpërmendura (Corsaro, 2001:143). Duhet, pra, të jetë mjaftueshëm i kryer me faj një veprim për ta përfshirë në rastin në fjalë. Edhe nëse është e kufizuar vendi i rezervuar për fajin që kanë të bëjnë me një fushë në të cilën vështirë se gjërat ndodhin rastësisht, prandaj nuk shohim përse ta mohojmë apriori këtë mundësi. Një zgjedhje në kuptimin e kundërt, më e favorshme, për dëmtuesin, nuk do të ishte e pranueshme duke pasur parasysh gjendjen e të drejtave të shkelura (Viola, 2010:119).

4.2.2.1 Kufijtë e rregullave të përgjithshme të përgjegjësisë me faj

Individualizimi i një “sistemi” për dëmin ekzistencial ka kaluar fillimisht nëpërmjet një rruge më tradicionale, pra duke iu referuar përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit të parashikuar nga Kodi Civil, në mënyrë të veçantë duke u nisur nga norma “e hapur” që konsiderohet neni 608 i K.C. Kjo dispozitë, e cila evidenton në formë atipike, llojin e veprimeve të kryera me dashje ose nga pakujdesia shfaqet shumë shpejt si joefikase në lidhje me problemin e personave të dëmtuar, për të dhënë provë të elementit subjektiv të dashjes apo pakujdesisë dhe i të njëjtit problem që shkakton dëmin (Gjata, 2010:124).

Rastet e praktikës gjyqësore evidentojnë për këtë qëllim një hap përparimtar në drejtim të prezumimit të fajësisë. Në planin historik, duhet të kemi në konsideratë që legjislacioni civil ka një peshë veçanërisht vendimtare për të prodhuar një tejkalim të vërtetë, edhe konceptual të fajësisë edhe në dritën e analizës së studiuesve (Trimarchi, Castronovo e Carnevali) është denoncuar inefiçensa e modelit të përgjegjësisë me faj duke theksuar rastet në të cilat përgjegjësia objektive është propozuar si një zgjidhje preferenciale për një shpërndarje të kostove të tregut dhe për një mbrojtje sa më të mirë të viktimës (Basso, 2015:34).

Kalimi gradual nga rregulli i përgjegjësië objektive drejt një objektivizmi paraparak të kriterit të fajit ku diskutohet për dëmin e drejtëpërdrejtë është bërë duke iu ngarkuar një përgjegjësi dhe duke ndryshuar qartë detyrimin për barrën e provës sipas nenit 608 të K.C.

4.2.2.2 Objektiviteti (mishërimi) i fajit

I ashtuquajtur ‘mishërim’ i fajit për sektorët e referimit në kriteret e fajit nuk i përket vetëm përgjegjësisë për dëmin ekzistencial, por është tregues për një seri zhvillimesh në fushën e përgjegjësisë civile. Mund të sjellim në vëmendje një vendim të rëndësishëm dhe

të njohur të Gjykatës së Apelit së Milanos (Itali), i cili konfirmoi se: Në rastin e sipërmarrjes, kriteri i kujdesit, si në fushën kontraktore dhe në fushën jashtëkontraktore, nuk mund të lidhet vetëm me natyrën e marrëdhënies dhe të aktivitetit, që zhvillon pala dëmtuese (Ponzanelli, 2004:44).

4.2.2.3 (PARIMI) *Prezumimi i fajit*

Për të hapur rrugën, përtej dëmit, të kriterëve dëshmuese që mund të kualifikohen nga neni 608 i K.C dhe ndaj një favori më të madh pasues drejt palës së dëmtuar vlen V.U.GJ.L 12/2007 me të cilin Gjykata e Lartë, pas miratimit të doktrinës parashtrohet një parim të rëndësishëm: atë të përgjegjësisë direkte të subjektit dëmtues kundrejt palës së dëmtuar duke favorizuar përgjegjësinë jashtëkontraktore përballë asaj kontraktore .

Pra, bëhet fjalë për të përcaktuar modelet e fajit, jo mbi parime etike apo kontrolli, por për të kërkuar sjellje të mira në kuptim të efikasitetit sepse janë të volitshme dhe të përshtatshme. Faji vepron në aspektin e parandalimit, që ndikon mbi të dëmtuarin duke i imponuar sjellje të kujdesshme brenda kufirit që është e lidhur me fajin e të dëmtuarit. Faji ka kuptim, atëherë kur krijon stimul mbi sjelljen e palëve dhe përcakton një strukturë të sjelljes bazuar në kriteret e parandalimit dypalësh (Scognamiglio, 2010:42). Në këto raste kriteri i efikasitetit kthehet në një vlerë komplekse të kontekstit në të cilin një veprim i dhënë përfshihet; disa herë ajo konkludon se asnjë sjellje nuk mund t'i imponohet viktimës së mundshme dhe që një cilësi e sistemit të prodhimit nuk mund të ndahet nga kriteri i solidaritetit, në këto raste janë të rrënjosura supozimet e përgjegjësisë objektive. Kjo e bën të dëmtuarin përgjegjës për dëmet duke marrë parasysh, veç e veç, sasinë dhe cilësinë e veprimeve të tij në kufijtë e parandalimit (Ponzanelli,2004:). Në fakt, nuk ka asnjë veprim

parandalues që të mund të shpëtoj dëmtuesin nga përgjegjësia apo të imponojë ndonjë standart të kujdesit mbi viktimën, i cili nuk thirret për asnjë lloj bashkë-përgjegjësie (Rodotà,1964:140). Teoria, që kombinon përgjegjësinë dhe efikasitetin e ekonomike argumenton që duhet të plotësohen tre kushte, që përgjegjësia objektive të klasifikohet si një instrument efikas që minimizon kostot sociale të dëmit: teknika e parandalimit duhet të jetë e njëanshme; kompesimi i viktimës duhet të jetë perfekt; duhet të qartësohet paraprakisht kush është i dëmtuari i mundshëm dhe kush është viktimja e mundshme.

Interesi i ligjshëm duhet të kuptohet si pozitë e favorshme e një personi në lidhje me një të drejtë që është subjekt i një mase administrative dhe që konsiston në atributin, që çdo subjekt kompetent mund të influencojë në ushtrimin e duhur të pushtetit, në mënyrë që të bëjë të mundur realizimin sa më të mirë të mbrojtjes së të drejtës (Viola, 2009:194).

Me fjalë të tjera, interesi i ligjshëm del në pah kur interesi vetjak për të pasur ose për të ruajtur një të drejtë krahasohet me pushtetin administrativ dhe të administratës shtetërore për të përmbushur interesat ose për t'i sakrifikuar ato (Alpa,1982:367).

Kompesimi, edhe kjo figurë ligjore, siç u përmend, ka qenë e sanksionuar më parë juridikisht, pastaj ligjërisht. Ekspozimi i shkurtër i situatave juridike subjektive është i nevojshëm për shkak të përkufizimeve të saj dhe për shkak të qasjes tradicionale të sistemit të përgjegjësisë që mund të kuptohet plotësisht ndryshimi radikal në drejtim të interpretimit shpjegues, të cilin e kemi parë në këto vite dhe kriteret përkatëse për identifikimin e dëmit (Cassano,2012:723). Në lidhje me këtë profil të ulët të jurisprudencës është V.U.GJ.L 12/2007, në pjesën shpjeguese të të cilit janë ilustruar gjurmët interpretuese mbi çështjen në fjalë në hapsirën e viteve dhe përshkrimin e procedurës logjike-hermetike të dobishme për të arritur të ashtuquajturin kualifikim të padrejtësisë. Duke ndjekur shkakun motivues të

këtij ‘rasti kryesor’ bëhet e mundur të dallojmë një histori dhe një udhëzues zbatues të padrejtësisë së dëmit civil.

4.2.3 Dëmi

Duke qenë se lind përgjegjësinë civile dhe si pasojë detyrimin për shpërblim, nuk mjafton vetëm kryerja e një fakti të paligjshëm, në kuptim të asaj që kemi shpjeguar më lart, por si duhet të prodhohet një dëm në kuptimin juridik. Në Kod për dëmin si element i përgjegjësisë jashtëkontraktore mund të gjejmë kuptime të ndryshme: I pari, i cili i referohet nenit 608 të K.C, është kuptuar tradicionalisht si shkelje e kundraligjshme e të drejtave të të tjerëve, i dyti është dëmi, pasojat e të cilit përlllogariten në terma ekonomikë.

Në të vërtetë, më tepër sesa koncept i dyfishtë i dëmit bëhet fjalë për dy momente të ndryshme të gjykimit akuilian: bazat për faktin e përshtatshëm për të shkaktuar përgjegjësinë dhe përkufizimin e dëmit të shkaktuar, përbëjnë objektin e kërkesave për kompesim (Montaneri, 1998:305). Në mënyrë të veçantë, në kuptimin e parë dëmi përkon me ngjarjen juridike të dëmshme dhe duke iu referuar këtij momenti shkaktohen dhe pasojat përkatëse problemet e përgjegjësisë si subjektive dhe objektive (kjo me problematikën mbi lidhjen shkaksore të ngjashme me rastet në të drejtën penale), ndërsa në të dytin presupozohet zgjidhja e problemit të atribuimit të përgjegjësisë dhe përcaktimit të elementëve mbi bazën e të cilëve llogaritet shpërblimi i dëmit (Grappolo, 1989: 236).

Fakti që dëmi duhet të jetë i kundraligjshëm për të qenë i kompesueshëm është një parashikim shtesë i kodit aktual që me kalimin e kohës ka ardhur dukë marrë një rol themelor në evolucionin interpretativ të institutit të përgjegjësisë civile, ndoshta përtej qëllimit të legjislatorit (Semini, 2003:8).

Nëse një zhvillim ka të bëjë me konceptin e kundërligjshmërisë të parashikuar nga neni 608 I K.C, që sipas asaj që kemi përmendur më lart nuk bën gjë tjetër veçse rivendos atë që ishte parashikuar në kodin e mëparshëm mund të themi se ka një marrëdhënie direkte mes dëmit dhe kundërligjshmërisë, që mund të jap idenë e rëndësisë, atribuar faktit objektiv të shkeljes më tepër se sa sjelljes së dëmtuesit, duke i dhënë kështu natyrë teknike zhvendosjes së vëmendjes nga kryerësi i dëmit te veprimi/mosveprimi që ka shkaktuar dëmin te i dëmtuari-akuzues.

4.2.3.1 – Kriteret e përzgjedhjes së dëmit sipas nenit 608 e 625 të K.C

Sistemi i hartuar nga Kodi Civil i vitit 1994 është bazuar në konceptin që e dallon dëmin pasuror të rregulluar nga neni 608 K.C nga dëmi jopasuror i rregulluar nga neni 625 i K.C me pasojën për të cilën dëmi jopasuror mund të kompesohet vetëm në rastet e parashikuar nga ligji. Në këtë mënyrë rastet e parashikuara nga ligji në të cilat është pranuar në mënyrë të qartë kompesimi për dëmet jopasurore lidhen me rastet në të cilat dëmi rrjedh nga veprimet që shkaktojnë përgjegjësi jashtëkontraktore, që konfigurohen domosdoshmërisht si një krim: kjo do të thotë që dëmet jopasurore mund të kompesohen vetëm nëse shkaktohen nga një krim (kompesimi për kombinimin e posaçëm me nenin 625 të K.C dhe nenit 119,120,143, 143/a/2, 143/a/3, të K.P në fuqi).

Praktika gjyqësore ka një qëndrim kufizues mbi këtë çështje, duke vendosur që dëmet jopasurore do të mund të kompesohen vetëm në rast se të gjitha elementët e faktit që rrjedh përgjegjësinë jashtëkontraktore janë përmbushur (V.U Nr.12/2007). Pika kritike e këtij udhëzimi qëndron në lidhje me provimin e elementit subjektiv: në fakt, i dëmtuari nga 'krimi' (veprimi/mosveprimi i kundërligjshëm) ka të drejtën për dëmshpërblim për dëme jopasurore vetëm pasi ka provuar dashjen ose pakujdesinë e dëmtuesit, pa iu dhënë

mundëisa e prezumimit. Për të dhënë një shembull: një Gjykatë e ulët në Itali, me vendimin nr.7905, datë 11 gusht 1998 mohoi shpërblimin e dëmeve jopasurore një personi të përfshirë në një aksident rrugor për shkak të prezumimit të fajit për drejtuesin e mjetit. Kjo u argumentua me faktin se gjykata nuk mund të vendos për shpërblimin e dëmeve jopasurore të ndodhur nëse përgjegjësia e pranohet në bazë të një prezumimi.

Evolucioni jurisprudencial ka lejuar tejkalimin e këtij kufizimi interpretues (Grappolo,2004: 238). Në fakt, qëndrimi origjinal është braktisur përfundimisht në 2007 me vendimin Unifikues nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga viti 2007, dëmi jopasuror duhet të kompesohet edhe në rastet në të cilat faji i autorit të veprës korrespondon vetëm në thelb të një veprimi të kundraligjshëm.

Sa i përket nocionit të dëmit jopasuror, legjislatori e nënkupton të rregulluar nga neni 625 i K.C por nuk e shpjegon, në fakt nuk ekziston një përkufizim legjislativ. Prandaj, detyra e përcaktimit se çfarë nënkupton ‘dëmi jopasuror’ del si detyrë e praktikës gjyqësore dhe doktrinës, që ende kujdesen duke na siguruar informacion të mëtejshëm duke modifikuar qëndrime të mbajtura në të kaluarën.

Fillimisht, prezantimi i nenit 625 të K.C ka paraqitur një koncept të ngushtë të dëmit jopasuror që konsiston vetëm në dëmin moral subjektiv, që kuptohet si dëmtim i shëndetit ose nderit e personalitetit të një personi ose si fyerje e kujtimit të një personi të vdekur, që shkaktohen si rezultat i dëmit të ndodhur. Ky interpretim kufizues i dëmit jopasuror, që konsiston vetëm në dëmin moral duke i dhënë në të kaluarën dyshime mbi kushtetueshmërinë, veçanërisht në lidhje me të drejtën për cilësinë e jetës. Duket se kombinimi i sistemit të shpërblimit të dëmit jopasuror duke kombinuar dispozitat 608 e 625 të K.C përfshijnë rastet e parashikuara nga nenet 30, 27, 25, 21 e 15 i Kushtetutës.

Në fakt, çfarë do të ndodh me gjykimin e kompesimit të dëmit me natyrë pasurore , që e drejta e shëndetit përfundimisht i shkaktohet nga veprimi i kundraligjshëm? Sipas praktikës gjyqësore një dëm i tillë nuk do të kompesohet as si dëm pasuror referuar nenit 608 të K.C dhe as si dëm moral sipas nenit 625 të K.C. Shprehja ‘dëm jopasuror’ e miratuar nga legjislatori është e gjerë dhe e përgjithshme dhe i referohet çdo mendimi të kundërt, që lidhet me atë pasuror e që karakterizohet nga kostoja e interesit të shkelur. Kjo na çon atje që, fusha e zbatimit të nenit 625 të K.C përfshin të gjitha dëmet e paprekshme drejtpërdrejt nga vlerësimi ekonomik, përfshirë edhe të drejtën për shëndet e një jetë të mirë e të qetë. Vetëm duke mos e lidhur shëndetin ose siç preferohet të quhet integritetin fizik dhe cilësinë e jetës me aftësinë për të gjeneruar të ardhura dhe duke e konsideruar si një të drejtë të pavarur dhe primare i jepet kuptimi i duhur dispozitës në fjalë.

Pranë dëmit moral të pastër praktika gjyqësore ka identifikuar dëmin biologjik, shprehje e huazuar nga mjekësia ligjore dhe më pas nga jursitet për të identifikuar si fillim një kategori të tretë të dëmit të ndryshme nga dëmi pasuror dhe jopasuror (Vendimi Unifikues nr.12, datë 14.09.2007). Në arsyetimin e vendimit unifikues Gjykata kritikon pamjaftshmërinë e një sistemi vlerësimi për dëmin ndaj personit i kufizuar vetëm në shpenzimet dhe fitimin e munguar në rastin e ndodhjes së dëmit dhe tregon zgjidhjen në rast të dëmit të pastër biologjik për t’u likujduar në mënyrë të njëjtë për të gjithë shtetasit, pavarësisht aftësisë së tyre për të prodhuar të ardhura.

Praktika gjyqësore u përball me një tejkalim të jurisprudencës gjenoveze¹⁹ duke deklaruar se dëmi ndaj personit që nuk ndikon në të ardhurat nga puna do të konfigurohej si dëmtim i shëndetit si vlerë e njëjtë ekonomike.

Në vitin 2007 Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr.12, datë 14.09.2007 dha një ineterpretim të ri të dëmit biologjik. Konfirmohet se dëmi ndaj shëndetit përbën një dëm të padrejtë që konsiderohet si ‘*dëm pasuror indirekt*’i kompesueshëm në përputhje me nenin 608 të K.C dhe pavarësisht nga aftësia e palës së dëmtuar për të prodhuar të ardhura .

Përfundimisht dëmi biologjik përfshihet në nenin 625 të K.C bashkë me dëmin moral. Me vendimin unifikues të 2007 Gjykata e Lartë e njeh dëmin biologjik si një dëm jopasuror i pavarur nga aftësia e personit për të gjeneruar të ardhura duke i dhënë të njëjtën të drejtë për kompesim të gjithë subjekteve që kanë pësuar një dëm.

Përfshirja e dëmit biologjik në kategoritë e dëmit sipas nenit 625 të K.C nuk nënkupton identifikimin e tij me dëmin moral subjektiv, por kategorizimin e këtyre dy figurave si dy lloje të ndryshme të dëmit jopasuror.

Duke përmbledhur edhe njëherë konkluzionet e vendimit unifikues çdo dëm me natyrë jopasurore që rrjedh nga shkelja e vlerave të natyrshme të njeriut përfshin dëmin moral subjektiv që kuptohet si shqetësim kalimtar i gjendjes shpirtërore të viktimës, dëmin biologjik në kuptimin e ngushtë, që nënkuptohet si shkelje e interesave, të garantuar nga Kushtetuta, të integritetit fizik e psikik të personit që ka ardhur si rezultat i një vlerësimi mjekësor ashtu edhe dëmin (shpesh i përkufizuar si ekzistencial) që rrjedh nga shkelja e intersave të tjera kushtetuese të lidhura me individin. Gjykata e ka ndarë dëmin jopasuror në tre kategori: dëmi moral subjektiv, që përfaqëson shqetësim shpirtëror dhe turbullim

¹⁹ E njohur ndryshe si jurisprudenca alternative. Për herë të parë me vendimin e Gjykatës së Gjenovës u njoh shpërblimi i dëmit ndaj shëndetit në bazë të të ardhurave të viktimës, kjo do të thoshte të përjetësoje rrezikun e koncepteve dhe vlerësimeve të prapambetura.

psikik; dëmi biologjik, që përfaqëson dëmtim të shëndetit psiko-fizik; dëmi ekzistencial, që përfaqëson çdo dëmtim tjetër të të drejtave të garantuara kushtetueshmërisht ose më qartë ka të bëjë me cilësië e jetës së njeriut.

Për herë të parë në Shqipëri, për dëmin ekzistencial është folur në vitin 2007 kur u dha vendimi unifikues, i cili përkufizohet si përkeqësim i kushteve të jetës së përditshme nga shkelja e të drejtave themelore të njeriut, ndryshe nga dëmi ndaj shëndetit i kompesueshëm nën nenin 608 të K.C si dëm pasuror indirekt, në mënyrë që të jetë e pavarur nga neni 625 i K.C (i njëjti veprim që më parë realizohej për dëmin biologjik).

Kjo figurë e dëmit lind nga qëllimi i deklaruar për të zgjeruar fushën e mbrojtjes për dëmet e natyrës jo pasurore të ndodhura ndaj personave i çliruar nga kufizimet e nenit 625 të K.C'94 që përcakton se fakti i kundraligjshëm kufizon veprimet e veprimtarisë njerëzore duke detyruar që të përshtasë në përditshmërinë e tij sjellje të ndryshme nga ato të të kaluarës duke shfaqur një lloj të ri dëmi.

Dëmi ekzistencial si dëm pasuror indirekt hidhet poshtë kur argumentohet se sistemi akuilian duhet domosdoshmërisht të jetë i ndarë në : dëmin pasuror (neni 608 i K.C) që konsiston në dëmtimin e pasurisë së vlerësueshme ekonomikisht dhe të kompesueshme përmes një ekzaminimi që krahason gjendjen e pasurisë para dhe pas ndodhjes së faktit të paligjshëm (dëmi efektiv) dhe zotësisë së subjektit për të prodhuar të ardhura (fitim), dëmi jopasuror (neni 625 i K.C) i përbërë nga të gjitha dëmet e sferës jopasurore të të dëmtuarit, në të cilën përfshihen dëmi moral, biologjik dhe ekzistencial.

Ky klasifikim tre klasësh është mirëpritur nga legjisalcioni i brendshëm edhe pse ligjëron pikën më të diskutuar dhe kundërshtuar nga këndvështrimi interpretues i V.U 12/2007. Ecuria e praktikës gjyqësore, më vonë, megjithatë ka gdhendur thellë në këtë

koncept tipet e reja të dëmit duke ripërcaktuar kufijtë e dëmit jopasuror të kompesueshëm (Vendimi nr.266, datë21.05.2015 i K.C.Gj).

4.2.3.2 Dëmi si veprim/fakt juridik dhe dëmi si pasojë në mbrojtje të interesave të

ligjshme

Një pikë kritike në reflektimin mbi këtë temë është dallimi midis dëmit si ngjarje dhe dëmit si pasojë. Sipas ndarjes tradicionale të dëmit në pasuror dhe jo pasuror, të gjithë dëmet vijnë si pasojë e një ngjarje natyrore. Konfirmohet që për disa dëme është e mjaftueshme vetëm dëmi si ngjarje ose shkelja e së drejtës subjektive të mbrojtur (Ponzanelli,2004:34). Kjo procedurë ka thyer skemat si dhe në mënyra të tjera kur pohojnë se e drejta e individit kompesohet kur procedura administrative është shkelur. Në traditën juridike ekziston dëmi si shkelje e pasurisë në kuptimin e gjerë (që përfshin jo vetëm të mirat dhe marrëdhëniet, por edhe dobinë e tipeve të ndryshme), ky është kushti që ka shkatuar një humbje ekonomike (Salvi, 1988:118).

Pikërisht për këtë arsye, për çështjen e dëmtimit të individit shumë ekspertë ligjor kanë argumentuar se dëmi ndaj shëndetit është një dëm pasuror edhe pse në vlerën e përmbushjes së detyrimeve nën konceptin e pasurisë gjithmonë e më shumë kuptohet natyra monetare e kompesimit të të drejtës së shkelur nga ngjarja (Negro,2011:205). Ky dështim është manifestuar në mënyrë të qartë kur Gjyjkata e Lartë filloi të përkufizojë dëmin ekzistencial si një kategori të tretë midis dëmit pasuror efektiv (humbje e aftësisë për të punuar, humbja e mundësive të punësimit, etj) dhe dëmit jopasuror (ai i parashikuar nga neni 625 i K.C, për të cilin kërkohet një fakt që të përbëjë ‘krim’).

Kategoria e tretë e profilizon dëmin, në vetvete si ngjarje ose fakt juridik, por ç'është dëmi si ngjarje që duhet të kompesohet? Sipas konceptit tradicional , ai mund të përbëjë një dëm pasuror pasi mund të matet me një kriter të caktuar (Forchielli, 1960:433).

Për sa kohë të ekzistojë një treg që mat dhe përcakton vlerën e të mirave në mënyrë analoge ne mund të masim dhe t'i përcaktjmë një vlerë dëmit. Diskutimi lind kur kriteri i vlerësimit mungon. Mund të ndodh që funksionimi i kompesimit nuk është vetëm për të dëmshpërblyer humbjen pasurore që ndodh, i marrë në kuptimin e gjerë. Funksioni kompesues është ai në bazë të të cilit, në terma ekuivalentë juridik tregon gjendjen në të cilën ndodhej pala e dëmtuar para ngjarjes, duke marrë në konsideratë interesin subjektiv të viktimës së prekur nga fakti i dëmshëm (Monateri, 2005:193).

Kur konfirmohet ekzistenca e një fakti të dëmshëm të kompesueshëm në vetvete, edhe nëse i është nënshtruar një kriteri social tipik në lidhje me vlerën mbi invaliditetin e përkohshëm (më parë ka qenë e lidhur me vlerën e pensionit minimal) si është e mundur të arsyetojmë në termat e dëmit pasuror dhe jopasuror? Për momentin e lëmë pezull përgjigjen e kësaj pyetjeje.

Një nga çështjet e diskutuara në rast të dëmit jopasuror është edhe të provuarit e tij. Mbi këtë pikë Kolegjet e Bashkuara konfirmojnë rëndësinë e veçantë, duke qartësuar që dëmi jopasuror edhe kur është përcaktuar nga shkelja e të drejtave të padhunueshme të njeriut është gjithmonë një dëm-pasojë, që si i tillë duhet të provohet në gjykim. Në këtë mënyrë mohohet njëherë e mirë teza e ngritur që identifikon dëmin me ngjarjen e dëmshme ose të ashtuquajturin dëmi-fakt/veprim juridik, ashtu edhe tezën që synon të argumentojë se në

rast të shkeljes së vlerave të personit dëmi do të jetë *re ipsa*²⁰ (Cendon,2008:1473) nga momenti që ajo shtrembëron funksionin e dëmshpërblimit që do të jepej, jo si pasojë e një hetimi efektiv të një dëmi, por si vlerë civile për një sjellje të kundraligjshme.

Kolegjet e Bashkuara vijojnë duke përcaktuar disa specifika në lidhje me mjetet provuese. Veçanërisht, për dëmin ekzistencial konfirmohet se konstatimi mjeko-ligjor kërkohet nga legjislacioni aktual (neni 26/2ai, ligji nr.10076, datë 12.02.2009 ‘*Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit*’, i ndryshuar) edhe pse nuk ngre një mjet ekskluziv dhe të nevojshëm ajo nuk duhet të urdhërohet domosdoshmërisht nga gjykata, e cila mund ta konsiderojë të tepërt duke vendosur bazat e vendimit të tij mbi të gjitha elementët e paraqitur gjatë gjykimit (dokumente, dëshmi) dhe duke përdorur nocione dhe eksperiencë të mëparshme.

Ndërsa, për dëmet e tjera jopasurore është parashikuar marrja e provave me dëshmitarë, dokumentare dhe të supozuara. Sa i përket kësaj të fundit, në mënyrë të veçantë vihet në dukje se ‘duke bërë supozimin (jo referuar dëmit ekzistencial) të një të mire jo-materiale, mbështetja në provat e prezumuara ka të ngjarë të jetë e rëndësishme dhe mund të përbëjë burimin e vetëm për dhënien e vendimit të gjykatës duke mos e trajtuar si një provë inferiore në raport me provat e tjera’.

Pala e dëmtuar duhet të bashkëngjit të gjithë elementët që në çështjen në fjalë të japë një seri faktesh, që bëjnë të mundur gjetjen e faktit të panjohur.

4.2.3.3 *Parimi neminem laedere*

²⁰ Termi *re ipsa* nënkupton fjalën “në vetvete”, shpesh thuhet se dëmi është *re ipsa*, pikërisht për të treguar që nuk kërkohet një provë e dëmit, prandaj vet fakti konsiderohet në vetvete një dëm.

Koncepti i përgjegjësië jashtëkontraktore si reagim ndaj shkeljes së detyrimit të përgjithshëm *neminem laedere* (thënë ndryshe *alterum non laedere*) në doktrinë ka qenë objekt i kritikave të forta që nga përpunimi i tij fillestar. Origjina e *neminem laedere* duhet të ndiqet nën gjurmët e parimit të Ulpianit ose *Iuris praecepta sunt haec* që thotë: *honeste vivere; alterum non laedere, suum cuique tribuere* (këto janë porositë e ligjit : të jetuarit me ndershmëri, duke mos fyer njeri dhe duke i dhënë gjithsecit atë që i takon).

Parimi Ulpianit ose siç njihet ndryshe kalimi (hapi) Ulpian është përmirësuar në periudhën e zbatimit të së drejtës natyrore (Hugo, 1856:43). Mbështetësit e *ius naturalus*²¹ kanë hetuar karakteristikat e përbashkëta të llojeve të ndryshme të shkeljeve të të drejtave dhe kanë arritur në një përfundim të përbashkët : *neminem laedere*. Ky parim, pastaj është konkretizuar në ligje të vendeve të ndryshme dhe në të drejtën tonë civile përfaqësohet nga neni 608 i K.C.

Mund të themi se *neminem laedere* mishëron në vetvete të gjithë klauzolën e parashikuar nga neni 608 i K.C duke vendosur një rregull sjelljeje-urdhër, shkelja e të cilit rezulton me një dënim. Francesco Canelutti ka qenë ndër të parët që kanë dyshuar mbi ekzistencën e *neminem laedere* si një detyrim i përgjithshëm ndaj të gjithë qytetarëve. Ai pranoi idenë (përpunuar nga Polacco) që faji kontraktor (i nënkuptuar si shkelje e një detyrimi të shoqëruar nga elementi subjektiv i pakujdesisë ose neglizhencës) duhet të kalojë kufijtë e kontratës, parashikon Canelutti, por, nuk pranon se elementi dallues mes fajit kontraktor dhe atij jashtëkontraktor qëndron në shkeljen e një detyrimi të veçantë ose të

²¹ Ose e drejta natyrore nënkupton mendimin aktual juridiko-filozofik, i cili presupozon ekzistencën e një norme sjellje ndërsujektive botërisht të vlefshme, të krijuar mbi një ide të veçantë të natyrës, që ekziston në çdo formë, historikisht të mbuluar nga e drejta pozitive (term i shpikur në mesjetë, që rridhte nga tezat greke, i përkthyer në latinisht si pozitë, e që i refrohej një veprimi të njeriut) dhe e aftë për të realizuar rregullimin më të mirë të shoqërisë njerëzore, duke shërbyer në rregullimin emarrëdhënieve mes shteteve dhe mes qeverisë dhe popullit të saj.

përgjithshme të *neminem laedere*. Autori e klasifikon *neminem laedere* si një '*fata moragata*' që ka mashtruar dhe vazhdon t'i mashtojë juristët.

Në fakt, nuk bëhet fjalë për një detyrim të përgjithshëm, por për përmbledhje të të gjitha detyrave specifike që i imponohen çdo partneri. Nuk mund të përcaktohet nëse një akt shkel një detyrim të përgjithshëm nëse nuk jemi të vetdijshëm për shkeljen e një detyrimi të veçantë. Sipas Carnelutti, faji nuk mund të ekzistojë nëse nuk ekziston shkelja e një detyrimi të veçantë nga ana e subjektit dhe kjo konfirmohet nga koncepti i veprës së kundraligjshme. Elementi i parë që e dallon veprimin/mosveprimin e kundraligjshëm është në fakt një shkelje e normës juridike dmth. përmbushja e detyrimit e vendosur nga kjo normë. Faji kontraktor dhe ai jashtëkontraktor, si pasojë, konsistojnë në shkeljen e një detyrimi ekzistues mes palëve (Chironi,2012:440).

Fakti që neni 490 i K.C nuk është i qartë për këtë pikë kjo është në favor të teorisë së Carnelutti-t sepse kjo bën të mundur një veprim në rinovim të vazhdueshëm ligjor. Si pasojë, faji jashtëkontraktor (por edhe ai kontraktor) nuk krijon një marrëdhënie të re mes palëve, siç presupozohet nga Polacco, por do të ndryshojë marrëdhënien ekzistuese. Marrëdhënia ekzistuese shndërrohet në një raport sekondar. Duke zëvendësuar një detyrim fillestar me detyrimin për kompesim. Dallimi i vetëm në rast të fajit kontraktor është se ky transformim rezulton më i dukshëm në lidhje me atë që ndodh në fushën jashtëkontraktore.

Ky përfundim i Carnelutti-t bazohet shprehimisht në natyrën ndëshkuese të nenit 490 të K.C, që përcakton vetëm sanksionet e të gjitha veprimeve të kundraligjshme që shkaktjnë si pasojë një dëm jashtëkontraktor. Argumentat janë marrë edhe pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil në vitin 1994. Veçanërisht, është konfirmuar se detyrimi specifik, në të cilin parimi *neminem laedere* është një sintezë terminologjike janë ato të lidhura me faktet

që përbejnë të drejta absolute (Castronovo, 1995:143). Përveç kësaj, detyra e mosndërhyrjes, që detyron çdo palë ka një përmbajtje të ndryshme sipas të drejtave absolute prej të cilave janë pasqyruar.

4.2.3.4 Pika kritike të dëmit akuilian për mbrojtjen e të drejtave personale

Fenomenet e reja të dëmit ndaj personit nuk përbejnë një problem të padrejtësisë sepse kur në çështjen në fjalë është personi, është e panevojshme përpjekja për të gjetur një bazë ligjore për mbrojtjen në konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në Kushtetutë apo në një ligj të sistemit juridik. Në këto raste e drejta ekziston sepse ekzistojnë njerëzit, nëse nuk do të ekzistonin njerëzit nuk do të ekzistonte e drejta.

Ndërsa, kur në fushën akuiliane kërkohet të mbrohet një pozicion subjektiv i individit është i mjaftueshëm referimi në nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për të zgjidhur problemin e shkeljes së të drejtës. Problemi i vërtetë në këtë rast nuk është padrejtësia, por ai i ndryshimit të llogaritjes dhe përcaktimit të vlerës së dëmit (që i përket paragrafit të dytë të neit 608 të K.C) sepse mungon një kriter referues që lejon ta paracaktoj atë, që viktimë humb efektivisht. Kjo është pika e vërtetë kritike në zbatimin e përgjegjësisë civile për mbrojtjen e personit.

4.2.3.4 Prova e dëmit.

Duke iu referuar teorive të ndryshme mbi nocionin e dëmit si pakësim i kapitalit, kjo vazhdon të jetë objekti i diskutimeve jurisprudenciale e doktrinare. Kodi Civil nga ana e tij përdor terma me kuptime të ndryshme duke kujtuar nga njëra anë shkeljen e një interesi dhe nga ana tjetër pasojat negative, që rrjedhin prej saj (Ferri,1984:151). Duke tejkaluar teorinë

e dëmit si fakt (dëmi ngjarje) të mbështetur nga Cernelutti në bazë të të cilit detyrimi për dëmshpërblim do të ekzistonte në prani të një ngjarje të dëmshme pa pasur nevojën që prej të njëjtëve kanë rrjedhur pasoja jo të favorshme që konsiderohen, përderisa rrjedh një detyrim kompesues nuk është e mjaftueshme vërtetimi i shkeljes së një interesi , por është e nevojshme që prej saj të kenë lindur pasoja të dëmshme për palën e dëmtuar (Cendon, 202:3). Duke pranuar teorinë e dëmit-pasojë, dëmi i kompesueshëm përfaqësohet nga pasojat e shkeljes së interesit, ekzistenca e të cilit duhet gjithmonë të provohet e nuk mund të merren të mirëqëna *re ipsa*, kjo zgjidhje jo vetëm përkon me dëmin pasuror, por edhe me atë jopasuror, i cili duhet të jetë i provuar edhe përmes përdorimit të supozimeve në dallim nga mendimi që vlerësonte shkeljen e të drejtave të personave që humbin një veprim të kundraligjshëm që kompesohet në vend të pasojave që rrjedhin prej saj (De Cupis, 1979:23).

Vlen të kujtojmë përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Milanos nr.7713, të vitit 2000, e cila dënoi me detyrimin për të paguar shpërblimin e dëmit nga babai, i cili gjithmonë ka qenë i painteresuar për të bijën, ku Gjykata e Lartë ka konfirmuar që shkelja e të drejtave kushtetuese përfshin zbatimin e zhdëmtimit për të drejtën e shkelur duke përfshirë në këtë mënyrë dëmin, të kualifikuar shprehimisht si ekzistencial brenda kategorisë së dëmit-ngjarje (Fiandaca, 2009: 56).

Edhe Gjykata e Apelit ka mbajtur qëndrim në lidhje me pyetjen e bërë nga një bashkëshort ndaj gruas së tij, e cila e kishte detyruar të lidhte martesë me anë të mashtrimit mbi atësinë e vërtetë të fëmijës deri në marrjen e kompesimit për dëmin nga humbja e cilësisë së atësisë dhe të dëmit ekzistencial të vuajtur për faktin që gruaja në kundërshtim me detyrën e besnikërisë ndaj bashkëshortit të ardhshëm kishte cënuar vendosjen dhe vullnetin e tij të

lirë ka mohuar ekzistencën e llojit të parë, të paprovuar, e ka ngarkuar me faj për dëmshpërblimin e të dytit duke pasur parasysh tipologjinë e dëmit ekzistues në *re ipsa* (Cendon, 2010:193-194).

Duke nënkuptuar kompesimin e dëmit si të ndjeshëm nga dhunimi i interesave në vetvete dhe për vete të individit konsiderohet se i shkakton pakënaqësi jo të vogla dhe një zgjerim joproporcional të kufijve të shpërblimit të dëmit ose një rrezik të mbikompesimit (Facci, 2006:521).

Pa marrë parasysh që rindërtimi duket se fsheh një optik ndëshkuese, e dukshme që si paraqitet ku dëmi shpërblehet në *re ipsa*, që prirën të ndëshkojnë me dëmshpërblim, jo me shkallën e dëmshpërblimit konkret të dëmit të pësuar nga viktimja, por ndaj sjelljes së personit dhe shkeljes së interesave në vetvete konsideruar, në mënyrë që nuk ka munguar kush, madje e ka konsideruar se në këtë mënyrë masa fsheh në të vërtetë një dënim civil (Ponzanelli, 2000:842).

Në përfundim, dëmi-ngjarje, përballet me përfundimin e përgjegjësisë civile kryesisht të riintegruar ndonjëherë për të kundërshtuar pasojat e pafavorshme në fushën e ‘fyerjes’ dhe jo cënimin e thjeshtë të një të drejte kundër të cilës me siguri ka instrumente të tjera si vendimi gjyqësor (D’Adda, 2001:200).

Në këtë aspekt kanë ndërhyrë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vitin 2007, që në mohimin e ekzistencës së dëmit jopasuror në *re ipsa* në rast të marrëdhënies me punëdhënësin kanë përsëritur që, forma riparuese e dëmshpërblimit të dëmit vepron vetëm në funksion të neutralizimit të humbjes së pësuar, konkretisht, të viktimës ndërsa, shpërndarja e saj në një shumë të vlerësuar në lekë, në kuadër të gjetjes së një pranimi të thjeshtë të shkeljes, përfundon duke u klasifikuar si shumë-penalizuese, si një dënim civil

ndëshkues e imponuar në bazë të dështimit (mospërmbushjes) por, ky institut nuk ka vlefshmëri në sistemin tonë.

Uniformimi në pranimin e cënimit të vetëm duket se proçedon, në fakt, drejt idesë së një dëmi ndëshkues, që nuk i përket traditës së dëmit ndaj personit. Prandaj, arrijmë në përfundimin që subjekti që vendos të reagojë në cilësisë e një anëtari të familjes duhet të provojë pasojat e dëmshme të shkaktuara nga shkelja e të drejtave të tij i vendosur në rolin e palës së dëmtuar, në të kundërt asnjë detyrim për dëmshpërblim nuk mund të lind (Franzoni, 2009:10).

4.2.3.5 *Il quantum*

Klasifikimi i dëmit duhet të bëhet në përputhje me parimin e riparimit të plotë të parashikuar nga neni 486 i K.C sipas të cilit palës së dëmtuar duhet t'i shpërblehet dëmi me qëllim rikthimin e gjendjes në të cilën ajo ndodhej para ndodhjes së ngjarjes së dëmshme, duke përjashtuar mundësinë për të përfituar pasurim të padrejtë. Nën këtë këndvështrim *il quantum* duhet të përcaktohet në lidhje me masën e dëmit (Franzoni, 2010:160).

Në Itali, pak ditë pas publikimit të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.26972/2008 gjykata e Milanos me vendimin nr.11865/2008 ka ndryshuar tabelat e përdorura nga Gj.L për vlerësimin e dëmeve

Nga mometi që, siç u tha më lart, dëmet e shaktuara nga një pjesëtar i familjes janë shpesh të kryera me faj duhet të konsiderohet që, edhe elementi psikologjik i qëndrimit të subjektit veprues luan një rol të rëndësishëm brenda kufijve të përcaktimit të *quantum debeatur*, duke mos theksuar vetëm pikpamjen e përgjegjësisë civile. Prania e fajit, në fakt, e bën të përshtatshme kalimin mbi autorin, të pasojave të dëmshme (Cendon,1976:21).

Kjo zgjidhje sipas disave, nuk jep një dënim mbi masën e humbjeve të pësuar në kundërshtim me parimin e riparimit të plotë, por përkundrazi do të rimodelonte këtë parim. Pjesa më e madhe e riparimit gjen, në këtë kuptim, origjinën e saj në pjesën më të madhe të pasojave të dëmshme që rrjedhin nga një sjellje e kryer nga pakujdesia, më shumë se sa e kryer me faj. Për më tepër, për dëmet e kryera nga një i pjesëtar i familjes janë në pjesën më të madhe jopasuror, kategori për të cilën nuk është e mundur, në përgjithësi, të provohet masa e saktë e *quantum*-it për dëmshpërblim, masë e cila do të përcaktohet nga gjykata në bazë të neneve 608 dhe 486 të K.C. Mes elementëve që ndikojnë në këtë vlerësim është edhe pakujdesia, siç u përmend për rastin në diskutim. Në përpjekje për të ndihmuar gjykatën në përcaktimin e masës së dëmit jopasuror, me qëllim njehsimin e procedurës së gjykimit p.sh në rastin e vdekjes së bashkëshortit ose fëmijve janë hartuar tabelat udhëzuese për përlllogaritjen.

Në këtë drejtim gjykata në rastin e divorcit nga bashkëshorti, i cili kishte gjetur në Malajzi një të dashur dhe kishte pasur prej saj dy fëmijë, ka vendosur si dënimin e së njëjtës për shpërblim të dëmeve jopasurore, që rrjedh nga sjelljet e tij të dëmshme, jo vetëm detyra e besnikërisë por edhe e dinjitetit të bashkëshortes, për të përcaktuar *quntum*-in për kompesim i është referuar shumës që do të jepej në rast të vdekjes së bashkëshortit. Vlera e dytë mund të përcaktohet si vlera e dëmit nga fitimi i munguar, shpeshherë e njohur në çështjet me objekt si ai në fjalë, në mesin e elementëve të përdorur për të kryer këtë llogaritje futet në lojë llogaritja rreth mundësisë për të realizuar ‘një përfundim të dobishëm’ (Cendon, 1976:82).

Në përfundim, në përcaktimin e dëmit duhet t’i jepet rëndësi më e madhe paraprakisht marrëdhënies mes palëve, që bën të mundur pranimin e pasojave serioze mes

palëve, kjo jo vetëm për rastë të shkeljeve të njëjta që mund të vërtetohen mes palëve të treta, por edhe për raste të shkeljeve brenda familjes kur dëmi është shkaktuar nga një palë mes të cilëve ka korrektësi dhe besim të mirë, vlera të cilat përbëjnë bazat e familjes (Favilli, 2004:373).

4.2.3.6 Analiza e llojeve të dëmit jopasuror

Sic e kemi përmendur paragjykimet/dëmet ngushtësisht familjare që mund të shkaktohen nga një anëtar i familjes, qofshin pasuror ose jopasuror, kanë tendencën të përfshihen te kategoria e dytë. Kjo e fundit në bazë të vendimit unifikues të vitit 2007 i sjell sërish në klasifikim të nenit 625 të K.C, përmes një leximi të orientuar nga ‘rastet e parashikuara nga ligji’ duke qëndruar te neni 608 K.C ai mbetet një instrument mbrojtës vetëm për dëme të natyrës pasurore. Në këtë këndvështrim, duke mos e identifikuar vetëm në kategorinë e dëmit moral ai mund të kuptohet si një dëm që rrjedh nga shkelja e vlerave të trashëguara të personit dhe neni 625 i K.C shpeshherë në pasqyrimin e qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese mbi dyshimet për kundërligjshmërinë ka arritur edhe kësaj here falë një riformulimi, në fazën e fundit të një procesi që ka zgjatur në kohë.

Nga vendimi rezulton një dëm jopasuror që nënkategorizohet në tre ndarje: a) Dëmin biologjik, kjo është konfirmuar edhe me ligjin nr.10076, datë 12.02.2009 ‘*Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit*’, i ndryshuar, në nenin 3, Përkufizimet, shkelja e përkohshme ose e përhershme e integritetit psikofizik, e konfirmuar në rrugë mjeko-ligjore; b) Dëmin moral, tradicionalisht është kuptuar si *pretium doloris*, shqetësim shpirtëror kalimtar; c) Dëmin ekzistencial, që i përket fushës që lidhet me cilësinë e jetës së personit,

në mënyrë të veçantë me aktivitetin e arritjeve të individit duke përfshirë edhe pasojat ekzistenciale negative që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit.

Të treja këto kategori në mënyrë abstrakte mund të gjejnë hapsirë brenda konsorciumit familjar: dëmi moral për faktin se shumë sjellje të dëmshme teorikisht mund të përbejnë një vepër penale vetëm si pasojë e shkeljes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia familjare (p.sh neni 124 i K.P aktual parashikon se braktisja e fëmijës nën moshën 16-vjeç nga prindi ose personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet); dëmi biologjik, ndërkohë sjelljet e familjarëve mund të sjellin një efekt të thellë mbi integritetin psikofizik, të tilla si stresi, depresioni, gjithashtu si të tilla mund të konsiderohen edhe tradhtia e partnerit, që mund të trajtohet si mosrespektim i dinjitetit të tjetrit, duke i shkaktuar një gjendje të patologjis së vërtetë.

Ndërkohë që ambjenti familjar përfaqëson përsosmërinë e arritjeve të individit, ka qenë një terren i përshtatshëm për zhvillimin e figurave të ndryshme të dëmit ekzistencial. Siç e kemi theksuar, përse i përket dëmeve jo pasurore, nuk mund të injorohet vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të 13-14 shtatorit 2007 sipas të cilit brenda figurës së dëmit jopasuror nuk do të ishte e mundur të krijoheshin nënkategori nëse nuk do të ishte për qëllime përshkruese, me qëllim shmangien e dyfishimeve të panevojshme të kompesimit.

Dëmi jopasuror është një kategori e bashkuar, jo e ndarë në nënkategori që emërtohen në mënyra të ndryshme, si p.sh dëmi ekzistencial, që sipas Gjykatës e drejton dëmin jopasuror drejt një natyre atipike. I parë nën këtë optikë, shpërblimi i dëmit jo pasuror, do të ishte i mundur vetëm në ato raste në të cilat verifikohet shkelja e një të drejte të patjetërsueshme të njeriut e karakterizuar nga shkalla e shkeljes dhe rëndësia e pasojave, ndërkohë është e

nevojshme edhe tejkalimi i pragut të tolerancës parashikuar nga neni 15 i Kushtetutës. Në këtë pikë, nëse nuk do të ishte vetëm për qëllime përshkruese atëherë dëmi jopasuror nuk do të ndahej në tre nënkategori, por do të vlerësohej si një i tërë.

Në çdo rast, pavarësisht dëshirës për ta klasifikuar dëmin jopasuror si pasojë e shkeljes së të drejtave të patjetërsueshme të njeriut ka hapsirë të mjaftueshme brenda familjes, në mënyrë të veçantë ajo flet për marrëdhënien prindërore, për kushtet e veçanta të fëmijëve të mitur, subjekte të pambrojtura, veçanërisht ‘të cënueshëm’ për shkak të gjendjes së tyre ‘të varësisë’ nga të rriturit si edhe individualizimit të informacionit, që kanë nevojë për një mbrojtje të veçantë, e bërë për t’i vendosur në kushte të tilla deri në përfundimin e procesit të rritjes.

Nga një veprim i kundraligjshëm i shkaktuar në marrëdhëniet ndër-familjare mund të rrjedhë edhe një dëm pasuror i konfiguruar në elementë të ndryshëm të dëmit të pësuar siç është dëmi efektiv dhe fitimi i munguar (Nuni,2012:132). Në mënyrë të veçantë kjo mund të përbëjë një rast të volitshëm për krijimin e një terreni të përshtatshëm për verifikimin e një dëmi që rrjedh nga humbja e mundësive, i cili nënkupton propabilitetin e mundshëm për mosarritjen e rezultatit të dobishëm. Mundësia nuk konsiston në një pritje të thjeshtë të faktit, por në një aset pasuror ekonomikisht dhe juridikisht të ndikueshëm nga një vlerësim vetjak në lidhje me mundësinë konkrete dhe të efektshme si një mundësi e favorshme për të arritur rezultatin e dobishëm. Nuk flitet për një dëm hipotetik, por për një dëm konkret dhe aktual, jo domosdoshmërisht i lidhur me humbjen e rezultatit, por me mundësinë për ta arritur atë.

Në fushën në fjalë, përcaktimi i llojeve të dëmeve mund të kryhet me lehtësi, mjafton të mendohen situatat në të cilat prindi, në kushte ekonomike të mira, nuk

interesohehet për fëmijën dhe nuk kujdeset për t'i ofruar atij dashuri, as mbështetje apo ndihmesë financiare që sipas ligjit duhet ta bëjë deri në rritjen e të miturit (Cendon, 2010:192). Në pamundësi të mjeteve të nevojshme në moshën kur zhvillohet personaliteti i tij në mangësi që janë baza për të ardhmen në drejtim të punësimit apo jetës sociale të fëmijës, duke mos marrë shkollimin bazë, arsimin universitar apo pas-universitar, udhëtime, ndjekur sporte dhe në fund aftësimin në kuptim të punësimit për të cilin ka pasur prirje nëse do të kishte mundësitë e nevojshme për t'u edukuar, duke marrë parasysh rëndësinë dhe kushtet e familjes. Dëmi i shkaktuar në këtë rast jo vetëm i marrë nga këndvështrimi ekonomik, që është i dukshëm, por duhet vërtetuar dhe provuar nga ana e palës së dëmtuar (Cendon, 2010:232).

4.2.3.7 Teoria e dyfishtë e dëmit

Kjo teori është ndër më aktualet dhe bindëset duke marrë parasysh doktrinën shqiptare, e cila në këtë pikë është shumë e ngjashme me atë italiane, duke u nisur edhe nga një vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në të cilin është mbajtur një qëndrim i ngjashëm. Përpara se të fillojmë analizën e çështjes është me rëndësi të përcaktojmë problemin duke u nisur nga të dhënat normative. Nga dispozita e nenit 608 të K.C vërejmë se termi dëm paraqitet dy herë: ‘....i shkakton tjetrit një dëm në personin apo pasurinë e tij...’ dhe ‘....detyrohet të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar’. Prej nga shtrohet pyetja nëse hyrja duhet të jetë atribut i të njëjtit kuptim ose të një të dhëne formale-gjuhësore që duhet të marrë vlera të ndryshme kuptimore. Duke parashtruar kështu pyetjen mund të vazhdohet duke përshkruar tiparet karakteristik të veprës.

Duhet të dallojmë nocionin e dëmit që i shkaktohet një personi në personalitetin ose pasurinë e tij nga ai i dëmit të kompesueshëm, duke nënkuptuar, me të parin elementët që merren parasysh në caktimin e përgjegjësisë, me të dytin përcaktimin e të gjithë dëmit të ndodhur. Kjo do të thotë se dëmin ndaj personit apo pasurisë e shohim si strukturë e një elementi subjektiv (i kryer me faj në formën e dashjes ose pakujdesisë) dhe të një elementi objektiv (lidhja mes veprim/mosveprimit të kundërligjshëm dhe pasojës, dëmit të ndodhur që njihet si lidhja shkaksore), ndërsa dëmi i kompesueshëm konsiston në zvogëlimin e pasurisë pas ndodhjes së ngjarjes së dëmshme. Me një këndvështrim të tillë jo çdo dëm që ndodh në personin apo pasurinë e personit shoqërohet nga lindja e së drejtës për dëmshpërblim, vetëm në rast se vërtetohet se nga ngjarja e dëmshme është shkaktuar zvogëlimi i pasurisë së palës së dëmtuar atëherë dëmi kualifikohet si i kompesueshëm.

Nga këndvështrimi funksional, detyrimi për shpërblimin e dëmit duhet të jetë i ndarë në dy transaksione të dallueshme nga njëra-tjetra: përcaktimi i dëmit, si analizë e pasojave të rrjedhura nga ngjarja e dëmshme, që pasqyrohen në të mirat ose interesat e shkelur dhe dëmi në terma financiare (Franzoni, 2010:75). Prandaj, ndërsa i pari nuk mund të mungojë gjatë gjyqimit për dhënien e dëmshpërblimit nuk mund të thuhet e njëta gjë për të dytin. Prandaj, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e konceptit të dëmit, do të jenë të ndryshme edhe kriteret mbi të cilat ai të përcaktohet, ndërsa në caktimin e vlerës së dëmit do të merret në konsideratë lidhja shkak-pasojë dhe në fazën e dytë do të merret në konsideratë shkaku ligjor (Franzoni, 2010:12).

Më shprehjen lidhje e fakteve ose materiale kuptohet marrëdhënia që ekziston mes ngjarjes dhe veprimit/mosveprimit, për këtë arsye kjo e fundit është shkak i faktit vetëm nëse rezulton si pasojë e parashikuar e sjelljes, sipas rregullave statistikore dhe/ose

shkencore (teoria *sine qua non*- shkak pa të cilin). Megjithatë, mbetet dyshimi për sa i përket parashikueshmërisë mbi të cilën duhet të bëhet vlerësimi (De Cupis, 1979:213).

Ndonëse, pjesa më e madhe e teorive që lidhen më shkakun e faktit janë huazuar nga e drejta penale, në dallim nga ajo, në të cilën vlerësimi duhet të bëhet ‘*tej çdo dyshimi të arsyeshëm*’, Gjykata e Lartë e ndalon kriterin standart ‘*më i mundshëm se jo*’ ose të ‘*sigurisë së mundshme*’ duke saktësuar që kriteri standart nuk duhet të lidhet ekskluzivisht me përcaktimin sasior të ndodhjes së ngjarjes (probabiliteti sasior ose Paskali-an), por duhet verifikuar duke çuar sërish shkallën e vlefshmërisë nën kontesktin e elementëve të vlefshmërisë për përgjegjësinë, në varësi të rastit konkret (propabiliteti logjik ose Bakoni-an).

Me shprehjen shkak ligjor nënkuptohet raporti që lidh dëmin ndaj personit ose pasurisë së tij me humbjen pasurore: mes faktit (ose ndryshe e quajtur ngjarja e dëmshme) dhe dëmit (ose humbja pasurore e kompesueshme) duhet të ekzistojë një lidhje shkak-pasojë, në mënyrë që ky i fundit t’i atribuohet të parit (Visintini, 1999:239). Ky parim mbështetet juridikisht në pjesën e fundit të nenit 486 të K.C, të cilit i referohet edhe neni 608 i K.C, për të cilin mes pasojave të pafundme që një fakt mund të shkaktojë, klasifikon si të kompesueshme vetëm ato, që janë pasojë e drejtëpërdrejtë dhe e menjëhershme e ngjarjes së dëmshme.

Nga një pikëpamje funksionale ka qenë Gjykata e Lartë, që ka dhënë kriteret e vlerësimit. I pari është kriteri normalitetit dhe sigurisë, që rrjedh nga rregullat e përvojës, nga rregulli i propabilitetit dhe statistikor. Rregulli i dytë është parashikueshmëria, që duhet kuptuar në mënyrë objektive: nëse është normale që nga një sekuencë e ngjarjes së ndodhur mund të prodhohen zhvillime të mëvonshme (Alpa, 2003:94). Në këtë logjikë ai vijon se

kushtet e zakonshme, të rregullshmërisë statistikore, propabilitare dhe të parashikueshmërisë duhet të konsiderohen si sinonime që shprehin kuptimin e shkakut ligjor.

Në përfundim, pavarësisht nivelit abstrakt dhe teorik të dy nocionet e shkakut janë të përcaktuara qartë e drejtë, në praktikë duket se vlerësohen në bazë të kriterit të parashikueshmërisë. Vlen të theksohet se nuk mund të përcaktohet në mënyrë të detajuar dallimi mes parashikueshmërisë, që i referohen rregullat e shkakut të faktit, nga parashikueshmëria e atyre të shkakut ligjor (Franzoni, 2004:18). Ky kufizim, vërehet kur rregullat e ndryshme që rrjedhin nga praktika gjyqësore mund të zbatohen si për lidhjen e faktit ashtu edhe për shkakun ligjor (Franzoni, 2004:61). Edhe pse këto mund të rezultojnë shumë të ngjashme nga këndvështrimi praktik, ndryshimi mund të vërehet vetëm duke e parë problemin në një pikëpamje funksionale: për shkakun e faktit duhet referuar për të shqyrtuar lidhjen mes elementëve përbërës të përgjegjësisë civile që lindin nga shkaktimi i dëmit, ndërsa për shkakun ligjor duhet të merren në analizë sa herë që është e nevojshme për të përcaktuar dhe matur dëmin .

4.2.4 Lidhja shkaksore

Në fushën e përgjegjësisë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit ka hipoteza, në të cilat shkaqet mbi bazën e të cilave vendoset lidhja shkaksore, janë të ndryshme. Në fushën e së drejtës civile lidhja shkaksore është ai element përbërës i përgjegjësisë civile, që në planin objektiv përcakton një raport të jashtëm të dyfishtë, nga njëra anë, lidhja që ekziston midis sjelljes së kundraligjshme dhe ngjarjes së dëmshme dhe nga ana tjetër lidhja mes ngjarjes së dëmshme dhe pasojave që rrjedhin prej saj. Megjithatë një parim i tillë kërkon një shpjegim

të mëtejshëm. Nenet 608 e 622 të K.C paraqesin një lidhje shkaksore midis sjelljes së personit përgjegjës dhe dëmit, dispozita të tjera variojnë në shkaqe të ndryshme që lidhen me sjelljen e cila është bërë shkak për ardhjen e pasojës: neni 613 i K.C parashikon që ajo që shkakton dëmin është sjellja e të miturit ose personit të pazotë për të vepruar; neni 615 i K.C lidh dëmin e shkaktuar nga të miturit ose personat nën mbikqyrje dhe faktin juridik të ndodhur gjatë kohës që kanë ekzistuar kushtet e mbikqyrjes ose kujdesit prindëror; neni 618 e K.C se për të lindur përgjegjësia e punëdhënësit duhet të vërtetohet lidhja shkaksore mes veprimit/moveprimit të kundraligjshëm të punëmarrësit dhe dëmit; etj.

Do të shqyrtojmë në këtë pjesë lidhjen shkaksore ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundraligjshëm dhe dëmit. Lidhja shkaksore në të drejtën civile në përgjithësi është rregulluar nga parimi i ‘shkakut të faktit’. Kriteri që do të përdoret gjatë vlerësimit të lidhjes shkaksore nuk është ai i sigurisë absolute, por ai i propabilitetit, që jep një fakt i caktuar, që është si një shkak paraprak dhe verifikon ekzistencën e dëmit. Prandaj, lidhja shkaksore mund të gjendet jo vetëm kur ndodh një dëm si pasojë e një sjelljeje të kundraligjshme, por edhe kur ekziston mundësia për të ardhur pasoja (Benedetti, 2015:5).

Pra, në të drejtën civile lidhja shkaksore nuk është një e dhënë e vetme për çdo hipotezë të përgjegjësisë, por shfaqet e ndryshme në varësi të kriterit të fajit. Me fjalë të tjera, në dallim nga ajo që ndodh në veprën penale (ku, duke marrë parasysh parimin e personalitetit, gjykata merr në shqyrtim vetëm verifikimin e raportit që ekziston mes veprimit të të akuzuarit dhe ngjarjes), në veprat civile nuk kërkohet gjithmonë i njëjti verifikim i lidhjes shkaksore, por i ‘lidhjes shkaksore’ që kërkohet nga ligji, që herë pas here tregon hapsirën në lidhje me të cilën duhet të përmbushet vlerësimi shkakor (Pucella, 2007:3). Lidhja shkaksore është e rëndësishme si për të përcaktuar përgjegjësinë për faktin

e dëmshëm ashtu edhe për të përcaktuar pasojat e kompesueshme. Kodi ynë civil nuk e njeh formën e përgjegjësisë stokastike²², që bazohet në kriterin propabilitar, i cili bazohet te gjendja e rrezikut, jashtë një lidhjeje materiale me ngjarjen e dëmshme. Në këtë kuptim është shprehur edhe Gjykata e Lartë në vendimin nr.204, datë 04.05.2010 duke përjashtuar funksionimin e një kriteri të fajësimit “që bazohet, jo mbi lidhjen shkaksore, por thjesht mbi pjesmarrjen në ushtrimin e një veprimtarie të rrezikshme me sjellje të veçanta dhe të pavarura të kryera nga disa persona, të gjitha të njëkohshme dhe teorikisht si të mundshme për të shkaktuar dëm’.

Prandaj një kriter i tillë i fajësisë do të kërkonte një ndërhyrje të veçantë ligjore duke mos dështuar në ngatërrimin e një kriteri ‘jashtëzakonisht të dobët, i cili do të përfaqësonte *quid minoris* (ajo që është më pak) në lidhje me përfshirjen në të njëjtën sjellje që përbën përgjegjësinë solidare të parashikuar nga neni 626 i K.C. Në përputhje me rezervat për pranimin e hipotezave të përgjegjësisë propabilitare mund t’i përmbledhim efektivisht në dy arsye ato për të cilat është thelbësore ekzistenca e lidhjes shkaksore:

- e para, përkrah idenë që lidhja shkak-pasojë përbën kriterin minimal që lidh dëmin me personin përgjegjës;
- e dyta, lidhet me qëndrimin se përgjegjësia me faj heq dorë nga kriteri i lidhjes shkaksore, që kufizohet nga shkak i faktit synon të ndalojë veprimet jo shkaksore të dëmit dhe veprimet e mbetura në tentativë, mbi bazën e dyshimit të thjeshtë të ndikimit të tyre shkaksor abstrakt; në këtë mënyrë, gjykimi do të varej nga elementë hipotetikë dhe do të bëhej i vështirë kontrolli.

²² Quhet përgjegjësia stokastike, e cila ka të bëjë me rastet kur edhe në mungesë të lidhjes shkaksore mund të ekzistojë përgjegjësia juridiko-civile (Bordon, 2010: 123).

Në kushtet aktuale, në sistemin tonë të brendshëm lidhja shkaksore përbën një element thelbësor të çdo rasti të përgjegjësisë civile dhe barra e provës bie mbi palën e dëmtuar edhe në rastin e përgjegjësisë objektive parashikuar nga Kodi Civil, në të cilin është përjashtuar nga prova e elementit subjektiv.

4.2.4.1 Tezat mbi lidhjen shkaksore

Në debatin mbi kufizimin e kompesimit vetëm të pasojave të menjëhershme dhe të drejtpërdrejta sipas parashikimeve të nenit 609 të K.C janë mbajtur dy qëndrime kundërshtuese në këtë fushë: drejtimi i parë, shprehje e shkollave konceptualistike, që e lexon normën në aspektin e shkakut ligjor dhe drejtimi i dytë, refleksion i antiformalistëve, që vendos një kufi në masën e kompesimit të dëmit (Pucella,2007:3).

Autorët që e lexojnë normën nën dritën e shkakut ligjor përmbledhin në një koncept të përgjithshëm të përbashkët përgjegjësinë kontraktore dhe jashtëkontraktore që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, duke e identifikuar si shkelje të një norme të vetme (Musial kundër Polonisë). Në këtë pikëpamje dëmi dhe elementi që i shtohet dhe është i ndryshëm nga akti i paligjshëm dhe që t'i atribuohet sjelljes së paligjshme (ose shkeljes së ligjit) duhet të lidhet me një raport të veçantë (Alpa, 2010:349).

Në këtë pikëpamje referenca për 'pasojat e menjëhershme dhe të drejtpërdrejta' të parashikuara nga neni 609 i K.C do të zgjidhte problemin e fajësisë, duke përzgjedhur mes pasojave që i atribuohen sjelljes së kundraligjshme, ato që juridikisht konsiderohen drejtpërdrejtë të kundraligjshme. Analiza konceptuale bën dallimin, midis konceptit juridik mbi dëmin (i nënkuptuar si fakt juridik) dhe konceptit material të dëmit (i nënkuptuar si një fenomen i gjendjes fizike) (Salvi, 1985:49). Rrjedhimisht, zbatohen kritere autonome për

përcaktimin e secilit prej tyre, kjo është arsyeja që ndryshimi mund të jetë sasior në pasojën e ardhur mbi palën e dëmtuar, po aq sa është i ndryshëm në pasojën e ardhur nga shkelja ligjore.

Për përcaktimin e përmbajtjes ligjore të dëmit është e nevojshme të vendoset një marrëdhënie shkaksore mes pasojës së ardhur nga dëmi dhe vetë dëmit. Lidhja shkaksore materiale konsiston në aspektin e lidhjes objektive të jashtme, që lidh një fenomen me tjetrin sipas të cilit fakti është shkak i dëmit ku në mungesë të të parit nuk do të kishte ndodhur i dyti kjo njihet ndryshe si *conditio sine qua*. Ky koncept, që na mundëson të dallojmë kur një pjesë e ngjarjes shërben për të njohur jo vetëm një rrjedhë kronologjike por një lidhje shkaksore, është dhënë nga shkencat e natyrës (Brusco, 2012:12).

Në planin juridik ekziston një kufizim për sa i përket shtrirjes së shkallës së kompesimit në bazë të kriterit të lartpërmendur është vërejtur se kjo vlen edhe për përjashtimin e mundësisë që kompesimi e vendos palën e dëmtuar në kushte më të mira se ato që ajo ndodhej përpara se të ndodhte dëmi, i cili është burim i përgjegjësisë (Berti, 2013:19). Lidhja shkaksore e identifikuar sipas ligjeve të natyrës na orienton në identifikimin e një marrëdhënieje që ekziston mes faktit dhe ngjarjeve për t'i klasifikuar këto si pasoja të dëmshme. Por, e drejta do të dështonte në detyrën e saj nëse nuk ndërhyr për t'i dhënë lidhjes shkaksore një kuptim specifik, nevoja për siguri, barazi dhe lehtësi e detyrojnë të drejtën të mos heq konceptin e dëmit të përcaktuar nga kriteret e ligjeve të natyrës dhe të krijojë duke shtuar në të, kriteret e pavarura të cilët bëjnë të mundur përcaktimin kur një ngjarje e dëmshme mund të thuhet juridikisht se ka rrjedhur nga një veprim i njeriut (Dominici, 2014:45).

Arsyeja e këtij kufizimi do të shfaqte nevojën për të shmangur ekspozimin e një përgjegjësie të tepërt deri në rrezikun e humbjes së të gjithë pasurisë së palës përgjegjëse dhe shmangien e krijimit të një shoqërie ‘të gjendjes së mirë të familjes’. Në bazë të këtij funksioni përcaktimi në fjalë do t’i korrespondonte kriterit të kompesimit të pasojave të drejtpërdrejta dhe të mënjëhershme të parashikuara nga neni 609 i K.C. Kështu, kundërshtimi i tezave të ndryshme kryesisht të huazuara nga përpunimi i doktrinės penale na lidh me përmbajtjen e kuptimit të shkakut ligjor.

Teza e rregullsisë shkakore e hartuar në gjysmën e shekullit të nëntëmbëdhjetë nga doktrina gjermane e gjejmë sot të përhapur në zbatimin në jurisprudencë. Sipas saj ligjërisht i atribuohen debitorit ngjarjet e dëmshme (edhe ato të ndërmjetësuara dhe jo të drejtpërdrejta) të ndodhura në përputhje me rrjedhën normale dhe të zakonshme të ngjarjeve në bazë të një gjykimi mbi propabilitetin. Autoriteti i këtij parimi i gjen gjurmët që nga e drejta romane ku rikuperimi i dëmit të shkaktuar nga vdekja e skllëvërve për shkak të mosdorëzimit të një sasive gruri me sa duket rrjedh nga karakteri jo normal dhe i pazakontë i një pasoje të tillë në lidhje me përgjegjësinë (Pucella, 2007:93). Ndërsa, në rastet e fatit të keq kriteri i lidhur ngushtë me normën për shkakun e mënjëhershëm, të cituar në hyrjen e *in iure non remota causa, sed proxima spectatur*²³ është shkak i dëmit vetëm shkak më i afërt.

Në një interpretim, në kuptimin, që përjashtohet ekzistenca e një lidhjeje shkaksore në prani të rrethanave rastësore të marra në një interpretim thellësisht kronologjik të çojnë në afrimin me përfundime, që konsiderohen të kënaqshme.

²³ Nga latinishtja përkthehet : Në ligj jo çdo shkak i një ngjarjeje duhet të merret në konsideratë.

Për shkak të pranimi të tezës së rregullsisë shkakore indirekte, janë të kompesueshme, nëse janë të vazhdueshme ose nëse janë të mundshme; ndërsa, dëmi i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë kompesohet gjithmonë sepse ekziston një lidhje shkakore natyrore. Duket se ky është parimi i sanksionuar në ligj kur vërehet se përcaktimi i ‘menjëhershëm’ duhet të merret duke zbatuar elasticitetin e kriterëve, në mënyrë që të ketë mundësi të dëmshpërblehen edhe ato dëme jo të drejtpërdrejta, të cilat ndodhin si rezultat i mospërmbushjes së një detyrimi. Është e thjeshtë të imagjinohet se si një tregues kaq i paqartë mund të ofrojë pak ose aspak ndihmë në interpretim gjatë zbatimit të normës (Brusco, 2012:39).

Përtej formulave stereotip me të cilat jurisprudenca shoqëron thirrjen për disiplinën e pasojave të menjëhershme dhe të drejtpërdrejta, mungesa e udhëzimeve të qarta në zbatim shkakton pasoja më të rënda po t’i referohemi kuptimit interpretues tashmë të konsoliduar sipas të cilit gjykimi i ekzistencës së lidhjes shkakore ligjëron sigurinë e faktit, si të padënueshme nga gjykata (Dominic, 2014:49). Mungesa e treguesve të qartë për zbatim nga ana e ligjvënësit dhe interpretuesve bashkë me mungesën e një praktike unifikuese në lidhje me interpretimin ka çuar në një praktikë gjyqësore të pjesëzuar, zgjedhja e të cilës kapërcen përpjekjen për racionalizimin e shfaqjen e një sistemi rregullash të njëjta dhe metodologje konkrete.

4.2.4.2 Teoritë funksionale mbi lidhjen shkakore

Orientimi i kundërt i fushës funksionale do të rimodelojë në përmbajtjen teorike disa koncepte juridike, interesa konkretë, që dispozita synon të rregullojë duke u përpjekur për të krijuar një lidhje të tipit funksional midis kriterit të kufizuar nga përgjegjësia dhe qëllimit të dispozitës mbi përgjegjësinë. Çdo nocion i shkakut nuk mund të ndahet sipas këtij

rregullimi, nga koordinimi funksional me një objektiv të qartë. Paqartësia e të dhënave ligjore nuk mund t'u ofrojë informacion të saktë interpretuesve por, përbën thjesht një kriter të kontrollit të rezultateve të marrë nga të tjerët duke bërë që t'i drejtohem interpretimit teologjik (Dominici, 2014:45).

Ky është shkak që mungon për të shkuar drejt formulimit të një teorie si ajo e shkakut të përshtatshëm, që përkundrazi paraqitet nga përkrahësit e saj me arsyetimin tërësisht në përputhje me sektorë të ndryshëm të sistemit, pothuajse e trajtojnë konceptin e shkakut për përsosmëri, duke i dhënë një vlefshmëri logjike ose shkencore, edhe pse fillimisht ishte formuluar për zgjidhjen e një problemi praktik: për të përshtatur përgjegjësinë penale ndaj funksionit parandalues dhe ndëshkues të ligjit penal (Trimarchi, 1967:52).

Por, siç është vërejtur janë përsëritësit, që më pas harrojnë si lind një teori dhe vendosin një koncept logjik të shkëputur nga shkaqet që e kishin diktuar këtë gjë fillimisht, edhe në aspektin e rezultateve, teoria e shkakut të përshtatshëm dështon në drejtim të dhënies së një kriteri të saktë të faktit që është i pandarë në gjykimin e propabilitetit (Gorla, 1951:410).

Duke refuzuar çdo nocion që pretendon të luajë një rol unifikues në lidhjen shkaksore dhe në vlefshmërinë e çdo zgjidhjeje të vlefshme të fushës së përgjegjësisë civile, ndoshta të krijuar mbi nocionet e kuptimit të përbashkët me karakter intuitiv, pjesa urdhëruese e nenit 640 të K.C presupozon në një aspekt funksionalist një kuptim tërësisht të ndryshëm. Fakti si burim i përgjegjësisë dhe ngjarjes së dëmshme nuk janë dy kategori apriori që shkak ligjor i përdor për t'i lidhur. Fakti është një koncept që mendja jonë ndërton duke izoluar, sa për të thënë në ndryshimin e vazhdueshëm e të bërit ku gjithçka është ngjarje ose seri ngjarjesh, që për pasojë një pjesë e vet ngjarjeve është bashkim i tyre (Gorla, 1951:408).

Ky veprim duhet të kryhet në funksion të një interesi praktik, teorik dhe historik. Duke rindërtuar edhe njëherë faktin për të cilin bën fjalë neni 640 të K.C, identifikojmë interesin praktik, kriterin ose procesin mendor në bazë të të cilit, duke unifikuar një seri ngjarjesh ndërtohet 'fakti' pasojat e të cilit parashikohen nga neni 640 i K.C.

Rastet e rindërtuara, rregulli i nenit 640 të K.C nuk janë veçse kufizime të shkakut nga pikpamja e qëllimit praktik të mos përkeqësimit të përgjegjësisë së debitorit. Nëse kushtet janë premtuese më të pakta janë rezultatet e kësaj analize, ndërkohë që në çështjet e mospërmbushjes për shkak të 'faktit' verifikojnë ngjarjen e kundërt në përmbajtjen e detyrimit, pra, mospërmbushje pas së cilës fillojnë pasojat e rregulluara nga neni 640 i K.C.

Rezultatet funksionale që rindërtohen sipas këtij rregulli nuk janë shumë të ndryshëm nga ato të propozuara nga teori të ndryshme të shkakut, në të cilin ka një kufizim në fushën e dëmit të kompesueshëm vetëm për dëmet e zakonshme (Pucella, 2007:18).

Edhe kjo qasje nuk i përgjigjet problemit të vërtetë, që është ai i kushteve në prani të të cilëve do të bëhet shpërndarja e humbjes ekonomike që rrjedh nga mospërmbushja, e që shtrihen nga pasuria e viktimës të ajo e palës në mungesë. Në zbatim, teoritë e ndryshme çojnë në zgjidhje plotësisht të njëjta. Nërkohë që, mungojnë arsyet e origjinës të cilat çojnë drejt konfirmimit të parimit në fjalë, i lidhur me nevojën për të ratifikuar përjashtimin, siç do të shihet, në llogaritjen e dëmit të kompesueshëm dhe të pasojave të dëmshme, që rrjedhin nga pa aftësia paguese e kreditorit (Brusco, 2012:85).

Pasojë e paqartësisë së treguesve të dhënë për një arritje funksionale efektive pasqyrohet, pashmangshmërisht mbi praktikën gjyqësore, që vepron në mungesë të pikave të forta që i referohen dhe mbi një doktrinë që bie në mënyrë të paevitueshme në kontekste të natyrës metafizike. Kriteri i pasojave të mënjehershme dhe të drejtpërdrejta është përdorur shpesh

për të arritur në konkluzione në të cilat u mbështet analiza e mëvonshme që në termat ekonomik ka hedhur shumë dyshime (Dominici, 2014:56). Mendojmë p.sh prezumimin e humbjes së përfitimeve që do të rridhnin nga mosrealizimi i shitjes për shkak të blerësit mbi bazën e të cilit Gjykata e Lartë e Italisë duke u mbështetur në të drejtën e shkakut ka njohur dëmin nga mungesa e fitimit që 'shitësi' do të kishte përfituar në rast të realizimit të shitjes, pavarësisht faktit se malli objekt i kësaj shitje mund t'i shitej më vonë një pale tjetër. Një konfirmim i tërthortë i efektivitetit të ulët të dispozitave urdhëruese të ligjit në kuptim të lidhjes shkaksore vjen nga common law dhe nga parimet Unidroit ku nuk përmendet ndonjë kriter i kufizimit të kompesimit të dëmit të tipit shkaksor dhe në të cilën ajo mbështetet në përzgjedhjen e pasojave të dëmshme të sigurisë së dëmit dhe kërkesave të parashikueshmërisë dhe shmangies (Franzoni, 2010:159).

KAPITULLI V

DËMI EKZISTENCIAL NË DRITËN E DOKTRINËS DHE VENDIMIT UNIFIKUES NR.12, DATË 14.09.2007 TË KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

5.1 NJË PËRMBLEDHJE E SHKURTËR HISTORIKE MBI DËMIN EKZISTENCIAL

Deri në dhënien e vendimit unifikues nr.12 në shtator të vitit 2007, i cili na njohu me dëmin ekzistencial, jurisprudenca tradicionale, ajo që ka ekzistuar pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil në vitin 1994, e konsideronte dëmin ndaj personit si një dëm në thelb pasuror. Dëmi ndaj personit, konsiderohej si një tip dëmi pasuror i drejtpërdrejtë, që konsistonte në humbjen (e përhershme ose të përkohshme) të aftësisë për të prodhuar të ardhura nga ana e palës së dëmtuar.

Me hyrjen në fuqi të kodit të ri e në mënyrë të veçantë nenit 625 të K.C, së bashku me dëmin pasuror ndaj personit, jurisprudenca mundi t'i njoh palës së dëmtuar edhe një dëm të natyrës jo pasurore por, vetëm për rastet e përcaktuara në ligj. Në bazë të një ndjeshmërie sociale të ndryshuar, gjykata ka konstatuar se me kalimin e kohës janë kompesuar gjithmonë edhe më shumë dëmet ndaj individit në mënyrë të veçantë dëmi ndaj jetës sociale të personit. Për jurisprudencën tradicionale këto lloj dëmesh kanë natyrë pasurore (edhe pse bëhet fjalë për dëme pasurore jo të drejtpërdrejta, për sa kohë ato ndikojnë në mënyrë indirekte mbi aftësinë për të prodhuar të ardhura të individit në dallim nga dëmi pasuror i drejtpërdrejtë siç u përkufizua më lart). Ky lloj interpretimi dhe

përdorimi e largon konceptin e dëmit nga ai që jepet në lex Aquilia²⁴ dhe me një konceptim të drejtpërdrejtë të dëmit (Bacache, 2012:743).

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet jurisprudenca për kompesimin e dëmit pasuror të personit është neni 486 i K.C. Dispozita, në fakt, është përshtatur më së miri me konceptin e dëmit ndaj personit siç është shpjeguar nga jurisprudenca tradicionale sipas së cilës ka natyrë thellësisht pasurore. Neni 486 i K.C (që zbatohet si ë fushën e përgjegjësisë kontraktore edhe në atë jashtëkontraktore referuar edhe nenit 625 të K.C) ka lejuar dhe lejon kompesimin e të gjitha pasojave pasurore të dëmshme, që janë në një lidhje shkaksore të rregullt (kriteri i pasojave të menjëhershme dhe të drejtpërdrejta) me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm prej nga lind përgjegjësia civile.

Për sa i përket dëmit jopasuror, jurisprudenca²⁵ i është referuar vetëm nenit 625 të K.C, i cili parashikon shpërblimin e dëmit jopasuror vetëm në rastet e përcaktuar nga ligji (rezerva ligjore). Interpretimi tradicional i dispozitës ka nënkuptar se kompesimi për dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar nga një fakt i paligjshëm konsiston vetëm në dëmin moral (*pecunia doloris*). Vlera financiare që caktohej nga gjykata është konsideruar si një kompesim i drejtë për vuajtjet shpirtërore të pësura nga viktimat e faktit të paligjshëm (Vendimi nr.2600, datë 02.11.2012 GJ.A.T).

Me qëllim që në procedurat civile të njihen të drejta të tilla (të kompesimit të dëmit) është e nevojshme që pala, që ka shkaktuar dëmin e që është përgjegjës edhe penalisht, duhet të provojë objektivisht elementin subjektiv të fajit, qoftë në formën e dashjes, qoftë

²⁴ Lex aquiliana është ligji i parë i shkruar në fushën e shpërblimit të dëmit ndaj pronës së dominus (është quajtur avokati që trajton çështjend dhe harton aktet për mbrojtjen). Ai është përfaqësues, që është votuar nga një gjykatë popullore e quajtur Aquilio në 286 p.kdhe që provokoi e të gjitha ligjeve të mëparshme duke përfshirë edhe Ligjin e 12 Tabelave.

²⁵ Deri në daljen e V.U 12/2007, në të cilin për kompesimin e dëmit u bazua në interpretimin kushtetues të të drejtave të pacënueshme.

në atë të pakujdesisë. Ky është një fakt që ka pasur dhe ka një rëndësi nga pikëpamja procedurale, pasi pretenduesit e të drejtës së shkelur duhet të provojnë fajësinë e autorit të veprës (Neni 12 i K.Pr.C). Kjo nënkupton se për këtë kategori dëmi nuk mund të përdoret për qëllim përfitimi përgjegjësia civile indirekte ose objektive e parashikuar nga Kodi Civil. Për këtë le të sjellim shembullin më tipik atë të përgjegjësise nga aksidentet rrugore ku faji i drejtuesve të mjeteve prezumohet i njëjtë deri sa provohet ndryshe, ky prezumim sipas së drejtës penale nuk është i mjaftueshëm për të provuar fajësinë e palës, që ka shkaktuar dëmin, në kuptimin penal (Elezi, 2004:112).

Për sa i përket likujdimit të dëmit, dëmi pasuror ndaj personit përcaktohet nga gjykata sipas teorisë së njohur të diferencimit sipas së cilës kompesohet diferenca midis pasurisë së tashme të palës së dëmtuar dhe shtimit të pasurisë që do të kishte pasur pala e dëmtuar në rast se fakti i paligjshëm nuk do të kishte ndodhur. Në mënyrë të veçantë, shoqëritë e siguracioneve kanë vepruar dhe veprojnë për llogaritjen e dëmit pasuror ndaj personit mbi bazën e tabelave ku merret në konsideratë mosha, të ardhurat e gjeneruara nga i dëmtuari para se të ndodhte ngjarja e dëmshme dhe paaftësia e pësuar (Tabela 1, Vendimi Nr.53, datë 25.06.2009, i ndryshuar i Bordit të AMF).

Likujdimi i dëmit jopasuror (ose *pecunia doloris*) ka paraqitur shumë vështirësi. Nuk ka ekzistuar dhe në fakt nuk ekziston akoma, një sistem që mund të përlllogarisë vuajtjet shpirtërore në rast të një ngjarje të dëmshme (Cendon a, 2009:89). Për këtë arsye, gjyqtarët kanë përdorur si të njëvlefshme parashikimet e nenit 486 të K.C ose nenit 625 të K.C tek i cili referohemi në rast të përgjegjësise jashtëkontraktore. Megjithatë, ky sistem nuk duket se i përgjigjet plotësisht nevojave sociale dhe drejtësisë, prandaj doktrina dhe jurisprudenca kërkojnë mënyra të reja për të vlerësuar dëmin ndaj personit.

Duke iu referuar G.Comandè mund, pothuajse të flasim për një të ‘drejtë dembele’ (të paktën nga ana e ligjvënësit), të ngurtë për t’iu përshtatur problemeve të reja dhe çështjeve të barazisë, që ekspertët e fushës, por jo vetëm, kanë ngritur. Në të vërtetë është e mundur që të ketë (dhe ka pasur) frikë për të zëvendësuar me teknika eksperimentuese një traditë të konsoliduar (Russo,2014:34).

Këtu shtohet edhe kostoja ekonomike e kompesimit jo të njëtrajtshëm dhe diskutimi i vazhdueshëm i funksionimit interpretues të bazuar mbi interpretimin kushtetues. Puna e vazhdueshme e doktrinës, e ndjekur edhe nga praktika gjyqësore (të paktën pjesërisht), me kalimin e kohës ka futur figura të reja të dëmit ndaj personit (Gjata, 2010: 126). Pas vendimit unifikues nr.12 të vitit 2007 ka pasur diskutime mbi faktin se dëmi ekzistencial ka lindur shumë më vonë se dëmi biologjik, të cilat edhe sot vazhdojnë të jenë objekt diskutimesh dhe debatesh në ndryshim (Mataj b, 2015:14). Është e pamohueshme se, pavarësisht shumë ndryshimeve midis tyre dëmi ekzistencial po ndjek një rrugë të ngjashme me atë të dëmit biologjik me shpresën, që qasjet e të njëjtit rezultat dhe kriteret e dëmit ndaj personit, të qartësohen dhe të mos jenë më objekt diskutimesh.

Ajo, që duhet të theksojmë përtej përplasjeve teorike është mbi të gjitha dinamika e së drejtës e në mënyrë të veçantë e doktrinës dhe praktikës gjyqësore (Mataj a, 2015:12). Pra, flasim jo për një strukturë të qëndrueshme dhe të pandryshueshme, por dinamike falë interpretuesve që veprojnë vazhdimisht në respektim të ligjit, veçanërisht në interpretimin e tij, lidhur me ndryshimin e nevojave sociale dhe ndjenjave të përbashkëta.

5.2 KUPTIMI I DËMIT EKZISTENCIAL DHE IDENTIFIKIMI I KATEGORIVE TË DËMIT JOPASUROR

Në ditët e sotme përdoruesve të ligjit shpesh u duhet të përballen e luftojnë me një shoqëri të globalizuar, në të cilën duket se nuk ka kufizime për individin dhe lirinë e tij për të zgjedhur. Aktualisht duke e parë në një këndvështrim modern shoqëria duket se ka një shqetësim në lidhje me një ‘rend të tepruar’ për individin. Koncepti i rendit në shoqëritë moderne thekson sakrifikimin e lirisë individuale për të përfituar një gjendje sigurie. Kjo e jona është një shoqëri postmoderne që karakterizohet nga një liberalizim i përgjithshëm (Zygmunt, 1999: 12). Shtërëngimi dhe dorëheqja e detyruar, që dikur dukej se ishin të nevojshme për sigurinë e përgjithshme bëjnë sot luftë kundër lirisë së individit, por pa qenë të sigurt në fitimin e saj (Bagolini, 1958: 198).

Në shoqërinë postmoderne rendi vazhdon të jetë një ideal që duhet të ndiqet përmes përpjekjeve, mënyrës dhe dëshirës personale. Liria individuale është bërë sot përparësia dhe pasuria më e madhe në procesin e vazhdueshëm të krijimit të botës njerëzore. Prandaj, tema në lidhje me dëmin ndaj individit ndikohet nga ndryshimet e sotme social-ekonomike. Nga pikpamja e ligjit duke nisur nga vitet’60, në saj të një vendimi të marrë nga jurisprudenca italiane, pati një pikë kthese në çështjet që kanë të bëjnë me dëme ndaj personit (Mazzola,2007:15).

Në lidhje me këtë, referenca bëhet në Gjykatën Kushtetuese të Italisë në vendimin nr.184 të vitit 1984. Historia e këtij vendimi është tashmë e njohur, por nga vitet tetëdhjetë e deri në ditët e sotme jurisprudenca është zhvilluar shumë drejt interpretimit të rasteve që lidhen me shkeljen e të drejtave të personit (Perlingieri, 2007:192). Ai hodhi themelet për një trajtim të ri të dëmit jo pasuror, duke vendosur një kufizim të thjeshtë midis dëmit

pasuror dhe moral, kjo nënkupton se lihen jashtë shumë lloje të shkeljeve mbi aspekte të ndryshme të personalitetit të njeriut, për të cilën Kushtetuta (neni 3) garanton një mbrojtje të përgjithshme dhe primare (Scognamiglio, 2010: 25). Ajo, që vlerësohet si kryesore në personalitetin e individit, që ka rëndësi kushtetuese dhe që në një shoqëri konsumi, siç është kjo e sotmja, shpesh bëhet objekt i shkeljeve të natyrave dhe formave të ndryshme (Viola, 2007:8).

Elementët përbërës të strukturës së vlerave të personalitetit në përpjekje për të ndërtuar bazat japin një të dhënë mbi identitetin e personit.

Prej kohësh juristët i kanë njohur të drejtës së identitetit personal një legjitimitet tipik të një shoqërie civile përmes një rikonceptimi siç është e drejta për të mos parë ndryshimet e tipareve identifikuese të personit. Për këtë arsye, identiteti social lidhet me dimensionin publik të individit, pa lënë mënjanë identitetin e brendshëm të njeriut, termi social në këtë rast nënkupton aspektin e marrëdhënieve që krijon individi në shoqëri (Wagner, 2005:7).

Vlera e identitetit e çmon njeriun në dimensionin e tij global, brenda dhe jashtë tij, duke marrë një kuptim të qartë si në aspektin e përfshirjes sociale, roleve, pritshmërive që ka shoqëria prej personit, identitetit të tij në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari etnike, fetare, grupe politike, shoqata apo edhe në veprimtari të tjera. Fusha të ndryshme të jetës shoqërore, kërkesat mbi identitetin e personit nga pikëpamja e ligjit vijnë shpesh në kundërshtim me vlera të tjera të personit (Ponzanelli, 2004:14). Kjo, sepse nga ana e juristëve, e drejta për identitet personal mund të shihet e ndarë nga aspektet e tjera të personalitetit të njeriut të tilla si nderi, reputacioni, imazhi shoqëror në kuptim të mënyrës se si shfaqet në sytë e të tjerëve (Monateri, 2001:724). Por, është e vërtetë që sa më shumë largohemi nga tradita, sipas së cilës shumë aspekte të personalitetit të njeriut barazohen me

identitetin e tij, aq më shumë gjejmë të dhëna specifike, që e vlerësojnë identitetin si një të mirë të njeriut, kjo mund të jetë objekt jo vetëm i diskriminimit, por edhe i disa sjelljeve, pasojë e të cilave është fyerja mbi mundësinë e vet-identifikimit, që e bën një individ ‘të jetë ai person që është’ (Cendon, 2014:59).

E mira e identitetit mund dhe duhet të gjejë mbrojtje në sistemin e përgjegjësisë civile dhe çështja e dëmit ekzistencial duket se është e lidhur edhe me hipotezat e mbrojtjes së identitetit, si sintezë e tipareve që e bëjnë një person të ekzistojë në botën e gjërave dhe marrëdhënieve. Vlerë e identitetit të personit është edhe fusha e krijimtarisë dhe aktiviteteve të lidhura me të (Cendon, 2010:61).

Kategorizimi i dëmit ekzistencial përbën një ‘risi’, e cila u evidentua, në Shqipëri, nga një vendim i Gjykatës së Lartë. Si rrjedhojë, del e nevojshme që për kategoritë e reja që shfaqen në kufijtë e tij, që përputhen me realitetin e sotëm të një shoqërie të globalizuar, me qëllimin e realizimit të një mbrojtjeje, në kuptimin e gjerë të konceptit individ dhe vlerave njerëzore të mbrojtura nga parimet kushtetuese (jo vetëm nga neni 59 i Kushtetutës), ligjvënësi duhet t’i marrë në konsideratë.

Nëpërmjet leximit të nenit 625 të K.C mund të sigurojmë pikën kyçe për të kuptuar dinamikën e dëmit ekzistencial. Në këtë aspekt Gjykata e Lartë me vendimin unifikues ka kontribuar në riinterpretimin e nenit 625 të K.C, në të cilin është përsëritur se si dëmi jopasuror është thjesht një dëm moral subjektiv dhe ka interpretuar nenin 625 të K.C në kuptimin që dëmi jopasuror duhet të kuptohet si një kategori e gjerë, që përfshin çdo rast në të cilën shkelet një vlerë e qënësishme e njeriut, në dallim nga dëmi biologjik, konsiderohen si fyerje që jo domosdoshmërisht kërkojnë vlerësim teknik të bazuar në parametra apo të dhëna tabelore apo pasoja negative dhe të dëmshme.

Ajo që synohet të mbrohet nga sa më lart thamë është dëmi i shkaktuar nga palë të treta edhe nëse kjo nuk rezulton në një dëmtim konkret e material të integritetit fiziko-psikik, por që ndikon negativisht në mundësinë e arritjeve të njeriut. Pavarësisht se dëmi biologjik përkon me një shkelje konkrete, që provohet nga konfirmimi mjeko-ligjor për dëmet kompesuese duke iu referuar vlerësimit ekonomik, atij ekzistencial, i cilësuar si ‘lëndim në vetvete’ duhet të jetë specifikisht i provuar në hipotezat e ngritura për të, kjo e fundit mund të rezultojë si pasojë ekskluzive dhe e vetme e faktit që u supozua si i dëmshëm (Cendon, 2014:39).

Njohja e dëmit ekzistencial si kategori e pavarur dhe e kompesueshme e dëmit ndaj personit nuk duhet të çojë në përhapjen e figurave të reja që në planin normativ shfaqin ligjshmëri të dyshimtë dhe të ndikueshëm nga manipulimet e lehta. Një kontribut i rëndësishëm që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë dhënë në drejtim të dëmit ekzistencial është përkufizimi i tij “*Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit çënon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuajse në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizmin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës, të marrëdhënieve personale.....*” bën që nga dëmi që i shkaktohet personit t’i ndryshojnë zakonet e përditshmërisë dhe aktivitetet e tjera të lidhura duke e përjashtuar nga shprehja dhe realizimi i personalitetit të tij në botën e jashtme. Përkundër kësaj, dëmi ekzistencial është i bazuar jo vetëm në natyrën emocionale dhe të brendshme (të ashtuquajturin dëmin moral) por, edhe shkeljen e pranuar objektivisht përmes të provuarit të zgjedhjeve të jetës, që

bëhen të ndryshme nga ato që do të ishin bërë në rast se nuk do të kishte ndodhur ngjarja e dëmshme.

Dëmi ekzistencial konfigurohet atje ku kategoritë e dëmit ndaj personit nuk mund të sigurojnë një mbrojtje të plotë. Kjo së paku është e mundur për përkrahësit e atij sistemi të përgjegjësisë civile që në fushën e dëmit ndaj personit nuk kufizohen vetëm në dëmin biologjik dhe jo pasuror (Dominici,2006:30). Prandaj, duke pasur parasysh dëmin ndaj personit dhe dëmin jopasuror ne mund të bëjmë një përmbledhje të shkurtër në tre lloje të tij:

- Dëmi moral subjektiv, tradicionalisht i kuptuar si një vuajtje psikologjike ose shqetësim i përkohshëm i shkaktuar nga fakti i paligjshëm; ky ka përbërë një shembull klasik të dëmit jo pasuror;
- Dëmi biologjik, që është rezultat i praktikës gjyqësore (së fundi është konfirmuar edhe ligjërisht me hyrjen në fuqi të ligjit 10076, datë 12.02.2009 “*Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit*”, i ndryshuar) përbëhet nga zhvlerësimi me natyrë pasurore, të integritetit psikofizik të njeriut. Përgjithësisht, është konsideruar si e nevojshme, që ky dëmtim të shoqërohet me një humbje ose zvogëlim të funksioneve jetësore, edhe pse jo përfundimtare. Shkelja e një të drejte juridikisht të mbrojtur jo domosdoshmërisht përbën një shkelje me natyrë pasurore.
- Dëmi ekzistencial, i cili është i lidhur me një keqësim të përhershëm të cilësisë së jetës së palës së dëmtuar që shoqërohet me një ndryshim radikal në zakonet dhe marrëdhëniet që ajo ka si p.sh marrëdhëniet personale dhe familjare.

Nuk do të ishte korrekte, edhe pse në doktrinë kjo do të përbënte një diskutim të fortë, të pranohet se dëmi moral subjektiv të barazohej ose identifikohet me dëmin ekzistencial

sepse në këtë mënyrë do të konfondonim në një dy tipe dëmi: dëmi moral subjektiv konsumohet me dhimbjen e shkaktuar nga fakti i paligjshëm dhe është një dëm i përkohshëm me natyrë thjesht psikologjike; dëmi ekzistencial (të mos bërit por edhe të bërit të një detyrimi që më parë nuk ekzistonte), për të pasur pasoja me natyrë psikologjike kalohet në ndryshime të përkohshme të përkeqësimit të zakoneve të jetës dhe përkeqësime të përkohshme thellësisht të pakthyeshme të marrëdhënieve ndërpersonale (Dominici,2006:31).

Kategoria e dëmit ekzistencial mund të pranohet si një përmbledhje e situatave subjektive negative me karakter psiko-fizik që nuk i përkasin as dëmit moral subjektiv as dëmit biologjik (Cendon, 2010:49). Duke mos lënë mënjane, në rastin në fjalë, nevojën për individualitet dhe parimin e përgjithshëm të së drejtës në bazë të të cilit dëmi duhet të shpërblehet nga ai që e shkakton dhe ky i fundit të përgjigjet për masën e dëmit që ka shkaktuar.

Tema mbi dëmin jopasuror prej kohësh ka një pozitë kryesore në zhvillimin e praktikës gjyqësore dhe doktrinës. Por, për gjyqtarët si përdorues të ligjit shpesh del detyra e qartësimit të rasteve të sipërmendura gjatë gjykimit të tyre, veçanërisht në rastet që pasqyrojnë kërkesat e paparashikueshme dhe të paparandalueshme të mbrojtjes.

5.3 KONCEPTI I DËMIT EKZISTENCIAL SIPAS VENDIMIT UNIFIKUES NR.12, DATË 14.09.2007 KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Vendimi Unifikues nr.12, datë 14.09.2007 ka shkaktuar dyshime të forta te shumë profesionistë në lidhje me mundësinë e njohjes së kompesimit, që rrjedh nga një

shumëllojshmëri dëmsh të shkaktuar ndaj personit, veçanërisht të atyre me natyrë jo pasurore, mes të cilave përfshihet edhe dëmi ekzistencial.

Dëmi ekzistencial ka mbështetje në Kushtetutë në nenet 3,16,21,25, etj përgjithësisht dhe në mënyrë të veçantë në Titullin IV të Kodit Civil, “*Detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit*”, në marrëdhëniet civile, etike dhe sociale, ekonomike dhe politike në të cilën flitet për shëndetin, familjen, produktivitetin dhe aftësitë për të punuar të njeriut si edhe gadishmërinë e tij për të mbledhur dhe për të vepruar me kujdes në çdo fushë. Vetëm për të lehtësuar aktivitetet e shumta që njeriu përfshihet për të realizuar qëllimet e tij (që përfshijnë interesa të mbrojtura me Kushtetutë), të cilat mund të grupohen në katër kategori: veprimtari me natyrë biologjike-ekzisenciale; marrëdhënie emocionale dhe familjare; marrëdhënie shoqërore dhe veprimtaritë me natyrë kulturore, shkencore, fetare, në organizatat joqeveritare; veprimtaritë sportive të kohës së lirë dhe argëtuese (Cendon, 2010:61-67).

Vendimi unifikues nr.12, datë 14.09.2007 me të cilin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bënë të mundur një ripërcaktim të kategorisë së dëmit ekzistencial duke kufizuar maksimalisht kompesimin e dëmeve mikroekzistencialë të atyre dëmeve të kota ose jo të rëndësishme, të shkaktuar nga sjellje që janë jashtë kritereve që merren në konsideratë për kompesimin. Kjo nxjerr nevojën në rimarrjen në shqyrtim të çështjes mbi dëmin jopasuror nën dritën e një konfigurimi të ri të modelit kompesues të zbatuar deri më tani nga gjykatat më të ulta.

Shkalla e ndërgjegjësimit mbi këtë nevojë synon të jetë pjesë e situatës ligjore dhe të jurisprudencës aktuale, duke iu kthyer debatit juridik, që veçanërisht në vitet e fundit ka

ndryshuar thellësisht temën e dëmit ekzistencial²⁶. Një vëmendje e veçantë i kushtohet doktrinë që ka hedhur bazat për shfaqjen graduale të kësaj kategorie të re dogmatike. Theksi duhet të vihet në pasurimin e referencave bibliografike dhe të jurisprudencës, që i japin këtij problemi një natyrë teoriko-praktike dhe rishikimin e artikuluar të jurisprudencës.

Mbledhja, shumë e kujdesshme është e përbërë nga dy pjesë: në të parën është integruar vendimi unifikues nr.12 , që mund të konsiderohet edhe si origjina e ‘gurëve të suksesit’; pjesa e dytë, përmbledh, duke urdhëruar argumentat dhe vendosur interpretimet përkatëse maksimale të ligjshmërisë në lidhje me dëmin jopasuror në përgjithësi dhe specifikat e tij kryesore.

Sipas Kolegjeve të Bashkuara dëmi ekzistencial bazohet jo vetëm në lëndimin e natyrës emocionale dhe të brendshme (që Kodi Civil e njeh si dëmi moral) por, objektivisht i vërtetueshëm si lëndim dhe nuk është është gjë tjetër veçse një përmbledhje verbale e dëmeve jo pasurore, si p.sh dëmi në imazhin profesional në vendin e punës, në shfaqjen ose në jetën shoqërore ose në dëmtimin e së drejtës themelore të punonjësit në shprehjen e lirë të personalitetit të tij në vendin e punës të mbrojtura nga neni 3 e të tjerë në Kushtetutë. Paqartësitë në lidhje me përkufizimin e jurisprudencës do të reflektohen pashmangshmërisht në jurisprudencën e gjykatave më të ulta duke qenë se diskutimi mbi përcaktimin konkret të dëmeve që kompesohen është akoma i papërcaktuar mbi pranueshmërinë e dëmit ekzistencial dhe në kërkim të situatave juridike subjektive të mbrojtura kushtetueshmërisht dhe si të tilla duhet të shpërblehen (V.K.C.Gj.L nr.739, datë 19.03.1999).

²⁶ sipas analizës së rasteve të jurisprudencës së brendshme

Në këtë kuadër problemi i vërtet me të cilin përballen interpretuesit e ligjit nuk është ai i përkufizimit të dëmit pra, nëse dëmi jopasuror i ndryshëm nga shkaktimi i dëmit në shëndetin e personit duhet të quhet moral apo biologjik nga njëra anë apo ekzistencial nga ana tjetër, problemi në fakt, është ai i individualizimit të kufijve të arsyeshëm mbi kompesimin e dëmeve mikro-ekzistencialë si edhe ai i përzgjedhjes së interesave kushtetueshmërisht të mbrojtur (Marchesini,2007:15). Prandaj, nëse duhet të mbajmë në përdorim formulën e dëmit ekzistencial duhet që të njihen mbi bazën e një kuptimi përrshkrues.

Së pari, është e rëndësishme të identifikohet e drejta e shkelur duke pasur garanci kushtetuese dhe *së dyti*, të verifikohet nëse nga dëmi janë shkaktuar pasoja të cilat duhet të dëmshpërblehen, duke shmangur atë ndryshim metodologjik të pambështetur, për të cilin fillimisht duhet të identifikohet dëmi dhe pastaj në bazë të tij të vlerësohet se cila prej veprimtarive të suksesit të personit është dëmtuar (Cendon, 2010:57).

Një tjetër aspekt për të përcaktuar dëmin ekzistencial, gjithmonë duke u mbështetur në supozimin e bazës kushtetuese të së drejtës ose interesit të shkelur, duke e parë në aspektin ekonomik si një dëm-pasojë dhe jo si një dëm-fakt/ngjarje; pala e dëmtuar ka detyrimin për të provuar ngjarjen duke vërtetuar të gjithë elementët e vlefshmërisë së përgjegjësisë jashtëkontraktore të parashikuara nga neni 608 i K.C (veprimi/mosveprimi i kundraligjshëm, faji, dëmi e lidhja shkaksore) dhe për më tepër pasojën e dëmshme që përkon me heqjen ose pakësimin e një vlere personale për shkak të veprimit të atij që ka shkaktuar dëmin, në bazën e të cilës ai është i detyruar të kompesojë dëmin (Cendon, 2010:69).

Duke folur për dëmin ekzistencial edhe në mungesë të lëndimit fizik është e kuptueshme moria e paragjytimeve, që projektohen për ta pranuar, në të ardhmen, gjykata duhet të marrë në konsideratë masat parandaluese dhe parashikimet e ligjit mbi bazën e elementëve objektivë të provuara nga pala e dëmtuar. Në fakt, dëmi ekzistencial nuk është një dëm ‘reflektim’ dhe as një dëm pasojë si dhe nuk passjell një detyrim të dyfishtë për shpërblim, por është rrjedhim i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm i faktit të paligjshëm që shkakton dëmin, që duhet të marrë një kompesim të drejtë për shkak se bëhet fjalë për një të drejtë të mbrojtur kushtetueshmërisht (Christandl, 2007:292).

Kështu mbetemi në thelb në atë kategori dëmi të ripërcaktuar nga vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr.12, datë 14.09.2007, që përjashtohen nga detyrimi për shpërblim dhe që Gjykata e Lartë i përkufizon si një prodhim të jurisprudencës së afërt si p.sh është dëmi ekzistencial i shkaktuar nga prishja e pushimeve, prerja e flokëve e bërë keq, etj

Prandaj, këtë e tutje, irritimi, trazimi i gjendjes shpëtore, pengesat e shkurtra nuk do të dëmshpërblehen sepse janë mbështetje, që duhet të tolerohen në jetën dhe bashkëjetesën shoqërore, pra në këto raste nuk kemi të bëjmë me dëm ekzistencial. Kompesimi i dëmit ekzistencial ose shkelja e interesave kushtetuese bëhet nëse e justifikojnë pasojat e ngjarjes së dëmshme (Ponzanelli, 2004:60-61). Shpërblimi i tij bazohet si edhe në rastin e dëmit biologjik në të dhënat tabelore që kanë të bëjnë me vlerësimin sociologjik dhe psikologjik të gjendjes së të dëmtuarit. Nën këto kritere mund të gjejmë vend për kompesim edhe rastet e dëmeve mikro-ekzistenciale, që në doktrinën italiane njihen si dëmet bagattellari²⁷ .

²⁷ nuk janë të kompesueshëm dëmet bagattellari, të cilët konsistojnë në pakënaqësi, shqetësime, zhgënjime, ankth dhe çdo lloj tjetër të pakënaqësisë dhe që në jetën e përditshme ata nuk perceptohen si të tillë

5.4 KONFIRMIMI I INTERPRETIMTI KUSHTETUES TË NENIT 625 TË KODIT CIVIL, SISTEMI I KOMPESIMIT TË DYFISHTË TË PËRGJEGJËSISË JASHTËKONTRAKTORE DHE DËMI JOPASUROR SI KATEGORI E PËRGJITHSHME DHE UNITARE E NDARË NË DISA NËNKATEGORI VETËM PËR QËLLIME PËRSHKRUESE

Siç u përmend, në parashikimet e nenit 625 të K.C dëmi jopasuror përkon me dëmin moral subjektiv, që nënkuptonte një vuajtje morale me natyrë të përkohshme të pësuar nga pala e dëmtuar për shkak të një fakti të paligjshëm sipas interpretimit të bërë me vendimin unifikues nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Siç u përmend, në parashikimet e nenit 625 të K.C dëmi jopasuror përkon me dëmin moral subjektiv që nënkuptonte një vuajtje morale me natyrë të përkohshme të pësuar nga pala e dëmtuar për shkak të një fakti të paligjshëm.

Sipas interpretimit të bërë me vendimin unifikues nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë neni 625 i K.C përfshin si dëmin moral subjektiv, *pretium doloris* ashtu edhe dëmin jo pasuror, duke e marrë në kuptimin e gjerë, me qëllim që të nënkuptojë të gjitha pasojat negative që ka pësuar viktimja nga fakti i paligjshëm, të cilat ndikojnë në aspektin personal dhe jo të ardhurat e viktimës me kusht që këto dëme rrjedhin nga shkelja e të drejtave të padhunueshme të garantuara nga Kushtetuta.

Neni 625 i K.C nga ana e vet na jep një renditje të rasteve kur lind detyrimi për përgjegjësi për dëmin jopasuror me kërkesën për të ekzistuar të gjithë elementët e vlefshmërisë të

përgjegjësisë jashtëkontraktore, që rrjedh nga fakti i paligjshëm, të paracaktuara në nenin 608 të K.C²⁸.

Kolegjet e Bashkuara, përpara se të ndodhnin ndryshimet ligjore të vitit 2012 në Kodin Civil, me vendimin nr.12 , datë 13 e 14 shtator 2007, kategorizuan dy lloje të kompesimit për dëmin jopasuror, nga njëra anë rastet, që parashikonin dispozitat ligjore dhe nga ana tjetër mundësinë e shkeljes së të drejtave të patjetërsueshme të mbrojtura nga Kushtetuta. Përveç rasteve që parashikohen shprehimisht nga legjislatori ekziston dhe një kompesim virtual që i atribuohet karakterit të pacënueshëm të të drejtave të mbrojtura me një ligj të veçantë.

Fusha e kompesimit të dëmit jopasuror rrjedh nga individualizimi i normave që parashikojnë një mbrojtje të tillë dhe kanë lidhje si p.sh me nenin 60 të K.P, që edhe pse nuk jepet në mënyrë të drejtpërdrejtë sanksionohet detyrimi për shpërblimin e dëmit civil në rast të shkakut të saj gjatë ndodhjes së një vepre penale dhe raste të tjera të ligjeve të zakonshme, që në lidhje me cënimin e vlerave personale sigurojnë kompesimin edhe të dëmeve jopasurore, kjo në mbështetje të parimit të mbrojtjes minimale të kompesimit, i cili është zgjeruar duke përfshirë në të edhe rastin e të drejtave kushtetueshmërisht të mbrojtura (Ligji nr.8934/2002, nr.9323/2004, ligji nr.9572/2006, ligji nr.9863/2008, ligji nr. 9902/2008, ligji nr.9970/2008, ligji nr.10221/2010, ligji nr.10347/2010, etj).

Në këtë kuadër, Kolegjet e Bashkuara integruan për herë të parë, pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil në vitin 1994 brenda figurës së dëmit jopasuror, tre nënkategori të tij, dëmin biologjik, moral dhe ekzistencial, i cili për kohën njëhej pak ose aspak në radhët e juristëve e që në përshkrim të ngjarjes së ardhur në rastin e paraqitur në vendimin unifikues nr.12,

²⁸ dhe nga dispozitat e tjera që parashikojnë raste të përgjegjësisë objektive.

paraqet dëmin e rrjedhur nga humbja ose dëmtimi i marrëdhënies prindërore nga vdekja ose rasti kur shkaktohet paaftësi e rëndë e përhershme apo e përkohshme apo dëmi që shkaktohet nga shkelja e të drejtave të reputacionit, të imazhit, emrit, jetës private si të drejta të pacënueshme të njeriut (neni 3 e 15 të Kushtetutës).

Kolegjet e Bashkuara, në fushën e përgjegjësisë akuiliane është mbështetur në një sistem të dyfishtë kompesimi, bazat e të cilit jepen në nenet 608 e 625 të K.C, duke krijuar në këtë mënyrë një paralelizëm midis dy rregullave, të cilat ndryshojnë përsa i përket qëndrimit mbi kërkesat e paligjshmërisë së veprimit/mosveprimit duke vendosur një kriter jo të zakonit të lidhur me shkeljen e një interesi ligjërisht të mbrojtur në rast të dëmit pasuror dhe të zakonshëm që përsërit faktin “ vetëm në rastet e parashikuara nga ligji dhe në rastet kur shkaktohet nga një ngjarje, në të cilën dëmi konsiston në shkeljen e të drejtave të veçanta e të pacënueshme të njeriut”, për dëmin jopasuror (Semini, 2011:12).

Gjithashtu, duhet të theksohet se në logjikën e dyfishtë të nenit 625 të K.C bëhet fjalë për dispozitë, që rregullon një çështje jo të plotë: dispozita në fjalë përcakton vetëm rastet kur lind përgjegjësia për kompesimin e dëmit jopasuror, për elementët e tjerë të vlefshmërisë së përgjegjësisë mbështetja bëhet në nenin 608 të K.C ose në dispozita, që rregullojnë regjime të veçantë të përgjegjësisë.

Neni 625 i K.C paraqet veçanërisht identifikimin e interesave të natyrës jopasurore, të cilët kompesohen në rast se verifikohen raste që sipas ligjit ose në çmuarje të gjykatës, i nënshtrohen një interpretimi në fushën e ligjit ose Kushtetutës për rastet e një të drejte të veçantë të pacënueshme të njeriut, të mbrojtura nga mbrojtja kompesuese minimale.

Më pas Kolegjet e Bashkuara analizojnë hipotezat konkrete të riparimit të dëmit jopasuror, me synimin për të vërtetuar se cilat janë interesat e mbrojtur. Përfundimet e arritura janë: në

praninë e faktit të paligjshëm është i kompesueshëm dëmi jopasuror që shkel të drejta kushtetueshmërisht të mbrojtura por edhe në rast të shkeljes së çdo të interesi të qënësishëm të personit, që nuk parashikohet nga një normë urdhëruese e ligjit por, që mbrohet nga rendi juridik në bazë të parimit të sanksionuar nga neni 608 i K.C, për shkak se e zakonshme në këtë rast është se nuk është parashikuar vetëm në nivel të interesit të mbrojtur, por për shkak të zgjedhjes së ligjvënësit për t'i quajtur dëme jopasurore të shkaktuara nga fakti i paligjshëm. Zgjedhje, e cila përfshin rëndësinë e të drejtës së shkelur parë nga pikëpamja e mbrojtjes penale.

Në rastet e tjera të parashikuara nga ligji, zgjedhja e së drejtës së përshtatshme për t'u mbrojtur bëhet drejtpërdrejtë nga ligjvënësi, i cili mund të parashikojë mbrojtjen kompesuese jopasurore edhe në lidhje me të drejta jetike të njeriut pa qenë e nevojshme për të qenë të mbrojtura nga Kushtetuta si të drejta të pacënueshme (Skrame, 2011:542). Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj jepet mbrojtje kompesuese për dëmet jopasurore vetëm nëse konstatohet shkelja e një të drejte të patjetërsueshme të njeriut si dhe duhet të ekzistojë një padrejtësi e kualifikuar si e tillë kushtetueshmërisht e interpretuar nën dritën e nenit 3 të Kushtetutës, e cila i lejon interpretuesit të gjejnë në sistemin e përgjithshëm kushtetues tregues, që janë të përshtatshëm për të vlerësuar të drejta të reja të shfaqura në realitetin shoqëror jo përgjithësisht të rëndësishëm për sistemin, por që në nivelin kushtetues i përkasin të drejtave të pacënueshme të njeriut (Semini, 2011:13).

Në këtë mënyrë lista e të drejtave të pacënueshme është në thelb e hapur nga momenti që kompesimi sipas Kolegjeve të Bashkuara duhet të vendoset ndaj shkeljeve të çdo të drejte të njeriut të mbrojtur nga neni 3, 15 e vijues i Kushtetutës edhe pse shteti nuk i njeh shprehimisht me Kushtetutë.

Për të përcaktuar të drejtat që në sistemin tonë kompesues rezultojnë të mbrojtura në drejtim jo ekonomik, Kolegjet e Bashkuara kanë dhënë disa konsiderata thelbësore mbi kategoritë e dëmit jopasuror. Duke folur për rastet në të cilat fakti i paligjshëm konfigurohet si krim, Kolegjet e Bashkuara u fokusuan mbi kuptimin e dëmit moral pasi vunë në pikëpyetje bazën ligjore të figurës dhe vunë në dukje që vuajtja shpirtërore e shkaktuar nga krimi nuk është domosdoshmërisht e përkohshme edhe duke u shoqëruar me pasoja të dhimbshme për një kohë të gjatë duke pohuar se emërtimi dëm moral nuk identifikon një nënkategori të dëmit, por përshkruan, mes shkeljeve të mundshme të ndryshme jopasurore një lloj cënimi, që përbëhet nga vuajtjet e brendshme të shkaktuara nga krimi i vetpërcaktuar ky intensitet i zgjatur në kohë nuk do të kishte rëndësi për ekzistencën e dëmit, por vetëm për përcaktimin relativ të tij (Mataj, 2015:14).

Duke iu referuar hipotezës për shkelje të të drejtave të patjetërsueshme, Kolegjet e Bashkuara pohojnë se ‘nuk shfaqen si pjesë e kategorisë së përgjithshme të dëmit jopasuror, por si nënkategori që pasqyrojnë raste të përcaktuar nga ligji , në nivelin më të lartë të vendosur nga Kushtetuta për riparimin e dëmit jopasuror. Në këtë kontekst, merret vlera e veçantë përshkruese për emërtimet e ndryshme, si dëmi moral, biologjik, ekzistencial, dëmi nga humbja e marrëdhënies prindërore, që nuk janë veçse shprehje e përmbledhjeve e përshkrimeve të shkeljeve të caktuara (vuajtja subjektive në vetvete konsiderohet si shkelja e përhershme ose përkohshme e integritetit psiko-fizik të njeriut e vërtetuar nga raporti mjeko-ligjor që shprehet në ndikimin negativ të veprimtarisë së përditshme dhe në aspektet dinamike të jetës së palës së dëmtuar, pavarësisht, çdo pasoje në aftësinë për të fituar të ardhura, shkelje e të drejtave të familjes). Këtu i referohemi atyre rasteve, që kapërcejnë figurat e veçanta të dëmit që rrjedhin nga fakti i paligjshëm duke marrë në konsideratë atë

kategori të dëmit jopasuror në kompleksitetin e saj, kjo e fundit është parë si pikë e vetme referuese për interpretim, pa e shpërbërë në nënkategori të llojeve të ndryshme.

Për të konfirmuar sa më lart, Kolegjet e Bashkuara nënvizojnë se nuk është e favorshme rindarja brenda kategorisë së përgjithshme të dëmit jopasuror, figura të veçanta të dëmit, duke i riemërtuar në mënyra të ndryshme dhe leximi i Kushtetutës nën dritën e nenit 625 të K.C nuk ligjëron një rast të rritjes së nënkategorive të dëmit (dhe aq më pak një mjet për dyfishimin e kompesimit të të njëjtave dëme) por, si një mjet për të plotësuar mangësitë e mbrojtjes kompesuese të personit.

5.5 RËNDËSIA JURIDIKE E DËMIT EKZISTENCIAL DHE KUADRI DOKTRINOR I FIGURËS

Prej disa vitesh praktika gjyqësore na ka njohur me një figurë të re juridike, që doktrina prej kohësh e kishte pranuar. E dhëna lehtësuese ka konsistuar në faktin e zbatimit, në fushën gjyqësore, të kërkesave të bëra prej atyre që kishin pëuar një dëmtim që i përket fushës ekzistenciale më natyrë jopasurore. Pra, bëhet fjalë për një lloj dëmi, që, siç kishte ndodhur me dëmin biologjik²⁹ është njohur fillimisht në rrugë gjyqësore, pavarësisht ligjeve kualifikuese ekzistuese (Alpa, 1982:11).

Trajtimi i çështjes duhet të nis nga një diskutim më bazë psikologjike më shumë sesa juridike pastaj aspekti psikologjik përfaqëson një pararendës për një kuptim më të gjerë të figurës juridike dhe institutit të përgjegjësisë akuiliane (Dominici, 2006:9).

Ky lloj dëmi nxit studimin e një fushe delikate siç është ajo e personalitetit të individit, që në thelbin e vet kuptohet si tërësia e vlerave komplekse të paprekshme dhe të

²⁹ Për herë të parë dëmi ndaj shëndetit është njohur nga gjykata gjenoveze në vitin 1974 dhe pas 7 vitesh u konfirmua nga Gjykata e Kasacionit të Italisë, në vitin 1981.

patjetërsueshme të njeriut. Ky koncept i hapur dhe dinamik i individualitetit në të vërtetë është parathënë nga Kushtetuta nën nenin 3 dhe 15 të saj, e cila është garantuese e vlerave të brendshme dhe që përbëjnë objektiv kryesor të rendit juridik. Në ditët e sotme ka diçka më tepër në lidhje me qëndrimin juridik tradicional që mbështet lindjen dhe njohjen e këtyre lloj dëmeve (Ponzanelli 2003:36).

Në fakt, ai është vendosur përballë një prirje të gjerë të forcimit të subjektit, që shihet se janë të destinuar për të ndjekur një projekt të gjerë mbi realizimin personal për të pasur një karakter të përgjithshëm që kapërcen e ndonjëherë kalon nga aftësia për të fituar të ardhura drejt formave të rritjes së aftësive krijuese, individuale dhe shoqërore. Pra, duke mos u kufizuar vetëm në rolin ekonomik të individit, por e parë e mishëruar në mundësinë për të shprehur veten në të gjitha nivelet (Cendon, 2010:61).

Interpretuesit që merren me analizimin e kësaj çështjeje duhet të kenë në konsideratë zhvillimin e personalitetit të viktimës në të gjitha format në të cilat ajo mund të shfaqet për të vërtetuar si dhe në çfarë mase dëmi i ndodhur ka shkaktuar shtypjen ose kufizimin e sferës psikologjike dhe në ç'mënyrë dëmi është kthyer në një përkeqësim të ndjeshëm të cilësisë së jetës në përgjithësi, që justifikon rënien e të ardhurave, pa marrë parasysh ekzistencën e njëkohshme edhe të dëmit ndaj shëndetit apo dëmeve morale që pasohen nga ankthi, dhimbja dhe vuajtja psikike që janë të kompesueshme nën parashikimet e nenit 625 të K.C.

Për këtë qëllim drejtohem tek vendimi unifikues nr.12, datë 13 e 14 shtator 2007, i cili specifikon se përkeqësimi i mënyrës së jetesës varet nga fakti se janë ndaluar në zhvillimin e një aktiviteti nëpërmjet të cilit shpjegohet përmasa ekzistenciale e njeriut që nuk mund të përmblihet në një përmasë thjesht të brendshme dhe të pakëndshme, por që

është e nevojshme të përfshijë aspektet dinamike të jetës së njeriut. Nocioni i dëmit nënkupton një ngjarje që për ndikimin e saj negativ ka mundësi të ndikojë ndjeshëm në jetën e njeriut. Në këtë mënyrë bëhet vendimtare një konsideratë jo kufizuese e “*dëmit-ngjarje*” duke mos u vendosur nën vlerësime teknike të bazuara në parametra tabelorë, për më tepër për të shënuar herë pas herë ndërhyrjet e dëmshme të mundshme.

Njohja e dëmit ekzistencial është përshtatur qartazi në fushën e trendit të përgjithshëm të përhapur në vitet e fundit nga drejtësia e merituar dhe legjitime drejt një kujdesi të madh për çështje të solidaritetit dhe marrëdhënieve shoqërore (Magliona, 2005:29). Ky përpunim që gjen elementë të njëjtë edhe në Kodin tonë Civil ka ndërtuar bazën e zgjerimit të mbrojtjes kompesuese për të drejta që në të kaluarën nuk ka pasur mbrojtje për të qenë shoqërisht legjitim pa marrë asnjë konfirmim ligjor. Në mënyrë të veçantë për të drejta të shëndetit, mjedisit, mbrojtjes së konsumatorit, për të gjitha fushat që nuk përbëhen nga një e drejtë subjektive perfekte por, nga një interes i gjerë, që i përket një kategorie që prek njeriun.

Prandaj, dëmi ekzistencial duhet të kuptohet saktësisht, jo vetëm në qasje personale, por edhe në një qasje kolektive, që mundëson t’i jepet hapsirë edhe problemeve sociale më emergjente (Rossi, 2008:940). Por, nëse flasim për një zgjerim të situatave të përfshira në kategorinë e dëmit ekzistencial deri më tani nuk ka një skemë ligjore që nuk lejon zgjerimin e kësaj gjinie. Në fakt duke nisur nga vitet ’90 gjykatat kanë filluar me rezervë të përshkruajnë figurën e dëmit ekzistencial.

Mjetet për mbrojtjen kompesuese përfaqësohen nga neni 608 i K.C, ndërsa referimi kryesor ligjor, që justifikon zbatimin e rregullit në fjalë është vendosur nga neni 3 i Kushtetutës , garancia kushtetuese e të drejtave themelore të njeriut.

Dëmi ekzistencial ka pasur gjithmonë në referencë parimet kushtetuese, por kjo nuk heq atë që supozohet si fusha mbajtëse, e aftë për të përmbledhur të gjitha në një seri hipotezash, të cilat p.sh nuk kanë të bëjnë me shkeljen e një të drejte që ka mbrojtje të drejtëpërdrejtë kushtetuese, por që kanë vlerë emocionale, por të rëndësishme për realizimin e interesave të tjera më të rëndësishme. Në këtë rast, dëmtimi ose humbja e disa të mirave materiale do të ndikojë në sferën ekzistenciale të njeriut në formën e një dëmtimi të kompesueshëm (Bona, 2004:364). Shembull i një situatë tipike të kësaj natyre mund të jetë rasti i vlerës së shtëpisë dhe mobiljeve që janë në të . Nëse pronarit i ndodh një vjedhje me vlerë të konsiderueshme ose shkatërrim i banesës rrjedhin pasoja jo vetëm pasurore por edhe me natyrë ekzistenciale për shkak të shqetësimit serioz të ndodhur.

Megjithatë, vrasja e qenit për një person të verbër, shkatërrimi i karrocës për një person me aftësi të kufizuara, vjedhja e punimit të diplomës së një studenti janë hipoteza të shkeljes së të mirave funksionale që flasin për aktivitete të nevojshme të jetës së njeriut. Kjo është arsyeja për të cilën njihet prania e dëmit ekzistencial për shkak të natyrës shumë personale të disa të mirave që janë mjete të rëndësishme dhe të nevojshme për jetën (Ziviz, 2006: 145).

Rruga e ngadaltë drejt zgjerimit të fushës së shpërblimit të dëmit jopasuror ka nisur fillimisht me njohjen e dëmtimit të shëndetit në nenin 17 të dekretit nr.295, datë 15.09.1992 *”Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”* (i ndryshuar).

Me daljen e vendimit unifikues nr.12, datë 14.09.2007 u bë kapërcimi i ndarjes në kuptimin e ngushtë të dëmit (pasuror dhe jopasuror) sepse u kalua, nga koncepti i aftësisë së subjektit për të fituar të ardhura për qëllim të kompesimit drejt rikuperimit të dëmit

vetëm në rast të ngjarjeve të dëmshme. Në vijm të këtij evolucioni të rëndësishëm, tashmë të konsoliduar, ka dal vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që ka sanksionuar njohjen e figurës së dëmit ekzistencial, krahas atij moral dhe biologjik.

Shkelja që shkakton dëmi ekzistencial pasqyrohet në ndryshimin e jetës shoqërore, në humbjen e cilësisë së jetës, në zhvlerësimin e dimensionit ekzistencial të personit duke ndjekur rrugën e dëmit biologjik, i cili ishte në përputhje me parashikimet e nenit 625 të K.C që kompesohet në bazë të nenit 608 të K.C dhe nënkuptohet si normë që rregullon shpërblimin jo vetëm të dëmit pasuror, por edhe atij jopasuror të lidhur me personin.

Në këtë kuadër figura e re e dëmit do të zgjidh në përshkrimin e një shkeljeje të natyrës ekzistenciale (keqësimin e cilësisë së jetës, ndryshimin në sferën e jopasurores) të pashoqëruar me nevoja personale sipas qëllimit të kërkesave të ligjit, që janë të drejta juridike të rëndësishme, të shkelura nga fakti i paligjshëm.

Kolegjet e Bashkuara me vendimin nr.12, datë 14.09.2007 konfirmuan se dëmi jopasuror është i kompesueshëm, përveç rasteve të përcaktuara nga ligji vetëm në rast të shkeljes së të drejtave specifike të pacënueshme të njeriut të njohura si dëme të kualifkuara nga pikpamja kushtetuese, dëmi ekzistencial si figurë autonome e dëmit nuk ka më një diskutim, nga koha që ai u shfaq për të plotësuar një boshllëk ligjor, i cili nuk ekziston më.

Pra, del e qartë se dëmi ekzistencial nuk mohohet nga Kolegjet e Bashkuara si element përshkrues, por shihet si një figurë që mundëson zgjerimin e interesave përkatëse në fushën e mbrojtjes jopasurore përtej kufijve të të drejtave të vendsoura nga neni 625 i K.C.

Në zbatim të nenit 625 të K.C shkeljet me natyrë ekzistenciale do të jenë të kompesueshme në rastin e një vepre penale në raste të tjera, vetëm kur e përcakton ligji dhe

jo vetëm kur lind si pasojë e shkeljes së një të drejte të pacënueshme të njeriut, p.sh në rast të shkeljes së të drejtës së pacënueshme të familjes, si në rastin e shkatërrimit të jetës familjare për shkak të humbjes së bashkëshortit ose në rast të faktit të paligjshëm që i shkakton të martuarit pamundësinë e marrëdhënieve seksuale dhe menjëherë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e të drejtave të tjetrit për një raport të tillë (V.K.C.Gj.L nr.1334/2007). Në pikëpamjen e dhënë nga Kolegjet e Bashkuara shkelja e tipit ekzistencial është e kompesueshme vetëm brenda kufijve të shkelejes së një të drejte të pranuar kushtetueshmërisht si rast dëmi. Nëse kjo nuk vërtetohet, pra cënimi i një të drejte kushtetuese të pacënueshme atëherë nuk përfitohet kompesimi mbrojtës.

Kolegjet e Bashkuara sollën në vëmendje përpjekjen për të tejkaluar qëndrimin si përkrahës të dëmit ekzistencial brenda kufijve të orientimit kushtetues të nenit 625 të K.C, duke kaluar nga teza sipas së cilës rëndësia kushtetuese nuk duhet t'i përmbahet së drejtës së shkelur, por lëndimit, dëmit të ardhur, në tezën, që lidh shpërblimin e dëmit ekzistencial jo vetëm për shkak të cënimit të një të drejte kushtetueshmërisht të mbrojtur, por edhe për cënimin e çdo të drejte juridikisht të rëndësishme.

Sipas gjyqtarëve të shkallëve më të ulta, këto dy teza duhet të hidhen poshtë pasi, *së pari*, duke mohuar kufizimin e mbrojtjes kompesuese në prani të faktit të paligjshëm të cilësuar nga ana kushtetuese si ngjarje e dëmshme zgjidhet me shfuqizimin e nenit 625 të K.C, parë në këndvështrimin kushtetues të tij, *së dyti*, sepse e çon dëmin jopasuror nën rregullimin e nenit 608 të K.C sipas të cilit shpërblimi jepet nëse shkelet një e drejtë e përgjithshme e rëndësishme në redin juridik, duke kundërshtuar në këtë mënyrë parimin e zakonshëm mbi dëmin jopasuror.

Kolegjet e Bashkuara theksojnë se nuk ka antikushtetueshmëri në nenin 625 të K.C në lidhje me parashikimin e kompesimit të kufizuar për dëmin jopasuror, kur përkrah tij renditen disa nënkategori të papërmendura nga ky nen, pavarësisht se jo të përmendura shprehimisht duke argumentuar se “... edhe dhimbja e brendshme e vuajtja shpirtërore, si edhe cënimi i normalitetit të jetës së njeriut (*non iure perturbatio*) në ekzistencën e tij si individ dhe anëtar i shoqërisë, të shkaktuara nga vepra e paligjshme e të tretit, përbëjnë cënime të vlerave të lartpërmendura të të drejtave të personalitetit të mbrojtura nga Kushtetuta. Në zbatim të tyre, në nenin 625 të K.C, parashikohet e drejta për të kërkuar shpërblim nëse cënohet në nderin dhe personalitetin e tij”. Këto cënime formësohen në dy lloje dëmsh jo pasuror të fushës jashtëkontraktore: dëmin moral dhe ekzistencial.....”(VENDIMI UNIFIKUES NR.12/2007).

Ky është interpretimi i Kolegjeve të Bashkuara në vitin 2007, por edhe pse në vitin 2012 Ligji nr.7850, datë 29.07.1994 ‘Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë’ pësoi ndryshime, më konkretisht edhe në nenin në fjalë, përsëri në këtë dispozitë nuk u reflektuan llojet e dëmeve jopasurore të parashikuara nga Vendimi Unifikues nr.12, datë 14.09.2007, duke përcaktuar dhe njohur vetëm pesë forma (shteruese) për të cilat mund të kërkohej mbrojtje kompesuese për dëm jopasuror, të cilat përfshijnë : dëmtim të shëndetit, integritetit fizik ose psikik, dëmin që cënon nderin, personalitetin ose reputacionin e personit, dëmin që rrjedh nga cënimi i të drejtës së emrit, dëmin që cënon respektimin e jetës private dhe dëmin në të cilin është cënuar kujtimi i një të vdekuri. (Mataj, 2012: 2).

Kapërcimi i kufijve të kërkesave për kompesim të dëmeve jopasurore nga Kolegjet e Bashkuara rrjedh nga të drejtat themelore sikurse janë jeta dhe shëndeti e dinjiteti, paprekshmëria e njeriut në qënien fizike e psikike, paprekshmëria në jetën private, familjare

e sociale, në të drejtën për të gëzuar dhe zgjedhur me vullnet të lirë mënyrën e jetesës, janë të drejta të personalitetit, të drejta absolute të njeriut, të mbrojtura *erga omnes* në raport me çdo pjesëtar tjetër të shoqërisë dhe që si të tilla përbëjnë rendin tonë juridik dhe që gëzojnë mbrojtje kushtetuese sipas neneve 3,15,18,21,42,419,52,53,54 e 55 të Kushtetutës.

Nga këndvështrimi praktik ka një përballje mes parimit të solidaritetit me viktimën dhe atij të tolerancës të imponuar nga bashkëjetesa në shoqëri, duke vendosur një filtër të dyfishtë për pranimin e dëmshpërblimit të dëmeve jopasurore që rrjedhin nga shkelja e të drejtave të mbrojtura kushtetueshmërisht, duke konfirmuar që shkelja duhet të tejkalojë një kufij të caktuar cënimi duke e bërë shkeljen aq të rëndë sa që duhet të kompesohet nga një sistem që ka një shkallë minimale tolerance (Cendon, 2000: 79). Prandaj, është gjykata që çmon në bazë të parametrave të mbështetur në vetdijen sociale në një moment të caktuar, që ka tejkaluar nivelin e tolerancës dhe që shkelja ka qenë e rëndësishme.

Nën këtë argumentim të Kolegjeve të Bashkuara duhet theksuar fakti që dëmi jopasuror nuk është kategori e përgjithshme e ndarë në nënkategori me emërtime të ndryshme. Në mënyrë të veçantë, nuk mund t'i referohemi një nënkategorie të përgjithshme të emërtuar si '*dëm ekzistencial*' sepse duke thënë këtë vendoset dëmi jopasuror në një pozicion atipik, edhe pse nëpërmjet evidentimit të shfaqjes së figurës së veçantë të dëmit ekzistencial, në të cilin ndërthuren raste jo domosdoshmërisht të parashikuara nga dispozitat ligjore për shpërblimin e këtyre llojeve dëmeve, kjo situatë nuk është rregulluar nga legjislatori dhe as ka dal nga interpretimi kushtetues i nenit 625 të K.C, i cili kënaqet me mbrojtjen kompesuese të vlerave të veçanta të njeriut që rrjedhin nga të drejtat e padhunueshme sipas Kushtetutës.

Pavarësisht përpjekjeve fillestare për ta bashkuar kompesimin e dëmit ekzistencial me kritere financiare tashmë jemi përballë një praktike gjyqësore që përpiqet të thyjë tabut

e nenit 625 të K.C, në lidhje me shpërblimin e dëmit jopasuror dhe të zgjerojë fushën e dëmit jopasuror të kompesueshëm tej modelit kufizues të parashikuar nga Kodi Civil.

5.6 NDRYSHIMI I KODIT CIVIL DHE MOSREFLEKTIMI I DËMIT EKZISTENCIAL SI FIGURË E POSAÇME E DËMIT JOPASUROR BRENDË NENIT 625 TË K.C'94

Vendimi nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka shkaktuar në shumë profesionistë dyshime të forta mbi mundësinë njohëse të shpërblimeve, që rrjedhin nga shumëllojshmëria e dëmeve ndaj personit, në mënyrë të veçantë ndaj atyre me natyrë jopasurore, mes të cilëve përfshihet edhe dëmi ekzistencial, përkufizimin e tij qoftë doktrinar, qoftë të jurisprudencës e kemi paraqitur më lart. Çështja që na lind për diskutim, pas ndryshimeve që ndodhën në Kodin Civil në vitin 2012 është se figura e dëmit ekzistencial si një kategori autonome e dëmit jopasuror nuk u përfshi në parashikimet e nenit 625 të K.C, duke hequr në këtë mënyrë një pjesë të rëndësishme në analizimin dhe vlerësimin kompesues për vuajtjen e shkaktuar palës së dëmtuar në këtë kategori dëmi.

Rëndësia dhe njohja e dëmit ekzistencial nuk prek vlerat e tij përcaktuese, në rastet kur kjo mund të paraqitet si rrjedhim i dëmit biologjik duke vlerësuar dhe prekur kështu hipotezat mbi shpërblimin në formë të përmbledhur të tyre. Në mënyrë më konkrete paraqesim arsye mbi të cilën ai u evidentua në vendimin unifikues nr.12, datë 14.09.2007 duke pasur një argumentim në të cilin mpleksen elementë psiko-ligjor të kësaj kategorie dëmi. Tej rasteve të përcaktuara nga ligji sipas parimit të kompesimit mbrojtjes minimale, që rrjedh nga të drejtat kushtetuese të padhunueshme, mbrojtja është zgjeruar për rastet e dëmit jopasuror që shkaktohet nga shkelja e të drejtave të padhunueshme të njeriut të

njohura nga Kushtetuta. Si rezultat i këtij zgjerimi është njohur brenda nenit 625 të K.C dëmi shkaktohet nga shkelja e të drejtës së padhunueshme të shëndetit (neni 59/1.c i Kushtetutës) i quajtur dëm biologjik për të cilin jepen të dhëna në nenin 3 dhe 25 të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 “*Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të transportit*”, (të ndryshuar).

Siç dihet, më parë mbrojtja e dëmit biologjik bëhej mbi lidhjen argumentuese mes nenit 608 të K.C dhe nenit 59, pika c, të Kushtetutës, për të hequr kufirin e vendosur nga neni 625 i K.C, dispozitë brenda së cilës mund të kishte pasur një rregullim që prej fillimit, siç është përcaktuar edhe në vendimin unifikues nr.12, datë 14.09.2007. Në këtë rast është e përshtatshme edhe lidhja me dispozitën që flet për mbrojtjen ndaj individëve që kanë pësuar shkelje të së drejtës së pacënueshme të familjes, neni 3, 15 dhe 55 i Kushtetutës (vendimi nr.12, datë 14.09.2007 lidhur me rastin e humbjes ose dëmtimit të marrëdhënies prindërore në rastin e vdekjes së fëmijve, prindërit apo bashkëshortit). I njëjti arsyetim vlen edhe për dëmin-pasojë që rrjedh nga cënimi i të drejtës së reputacionit, të imazhit, të emrit, të jetës private, të drejta të padhunueshme të integruara në dinjitetin e njeriut dhe të garantuara nga neni 3 e 15 i Kushtetutës.

Në këto rreshta gjejmë përkufizime që na orientojnë pozitivisht drejt mundësisë për t’i dhënë vlerë kërkesës mbi njohjen dhe vlerësimin e shpërblimit të dëmit ekzistencial siç dëshmohet në pjesën e fundit të koncepteve të sipërmendura që dëmi është, nëse jo ekzistencial në tërësinë analitike, pasojë e shkeljes së reputacionit, të imazhit, emrit dhe rasteve të tjera të përmendura më lart. Në fakt, vendimi unifikues në fjalë synon të rrëzojë kërkesën për shpërblim për një dëm të supozuar, që ndikon në shëndet jo si integritet psiko-

fizik, por si ‘ndjenjë mirëqënieje’ ku me këtë term mund të nënkuptojmë çdo të keqe që mund t’i ndodh një njeriu nga një fakt i parëndësishëm i një ngjarje të dëmshme.

Në referim të pikës 10 të vendimit unifikues nr.12, datë 14.09.2007 vërejmë se në mungesë të shkeljes dhe jashtë rasteve të përcaktuara me ligj dëmtimet e natyrës ekzistenciale janë të kompesueshme me kusht që të jenë pasojë e shkeljes së një të drejte të padhunueshme të njeriut. Kjo hipotezë vërtetohet p.sh në rastin e prishjes së jetës familjare e shkaktuar nga humbja e bashkëshortit/bashkëshortes (ose dëmi nga humbja e marrëdhënies prindërore) për shkak se dëmtimi me natyrë ekzistenciale pason rrjedh nga shkelja e të drejtave të padhunueshme të familjes (neni 3, 55 e 59/a i Kushtetutës). Në këtë rast merren në konsideratë shkeljet që prekin ekzistencën e personit që për lehtësi përcaktimi mund të përshkruhen dhe përkufizohen si ekzistenciale, që sidoqoftë mund të konfigurohet si një kategori autonome e dëmit.

Shkelje të tjera të natyrës ekzistenciale, që i përkasin sferës që lidhen me njeriun, por që nuk janë pasojë e një lëndimi psiko-fizik (Rossi,2008:946) e për këtë arsye nuk përfshihen në fushën e dëmit biologjik (që përfshin sipas jurisprudencës dhe legjislacionit dëmin estetik, që sipas Kodit Civil nënkupton dëmin në marrëdhëniet njerëzore) janë të kompesueshme sepse janë pasojë e shkeljes së një të drejte të padhunueshme të personit për të drejtën për integritet psiko-fizik.

Duke e parë në këtë dritë kemi të bëjmë me dëmin e njohur si “dëmi nga vuajtjet”, që ka pasoja dhe mund të vërtetohet hipoteza për kompesim dhe në këtë rast vendimi nr.12 nuk përmban ndryshime të rëndësishme në të drejtat e padhunueshme të njeriut. Gjykimi ynë, mbështetur veçanërisht në analizën e vendimit unifikues nr.12, mbi rëndësinë e figurës së dëmit ekzistencial dhe nevojës për përfshirjen e saj në ndryshimet legjislative që pësoi

Kodi Civil në vitin 2012 mund të vazhdojnë më tej me argumenta të plota mbi domosdoshmërinë e njohjes së kësaj figure dëmi në të drejtën civile. Në vijim të pikës 10 të vendimit unifikues nr.12 gjejmë më shumë përshkrime mbi dëme që u atribuohet njohje dhe kompesim. Shkelje të tjera të sferës personale të njeriut, por që nuk shoqërohen me një lëndim psiko-fizik, pra që nuk përfshihen në rastin e dëmit biologjik, kanë të bëjnë p.sh me rastin e dëmit të shkaktuar ndaj një personit të martuar, p.sh në pamundësinë e marrëdhënieve seksuale, kjo është shkelje e drejtëpërdrejtë dhe e menjëhershme e të drejtës së bashkëshortit tjetër për këto marrëdhënie, si një detyrim reciprok i lidhur me personin së bashku me të drejta-detyrime të tjera reciproke në marrëdhënien martesore. Në këtë rast dëmi është pasojë e shkeljes së të drejtave të padhuenueshme të familjes që duhet ti kompesohet palës së cënuar në integritetin psiko-fizik të tij.

Mbrojtja ekzistencialiste duket se është e garantuar nga kufiri i pakapërcyeshëm që në thelb përbëhet nga shkelja e një të drejte kushtetueshmërisht të pacënueshme. Marrim në shqyrtim një rast që është shoqëruar me diskutime si në çështjet civile dhe në ato penale, lidhur me dëmin ndaj personit në vendin e punës, si rezultat i veprimeve të përsëritura të ngacmimeve, presionit, nënshtrimit dhe të tjera të lidhura me këto, e cila e vendos palën e dëmtuar qëllimisht në kushte të këqija psikologjike dhe fizike dhe bashkë me të edhe persona me të cilët ai ka lidhje të ngushta (Vendimi nr.2, datë 11.01.2013 i K.M.D).

Në çështjen në fjalë ndarja e përgjegjësisë së barrës së provës për njohjen e së drejtës së punonjësit për kompesimin e dëmit profesional ekzistencial ose biologjik për shkak të poshtërimit ose skualifikimit në marrëdhënien e punës e kanë përkufizuar dëmin ekzistencial si një shkelje me natyrë jo vetëm emocionale dhe të brendshme, por objektivisht të vërtetueshme të shkaktuar në ekuilibrin e jetës së personit, që ndryshe nga

zakonet e tij të jetës të marrëdhënieve të tij i kanë imponuar zgjedhje të ndryshme në jetë si shprehje e jashtme e arritjeve të tij personale.

Këto lloj qëndrimesh mbi dëmin ekzistencial konfirmojnë gjithmonë edhe më shumë hipotezën se ai është një kategori autonome që ka rëndësi edhe jashtë fushës së marrëdhënieve të punës dhe që mund të rrjedhin edhe nga shkelja e detyrimeve kontraktore të punës (Machesini, 2007:57). Përveç, detyrimit të punëdhënësit për të mbrojtur integritetin fizik dhe personalitetin moral të punëmarrësit (neni 32 i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar) merren në konsideratë edhe të drejta të punëmarrësit që mbrohen nga Kodi Civil i vitit 1994, të hartuara në përputhje me Kushtetutën në nenin 59/1.a për mbrojtjen e integritetit fizik dhe në nenin 2,3 e 59/1.a për mbrojtjen e dinjitetit të punëmarrësit, si të drejta të padhunueshme, shkelja e të cilave i hap rrugën kompesimit të dëmit jopasuror, të natyrës jopasurore që rrjedh nga mospërmbyllja e suksesshme e kontratës.

Në këtë rast jemi në kushtet e një kompesimi të një dëmi jopasuror kontraktor të parashikuar ligjërisht. Për të pranuar ligjshmërinë e dëmit ekzistencial të një punëmarrësi duhet të provohet nga diagnostikimi psikologjik ndryshimi që ai ka pësuar në mënyrën e jetesës, zakoneve apo në drejtime të tjera siç mund të jenë dëmet në raportet familjare si bashkëshort/e, në raportet prindërore, nëse ekzistojnë, duke dëmtuar kështu të drejtën e padhuenueshme të familjes në cilësinë e familjarit, që i është cënuar e drejta e integritetit psiko-fizik. Në fakt, është e pamundur të mos marrim në shqyrtim dëmin që pësojnë familjarët e një personi që vuan “tensionet e punës” e që i shkaktojnë një gjendje me çrregullime të sjelljes, që shoqërohen dhe zhvillojnë shenja të karakterit përkeqësues jo vetëm të përkohshme, por edhe të përhershme, në një fushë shumë të rëndësishme për

mirëqënien e njeriut në përgjithësi (fizike, psikike, shoqërore, seksuale...) nuk është e mundur, pa përfshirë sferën e dinjitetit njerëzor, si pasojë nuk konfirmohet dhe vlerësohet dëmi biologjik (që përfaqësohet edhe nga shqetësimet psikologjike, që dëmton integritetin e tyre) dhe ekzistencial, që shkaktohet.

Gjykata e Lartë në mënyrë të përsëritur ka trajtuar të drejtat e padhuenueshme, që janë objekt i njohjes së dëmit jopasuror. Është e përshtatshme që të ketë një vlerësim, *il quantum*, të dëmit, që nënkupton se shkalla e dëmit përbën një kërkesë thelbësore për shpërblimin e dëmeve jopasurore ndaj personit që shkaktohen nga shkelja e të drejtave të padhuenueshme kushtetuese. Shkelja duhet të jetë e tillë që pasoja e ndodhur të ketë shkakuar dëme serioze, që meritojnë të shpërblehen nga një rend, që ka një shkallë minimale tolerance. Vlerësimi i shkallës së shkeljes dhe i rëndësisë së pasojave bazohet në ekuilibrin mes parimit të solidaritetit me palën e dëmtuar dhe atij të tolerancës, me pasojën që shpërblimi i dëmit jopasuror jepet vetëm në rast se është tejkaluar niveli i tolerancës dhe shkelja nuk është e parëndësishme, kjo është në çmuarje të gjykatës, e cila vendos mbi bindjen e vetdijes shoqërore për të respektuar e mbrojtur të drejtat e individit nga njëra anë dhe tolerancën që bashkëjetesa sociale na imponon, nga ana tjetër (Ponzanelli, 2003:36).

Elementët e ndryshëm të dëmit jopasuror, në thelb, duhet të përfshihen në vlerësimin e përgjithshëm të përkufiimit të dëmit biologjik pa kaluar kufirin përveç të cilit dëmi ekzistencial nuk mund të ketë dinjitetin e pavarësisë si nënkategori e dëmit jopasuror. Në nënin 3, pika 8 të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 “*Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit*”, i ndryshuar, dëmi ekzistencial dhe moral të përfshirë brenda kategorisë së dëmit jopasuror, jepen si vijim i përkufizimit të dëmit biologjik, që nënkupton dëmtimet që lidhen me aspektet dinamike e shoqërore të jetës së të dëmtuarit, duke lidhur

përjetimin e brendshëm (dëm moral) të shprehur në shfaqjet e botës së jashtme të individit, në marrëdhëniet familjare, sociale, kulturore, afektive, etj (dëmi ekzistencial) për dëmin që ka ardhur si rezultat i vdekjes, dëmtimeve trupore dhe përkeqësimeve të shëndetit që pëson pala e dëmtuar ose të afërmit e saj (dëmi biologjik).

Nga ana tjetër, për sa i përket llojit të dëmit të ankimuar nuk mund të shfrytëzohet për të konfirmuar moskompesimin e disa zërave të dëmit dhe ndër të cilat, vuajtja nga pritja e gjatë e pajustificuar e një procesi gjyqësor duhet të përfshihet në dëmin moral të kompesueshëm sipas parashikimeve të nenit 625 të K.C nën një interpretim të orientuar nga mbrojtja kushtetuese e të drejtave të padhunueshme. (demi ekzistencial veshtrim psikologjik)

5.7 KËNDVËSHTRIM KRITIK MBI FIGURËN E DËMIT EKZISTENCIAL

Disa vite pas vendimit unifikues nr.12, datë 14.09.2007 sipas teorive interpretuese të ngritura nga studiues të së drejtës mbi dëmin ekzistencial mund të thuhet se kjo figurë po merr një rol të rëndësishëm në praktikën gjyqësore. Megjithë rëndësinë juridike të figurës, le të bëjmë një analizë mbi anët negative që rëndojnë mbi dëmin ekzistencial dhe të vërtetojmë nëse qëndrojnë kritikrat që i bëhen kësaj figure.

Duke e vendosur në plan analizues praktikën gjyqësore në lidhje me kërkesat e ngritura për qëllim të kompesimit të dëmit ekzistencial, po përmendim vendimin nr.2159, datë 18.06.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në rastin e shkeljes së shëndetit të një familjari për shkak të një aksidenti automobilistik, gjykatat e shkallëve të tjera kanë hedhur poshtë kërkesën për shpërblim të dëmit ekzistencial duke iu referuar vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë unifikuar qëndrimin se në sistemin tonë

juridik nuk është e pranuar autonomia e kategorisë së dëmi ekzistencial, i cili njihet si shkelje e aktivitetit jo-fitimprurës së njeriut duke pasur parasysh se, nëse me të nënkuptohen shkeljet që shkaktohen nga cënimi i të drejtave kushtetuese ato kompesohen sipas parashikimeve të nenit 625 të K.C, me rezultatin që shpërblimi i një dëmi shtesë do të rezultonte me një kompesim të dyfishtë, ku dëmi ekzistencial do të përfshinte shkelje të të drejtave të pacënueshme dhe dhunueshme të njeriut, kjo kategori nuk do të ishte e ligjshme duke pasur parasysh që shkelje të tilla janë të pakompesueshme sipas nenit 625 të K.C.

Në këtë kuptim sjellim në vëmendje një vendim të gjykatës italiane të Kasacionit nr. 15707, datë 21.06.2013, që lidhet me kërkesën për shpërblimin e dëmit jopasuror që i është shkaktuar një konsumatori, që kishte hasur vështirësi për zbatimin e garancisë në lidhje me të metat e autoveturës duke shtuar faktin që dëmi biologjik, që rrjedh nga shkelja e të drejtave të shëndetit të garantuara nga neni 59/1.c i Kushtetutës dhe ontologjikisht ndryshe nga dëmi, që rrjedh nga shkelja e një të drejte të mbrojtur kushtetueshmërisht, pra, nuk mund të shpërblehet si dëm biologjik dëmi ekzistencial, që konfirmohet se rrjedh nga “*stresi psikologjik i frikës*” për zhvlerësim të qetësisë dhe sigurisë së palës së interesuar dhe kur thuhet stres kemi të bëjmë me një pasojë të shkeljes së një interesi të mbrojtur, i cili duhet të vërtetohet paraprakisht deri sa të vërtetohet që ka rrjedhur nga e njejta shkelje, por me saktësimin që, qetësia dhe siguria në vetvete nuk përbëjnë të drejta themelore e të qënësishme të njeriut në nivel kushtetues, prej nga shkelja lejon ushtrimin e kërkesës për kompesim të dëmit jopasuror.

Mbi këtë arsyetim lind ideja shumë e gabuar që synon të shpjegojë dëmin ekzistencial si përbërës i dëmit jopasuror që ka lidhje me rezultatin e punëve të palës së dëmtuar, me qëllimin që të hedh dritë plotësisht mbi ndryshimin negativ që ka rezultuar në jetën e tij

pas ndodhjes së dëmit (Cendon, 2010:232). Në këtë rast flitet për përkeqësime që pasqyrohen në realitetin konkret dhe si të tillë mund të përcaktohen si një figurë e tillë dëmi. Ndërsa, sa i përket kompesimit të tyre askush nuk ka deklaruar ndonjë mjet tjetër përveç parashikimeve të nenit 625 të K.C, i tashmë tashmë përfshin të gjithë zërat e dëmit jopasuror.

Pra, siç del e qartë dëmi ekzistencial nuk përbën një zë të mëtejshëm, që i shtohet dëmit jopasuror, por mbetet brenda këtij koncepti duke përshkruar një përbërës së tij të veçantë. Gjithashtu, duke e trajtuar si një figurë ‘përshkruese’ nuk merr kuptim shkëputja e saj nga fakti i paligjshëm, thënë më qartë duhet të konstatohet që në zbatim të parashikimeve të nenit 625 të K.C evidentohen dëmet ekzistenciale të kompesueshme dhe të pakompesueshme, ashtu siç ndodh edhe për llojet e tjera të dëmeve jopasurore.

Qasja përzgjedhëse e kësaj disipline varet nga mënyra e interpretimit me orientim kushtetues i dispozitës, që është një problem i pavaruar nga ndarja e konceptit të dëmit jopasuror në disa zëra përshkruar, mes të cilëve edhe dëmi ekzistencial, që lind e që përfaqësohet më së miri nga përkeqësimi që ndodh në sferën personale të palës së dëmtuar pas faktit të paligjshëm, që në rastin në fjalë është i izoluar brenda objektit të përgjegjësisë nga mospërbushja e detyrimeve, pa u dashur t’i jepet rëndësi kushtetuese qetësisë dhe sigurisë së personit, të mirat janë larg nga të qenit në kushtet e një shkeljeje të parëndësishme që vjen nga mospërbushja e garancisë kontraktore (Christandl, 2007:453).

Për këtë arsye arrijmë në përfundimin që gjykata e Kasacionit me vendimin nr.21716, datë 23.09.2013 në Itali ka rrëzuar kërkesën për shpërblim dëmi ekzistencial të familjarëve të të dëmtuarit për dëmtimin e shëndetit të bashkëshortit duke u përputhur në këtë mënyrë edhe me argumentin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nga Vendimi Unifikues

nr.12, datë 14.09.2007 sipas të cilit në sistemin tonë juridik nuk njihet kategoria autonome e dëmit ekzistencial, por vijoi me njohjen e kompesimit të pasojave që ishin shkaktuar nga kjo kategori dëmi të pësuar konkretisht nga pala e dëmtuar, duke i bërë një vlerësim të personalizuar shumës së përgjithshme të shpërblimit, pavarësisht asaj që do të rezultonte në rast të zbatimit të vlerave të dhëna nga tabelat e përlllogaritjes së dëmit biologjik dhe moral. Pra, përjashtohet pranimi i brendshëm i çështjes së uniformitetit kompesues të dëmit jopasuror, për të cilin neni 625 i K.C i parashikon si të ndara dhe autonome shpërblimin për shkak të vuajtjes (dëmi në marrëdhëniet shoqërore, dëmi estetik, dëmi ekzistencial, etj) me pasojën që kanë një shpërblim të dyfishtë, pavarësisht detyrimit të gjykatës për të marrë në konsideratë rastet e veçanta të dëmit jopasuror, që i paraqiten për zgjidhje e orientojnë atë drejt personalizimit të shpërblimit.

Për të gjitha këto arsye, nga ana e gjykatave të niveleve më të ulta duhet të merret parasysh njohja e figurës së dëmit ekzistencial vetëm për efekt shpërblimi. Kritika në këtë rast zhvendoset drejt mundësisë për të proceduar me vlerësimin e zërave të kompesueshëm duke bërë të mundur realizimin vetëm të një kompesimi, duke shmangur likujdimin e dyfishtë (Christland, 2007: 292). Elementi ekzistencial rrjedh nga nocioni i përgjithshëm i dëmit ekzistencial, pa asnjë dallim nga llojet e tjera. Një mekanizëm i tillë e bën pak transparent procesin likujdues, nëse nuk është e qartë se cila është pesha shpërblyese, që i atribuohet çdo përbërësi të fushës jopasurore duke e bërë të pamundur të vlerësohet nëse është respektuar ose jo parimi i kompesimit të plotë, mbi bazën e të cilit Kolegjet e Bashkuara kanë ngritur argumentat për shpërblimin e dëmit jopasuror si një i tërë.

Duke i parë nën një dritë pozitive që të dallohen komponentët e ndryshëm të dëmit duhet të pranohen përfundimet e Gjykatës së Lartë, e cila hodhi poshtë kërkesën që synonte kompesim të dyfishtë për riparimin e dëmit ekzistencial, parimisht.

Gjykatësit kanë vërejtur se nuk ka vend për kompesim të dyfishtë në rast se elementët shpërblyes i përkasin dëmit biologjik (që nënkupton rastin e shkeljes së integritetit psiko-fizik), dëmit moral (që nënkupton vuajtje të brendshme të përkohshme të shkaktuara nga ngjarja që ka ardhur si rezultat i faktit të paligjshëm) dhe dëmit ekzistencial (i cili kuptohet si poshtërim i aftësive dhe sjelljeve profesionale, që shoqërohen me dëmtim të imazhit të punëmarrësit në vendin e punës).

Kjo na orienton drejt diskutimit se në aspektin e dëmit jopasuror në vend të përcaktimit që kompesimi është i dyfishtë apo gabimisht është mbivlerësuar zë vend jo me emrin e përcaktuar nga gjykata për shkeljen e ndodhur ndaj paditësit (biologjik, moral, ekzistencial), por vetëm dëmi që do të shqyrtohet nga gjykata. Pra, jepet një kompesim i dyfishtë vetëm, nëse e njëjta shkelje është kompesuar dy herë, ndonëse duke përdorur emërtime të ndryshme ku dëmi biologjik d.m.th cënimi i shëndetit, dëmi moral d.m.th vuajtjet e brendshme dhe ai ekzistencial d.m.th përkeqësimi i cilësisë së jetës kompesohen nëse fakti i paligjshëm shkel të drejta themelore të njeriut që përbëjnë shkelje jopasurore ontologjikisht të ndryshme dhe të gjitha të kompesueshme, ky përfundim vjen në kundërshtim me parimin e unitetit të dëmit jopasuror i konfirmuar me Vendimin Unifikues nr.12/2007, si një parim që cakton shpërblim unitar të dëmit, por jo një rëndësi kuptimore të pasojave të tij.

Profilët e paqarta që dalin gjatë shqyrtimit të figurës së dëmit ekzistencial janë edhe përkrahës të tij si kategori më vete e dëmit jopasuror duke cilësuar se dëmi biologjik, moral

dhe ekzistencial japin këndvështrime të ndryshme për vlerësimin e së njëjtës ngjarje të dëmshme. Kjo nënkupton që, një ngjarje e caktuar mund të shkaktojë si te pala e dëmtuar edhe te familjarët e saj, një dëm në shëndet, të vërtetueshëm nga ana mjekësore, një dhimbje të brendshme dhe ndryshim të jetës së përditshme duke konfirmuar situata të ndryshme por, të lidhura mes tyre. Megjithatë, kjo nuk detyron gjykatat, që automatikisht të shpërblejnë të gjitha këto kategori dëmi, me një efekt përmbledhës, që mund të përsërisë problemin e kompesimit të dyfishtë, që Kolegjet e Bashkuara kërkojnë ta evitojnë plotësisht.

Një tjetër pikë e diskutimit lidhet me shkeljen dhe zbatimin e gabuar të neneve 482, 486, 608, 625 dhe 640 të Kodit Civil në lidhje me nenin 472 të K.P.C.

Sipas parashtruesit të kërkesës dëmi ekzistencial ka natyrë jopasurore dhe ndryshon si nga dëmi moral subjektiv, meqënëse nuk ka vetëm karakter emocional dhe të brendshëm, ashtu edhe nga dëmi biologjik sepse nuk konsiston në një dëmtim mendor dhe fizik. Përkundrazi, përfaqëson një lloj të tretë, që i përket mirëqënies së personit të kuptuar si cilësia e jetës dhe ekziston kur kjo manifestohet në të gjitha ose disa forma të shfaqjes së saj. Ky lloj dëmi duhet të shpërblehet i ndarë edhe nga kriteret paragjykses të dy llojeve të tjera të dëmit jopasuror (Christandl, 2007:292).

Dëmi biologjik, moral dhe ai ekzistencial janë dëme jopasurore ontologjikisht të ndryshëm dhe njëkohësisht që shpërblehen. Ky përfundim bie në kundërshtim me parimin e unitaritetit të dëmit jopasuror të sanksionuar nga vendimi unifikues nr.12, datë 14.09.2007 nga K.B.Gj.L, i cili parashikon likuidimin unitar të dëmit, por jo rëndësinë anatomike të pasojave të tij.

Në përputhje me këtë parim është hartuar edhe vendimi i mësipërm, që vë në dukje se kategoria e parathënë e ngjarjes së dëmshme jopasurore nga njëra anë vlerësohet dhe shpërblehet si një dëm me natyrë morale subjektive dhe nga ana tjetër si një dëm biologjik dhe cënim i jetës sociale.

5.8 AUTONOMIA E FIGURËS SË DËMIT EKZISTENCIAL

Fillimisht, mbrojtja kompesuese ndaj një shkelje me natyrë jopasurore të ndryshme nga dëmi biologjik dhe moral, hap rrugën nga *‘mungesa e të ardhurave të palës’* në *‘aktivitetin shprehës dhe realizues si person’*, që rrjedh nga një sjellje e paligjshme, e cila ndryshon, e që pasqyrohet në ndryshimin e jetës shoqërore dhe cilësisë së jetës (Cendon,2009:118). E gjitha kjo brenda zonës së përcaktuar nga neni 608 i K.C për të shmangur kufizimet e vendosura nga neni 625 i K.C. Në këtë drejtim ka një mangësi. Pa identifikuar interesin juridikisht të rëndësishëm të cënuar nga fakti i paligjshëm njeh një dëm pa qenë e nevojshme të hetohet mbi paligjshmërinë e veprimit/mosveprimit. Me Vendimin Unifikues Nr.12/2007 u arrit në njohjen e dëmit ekzistencial.

Nuk mund t’i referohemi një kategorie të përgjithshme me kufij të pacaktuar, që do të çonte drejt konfirmimit të natyrës atipike të dëmit jopasuror. Përtej legjislacionit dhe hipotezave tipike mbi dëmin jopasuror kanë të bëjnë me vlerat e garantuara kushtetueshmërisht (shëndet, familje, liria) aty ku nuk ka një dëm ekzistencial, por një dëm që lind për shkak të cënimit të një të vlere të mbrojtur (Christlandl, 2007;280).

Nga ana tjetër, në 2007 Kolegjet e Bashkuara njohën kategorinë e dëmit ekzistencial dhe i dhanë një përkufizim si cënim i të drejtave të personalitetit të njeriut duke dëmtuar pothuajse në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri,

shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, shfaqje të cilat nuk do të kishin ndodhur në mungesë të shkeljes. Dëmi duhet të provohet, e ndihmuar nga prezumimet, e gjithë kjo analizohet nën dritën e nenit 32 të K.P, i cili parashikon mbrojtjen në fushën morale të punëmarrësit dhe nuk bazohet në nenin 625 të K.C, vendimet gjyqësore të mëvonshme janë rrjedhojë e kundërt.

Në të njëjtin vendim, i njëjti dëm (humbja e një familjari) është cilësuar si shkelje e një të drejte të mbrojtur nga neni 3, 15 dhe 53, pika 1 e 2 i Kushtetutës ose si ekzistencial duke supozuar rëndësinë kushtetuese të së drejtës së shkelur dhe detyrimin për të qenë e provuar. Pavarësisht shumëllojshmërisë së terminologjisë, në jurisprudencë mund të paraqiten raste të dëmeve të ndryshme, që shtojnë vështirësinë e kualifikimit të tyre duke pasur mospërputhje me parashikimet ligjore ose rekomandimet e doktrinës. Marrim në shqyrtim dy raste, dëmin jopasuror që lidhet me shkeljen e një të drejte me rëndësi kushtetuese dhe dëmin pasuror që shpërblehet në bazë të rëndësisë juridike të interesit të shkelur (Christlandl, 2007;282).

Dëmi moral subjektiv mbetet i vendosur brenda një drejtimi të pakuptueshëm. Çelësi i diskutimit është gjetur në një seri figurash të shumëllojshme ndonjëherë qesharake në përmbajtje të vendimeve të gjykatave, kështu p.sh në Itali në vendimin nr.26972/2008 të Gjykatës së Paqes, në listat analitike kemi dëme të rrjedhura: nga prerja e gabuar e modelit të flokëve, nga pritja stresuese në aeroport, mos marrja e shërbimeve në zyrat e administratës publike apo shtetërore, nga dërgimi i gjobave të paligjshme, nga humbja e shikimit të ndeshjes për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike. Raste në të cilat gjykata vëren se kompesohen dëmet me rëndësi të dyfishtë, ku krahas përcaktimit të së drejtës së

shkelur është edhe kërkesa për paligjshmëri të faktit që ka shkaktuar dëmin (Scalisi, 2004:29).

Për këtë arsye, përparimi i zhvillimit i arritur në drejtim të mbrojtës së dëmit jopasuror për shkelje të të drejtave të padhuenueshme të personit vendosën një kufi të qartë për përcaktimin dhe konfirmimin e dëmit ekzistencial i krijuar për të plotësuar boshllëkun ligjor, ka humbur fuqinë e tij, pasi një boshllëk në mbrojtjeje nuk ekziston më. Kjo i hap rrugën heqjes së kufizimeve për kriteret deri në saktësinë e një liste preçize, në të vërtetë të vjetëruar, për shpërblimin e dëmit jopasuror.

Në këtë listë mund të përfshihen shumë natyra dëmsh, qoftë edhe ato dëme civile që rrjedhin nga një vepër penale. Në këtë rast, mbrojtja është e kompesueshme edhe kur ndodh një shkelje e një interesi të mbrojtur ligjërisht, që rrjedh nga e drejta pozitive (duke përfshirë edhe të drejtën ndërkombëtare si pjesë e legjislacionit të brendshëm siç është KEDNJ) me kusht që të plotësohen kushtet e vlefshmërisë së përgjegjësisë sipas nenit 608 të K.C.

Në mungesë të veprimit të kundërligjshëm duhet të kufizohet shkelja e një të drejte të padhuenueshme të personit, mes të cilave përfshihen raste të dëmit brenda familjes dhe të situatave të lidhura (dëmi estetik ose cënimi i jetës sociale) dhe humbja e aftësisë seksuale, më pas saktësohen procedurat për të rregulluar rëndësinë kushtetuese të interesit (Scalisi, 2005:283). Ky gjykim vërehet se nuk ka të bëjë me dëmin e pësuar, por ka si objektiv të drejtën e shkelur dhe përputhjen e saj me mbrojtjen kushtetuese.

Pikëpamja e kundërt thotë se ngatërrimi i vendit të shkeljes, që duhet të riparohet me atë të paligjshmërisë së aktit të paligjshëm dhe “shfuqizimit të supozuar” të nenit 625 të K.C bëhet nën një interpretim të orientuar kushtetues të tij. Përfundimi është i qartë. Dëmi

ekzistencial nuk është një kategori autonome dhe nuk përfitojnë mbrojtje shkeljet që konsistojnë në vështirësi, bezdisje, ankth dhe çdo lloj tjetër pakënaqësie që lidhet me aspekte nga më të ndryshme të jetës së përditshme dhe merret me mend çdo referencë në të drejtën për cilësinë e jetës, për mirëqënie, për lumturi, në fund të fundit në të drejtën për të qenë të lumtur. Kjo për shkak se, përtej rasteve të përcaktuar nga ligji vetëm shkelja e një të drejte të padhunueshme të njeriut të përcaktuar konkretisht është burim për lindjen e përgjegjësisë për dëmet jopasurore.

Për këtë jepet një aksiom shtesë. Rëndësia e mbrojtjes përcaktohet si ‘kërkesë’ për shpërblim sepse ky filtër vendos ekuilibrin mes parimit të solidaritetit ndaj viktimës dhe tolerancës me pasojën, që shpërblimi i dëmit jopasuror është i nevojshëm vetëm në rast se është kaluar niveli mbi tolerancën dhe kur shkelja nuk është shumë e rëndësishme. Në përfundim, kriteret e provuara në gjykim nuk mund të tejkalojnë parimin e barazisë për shkak të nenit 625 të K.C, i cili përbën një parim udhëheqës në fushën e dëmit jopasuror.

5.9 SHPËRBLIMI I DËMIT EKZISTENCIAL

Megjithë zhvillimin e vazhdueshëm evolutiv juridik dhe shoqëror të sistemit të shpërblimit të dëmit, në Shqipëri, ende sot, vazhdon të ketë një konceptim vetëm ‘jopasuror’ të dëmit ndaj personit, pra merren në konsideratë vetëm dëmet psiko-fizike të përkohshme ose të përhershme, që rezultojnë nga fakti i paligjshëm. Me qëllim pasjen e një vlerësimi të plotë dhe gjithpërfshirës të dëmit jopasuror jurisprudenca konsideron si të nevojshme vlerësimin e shkeljes “të sferës së aktivitetit” të personit në tërësinë e tij, pra në kuptimin e përkeqësimit të personalitetit të njeriut, të cilit i shkaktohet tronditje në

ekzistencën e tij dhe në mënyrë të veçantë në zakonet e jetës, që reflektohen në ndryshimet që ndodhin në marrëdhëniet me të tjerët, qofshin ato familjare apo sociale.

Kodi Civil shqiptar si dhe kode të vendeve të tjera, që janë në fuqi, nuk kanë një përkufizim për dëmin, por limitohen brenda vendosjes së kriterëve për vlefshmërinë e tij juridike dhe detyrimin për shpërblimin e tij. Parimi kryesor mbi të cilin udhëhiqet kodi ynë në aspektin e dëmshpërblimit është rikthimi i palës së dëmtuar në të njëjtën gjendje që ndodhej përpara se dëmi të shkatohej. Pra, e shpjegur me fjalë të tjera, ajo verifikon dëmin e kompesueshëm me ndryshimin, që ka ardhur nga dëmi pasuror, midis gjendjes pasurore të përgjithshme të të dëmtuarit pas ngjarjes së dëmshme dhe gjendjes pasurore që do të kishte në mungesë të faktit të paligjshëm (Nuni, 2012:132-133).

Rezultati është një funksion tërësisht riparues dhe jo një funksion penalizues. Sipas nenit 608 të K.C, paragrafi i parë parashikon se detyrimi për shpërblimin e dëmit i takon atij që e ka shkaktuar dëmin, ndërsa kërkesa për shpërblim parashtrohet nga pala e dëmtuar, e cila e ka edhe barrën e të provuarit në proces. Momenti që lind detyrimi për shpërblimin e dëmit është dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar, neni 120 i K.C.

Deri më tani është vërtetuar se kjo teori është efiçente për shkeljet e të drejtave pasurore, duke përmbushur disa kufizime të dukshme në rastet kur dëmi cënon drejtpërdrejt personin. Në lidhje me shkeljen e së drejtës pasurore shkelja duhet të jetë konkrete, materiale, jo e supozuar dhe shpërblimi duhet të përbëhet nga dëmi efektiv dhe fitimi i munguar, duke përfshirë edhe shqetësimin që ka shoqëruar ngjarjen (Ponzanelli, 2003:37). Në të kundërt, për çdo dëm që lidhet drejtpërdrejt me personin, gjykata, në momentin e llogaritjes së dëmit mund të marrë në konsideratë të dhënat tabelare për rastin konkret, që

do të thotë se duhet të individualizojë rastin dhe njëkohësisht të respektojë kriterin e barazisë.

Shpërblimi i dëmit ekzistencial është subjekt i rregullave të përgjegjësisë civile jashtëkontraktore. Detyrimi për shpërblimin e dëmit rrjedh nga rregullat e së drejtës objektive, gjithashtu edhe kërkesa e palës së dëmtuar për shpërblimin e dëmit rrjedh nga rregullat e së drejtës objektive (Dauti, 2004:189).

Ajo që e karakterizon sot sistemin e shpërblimit të dëmit nuk është, as kundërligjshmëria e veprimit/mosveprimit juridik dhe as klasifikimet apo kategorizimet brenda dëmit jopasuror, por është funksioni i dëmshpërblimit. Në këtë kontekst, shpërblimi nuk ka funksion kompesues përderisa nuk ka humbje të të ardhurave, por shërben për të pasur një përfundim të pëlqyeshëm.

Pra, një ndryshim kaq i madh në sistem nuk mund të ekzistojë veçse për një shkak ligjor, një rast i tillë mund të jetë zgjerimi dhe gjithpërfshirja e kategorive apo figurave të dëmit të kompesueshëm brenda nenit 625 të K.C apo zgjerimit të fushës përfshirëse të nenit 608 të K.C. Kur ka dispozita ligjore, që përmbajnë klauzola të përgjithshme ose koncepte elastike bëhet e mundur rindërtimi i sistemit në përshtatje të ndryshimeve të kohës. Në këto kushte jemi me nenin 608 të K.C ku kemi një klauzolë të përgjithshme (dëm në personin apo pasurinë e tij), por kemi edhe një normë elastike në paragrafin e dytë (dëmin). Edhe pse dëmi mund të jetë i përcaktuar, si një shkelje me natyrë ekonomike, për t'u klasifikuar si dëm juridik duhet të rrjedhë nga një fakt i paligjshëm e i kryer me faj dhe duhet të jetë i kompesueshëm.

Risia ishte përfshirja e dëmit ekzistencial (por edhe biologjik ose të shëndetit) të kompesueshëm në lidhje me nenin 608 të K.C , i cili e vendos në një plan tjetër dëmin sipas nenit 608 të K.C.

Deri disa vite më parë doktrina dhe jurisprudenca njihje vetëm dy kategori dëmi të kompesueshme, dëmin pasuror të rregulluar nga neni 486 e 640 i K.C dhe dëmin jopasuror ose moral të rregulluar nga neni 625 i K.C. Kjo ndarje, e cila ka përdorur kriterin e dyfishtë të dëmit nga fakti i paligjshëm, që rrjedh nga dispozita e përgjithshme e saj, vazhdon të ruaj një dobi ta pamohueshme.

Nën pikëpamjen e klauzolës së përgjithshme, pavarësisht diskutimeve, nëse përgjegjësia civile rrjedh nga dëmi i paligjshëm apo dëmi akuilian si një dëm i kompesueshëm, padyshim që e drejta për shpërbllim i jepet çdo kujt që i është cënuar një e drejtë apo interes i mbrojtur nga rendi juridik (Galgano, 2006:431).

Më pas këtyre dy llojeve të dëmit iu shtuan edhe dy figura të tjera të dëmit jopasuror dëmi biologjik dhe dëmi ekzistencial, kategori të rregulluara nga neni 608 i K.C, të cilët konvergojnë me një shumëllojshmëri dëmsh: dëmi në aspektin dinamik dhe ndërpersonal të jetës së personit, dëmi në aftësinë për të punuar, dëmet estetike dhe dëmet me natyrë pasurore ose jo. Sistemi tradicional i dëmit ndaj shëndetit bazohej mbi ndarjen mes dëmit biologjik, i cili përbëhet nga cënimi i integritetit psiko-fizik dhe dëmit jopasuror, i rregulluar nga neni 625 i K.C.

Së fundi, vëmendja e doktrinës dhe jurisprudencës është vendosur mbi ekzistencën e fakteve të paligjshme, që pa cënuar integritetin psiko-fizik të njeriut mund të shkaktojnë pakënaqësinë e subjektit pasiv duke ndaluar zhvillimin e duhur të personalitetit të tij. Në këtë propozim jurisprudenca dhe doktrina kanë zhvilluar kuptimin e dëmit ekzistencial, që

pasohet nga një kufizim i zhvillimit ndërpersonal të personit në të gjitha aspektet (emiocional, familjar, aktivitet kulturore, fetare, pasionet, argëtime, ..etj) dhe për të cilat nuk ka ndodhur as dëmtim i shëndetit (dëm biologjik) dhe as shqetësime shpirtërore (dëm moral).

Shembuj të fakteve të paligjshme që përkeqësojnë cilësinë e jetës janë identifikuar në rastin e shkeljes së të drejtave të personalitetit, në sjelljet e kundraligjshme të administratës publike, në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore, në ngacmimet në vendin e punës, etj. Një pjesë e doktrinës përkrah idenë se dëmi ekzistencial mbështetet ligjërisht në nenin 608 të K.C shqiptar duke u konfirguruar si dëm-ngjarje njësoj si dëmi biologjik (Magliona, 2005:29). Në këtë rast, paligjshmëria e faktit konsiston në shkeljen e të drejtave të personalitetit të mbrojtura dhe të garantuara nga neni 2 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, nuk gjen zbatim neni 625 i K.C, që kufizon shpërblimin e dëmit vetëm për fakte të paligjshme. Jurisprudenca më e fundit argumenton se në rastet në fjalë aplikohet neni 625 i K.C, i cili propozohet nën një interpretim të zgjeruar.

Në doktrinën dhe praktikën gjyqësore aktuale janë mbajtur dy qëndrime të ndryshme, njëra që e përkrah dhe tjetra që e kundërshton ekzistencën e dëmit ekzistencial. Kemi parashtruar më lart se sistemi i përgjegjësisë jashtëkontraktore, që mund të quhet i dyfishtë vërtitet rreth dy normave themelore: nenit 608 të K.C , për kompesimin e dëmit pasuror dhe nenit 625 të K.C për kompesimin e dëmit jopasuror (Rossi, 2011:21).

Figura e dëmit ekzistencial ka lindur për të plotësuar disa mangësi të hasura në mbrojtjen civile të attributeve dhe vlerave të njeriut, që inkuadrohen brenda parashikimeve të nenit 625 të K.C dhe që përbën një zë të dëmit jopasuror, të cilat i përkasin një veprimtarie konkrete jo me natyrë pasurore dhe jo thjesht si dhimbje e brendshme.

Sidoqoftë, me rëndësi edhe për doktrinën është mosreferimi në një kategori autonome, cilado qoftë ajo, që i nënshtrohet një regjimi kompesues të ndryshëm nga ai i parashikuar për dëmin jopasuror dhe duke mos marrë si të mirëqenë domosdoshmërisht, shfaqjen e saj, të njohur si cënim, që konkretizohet në ndryshimin e sjelljes së personit, si fakt të vërtetueshëm objektivisht ose mbi bazën e provave më të sigurta (reflektuar në ndryshimin e jetës shoqërore, zgjedhjeve që bëntë i dëmtuari zakonisht e kështu me radhë), prej atyre që vërtetojnë ekzistencën e një dëmi moral subjektiv.

Nga kjo analizë rezulton se ai është një dëm ndaj shëndetit në kuptimin e gjerë, pavarësisht që është ndryshe nga dëmi moral subjektiv i mëshiruar jo në formën e dëmit biologjik, i cili mbetet i integruar në të pavarësisht, nga paraqitja e tij në analizën mjeko-ligjore të rastit (Wagner, 2005:169). Me rëndësi është fakti që Kushtetuta njeh dhe garanton të drejta e padhunueshme të njeriut, të konfirmuara nga Gjykata e Lartë, e cila ka theksuar se dëmi jopasuror përbën një fushë të gjerë dhe që përfshin çdo rast në të cilin rezulton e cënuar një e drejtë e qënësishme e njeriut. Midis të drejtave themelore siç janë shëndeti, familja, liria e mendimit, etj, bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me sferën emocionale dhe të solidarititetit reciprok brenda familjes, në shprehjen e lirë dhe të plotë të aktiviteteve të njeriut në njësinë bazë të shoqërisë, që është familja, që gjejnë mbrojtje dhe garanci nga nenet 3 dhe 53 i Kushtetutës.

Në përfundim, mund të themi se pretendimi i ankimuesve për mungesën e supozuar të shpërblimit të dëmit ekzistencial nuk ka bazë ligjore, siç rezulton aspekti pluralist i një sjelljeje të dëmshme që rrjedh nga fakti i paligjshëm.

KAPITULLI VI:

LEGJISLACIONI MBI DËMIN EKZISTENCIAL NËN NJË PROFIL KRAHASUES ME VENDE TË SISTEMIT TË CIVIL LAW DHE TË COMMON LAW

Përpara se ta mbyllim këtë analizë ligjore dhe doktrinare do të japim shumë shkurt, një pasqyrim të kornizës ligjore dhe doktrinare tej kufijve dhe kjo për të verifikuar konstatimin doktrinor se njohja e dëmit ekzistencial nga ana e gjykatave nuk përbën një anomali shqiptare pa pasur raste të ngjashme në vende të tjera si dhe ky konfirmim, në një vështrim të parë nuk duket se përputhet me realitetin dhe kjo jo vetëm duke i hedhur një vështrim rendit juridik italian, francez dhe anglez, por edhe atij gjerman në lidhje me shpërblimin e dëmit që i referohet shkeljeve, që bëjnë pjesë në kategoritë e dëmit ekzistencial shqiptar.

Nisur nga kuptimi i harmonizimit të ligjit kombëtar me atë ndërkombëtar, konkretisht të BE dhe qëllimi i tij për të eliminuar ose të paktën reduktuar ndryshimet më të theksuara ose pranuar ngjashmëritë në aspektin e përmbajtjes thelbësore, është një fenomen që ndodh shpesh në të drejtën ndërkombëtare. Por, qasja sasiore dhe cilësore e legjislacionit me atë të BE-së nuk është e së njëjtës natyrë për çdo shtet. Ndërsa, ligjet kombëtare që kanë mbajtur deri më sot dallimin tradicional midis përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore janë të pamohueshme, megjithatë, pasqyrimi në projektet e ndryshme reformuese, në reformat e kryera në sisteme të ndryshme apo në udhëzimet e nxjerra në zbatim të ligjit vërehet prirja për tejkalim ose një përafrim të ndarjes.

Në doktrinë, teoria e dyfishtë, që është e përqëndruar në vullnetin e palëve, është vendosur përballë tezës individuale, e cila ka gjetur në ligj burimin e unitetit të dy përgjegjësive. Mbi këto teza ekstreme ka mbizotëruar një teori e ndërmjetme, që konfirmom unitetin e përgjegjësisë civile dhe elementët e përbashkët për të njohur ekzistencën e dallimeve mes dy regjimeve.

Doktrina më influencuese këmbëngul që paligjshmëria është elementi, që kalon nga rëndësia në efikasitet, duke u renditur si një kriter rregullues i detyrimit për kompesim dhe për pasojë mbetet parimi i vërtetë themelor i rregullimit të përgjegjësië civile (Alpa,2003:2). Por, rregullimet janë të ndryshme, të cilat duhet të konfirmojë dy aspekte. Para së gjithash mungon, në çdo sistem të civil law dhe common law një detyrim i përgjithshëm mbi shkaktimin e një dëmi të tjerëve dhe kjo për të paktën dy arsye (Fromont, 2009:12-13). Një parim i tillë është në kundërshtim me nevojën për të garantuar iniciativën e lirë “dëmtuese” për disa subjekte, por jo e kundraligjshme (kujtojmë rastin e konkurrencës që nxit sjelljet konkurruese, potencialisht të dëmshme për ata që operojnë në të njëjtën natyrë tregu, por që nuk janë të paligjshme) dhe që ballafaqohet me disiplinën e përgjegjësisë, e cila presupozon një vlerësim krahasues të interesave në konflikt dhe të pambrojtura, në çdo rast, të fushës së subjektit të dëmtuar, jo vetëm në prani të një dëmi që ka natyrë të kundërligjshme (Tavassi, 2007:140).

Modelet në sistemin aktual europian janë në thelb dy: një tregues specifik i fakteve të paligjshme i ngjashëm me veprat penale si Common Law dhe kodi gjerman (neni 823 flet për diskrecionin e tepruar të gjyqtarit) ose përdorja e një dispozite të përgjithshme, që konkretizohet në momentin e zbatimit të një norme sipas modelit francez (neni 1382), që detyron kompesimin në çdo rast kur është shkaktuar një dëm (Rolland, 2002:5).

Dëmi jopasuror përbën edhe në sistemet e tjera të së drejtës një nga pjesët më produktive të zhvillimit të doktrinës dhe jurisprudencës. Mbi dëmin ekzistencial ka një përputhje themelore midis sistemit të common law dhe civil law, që konsiderohet si aspekt negativ i së drejtës mbi cilësinë e jetës, jo në kuptimin natyror (fizik) por, që i referohet mirëqënies psiko-fizike të verifikueshme edhe nga ana psiko-mjekësore (Magnan,2011:1). Evoluimi i teorisë së dëmit ndaj personit, paralelisht me zgjerimin e shkencave humane, psikologjike dhe neuro-shkencës ka zgjeruar rëndësinë e aspektit epistemologjik të dëmit ndaj cilësisë së jetës.

6.1 ITALIA

Sistemi juridik italian i përket familjes së civil law ashtu si dhe ai shqiptar. Në Itali figura e dëmit ekzistencial është bërë e njohur nga doktrina dhe më pas nga jurisprudenca. Figura konsiston në faktin e pranimi në gjykatë të kërkesave për ata që kanë pësuar një dëm me natyrë jopasurore, në sferën ekzistenciale. Trajtimi i kësaj çështjeje bëhet nisur nga një diskutim psikologjik përpara atij juridik sepse aspekti psikologjik përfaqëson një kuptim të zgjeruar të kësaj figure brenda institutit të përgjegjësisë akuiliane (Cassano, 2012: 458). Siç dimë, Kodi Civil italian i vitit 1865 ndoqi modelin francez, ndërsa ai aktual ka përcaktuar si kërkesë për kompesim ekzistencën e një dëmi duke u pozicionuar midis sistemit gjerman dhe atij francez. Sjellim në kujtesë, se projektet për unifikimin e së drejtës europiane janë përfshirë në Kornizën e Përbashkët Referuese duke bërë një zgjedhje akoma më të ndryshme, që bazohet në kërkesën që dëmi të jetë i rëndësishëm juridikisht. Bazuar

në këtë fakt bëhet fjalë për saktësimin e kërkesave të kundërligjshmërisë dhe rindërtimet janë të ndryshme (Boele-Woelki, 2003:2).

Për disa “përcaktimi dhe kuptimi i natyrës juridike të interesit të shkelur” do të jetë kur të lejojë realizimin e situatës subjektive në prani të një të drejte të shkelur, një fuqie, mundësie, një statusi dhe aftësisë përkatëse, pritshmërisë dhe interesit të ligjshëm, përveç detyrave dhe detyrimeve që lidhen me raste të veçanta, por jo vetëm. Është vënë re një numër interesash të rëndësishëm për shkak se objekte të një mbrojtje vetëm konservatore, që nuk lejon zbatimin në mënyrë të plotë të tyre dhe nuk i atribuon atyre cilësinë e një situatë subjektive, por i atribuon gjithmonë vlefshmërinë e mbrojtjes sipas rendit juridik dhe sipas rëndësisë juridike (Alpa, 2008:98).

Pjesa tjetër shqetësohet të lehtësojë paligjshmërinë si një klauzolë e përgjithshme, duke saktësuar që një kërkesë e tillë ka të bëjë me një situatë subjektive qëllimi i së cilës është të pranohet shkelja e bërë ose sipas modeleve të ngulitura në ndërgjegjen shoqërore ose në përputhje me norma të tjera më specifike (Hondius, 2004:15). Disa të tjerë kërkojnë vendosjen e kriterëve shtesë sipas një përfundimi, i cili mund të diskutohet. Kërkojnë nëse ekzistojnë treguesit e rëndësisë së paligjshmërisë së veprimit/mosveprimit të ndryshëm nga karakteristikat dhe natyra e interesit të shkelur dhe përgjigja është pozitive ku treguesi i rëndësisë së paligjshmërisë mund të jetë gjetur në shkeljen e normave, të cilat për nga natyra nuk janë të destinuara për t’i atribuar të drejta subjektivit as për të mbrojtur në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën, por që, kjo e drejtë në një mënyrë parashikon dhe/ose supozojnë, e për këtë arsye mund të thirren në kompesim, kur ka ankesa se e drejta është cënuar (Serio, 2007:76).

Dëmi ekzistencial në vitet e fundit në Itali ka qenë objekt i kundërshtimeve të shumta pas vendimit të Nëntorit 2008 të Gjykatës së Kasacionit, me të cilin ai u konfirmua edhe si një figurë jurisprudenciale, përveç doktrinoe, iu dha fund qëndrimit se përbënte një kategori autonome dëmi brenda dëmit jopasuror. Një gjykim i tillë ekzistonte sepse shumë shpesh ishin vërejtur kërkesa në atë kuptim, që pak ose aspak kishin të bënin me këtë lloj dëmi (Cendon, 2010:79). Më vonë me vendimet e tjera të Gjykatës së Kasacionit, shqyrtimi i dëmit ekzistencial është ridimensionuar drejt të kuptuarit të një dëmi ndaj personit i shkëputur nga dëmi biologjik dhe psikologjik kur ata paraqesin kërkesat reale (Ziviz, 2006:296-298). Në lidhje me këtë Gjykata ka vendosur në vitin 2011, 2012 për të përmendur ato që më tepër paraqesin interesim për aktivitetin matës psikologjik. Ajo nënkupton se si një studio psiko-diagnostikuese duhet të konsiderojë këtë dëm, që i shtohet vlerësimit të subjektit (Triolo, 2015:6).

Por, edhe pse kanë kaluar shumë vjet nga qëndrimi jurisprudencial mbi njohjen e figurës së dëmit ekzistencial, vendimi nr.15350 i 4 korrikut 2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në Itali ka vënë në pikëpyetje orientimin tradicional të jurisprudencës mbi njohjen e shpërblimit të dëmit ekzistencial që shkaktohet nga shkaku i vdekjes së një personi

Në të vërtetë jurisprudenca e mëparshme ka një kornizë të ndryshme përreth shpërblimit të dëmit jopasuror duke na prezantuar konceptin e dëmit pasojë, shpërblimi ka në objekt jo ngjarjen në vetvete, por pasojat që e kanë shoqëruar atë. Ky qëndrim është i reflektuar jo vetëm në parashikimet e dispozitës së përgjithshme nr.2043 të Kodit Civil italian, në të cilën parashikohet se cilat janë kushtet për vlefshmërinë e përgjegjësisë civile akuiliane, por edhe në nenin 2050 të tij ku flitet për shpërblimin e dëmit (Ziviz, 2006:202).

Lidhja e ngushtë e dëmit ekzistencial me vlerat kushtetuese do të thotë se jashtë hipotezave të rregullave tipike gjen njohjen e saj të nënkuptuar në klauzolën e përgjithshme të nenit 2 të Kushtetutës italiane, i njohur si një burim i vetëm dhe i vërtetë normativ për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Orientimet e përmendura më sipër të jurisprudencës, në lidhje me dëmin ekzistencial forcojnë të drejtën për kompesim të tij edhe në raste të veçanta të veprimtarisë së jetës së përditshme. Rezultati i këtij argumenti janë dëmet e ashtuquajtur “mikroekzistencial”, të konfirmuara nga gjykatat e ulta. Këto dëme përfshijnë raste të dëmeve nga vonesat në udhëtimet ajrore, nga ndërprerja e sinjaleve telefonike apo të internetit, rezultat i të cilave është prishja e qetësisë dhe kënaqësisë personale të personit. Përgjegjësia civile e shoqërive të transportit ajror, nuk kufizohet vetëm në vlerën e biletës por mund të shkaktojë edhe humbjen e një pune dhe si rrjedhim edhe humbjen e qetësisë personale të të dëmtuarit (Gjykata e Napolit, 27.11.2002). Kjo është një figurë dëmi, që në Shqipëri nuk është konfirmuar ende.

6.2 FRANCA

E drejta franceze, e cila e njeh të ashtuquajturin dëm moral që prej shek.XIX nuk vendos kufi të tipit të dëmit të kompesueshëm me kushtin që të jetë direkt i lidhur dhe shkaktuar nga fakti i paligjshëm (Bacache, 2012: 4). Në lidhje me dëmin ekzistencial bëhet fjalë për dëmtime funksionale që likujdohet mbi bazën e paaftësisë së pranuar dhe mbi humbjen, që nënkupton në drejtim të reduktimit të aftësisë njerëzore të aftësisë për të vepruar dhe për të gëzuar jetën (Salas, 2008:1). Tradita e gjatë e dëmit moral ka favorizuar shumëfishimin e hipotezave të shkeljeve jopasurore, jofizike, për të cilat është paguar një shpërblim nga humbja e një kafshe që e ka pasur në kujdesje. Objekti i likujdimit të dëmit

është vuajtja emocionale nëse nuk mund të vlerësohet, kjo kërkon kompesim sepse ai fyen të drejtat e personalitetit dhe të drejtat e “ambjentit” që kuptohen si humbje e shpresës dhe mundësisë normale për të realizuar një projekt, një plan në jetën familjare. Doktrina dhe jurisprudenca i referohen në përgjithësi mbrojtjes së dinjitetit të personit që refuzojnë të marrin në konsideratë, qëllimin kompesues, vetëm si subjekt që prodhon të ardhura (Vogel, 2001:73).

Në të drejtën franceze çështja e unitetit të përgjegjësisë civile nuk është e re. Ideja e ndarjes mes përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore dhe ndryshimi mes tyre i parashikuar në Kodin Civil nuk ka penguar jurisprudencën për të pranuar bashkimin e veprimeve kontraktore me ato jashtëkontraktore (Vendimi datës 19.02.1997 të Dhomës së dytë Civile të Plenumit të Bashkuar të Gjykatës të Kasacionit të Francës).

6.3 GJERMANIA

Gjermania duket interesante në sytë e autorëve për sa i përket shpërblimit të dëmeve jopasurore, ligjvënësi shqiptar i vitit 1994 ka bërë një zgjidhje të ngjashme me atë të ligjvënësit gjerman. Në të dyja rastet, në fakt, të dy ligjvënësit kanë krijuar një sistem “kufizues” për shpërblimin e dëmeve jopasurore, duke përjashtuar kompesimin e tyre si një rregull i përgjithshëm dhe duke mundësuar kompesimin e tyre vetëm në mënyrë përjashtimore. Ashtu siç parashikohet nga neni 625 i K.C, ligjvënësi gjerman ka vendosur në nenin 163 të BGB (Kodi Civil gjerman), që kompesimi në para për një dëm jopasuror mund të jepet vetëm në rastet e përcaktuara nga ligji. Megjithatë, duhet të shtojmë se ky identitet në zgjedhjet ligjore i përket fondit, që konsiston në rikuperimin e dëmit jopasuror më përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji duke mos u shtrirë drejt një disipline

ligjore më specifike për shpërblimin e dëmeve jopasurore (Rolland, 2002:13). Ngjashmëria në zgjedhjet ligjore e bën më interesante analizimin e rrugës së ndjekur nga juristët gjerman për të njohur dëmet në fushën e realizimit personal të subjektit.

Siç është parashikuar, ligjvënësi gjerman nuk e lejon kompesimin në para të dëmeve jopasurore, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji, por referenca ligjore me rëndësi më të madhe praktike, në dallim nga sistemi shqiptar, që e parashikon në një dispozitë penale dhe më saktësisht në nenin 60 pika 3 të K.P është i njëjtë me nenin 253 të K.C gjerman, i cili parashikon se në rast të një shkelje të integritetit fizik, të shëndetit, të lirisë ose vetvendosjes seksuale i dëmtuari mund t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar një kompesim të drejtë financiar edhe për një dëm më natyrë jopasurore (Gordley, 2006:57).

Pra, duke supozuar që përmbushen të gjitha kërkesat për të ngarkuar çdo formë të përgjegjësisë (kontraktore, jashtëkontraktore ose objektive) i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin në para të dëmeve jopasurore që shoqërojnë shkeljen e një ose më shumë të drejtash të përmendur në nenin 253 të K.C gjerman. Vlen të theksohet se është shpërblimi në para për dëmet jopasurore, që praktika gjermane zakonisht e emërton me emrin “Schmerzensgeld” (si përkthim fjalë për fjalë “para për dhimbjen”), emërtim që nuk korrespondon me ndonjë figurë specifike të dëmit, siç është koncepti i *pretium doloris*, që tradicionalisht ka përkuar me dëmin moral subjektiv (Christandl, 2007:401).

Përsa i përket konceptit Schmerzensgeld vërehet që ka të bëjë me një koncept shumë të ngushtë, që përshkruajnë dëmet që janë të kompesueshme. Sipas nenit 253 të BGB, dëmet jopasurore nuk konsistojnë vetëm në dhimbjet fizike “Schmerzen”, por i referohen çdo shkeljeje jo të ndjeshme ndaj vlerësimit monetar pra, çdo ndryshimi të gjendjes fizike dhe/ose morale të palës që konsiston jo vetëm në dhimbje dhe vuajtje të përkohshme, por

edhe për shqetësime në të ardhmen edhe në pakësimin ose rënien e gëzimit të jetës, që rezulton në shpërfytyrime estetike ose në domosdoshmërinë e heqjes dorë nga veprimtaritë që i ka përzemër dhe është i apasionuar e kështu me radhë (Christandl, 2007:406). Shumëllojshmëria e shkeljeve të përfshira në fushën e dëmit jopasuror është klasifikuar në: cënime fizike (p.sh dhimbje), cënime psikologjike (p.sh depresioni pas shpërfytyrimeve estetike), cënime në jetën shoqërore (p.sh ulja e vlerës shoqërore të një personi) dhe cënimet mbi cilësinë e jetës si kufizimi i aftësisë për të lëvizur, zhvilluar apo realizuar jetën personale. Rezulton që në kategorinë e fundit të këtyre lloj dëmeve, që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës përfshin të gjitha ato dëme, që në Shqipëri njihen me emrin dëm ekzistencial (Gordley, 2006:143).

Një ndryshim i rëndësishëm mes dy sistemeve është fakti që në përfundim të likujdimit të dëmeve Schmerzensgeld gjithmonë është e nevojshme ose cënimi i integritetit fizik ose cënimi i shëndetit ose i lirisë ose vetvendosjes seksuale, ndërsa disiplina shqiptare nuk njeh një tillë të të drejtave, shkelja e të cilave si pasojë lind detyrimin për kompesimin e dëmeve jopasurore eventuale. Për shkak të ngurtësisë së sistemit dhe të mbrojtjes së pamjaftueshme të shumë të drejtave apo interesave që lidhen me individin, jurisprudenca gjermane e përkrahur dhe nga doktrina, në të vërtetë jo gjithmonë unanime, i ka dhënë jetë figurës së *allgemeines Persönlichkeitsrecht* ose të drejtës së përgjithshme të personalitetit, si një e drejtë shtesë, shkelja e së cilës i jep të drejtën të kërkojë shpërblim edhe për dëme jopasurore (Zekoll, 2005:210).

Kjo figurë është njohur nga Gjykata Federale e Drejtësisë së Gjermanisë (BGH) në 1954 në një rast në lidhje me një avokat, një letër e të cilit ishte publikuar në një gazetë në rubrikën e postës pa miratimin e tij paraprak. Si pasojë avokati kërkoi shpërblimin e dëmit

për shkelje të të drejtave të personalitetit të garantuara nga neni 1 dhe 2 i Ligjit Themelor gjerman, në të cilin deklarohen si të pacënueshme të drejtat e dinjitetit të njeriut dhe lirisë së zhvillimit personal. BGH i dha të drejtë kërkesës së autorit duke argumentuar që, në raste të shkeljeve të rënda që i përkasin të drejtave të garantuara, pala e dëmtuar ka të drejtën e shpërblimit të dëmeve jopasurore, pavarësisht nga ndonjë dispozitë e veçantë e parashikuar nga BGB dhe në bazë të një të drejte reale *Drittëirkung* të të drejtave themelore me kusht që dëmi nuk mund të riparohet në ndonjë formë tjetër (Xenos, 2012:42).

Duke rezultuar e mbrojtur në fushën e së drejtës së përgjithshme të personalitetit, liria e zhvillimit personal të individit nuk është e habitshme që në fushën e dëmit jopasuror të përfshihen shkelje të ndryshme që tek ne do të përfshiheshin në kategorinë e dëmit ekzistencial (jo biologjik). Duke pasur parasysh kërkesat strikte të kësaj figure jurisprudenciale, kanë mbetur jashtë mbrojtjes shumë të drejta jomateriale, që lidhen me personin duke inkurajuar gjyqtarët të zbatojnë Kodin Civil-Kommerzialisierungstheorie, domethënë teorinë e komercializimit duke bërë pasuror edhe dëme që nuk janë të tillë (Beverly, 2005:224).

Kjo përbën një shembull emblematic të dëmit nga pushimet e prishura (koha e pushimeve e kaluar në mënyrë të panevojshme) e komercializuar nga BGH në 1975 dhe e kodifikuar nga ligjvënësi gjerman në 1979, në nenin 651 të BGB si një rast i veçantë i dëmit jopasuror, të cilit i referohet neni 253 i BGB, në pikën 1 të tij. Një shembull tjetër ka të bëjë me dëmin nga makinat e palëvizshme që konsiston në mospërdorimin e autoveturës për një periudhë të caktuar dhe që likujdohet në bazë të tabelave, që midis të tjerave ndryshojnë për lloje të ndryshme makinash (Christandl, 2007:407). Por, do të shohim më në detaje disa nga temat

për të cilat janë dhënë vendimet gjyqësore që na japin një konceptim të ngjashëm me atë që kemi ne për dëmin ekzistencial:

- Bota familjare dhe afektive
- Jeta në familje
- Endrra për të pasur fëmijë (ose jo)
- Abuzimet në familje
- Vdekja e një të afërmi
- Jeta intime e një personi
- Bota e punës
- Pamundësia për të punuar
- Koha e lirë
- Aktivitete sportive të rrezikshme
- Dëmet nga pushimet e prishura
- Dëmet në personalitet
- Shkatërrimi i personalitetit
- Dinjiteti dhe nderi i njeriut
- Liria dhe përplotësimi personal

Duke qëndruar në dritën e jurisprudencës së lartpërmendur, pjesërisht, mund të konsiderohet si dëmtim i sferës së realizimit personal shumë të ngjashme me kategorizimin shqiptar të dëmit ekzistencial, të cilat përbëjnë një lloj të dëmit, që nuk është injoruar nga sistemi juridik gjerman. Në fakt, siç e kemi vërejtur gjykatësit gjerman kanë shumë dekada që pranojnë rëndësinë e dëmeve në aftësinë e vetvendosjes dhe lirisë në zhvillimin personal duke ngritur paragjykime të tilla jomateriale për dëme ekzaktësisht jopasurore që

kualifikohen për shpërblim sipas nenit 253 të BGB. Në rastet në të cilat, përveç shkeljeve të një prej të drejtave të mbrojtura nga neni 253 i BGB, përmbushen të gjitha kërkesat e përgjithshme të formave të ndryshme të përgjegjësisë civile (akuiliane, kontraktore, objektive), jurisprudenca gjermane nuk heziton të marrë në konsideratë edhe shkeljet ekzistenciale të shkaktuara ndaj palës së dëmtuar (Koch, 2012:125). Në fushën e dëmeve që rrjedhin nga cënimi i “trupit” ose “shëndetit”, gjyqtarët gjerman zakonisht marrin në konsideratë reflektimet ekzistenciale të faktit të paligjshëm në vend të likujdimit të Schmerzensgeld duke i konsideruar këto shkelje si rrethana të rëndësishme për caktimin e shumës kompesuese.

Të krahasosh eksperiencat dhe sistemet juridike nuk është kurrë e thjeshtë, megjithatë nuk gabojmë nëse themi se dëmet e emërtuara si ekzistencial në Shqipëri d.m.th zhvlerësimi i veprimtarisë realizuese të personit, gjejnë njohjen në fushën e përgjegjësisë civile në të drejtën gjermane edhe nëse mungon një kategori e vërtetë dhe e posaçme e dëmit ekzistencial .

Nëse duam të hetojmë se këto shkelje që i përkasin sferës së realizimit personal merren në konsideratë pa dallim nga një shkelje e mëparshme e integritetit psiko-fizik, në bazë të vëzhgimeve të bëra paraprakisht dhe vendimeve të gjykatave gjermane përgjigja është pozitive (Fromont,2009:38). Për rrjedhojë nga ky krahasim me sisteme të tjera (e veçanërisht në rastin konkret, atë gjerman) duket qartazi, që dëmi ekzistencial i njohur nga jurisprudenca shqiptare nuk duhet të konsiderohet një teprim ose një anomali shqiptare, por një tipar i përbashkët mes sistemeve juridike europiane.

Mund të ndodh, që në prani të një norme, që sipas modelit të lartpërmendur në nenin 823, pika 2 të Kodit gjerman, ndërsa, ka qëllime të tjera (p.sh norma penale ose administrative

ose kodi rrugor) ajo është e pajisur me cilësi të ndryshme (për sa i përket kompesimit) megjithatë, mund të përmenden për mbrojtjen e interesave të subjekteve nga nën kategori të dëmeve të përcaktuara nga shkelja (Reimann, 2005:221).

Këto rregulla, që konkludojnë p.sh në mbrojtjen e interesave të përgjithshme (p.sh normat penale) dhe/ose jo drejtpërdrejtë vetëm mbi të dëmtuarin mund të përdoren edhe për mbrojtjen e interesit të individit aty ku duhet të merret në konsideratë se interesi i shkelur është gjithashtu në mbrojtje të standartit (Christandl, 2007:361). Sipas kësaj teze është e ligjshme kërkesa e treguesve të ndryshëm për sa i përket interesit apo të drejtës së shkelur. Ku, në bazë të konfliktit të ndaluar në bazë të të drejtave ekskluzive të titullarit të të drejtës, në paligjshmërinë e aktit dhe në detyrimin e shkelur, në thelb janë veprime, të cilat në të dyja lejet dhe në shkeljen e rregullave të bashkëjetesës dhe në mënyrat e veçanta të sjelljes, duhet t'u kërkohej kundërligjshmëria e faktit (Christandl, 2007:362).

Në të drejtën gjermane dëmi ndaj shëndetit, që nënkupton lëndim trupor dhe dëmtim të shëndetit (paragrafi 253 i BGB) është i kompesueshëm së bashku me vuajtjen që shkaktohet nga "privimi i lirisë" (paragrafi 847 parasheh që ka një zgjerim të dukshëm të kuptimit, që ka ardhur nga jurisprudenca e që e ka ridimensionuar nën dritën e parimit të dinjitetit njerëzor të shpallur në nenin 1 të Kushtetutës gjermane). Likujdimi bazohet në kritere tabelare të zhvilluara nga jurisprudenca, që bashkon dëmin ndaj shëndetit dhe dëmin moral duke mbajtur këtë të fundit në një hipotezë të veçantë të dëmit jopasuror për funksionin e përzier parandalues-shpërblyes (Gordley, 2006:254).

6.4 ANGLIA

Në sistemet e common law kompesimi për dëme që shkaktohen nga lëndime psiko-fizike vlerësohen pasojat, që kanë lindur mbi palën e dëmtuar në bazë të rasteve të

mëparshme të ngjashme duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çdo rasti si p.sh gjendjen e nevojës së palës së dëmtuar (Fridman, 1977:2). Në Britaninë e Madhe likujdimi i lihet në dorë gjykatësit, i cili vendos në bazë të precedentit (Gardner,2011:2). Në Sh.B.A janë juritë, që vendosin në mënyrë të pavarur shpërblimin e dëmit ndaj personit duke u bazuar në Guidën e Vlerësimit të Dëmeve të përkohshme e hartuar nga Shoqata e Mjekëve Amerikan, ku shuma e shpërblimit është e përcaktuar në mënyrë konvencionale për çdo kategori shkeljeje, por, shpesh për shkak të veçantisë së çështjes gjykatësit vendosin për likujdim shuma shumë të ndryshme nga rastet e ngjashme, veçanërisht nëse veprimi i dëmshëm ka qenë i shoqëruar me dhimbje (Standler, 2011:2).

Shpesh trajtime të ndryshme justifikohen në pjesën më të madhe të zhvlerësimeve të veprimeve të dëmshme, që përcakton një përgjigje të sistemit thellësisht ndëshkuese ndaj autorit të saj. Në fakt, të gjitha sistemet e përgjegjësisë civile, që pranojnë shpërblimin e dëmeve jopasurore ngrenë një pyetje pak a shumë të qartë mbi funksionin e atribuimit me këtë titull të një shume në para për të dëmtuarin (Rudden, 1992:105). Pyetja është e saktë dhe e rreptë duke pasur parasysh që, e drejta që konsiderohet e shkelur nuk është ekonomikisht e matshme, duhet të vendoset kriteri i likujdimi dhe mbi të gjitha natyra, ndryshe nga kthimi ndaj palës së dëmtuar i të barazvlefshmes së vlerës ekonomike të shkatërruar, si kompesim për dëmin jopasuror (Campbell, 2004:457).

Në një konceptim solidar të përgjegjësisë civile kthimi i dëmeve jopasurore me përjashtim të dëmit biologjik, që objektivisht korrespondon me privim të dukshëm, të prekshëm të njeriut, kërkon një fakt të kënaqshëm si për të kënaqur viktimën e dëmit për të konceptuar pamundësinë e materializimit (Witting, 2001:481). Për t'i atribuar dëmeve jopasurore funksion ndëshkues si pjesë e doktrinës, dhe e rëndësishme politikisht mund të

mos jetë në pajtim me perspektivën e përgjegjësisë civile, që ka për qëllim kompesimin e viktimës dhe jo ndëshkimin e autorit (Glikier, 2000:20).

6.5 SH.B.A

Ndërsa, në Angli dëmet e ndëshkueshme (punitive damages) përbëjnë një numër të kufizuar të rasteve të detyrueshme, në Sh.B.A ata mbajnë funksionin e tyre ndëshkues pavarësisht kundërshtimeve të zellshme të lobeve të prodhuesve të ekspozuar ndaj shpërblimeve shumëmilionëshe brenda klasës së tyre edhe pse nuk mungojnë rastet e praktikës gjyqësore që konfirmojnë natyrën kompesuese kur bëhet fjalë për shpërblimin e dëmeve, që çënojnë të mira jomateriale të tilla si të drejtat e personalitetit (Green, 2015:431). Në kohë ka mbizotëruar funksioni ndëshkues i dëmeve si një lloj i kategorisë së dëmeve kompesuese, aq sa sot jurisprudenca e common law pranon grupimin e dëmeve nga ankthi emocional dhe dëmeve ndëshkuese (Green, 2011:337).

Sistemi ligjor amerikan rrjedh prej sistemit anglez. Prandaj, në Shtetet e Bashkuara, ligji i delikteve (torts) është plotësisht një fushë në të cilën gjykata bën, zhvillon dhe riformon ligjin. Ndërsa, në Angli ligji themelor ka ndikuar ligjin amerikan si fillim, pjesa më e madhe e ligjeve deliktore të zhvilluara në shek.19 pas gjykatave amerikane ishin përforcuar dhe funksionale. Ligji deliktor ishte krijuar në pjesën më të madhe në bazë të mendimeve të jurisë dhe gjykatat i përdorin ato si burime ligjore (Cardi, 2015:242).

Pavarësisht, nga vlefshmëria rastësore e lehtësimit deklarativ, dëmet që vijnë nga pasurimi pa shkak, dëmet nominale ose dëmet ndëshkuese dhe dëmet kompesuese përbëjnë ende kompesimin standart në rastin e dëmit nga fakti i paligjshëm. Deliktet e qëllimshme u afrohen atyre angleze dhe përfshijnë: deliktet me akte të dhunshme (pa pasoja dhe pa goditje) dhe kërcënimet ndaj personave (battery and assault), deliktet me cënim të lirisë

fzike (false imprisonment), deliktet me përvetësim të të mirave materiale të një tjetri (trespass stricto sensu), delikti i shpifjes (defamation). Dëmtimi (nuisance) është një cënim, i vullnetshëm ose jo ndaj një personi privat (d.privat) ose ndaj një grupi më të madh njerëzish (d.publik) (Fromont, 2009:130).

Në sistemin e common law ka disa lloje të shprehjeve që përdoren për të përkufizur reflekset ekzistenciale, për atë që është viktimë e një e shkeljeje të integritetit psikofizik. Pra, bëhet fjalë, për “humbje të lehtësive të jetës”, si pasojë e faktit të dëmshëm, që pala ka pësuar shihet e lidhur me aftësinë për të bërë gjëra të cilat përpara incidentit, ata ishin në gjendje t’i shijonin dhe përjashtimi i plotë nga pjesmarrja në aktivitetet e jetës së përditshme (Ligji i Komisionit UK 1995, 14) ose humbja e aftësisë ose humbja e funksionit ose humbja e lumturisë. Ndërkohë vuajtja morale, e cila nuk çon në shkaktimin e një sëmundjeje shfaqet me lëndimin dhe vuajtjen në të shprehur, që siç u përmend korrespondon me dëmin moral sipas konceptit të sistemit juridik shqiptar. Kjo është përcaktuar në bazë të pretendimeve të palës dhe të kriterëve propabilitare (Dobbs, 2011:436). Krahasimi mes çështjeve evolutive të dëmit jopasuror në kuadër të legjislacionit kombëtar thekson prirjen e përbashkët dhe i garanton palës së dëmtuar një riparim të plotë dëmit të pësuar.

Kjo është e qartë edhe në sistemet juridike të vendeve, që i përkasin familjes së common law, në të cilët përgjegjësia civile ka një funksion të përcaktuar ndëshkues, aty ku juritë mbështeten gjerësisht te dëmet ndëshkuese për shpërblimin e lëndimeve, bashkërisht të pranuar, që janë të pamatshme ekonomikisht (Holmes, 2013 :95-96).

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nisur nga institutet dhe të drejtat e trajtuara gjerësisht në këtë punim, në vijim po rendisim konkluzionet e arritura dhe disa rekomandime në mënyrë që, legjislacioni që rregullon përgjegjësinë juridiko-civile, e cila rrjedh nga dëmi ekzistencial të jetë efektiv dhe në funksion të rikthimit të gjendjes që gëzonte pala e dëmuar para ndodhjes së ngjarjes së dëmshme. Në punim është parashtruar një hipotezë kryesore: *Ndryshimet e nenit 625 të K.C janë të pamjaftueshme për të plotësuar hapësirat boshe që ka ligji në drejtim të sigurisë juridike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile që lindin nga shkaktimi i dëmit ekzistencial; dhe një nënhipotezë mbështetëse: Përfshirja e dëmit ekzistencial si një figurë dëmi e veçantë e parashikuar nga Kodi Civil është e nevojshme dhe kohorente.*

Me qëllim vërtetimin e këtyre hipotezave është bërë një analizë e plotë mbi legjislacionin shqiptar e shtrirë në dy kapituj (III dhe IV) dhe një analizë doktrimore (kapitulli II dhe V), në të cilën jepet përkufizimi dhe rëndësia juridike e figurës së dëmit ekzistencial sipas doktrinės dhe sipas Vendimit Unifikues nr.12 , datë 14.09.2007 të K.B.Gj.L dhe të drejtat e prekura e pasojat juridike që bien mbi palët në rast të shkaktimit të tij. Nëpërmjet kësaj analize dalin dhe rezultatet e para të studimit, të cilat evidentojnë faktin se ndryshimet ligjore që u bënë në vitin 2012 në Kodin Civil nuk reflektuan mbrojtje për shkelje të tjera të natyrës ekzistenciale, që i përkasin sferës që lidhen me njeriun dhe që nuk janë pasojë e një lëndimi psiko-fizik.

Gjithashtu, këto konkluzione dhe rekomandime prezantohen duke pasur parasysh që, së shpejti do të marrë jetë reforma gjithpërfshirëse në sistemin e drejtësisë, një nga pikat e së cilës është progresi në funksionimin e shtetit të së drejtës, në mënyrë që i gjithë kuadri

ligjor, por jo vetëm, të përafrohet sipas standarteve ndërkombëtare, por ndërkohë dhe zbatimi i tij në praktikë të ofrojë të njëjtën garanci.

Konkluzione

1. Thelbësore për të gjithë sistemin e përgjegjësisë nga fakti i paligjshëm është klasuzola e përgjithshme e nenit 608 të K.C, sipas së cilës *“cilido që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin apo pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar”*. Klauzola e përgjithshme është një teknikë ligjore jo e plotë, që i lë në çmuarje gjykatës identifikimin dhe vlerësimin e të drejtës që është e denjë për të pasur një mbrojtje juridike, në varësi të rastit konkret të paraqitur.
2. Përgjegjësia jashtëkontraktore zhvillohet më shpejt se ajo kontraktore sepse kjo ndihmohet nga formulimi fleksibël i nenit 608 të K.C, së paku praktika gjyqësore e njeh tashmë si ‘klauzolë të përgjithshme’, ndërsa doktrina është e ndarë mes atyre që janë të dyshimtë më pak ndaj ndryshueshmërisë, që e klasifikojnë si ‘normë të përgjithshme’, me një nomenklaturë ndryshe që korrespondon me konceptin e dëmshpërblimit të dëmit thjesht pasuror sipas K.C. Megjithatë, zgjerimi i përgjegjësisë akuiliane është shoqëruar me një hezitim të vazhdueshëm në funksionet e tij dhe kjo ka prodhuar një lloj krize të institutit.
3. Ndryshimet në sistemet politiko-ekonomike të ndodhura në pas vitet’90 në Europën-Juglindore, e rrjedhimisht edhe në Shqipëri shkaktuan domosdoshmërinë e një qasjeje të re mbi perceptimin e së drejtës dhe veçanërisht legjislacionit civil. Instituti i shkaktimit të dëmit, i cili jepej me definicione të politizuara dhe jo analitike pësoi ndryshime në përshtatje me legjislacione të vendeve europiane ose duke e parë në

optikën e së drejtës së brendshme iu rikthye pothuajse të njëjtit rregullim që bënte e drejta e Kodit Civil të Zogut.

4. Pavarësisht, qëndrimeve të ndryshme që kanë mbajtur civilistët, që i përkasin sistemeve të ndryshme të së drejtës, mbi çështjen se cili prej funksioneve duhet të konsiderohet si më i rëndësishmi mes tyre, vlen për t'u theksuar se përgjegjësia civile ka si funksion kryesor parandalimin ndaj fakteve të caktuara, e realizuar nëpërmjet detyrimit për shpërblimin e dëmit, që nxit subjektin, i cili kryen veprimin të marrë masat e nevojshme për ta shmangur atë, riparimin e dëmeve nga subjekti që e ka shkaktuar atë si dhe ndarjen përpjestimore të përgjegjësisë midis shkaktuesve. Përsa i përket analizës historike të rregullimit ligjor të çështjes së përgjegjësisë civile që rrjedh nga dëmi ekzistencial, figura e tij nga kodi i parë civil shqiptar deri në kodin, që është aktualisht në fuqi, nuk ka qenë e njohur asnjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ka pasur mospërputhje, në vijimësi mes asaj që ka aspiruar ligjvënësi me parashikimet e dispozitave, brenda legjislacionit civil dhe frymës së përgjithshme për të vënë në jetë zbatimin e tyre.
5. Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit është identifikuar, jo vetëm për shkelje të të drejtave absolute por edhe në rastin e shkeljes së të drejtave relative, atëherë kur dëmi ndaj të tretëve ndikon në të drejtën e kreditorit sipas kritereve që rregullojnë lidhjen, që ekziston midis veprimit/mosveprimit të kundraligjshëm dhe dëmit. Nga shqyrtimi mbi konsistencën e interesit material të bazuar në interesin legjitim, që nuk lind vetëm duke u kërkuar nëpërmjet një procesi gjyqësor, por që ka dhe një natyrë bazike, në kuptimin që lidhet me një interes material të titullarit të një të drejte shkelja e së cilës mund të pasojë lindjen e një dëmi ku edhe pse merret në

konsideratë mbrojtja e një interesi të ligjshëm dhe dallimi nga e drejta subjektive është vetëm mënyra ose masa me të cilën interesi material merr mbrojtje .

6. Ndikim të veçantë praktik ka ndryshimi midis ‘interesave të kundërt’ dhe ‘interesave të pretenduar’, sipas këtij të fundit mbrojtja jepet në mënyrë që të evitohet një parandalim të pafavorshëm ose favorshëm; duke marrë parasysh se në rastin e parë përmbushen kërkesat ligjore në fushën e të drejtave personale dhe pasurore të subjektit, kërkesat e fundit të zhvillimit të fushës së të drejtave personale dhe pasurore të të njëjtit subjekt, jurisprudenca ka zgjedhur një mënyrë interpretimi, i cili përfaqëson edhe një mundësi të vlerave duke i dhënë hapsirë kompesimi interesave të kundërta dhe hipotezave në të cilat autoritetet kanë dështuar për të kryer mbikqyrjen ose informimin ose kryerjen gabimisht të çertifikimit duke çuar në dëmtimin e palëve të treta, për të rikonfirmuar në kuadër të parimit të moskompesueshmërinë së interesave të ligjshme: e gjithë kjo e parë në optikën tradicionale të nenit 608 të K.C ku tendenca në rritje është për zgjerimin e fushës së kompesimit. Kjo konfirmohet dhe shpjegohet teorikisht duke argumentuar se masat e instrumentave shtetërore do të ndikojnë të drejtat individuale “te zbehura”, kështu që, duke anuluar normën që ushtronte të ashtuquajturin presion, e drejta subjektive ringjallte edhe pse me mangësi, në këtë lloj dëmi freskim të së drejtës
7. Problemi i parë, me të cilin përballemi kur duhet të përcaktojmë përgjegjësië civile që rrjedh nga dëmi ekzistencial është klualifikimi i saj, si përgjegjësi kontraktore apo jashtëkontraktore. Nga praktikat gjyqësore të marra në analizë, rezulton se ende sot ka konfondim sa i përket klasifikimit të saj, jo vetëm në nivel juristësh, avokatësh, por për fat të keq edhe gjyqtarësh.

8. Përfshirja e figurës së dëmit ekzistencial si një kategori autonome apo jo e dëmit jopasuror është një debat që ka përfshirë jo vetëm doktrinën por edhe, jurisprudencën. Në këtë rast me rëndësi është fakti që Kushtetuta njeh dhe garanton të drejtat e padhunueshme të njeriut, të konfirmuara nga Gjykata e Lartë, e cila ka theksuar se dëmi jopasuror përbën një fushë të gjerë dhe që përfshin çdo rast në të cilin rezulton e cënuar një e drejtë e qënësishme e njeriut. Midis të drejtave themelore siç janë shëndeti, familja, liria e mendimit, etj bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me sferën emocionale dhe të solidaritetit reciprok brenda familjes, në shprehjen e lirë dhe të plotë të aktiviteteve të njeriut në njësinë bazë të shoqërisë, që është familja, që gjejnë mbrojtje dhe garanci nga nenet 3 dhe 53 i Kushtetutës.
9. Vendimi Unifikues nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe ligji nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” janë dy rastet e vetme, në të cilat njihet në mënyrë të drejtpërdrejtë figura e dëmit ekzistencial.
10. E drejta për shpërblimin e dëmit ekzistencial realizohet nëpërmjet paraqitjes së padisë brenda afateve ligjore dhe barra e provës në këtë rast fillon me të dëmtuarin paditës, i cili duhet të provojë ekzistencën e dëmit dhe masën e tij si dhe ekzistencën e veprimit të kundraligjshëm dhe të lidhjes shkaksore. Në rastin e padisë për shpërblimin e dëmit i padituri ka barrën e provës për të provuar që dëmi nuk ka ardhur për fajin e tij dhe për rrjedhojë, ai nuk ka përgjegjësi. Pra, kjo barrë rëndon si detyrim, vetëm pasi është ushtruar paraprakisht barra e provës e të dëmtuarit/paditës.
11. Një element i rëndësishëm në lidhje me zbatimin ka të bëjë me afatet e parashkrimit. Parashkrimi dhjetë-vjeçar për përgjegjësinë kontraktore (ose afateve të ndryshme në

varësi të objektit të kontraktës sipas nenit 115 të K.C'94) kundrejt atij tre-vjeçar për paditë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor është elementi që sipas nesh ka pasur më shumë ndikim në zgjedhjen e ligjit. Në fakt, shpesh zgjedhja për të klasifikuar problemin në regjimin kontraktor lidhet më qëllimin për të shmangur afatin më të shkurtër të parashkrimit, atë trevjeçar.

12. Dëmi ekzistencial gjen mbështetje në nenin 3, 15 e vijues të Kushtetutës në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në pjesën e parë të marrëdhënieve etiko-sociale, ekonomike dhe politike, ku më rëndësi i jepet shëndetit, familjes, produktivitetit dhe aftësive të punës së njeriut si dhe në vullnetin e tij për të mbledhur dhe vepruar me kujdes në çdo fushë duke u përmirësuar gjithmonë dhe më shumë. Me qëllim që të thjeshtohen, aktivitetet realizuese të njeriut (që përfshijnë interesa kushtetueshmërisht të mbrojtura) sipas doktrinës, mund të grupohen në katër kategori të ndryshme:

- I. Aktivitetet me natyrë shëndetsore-jetësore;
- II. Marrëdhëniet afektive dhe familjare;
- III. Marrëdhëniet shoqërore dhe aktivitetet me natyrë kulturore-shkencore, fetare;
- IV. Aktivitetet sportive, të argëtimit dhe zbavitjes.

13. Qëllimi i përgjegjësisë nga dëmi ekzistencial është që të jap një mbrojtje të sigurtë dhe të matur për profilet e realizimit personal të personit në një optikë jo pasurore. Edhe në këtë rast, në mënyrë të përmbledhur rezultati mund të arrihet në bazë të teknikave që ndjekin qasjet të ndryshme metodologjike:

- I. Identifikimi në sistem i një kategorie të re dëmi, të identifikuar në termat e shkeljes së një situate subjektive të rëndësishme në planin kushtetues larg kufizimeve të parashikuara nga neni 625 i K.C'94:
- II. Zgjerimi i konceptit të dëmit pasuror, zbatohet me anë të ndryshimit të konceptit të pasurisë;
- III. Zgjerimi i konceptit të dëmit jo pasuror tej kufijve të shqetësimeve shpirtërore dhe kontekstuale heq nga rregullimi i nenit 625 të K.C të zërave të ndryshëm nga dëmi moral;

14. Nisur nga përkufizimi se dëmi ekzistencial në thelb është çdo dëmtim, që personi pëson në aktivitetin realizues të vetvetes nga njëra anë dhe nga analiza e praktikës gjyqësore nga ana tjetër konstatohet se, pjesa më e madhe e padive të ngritura që kanë në përmbajtjen e tyre përgjegjësi civile për dëm ekzistencial janë rastet e aksidenteve automobilistike dhe zgjidhja për to i referohet në analogji V.U Nr.12/2007. Kjo shkakton shmangie nga qëllimi i legjislacionit për t'i siguruar subjekteve të të drejtave mbrojtje kur u shkelet një e drejtë si dhe tregon shkallën e ulët të vetdijes juridike të individit, mbi të drejta që ekzistojnë dhe që janë pranuar si të tilla nga ligjvënësit.

Rekomandime

1. Në legjislacionin aktual del si e nevojshme ndërhyrja fillimisht në drejtim të kornizës procedurale të gjykimit, që ka të bëjë me konstatimin e dëmit ekzistencial. Konstatimi përgjatë katër rrugëve normale dhe më të përdorshme të verifikimit të dëmit në përgjithësi : bisedimi midis palëve, proçesi administrativ, proçesi penal dhe

proçesi civil është i vlefshëm dhe përbën shkak të objektit të padisë. Por, nisur nga praktika gjyqësore në kushtet më të zakonshme proceduriale gjyqtari i referohet nenit 16 të Kodit të Proçedurës Civile për vërtetimin e kundërligjshmërisë ku gjykata cilëson veprimet dhe faktet që lidhen me ngjarjen e kundërligjshme pa iu referuar përcaktimit që propozojnë palët, duke vazhduar me përcaktimin e bazës ligjore të padisë, nenin 625 të Kodit Civil, gjë e cila nuk rezulton kaq e thjeshtë, pasi kërkon njohje shumë të mirë të ligjit nga ana gjyqtarit.


2. Nisur nga parashikimet e nenit 476 të K.C, i cili prezumon fajësinë e debitorit, paragrafit të dytë të nenit 608 të K.C sipas të cilit barra e provës nis me të dëmtuarin paditës dhe parimit, që vendoset përballë këtyre dy kriterëve, se në rastin e padisë për shpërblimin e dëmit i padituri ka barrën e provës për të provuar që dëmi nuk ka ardhur për fajin e tij dhe për rrjedhojë, ai nuk ka përgjegjësi, bën që, kjo barrë rëndon si detyrim, vetëm pasi është ushtruar pararakisht barra e provës e të dëmtuarit/paditës. Meqënëse, jo në çdo rast të një dëmi ekzistencial ka edhe dëm pasuror, por gjithsesi kemi ekzistencën e një dëmi, për të pasur një masë ekonomike të vlerës së dëmit të ndodhur, duhen vendosur kritere që janë të mundur për t'u zbatuar. Meqë dëmi ekzistencial kategorizohet si një dëm-ngjarje, për të provuar praninë e tij mjafton të provohet fakti i shkaktimit të dëmit. Në lidhje me provën, ajo duhet të mbështetet në ekzaminimet mjeko-ligjore, të cilat duhet të përcaktojnë shkallën e aftësisë së palës së dëmtuar dhe si është reflektuar në sferën e aktiviteteve të jetës së përditshme të tij. Nisur nga fakti që në shumicën e rasteve mjeku apo psikologu e përkthen dëmtimin në terma të invaliditetit të subjektit, gjykata e Milanos ka hartuar një tabelë, e cila bazuar në shkallën e paaftësisë dhe moshës së

individit të dëmtuar cakton një mënyrë përlllogaritjeje të masës së shpërblimit të dëmit. Këto tabela mund të merren në konsideratë si kritere të sakta për llogaritjen e masës së kompesimit të dëmit dhe të integrohen në legjislacionin tonë.

3. Rekomandojmë që, përqasja me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut e legjislacionit të brendshëm dhe praktikave në proçedurat e gjykimit me objekt shpërblimi dëmin ekzistencial duhet të përbëjë prioritet në mendësinë tonë gjyqësore.
4. Neni 625 i Kodit Civil , i cili është ndryshuar me ligjin nr.17/2012, datë 16.02.2012 parashikon shpërblimin vetëm për raste të disa figurave të dëmit jopasuror siç është cënimi i nderit dhe personalitetit apo reputacionit të personit, duke nënkuptuar në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë figurat që përfshihen në dëmin joapsuror, duke mbetur e pandryshuar nga parashikimet e mëparshme të Kodit Civil.
5. Megjithë përmirësimin e dukshëm, në këto vitet e fundit, të praktikës gjyqësore në drejtim të kuptimit të dëmit jopasuror, vërehet ende ngurtësimi mbi interpretimin e figurave të ndryshme të dëmit jopasuror. Për të realizuar një përmbushje sa më të plotë të planit të përgjithshëm të funksionit primar të përgjegjësisë civile, e cila lind kur ndodh një dëm ekzistencial, propozoj shtimin e figurës së dëmit mikro-ekzstencial, njësoj si në rastin e Italisë, i cili në Itali ka lindur si rezultat i interpretimit të një gjykate të ulët (Gjykata e Paqes e Napolit, 27.11.2002).


Aneks.1

TENDENCA E ÇËSHTJEVE ME OBJEKT SHPËRBLIM DËMI JOPASUROR (EKZISTECIAL, MORAL E BIOLOGJIK TË SHQYRTUARA NGA KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË NË PERIUDHËN 1999-2015



Aneks. 2

GRAFIK I TRAGUESVE TË CILËSISË SË JETËS SIPAS TË DHËNAVE TË PËRPUNUARA NGA BE PËR BANORËT E BE PERIUDHA 2008-2011



(1) Enterprises employing 10 or more employees; NACE Rev. 2 B to S (-O)

(2) Provisional data, 2011

(3) Estimated data, 2008, 2011

(4) Definition differs, see metadata, 2008

HR: not available data, 2008

IE, EL: not available data, 2011

IS: not available data, 2008, 2011

EU-27 instead of EU-28 due to the lack of available data

BIBLIOGRAFIA

a) Burime parësore:

Legjislacioni

a) Shqiptar

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, *Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, 10 Dhjetor 1948.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, *Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, 20 Nëntor 1989.

Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për ratifikimin e Konventës Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

Deklarata e Kombeve të Bashkuara “Për parimet bazë të së drejtës për krimet ndaj viktimave dhe keqpërdorimit të pushtetit”, 29 Nëntor 1985.

Konventa Europiane “Mbi kompesimin e viktimave nga krimet e dhunshme”, Strasburg, 24 Nëntor 1983.

Konventa “Mbi përgjegjësinë civile për dëme që rrjedhin nga veprimtaritë e rrezikshme në mjedis”, Lugano, 21 Qershor 1993.

Direktiva 72/166/CEE e Këshillit të Europës “Mbi përgjegjësinë civile që rrjedh nga qarkullimi i mjeteve motorike dhe kontrollit të sigurimit të detyrueshëm të kësaj përgjegjësie”, 24 Prill 1972.

Direktiva 76/207/EEC e Këshillit të Europës “Mbi trajtimin e barabartë midis burrave dhe grave në punësim, në kualifikimet profesional dhe në marrëdhënien e punës, ”, 14 Shkurt 1976.

Direktiva 77/187/EEC e Këshillit të Europës “*Mbi përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare për sigurinë në punë*”, 5 Mars 1977.

Direktiva 85/374/ EEC e Këshillit të Europës “*Mbi përgjegjësinë nga produktet me të meta*”, 25 korrik 1985.

Direktiva 85/374/ EEC e Këshillit të Europës “*Mbi përgjegjësinë nga produktet me të meta*”, 31 dhjetor 1985.

Direktiva 2004/35/ EEC e Parlamentit dhe Këshillit European “*Mbi përgjegjësisë mjedisore në fushën e parandalimit dhe riparimit të dëmit në mjedis*”, 21 Prill 2004.

Kodi Civil (Kodi i Zogut), 1 Prill 1929.

Ligji nr.2359, datë 15.11.1956 “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*” .

Ligji nr.6340, datë 26.06.1981 “Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*”.

Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”.

Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*”.

Ligji nr. 8116, datë 23.03.1996 “*Kodi i Proçedurës Civile të Republikës së Shqipërisë*”.

Ligji nr.9062, datë 08.05.2003 “*Kodi i Familjes të Republikës së Shqipërisë*”.

Ligji nr.8405, datë 17.09.1998 “*Për urbanistikën*”.

Ligji nr.8934, datë 05.09.2002 “*Për mbrojtjen e mjedisit*”.

Ligji nr.9323, datë 25.11.2004 “*Për barnat dhe shërbimin farmaceutik*”.

Ligji nr.9572, datë 03.07.2006 “*Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare*”.

Ligji nr.9863, datë 28.01.2008 “*Për ushqimin*”.

Ligji nr.9902, datë 17.04.2008 “*Për mbrojtjen e konsumatorëve*”.

Ligji nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë në shoqëri”.

Ligji nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”

Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ligji nr.10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

Shteti Shqiptar-Ligjet e reja, Korçë, Korça, 1920.

Vendimi nr.53, datë 25.06.2009 “Rregullore për trajtimin e dëmeve, që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” i Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Vendimi nr.36, datë 30.04.2009 “Rregullore për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike” i Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Vendim nr.21, datë 08.11.2012 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Vendim nr.2, datë 11.01.2013 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

b) I huaj:

Karta Europiane e të Drejtave të Pacientëve, Bruksel, 15 Nëntor 2002.

Kodi Civil i Mbretërisë të Italisë, 25 Qershor 1865.

Kodi Civil i Francës (i Napoleonit), 21 Mars 1804.

Kodi Civil Gjerman, 2 Janar 2002.

c) *Raporte dhe Dokumenta*

Plani Strategjik dhe Plani i veprimit i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitet 2012-2015, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2011.

Përmbledhje e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

b) Burime dytësore:

LITERATURË

a) Shqiptare

Alishani A. S., *E drejta e detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme*, Buzuku, Botimi i dytë, Prishtinë, 2003.

Alishani A. S., *E drejta e detyrimeve, Pjesa e Veçantë*, Buzuku, Botimi i dytë, Prishtinë, 2003.

Alishani A. S., *Parimet themelore të ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve*, Kosova, Prishtinë, 2000.

Alishani A. S., *Studime nga e drejta e detyrimeve I*, Buzuku, Prishtinë, 2001.

Alishani A. S., *Studime nga e drejta e detyrimeve II*, Çabej, Prishtinë, 2006.

Bello H., Mexheleja Kodi Civil Osman dhe trashëgimia juridike osmane në Shqipërinë e viteve 1912-1929, marrë nga faqja në internet www.zaninalte.al/2013/09/mexheleja-kodi-civil-osman-trashegimia (parë më 2015/07/12).

Benussi B., *Komentar i Kodit Civil: Obligimet dhe kontratat përgjithësisht (Titulli II i librit të Kodit Civil)*, Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë, Tiranë, 2012.

Çela K., *Arritje të Pjesës së Përgjithshme të Detyrimeve në Kodin Civil të RPS të Shqipërisë*, Drejtësia Popullore Nr.1, Mihal Duri, Tiranë, 1957.

Deliaj H., *Dëmi ekzistencial*, Revista Shqiptare për Studime Ligjore Nr.4, Institut i Alb-Shkenca, 2009.

Dervishi K., *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005: organizimi shtetëror, jeta politike, ngjarjet kryesore, të gjithë ligjvënësit, ministrat dhe kryetarët e shtetit shqiptar në historinë 93-vjeçare të tij*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2006.

Dauti N., *E drejta e detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme dhe e Veçantë*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2004.

Elezi I., *E drejta zakonore e Labërisë (në rrafshin krahasues)*, Botimet Toena, Tiranë, 2003.

Elezi I., *Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, GEER, Tiranë, 2004.

Elezi I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2006.

Floqi K., *Gjyqësia në Shqipëri*, Përlindja e Shqipërisë, Nr.1, 3 gusht 1913.

Floqi K., *Gjyqësia në Shqipëri*, Përlindja e Shqipërisë, Nr.3, 7 gusht 1913.

Floqi G., *Mbi përgjegjësinë e shpërblimit të dëmit nga një veprim i paligjshëm në të drejtën civile*, Drejtësia Popullore Nr.5, Stabilimenti “Mihal Duri”, Tiranë, 1951.

Gjata R., Haxhiademi F., *Lidhja shkaksore në të drejtën civile*, Drejtësia Popullore Nr.1, Mihal Duri, Tiranë, 1972.

Gjata R., *Detyrimet jashtëkontraktore*, Muza, Tiranë, 2010.

Gjika G., *Mbi veprimet juridike të paligjshme*, Drejtësia Popullore Nr.4, Mihal Duri, Tiranë, 1960.

Gjeçovi Sh., *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shkodër, 1933.

Gjilani F., *Mbi disa çështje të përgjegjësisë për dëmet e shkaktuara nga të miturit*, Drejtësia Popullore Nr.3, Mihal Duri, Tiranë, 1958.

Hetemi M. J., *Detyrimet dhe kontratat*, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë, 1998.

Hoxha I., *Marrëdhëniet juridike në Kanunin e Lek Dukagjinit: pjesa e përgjithshme*, Albin, Tiranë, 2002.

Ilia F., *Kanuni i Skënderbeut*, Milot, 1993.

Krisafi K., Ballanca Z., Omari I., etj., *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*, Luarasi, Tiranë, 2001.

Koçi K., *Legjislacioni civil shpreh politikën e Partisë, interesat e klasës punëtore dhe të masave të tjera punonjëse*, Drejtësia Popullore Nr.4, Mihal Duri, Tiranë, 1981.

Kondi Th., *Disa probleme të detyrimeve, që lindin nga shkaktimi dëmeve jashtëkontraktore*, Drejtësia Popullore Nr.4, Mihal Duri, Tiranë, 1989.

Kondili V., *E drejta civile I, Pjesa e Përgjithshme*, GEER, Ribotim, Tiranë, 2008.

Kondili V., *E drejta civile II, Pjesa e Posaçme*, GEER, Tiranë, 2008.

Luarasi A., *Komentari i Kodit Civil: Obligimet dhe kontratat e përgjithshme*, Luarasi, Tiranë, 1998.

Luarasi A., *Detyrimet dhe kontratat përgjithësisht*, Luarasi, Tiranë, 1998.

Lole A., *Mjekimi i pakujdesshëm*, Drejtësia Popullore Nr.4, Mihal Duri, Tiranë, 1979.

Mamuti A., *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni, Disertacion për marrjen e titullit “Doktor”*, Universiteti i Tiranës, 2013.

Mandro A., *E drejta Romake*, Tiranë, 2004.

Molla V., *Rrethanat e krijimit dhe të veprimit të Kodit Civil të parë shqiptar, Vështrime historiko-juridike*, Revista Avokatia, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Korrik 2015.

Meka V., *Konkurrimi i fajeve dhe dënimeve*, Drejtësia Popullore Nr.1, Mihal Duri, Tiranë, 1949.

Mandro A., etj., *E drejta Familjare*, Kristalina KH, Tiranë, 2006.

Mataj R., *Disa sugjerime mbi vlerësimin sa më të drejtë të padisë: “Shpërblimi i dëmit jopasuror, Neni 608 dhe 625 i Kodit Civil”*, Jeta Juridike Nr.2, Viti IV i botimit, IRZ, Tiranë, 2007.

Mataj R., *Rishikimi i dispozitave të dëmit jashtëkontraktor, kërkesë e kohës*, Jeta Juridike Nr.1, Shkolla e Magjistraturës, Mars 2015.

Mataj R., *Dëmi jashtëkontraktor dhe kuptimet më të reja të tij në Shqipëri*, <http://magjistratura.academia.edu/rezartamataj> (parë më 2015.11.20).

Nathanail A., *Fuqia e dispozitave juridike të vjetra në shtetin e ri*, Drejtësia Popullore Nr.1, Mihal Duri, Tiranë, 1948.

Nathanaila A., *Ligja mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet, pjesë e rëndësishme e së drejtës sonë civile socialiste*, Drejtësia Popullore Nr.1, Mihal Duri, Tiranë, 1957.

Nuni A., *Leksione të së drejtës civile*, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2004

Nuni A., Mustafa I., Vokshi A., *E drejta e detyrimeve I*, Tiranë, Shqipëri, 2012.

Nova K., *I dëmtuari akuzues*, Drejtësia Popullore Nr.4, Mihal Duri, Tiranë, 1965.

Rrahmani S., *Vështrim historik mbi Kodin Civil dhe dispozitat e tij*, nga punimet e Konferencës “Drejtësia në 100-vjet shtet shqiptar”, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, 2012.

Sallabanda A., *La responsabilité pour le dommage causé par les tiers*, Drejtësia Popullore Nr.5, Mihal Duri, Tiranë, 1957.

Sallabanda A., *Përgjegjësia civile për shkakun e vdekjes dhe dëmtimin e shëndetit të punonjësve*, Drejtësia Popullore Nr.5, Mihal Duri, Tiranë, 1960.

Sallabanda A., *E drejta e detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme*, Mihal Duri, Tiranë, 1962.

Semini M., *Dëmi jopasuror (moral) nën rregullimin juridik të Kodit Civil*, Jeta Juridike Nr.1, Viti i II i botimit, IRZ, Tiranë, 2003.

Semini M., *Shkaktimi i dëmit dhe praktika gjyqësore lidhur me të*, Jeta Juridike Nr.4, Viti XI i botimit, IRZ, Tiranë, 2011.

Semini M., *E drejta e detyrimeve dhe kontratave (Pjesa e Posaçme)*, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, 2006.

Semini M., *E drejta e detyrimeve dhe kontratave (Pjesa e Përgjithshme)*, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, 2006.

Skrame O., *Komentari i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë*, vëllimi II, Onufri, Tiranë, 2011.

Shehu H., *Lidhja shkaksore në praktikën gjyqësore*, Drejtësia Popullore Nr.8, Mihal Duri, Tiranë, 1970.

Shehu H., *Përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar nga një veprimtari e rrezikshme, që lidhet me burim rreziku të shtuar dhe rastet, që përjahtojnë personin nga kjo përgjegjësi*, Drejtësia Popullore Nr.3, Mihal Duri, Tiranë, 1976.

Shehu H., *Lidhja shkaksore si kategori filozofike dhe aplikimi i saj në fushën e së drejtës*, Drejtësia Popullore Nr.3, Mihal Duri, Tiranë, 1973.

Tafaj F., *Procedura civile*, Pegi , Tiranë, 2003.

Terpo P., *Të forcojmë luftën parandaluese kundër shkeljeve të rregullave të qarkullimit të automobilave*, Drejtësia Popullore Nr.2, Mihal Duri, Tiranë, 1960.

b) E huaj:

Alpa G., Bessone M., *Obbligazioni e contratti, Tomo VI di dir. Privato*, Rescigno, Torino, Itali, 1982.

Alpa G., *Diritto della responsabilità civile*, Roma, Itali, 2003.

Alpa G., *Diritto privato comparato. Istituti e problemi*, Laterza, 2008.

Alpa, G., *La responsabilità civile, Parte generale*, UTET Giuridica, Torino, Itali, 2010.

Alexy R., *Teoria dei diritti fondamentali*, Collezione di Testi e di Studi, Il Mulino, 2012.

Bagolini Luigi (1961) “*Filosofia dei valori, etica, estetica- Responsabilità e analisi del linguaggio*”, Atti del XII Congresso Internazionale di Filosofia, Firenze, Itali, S.VIII, f.493.

Bocchini F., *Le funzioni della responsabilità, Lezione*, marrë nga http://d7.unicam.it/afg/sites/d7.unicam.it.afe/files/Flamini_Responsabilit%C3%A0.pdf (parë më 03.02.2015);

Bacache-Gibeili M., *Traité de droit civil, Les obligations, La responsabilité civil extracontractuelle*, 2^e édition, Economica, France, 2012 .

Basso A.M, *La responsabilità extracontrattuale, Il diritto tra ipotesi, possibilità e limiti*, Key, Milano, Itali, 2015.

Bagolini L., *Responsabilità analisi del linguaggio*, Italy, 1958.

Benedetti A., *Il nesso di causalità nella responsabilità civile* marrë nga www.academia.edu/2015-03-08.

Behrends O., *Rudolf von Jhering mediatore fra diritto romano e diritto moderno in un momento di grande rottura culturale*, Rivista di Diritto Romano, No.III, Roma, Itali, 2003.

Bell j.s.,Schwenzer I., etj., *The Oxford handbook of Comparative Law*, Oxford University press, Oxford, 2006.

Berti L., *Il nesso di causalità in responsabilità civile: nozione, onere di allegazione e onere della prova*, Giuffrè, Milano, Itali, 2013.

Bianca C.M., *Diritto civile, V, La responsabilità*, Giuffrè, Milano, Itali, 1994.

Bonini R., *Disegno storico del diritto privato italiano dal Codice Civile del 1865 al Codice Civile del 1942*, Pàtron, University of Virginia, 1980.

Boele-Woelki K., *Perspectives for the Unification and Harmonisation of Family Law in Europe*, Antwerp Oxford, New York, 2003.

- Bordon R.**, *La nuova responsabilità civile, Causalità, Responsabilità oggettiva, Lavoro*, UTET Giuridica, Torino, Itali, 2010.
- Brusco C.**, *Il rapporto di causalità, Prassi e orientamenti*, Giuffrè Editore, Milano, Itali, 2012.
- Castronovo C.**, *La nuova responsabilità civile*, Giuffrè Editore, Milano, Itali, 2006.
- Cassano G.**, *La responsabilità civile, Con ampio formulario e giurisprudenza sul nuovo danno non patrimoniale*, Giuffrè, Milano, Itali, 2012.
- Cendon P.**, *Il risarcimento del danno non patrimoniale. Parte generale*, UTET Giuridica, Milano, 2009.
- Cendon P.**, *Commentario al codice civile*, Giuffrè Editore, Itali, 2009.
- Cendon P.**, *Il quantum nel danno esistenziale, giurisprudenza e tabelle*, Giuffrè Editore, Milano, Itali, 2010.
- Cerini D.**, *Casi e materiali per un corso di diritto privato comparato, La responsabilità civile*, Giappichelli, Torino, 2009.
- Chironi P. G.**, *La colpa nel diritto civile odierno (colpa contrattuale ed extracontrattuale)*, Edizione Schientifiche Italiane, Trento, Itali, 2012.
- Christandl G.**, *La risarcibilità del danno esistenziale*, Giuffrè Editore, Milano, Itali, 2007.
- Collins H.**, *The European Civil Code*, Cambridge University Press, Cambridge, 2008.
- Collins H.**, *Il codice civile europeo, la via da seguire*, Edizione Schientifiche Italiane, Napoli, 2013.
- Corsaro L.**, *Tutela del danneggiato e responsabilità civile*, Giuffrè Editore, Milano, Itali, 2001.

- Costantini G.**, *Commento al Codice civile del regno d'Italia*, Tipografia Municipale di Gaetano Longo, Venezia, Itali, 1873.
- Darbellay J.**, *Théorie générale de l'illicéité*, Universiteti i Friboug, Friboug, Zvicër, 1955.
- Di Majo A.**, *La tutela dei diritti*, Giufrè, Milano, Itali, 2003.
- Dominici R.**, *Il danno psichico ed esistenziale*, Giuffrè Editore, Milano, Itali, 2006.
- Dominici R.**, *Le menomazioni sicliche nel danno alla persona. Diagnosi, nesso di causalità, valutazione. La perizia*, FrancoAngeli, Milano, Itali, 2014.
- European Group of Tort Law**, *Principles of tort law text and commentary*, Viena/New York, Springer, 2015.
- Ewan McK. ,Nili C.**, *Comparative Remedies for Breach of Contract (International Studies in the Theory of Private Law)*, Hart Publishing, 2005.
- Ihering R.V.**, *Il momento della colpa nel diritto privato romano*, Jovene, Napoli, Itali, 1990.
- Favilli C.**, *I danni da illecito endofamiliare in danni non patrimoniali*, Giuffrè Editore, Milano, Itali, 2004.
- Fiandaca L.**, *Il danno non patrimoniale*, Giuffrè, Milano, Itali, 2009.
- Forchielli M.**, *Il rapporto di causalità nell'illecito civile*, 1960.
- Fortino M.**, *I danni ingiusti alla persona*, CEDAM, Milano, Itali, 2009.
- Fromont M.**, *Sistemet e huaja më të mëdha të së drejtës*, Papirus, Tiranë, 2009.
- Franceschetti P., Marasca M.**, *Le obbligazioni*, Maggioli, San Marino, 2008.
- Franzoni M.**, *Trattato della responsabilità civile. L'illecito*, Giufrè, Milano, Itali, 2010.
- Franzoni M.**, *Trattato della responsabilità civile, Il danno risarcibile (Seconda edizione)*, Giufrè, Milano, Itali, 2010.

- Fridman G.H.L.**, *The interaction of tort and contract*, Canada, 1977.
- Fischer B. J.**, *Mbreti Zog dhe përpyekja për stabilitet*, Çabej, Përkthyer nga K.Hajdari, Tiranë, 2004.
- Franzoni Massimo**, *Trattato della responsabilità civile, L'illecito (Seconda edizione)*, Giufrè, Milano, Itali, 2010.
- Galgano F.**, *Manuale elementare di diritto civile*, Zanicheli, Bologna, 1987.
- Galgano F.**, *E drejta private*, Luarasi, Tiranë, 2006.
- Gerard L.**, *Detyrimet (Pjesa e pergjitheshme)*, 'Papirus', Tirane 2009.
- Georges V.**, *Kontratat, (Pjesa e posacme)*, 'Papirus', Tirane 2009.
- Giardina F.**, *Responsabilità contrattuale e responsabilità extracontrattuale*, Milano, Itali, 1993.
- Gilead I.**, *Proportional Liability: Analytical and Comparative Perspectives*, De Gruyter, Berlin/Boston, 2013.
- Golecki M.J** (2013) "Aristotle and the Philosophy of Law: Theory, Practice and Justice-Synallagma as a Paradigm of Exchange: Reciprocity of Contracts in Aristotle and Game Theory", Springer (www.springer.com), f. 249-264;
- Gordley J., Von M., Arthur T.**, *An introduction to the comparative study of private law: readings, cases, materials*, Cambridge University Press 2006.
- Gorla G.**, *Sulla cosiddetta causalità giuridica: fatto dannoso e consenguenze*, Vol. I., A.Cicu, Milano , Itali,1951.
- Grappolo R.**, *Criteri di quantificazione del danno non patrimoniale*, Giuffrè, Milano, Itali, 1989.
- Hugo G.**, *Storia di diritto romano*, Giuseppe Marghieri, Napoli, Itali, 1856.

Hondius E., Zimmermann R., Berger K. P. etj., *Towards a European Civil Code*, Third Edition, Kluwer Law International, London/New York, 2004.

Koch H., *Introduction to German Law, The law of Torts*, Kluwer Law International.

Koch B.A., *Unification of Tort Law: Strict Liability*, Kluwer Law International, Hague/London/New York, 2002.

Koziol H., *Unification of Tort Law: Wrongfulness*, Kluwer Law International, Hague/London/New York, 1998.

Labonia S., *La responsabilità civile, Lezione*, marrë nga www.unipegaso.it (parë më 03.02.2015);

Lando O., Hondius E., Grosheide F. W., etj., *The Principles of European Contract Law and Dutch Law, A Commentary*, Kluwer Law International, London/New York, 2002

Légier G., *E drejta civile, Detyrimet*, Papirus, Tiranë, 2008.

Magnus U., *Unification of Tort Law: Damages, Unification of Tort Law: Causation*, Kluwer Law International, Hague/London/New York, 2001.

Magnus U., Martín C. M., *Unification of Tort Law: Contributory Negligence*, Kluwer Law International, Hague/London/New York, 2004.

Maiorca C., *I fondamenti della responsabilità*, Giuffrè, Milano, Itali, 1990.

Magliona B. *La medicina legale e il danno esistenziale: le ragioni dell'intelligenza e quelle del cuore, in La valutazione neuropsicologica del danno psichico ed esistenziale*, Cedam, Padova, Itali, 2005.

Mancini L., *La colpa nella responsabilità civile*, Giuffrè, Milano, Itali, 2015.

Marchesini C., *I danni microesistenziali e bagattellari*, Halley Edition, 2007.

- Mark A. R.**, *Employment Law Cases and Materials (University Casebook)*, Foundation Press, 2007.
- Markesinis B.S.**, *An expanding tort law-the price of a rigid contract law*, Fourth Edition, Oxford University Press, United Kingdom, 1987.
- Mazzola, M.A.**, *Responsabilità civile da atti leciti dannosi*, Giufrè, Milano, Itali, 2007.
- Monateri P.G.**, *La responsabilità civile*, Giappichelli, Torino, Itali, 1998.
- Monateri C.**, *Manuale della responsabilità*, Torino, Itali, 2001.
- Padalletti M.L.**, *La tutela della proprietà nella Convenzione europea dei diritti dell'uomo*, Giufrè, Milano, Itali, 2003.
- Padelletti G.**, *Storia del Diritto Romano*, 2013.
- Pellegrini F.**, *Responsabilità in Nouvo diritto italiano.*, XI, Torino, 1938.
- Perlingieri P.**, *Manuale di diritto civile*, Napoli, Itali, 2007.
- Pucella R.**, *Il nesso di causalità, Profili giuridici e scientifici*, Cedam, Padova, Itali, 2007.
- Ponzanelli G.**, *Il "nouvo" danno non patrimoniale*, CEDAM, Padova, 2004.
- Rodotà S.**, *Il problema della responsabilità civile*, Giufrè, Milano, Itali, 1964.
- Rodotà S.**, *Costo degli incidenti e responsabilità civile, Analisi economico-giuridica*, Giufrè, Milano, Itali, 2015.
- [Roger B.](#), [Hans W. M.](#), *Foundations of European Private Law*, Hart Publishing, 2011.
- Rogers W.V.H.**, *Unification of Tort Law: Multiple Tortfeasors*, Kluwer Law International, Hague/London/New York, 2004.
- Rolland, W. Haas L.**, *Das neue Schuldrecht*, München, 2002.
- Rossello C.**, *Responsabilità contrattuale ed aquiliana: il punto sulla giurisprudenza*, Itali, 1996.

- Russo P.**, *I danni esistenziali*, UTET Giuridica, Milano, Itali, 2014.
- Salvi C.**, *Il danno extracontrattuale, Moedelli e funzione*, Napoli, Itali, 1985.
- Sandro O.**, *Significatoe metodo del diritto civile comparato*, Ed. Schientifiche Italiane, Università di Camerino, 2009.
- Scognamiglio R.**, *Responsabilità civile e danno*, Giappichelli, Torino, Itali, 2010.
- Serio M.**, *La responsabilità complessa. Verso uno statuto unitario della civil liability*, Palermo, 1988.
- Serio M.**, *Studi comparatistici sulla responsabilità civile*, Giappichelli,Torino, 2007.
- Sicchiero Gianluca**, *Le obbligazioni 2, La responsabilità patrimoniale*, UTET Giuridica, Torino, Itali, 2011.
- Spier J.**, *The Limits of Liability: Keeping the Floodgates Shut*,Kluwer Law International, Hague/London/New York,1996.
- Spier J.**, *The Limits of Expanding Liability: Eight Fundamental Cases in a Comparative Perspective*, Kluwer Law International , Hague/London/New York ,1998.
- Spier J.**, *Unification of Tort Law: Causation*, Kluwer Law International, Hague/London/New York ,2000.
- Spier J.**, *Unification of Tort Law: Liability for Damage Caused by Others*, Kluwer Law International, Hague/London/New York, 2003.
- Trimarchi P.**, *Causalità e danno*, Giufre Editore, Milano, Itali, 1967.
- Triolo D.P**, *Cenacolo giuridico: Casi e Lezioni Civile, La responsabilità extracontrattuale*, Key, Milano, 2015.
- Vieira De Mello S.**, *Komisar i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut , Deklarata për të Drejtat e Njeriut*, 2003.

Komisioni European (2013), *Further Eurostat information, Main Tables and Databases*, Tetor, 2013. Marrë nga http://ec.europa.eu/eurostat/statistic-explained/index.php/Quality_of_Life_Indicators (parë më mars 2014).

Viney G., *Introduction à la responsabilité*, LGDJ, Paris, France, 2008.

Visintini G., *Trattato breve della responsabilità civile. Fatti illeciti. Inadempimento. Danno risarcibile*, CEDAM, Milano, Itali, 2005.

Viola L., *La responsabilità civile ed il danno*, Halley, Macerata, Italia, 2007.

Viola L., *Danni da morte e da lesioni alla persona, Forme di tutela e responsabilità alla luce delle S.U 26972/2008 sul danno non patrimoniale*, CEDAM, Milano, Itali, 2009.

Ziviz P., *Il danno esistenziale, in Il danno alla persona, in Dottrina Casi Sistemi*, Zanichelli, Bologna, Itali, 2006.

Wagner G., *Tort Law and Liability Insurance*, SpringerWienNewYork, Mörlenbach, gjermani, 2005.

Widmer P., *Unification of Tort Law: Fault*, Kluwer Law International, Hague/London/New York, 2005.

JURISPRUDENCË

a) Shqiptare:

Vendimi unifikues nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vendimi unifikues nr. 9/, datë 09. 03.2006 i Kolegjeve të Bashkuar të Gjykatës së Lartë .

Vendimi nr. 641, datë 23.04.1999 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 669, datë 09.07.1999 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 739, datë 19.03.1999 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 633, datë 17.04.2002 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 1986, datë 25.11.2004 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 735, datë 28.04.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 197, datë 02.03.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 641, datë 23.04.1999 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2006-773 (1230), datë 02.11.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2013-190 (16), datë 02.11.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr.85/ 17.03.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimin nr. 99/04.03.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2013-273 (27), datë 10.01.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2013-2596 (618), datë 31.10.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 41 datë 13.02.2014 i i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 179 datë 20 shkurt 2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr.174 datë 24 shkurt 2014 i i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2014-895, datë 16.04.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2014-1392 (232), datë 20.05.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2014-1389 (39), datë 20.05.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2014-1871 (389), datë 19.06.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2014-1968 (411), datë 26.06.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2014-1871 (389), datë 19.06.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-806 (1), datë 14.01.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-810 (97), datë 19.02.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-473,datë 26.02.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.00-2015-1328, datë 22.04.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-1725 (228), datë 30.04.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-1328 , datë 22.04.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-2124 (245), datë 07.05.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-1723 (266), datë 21.05.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-1927 (279), datë 28.05.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-3581 (293), datë 12.05.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-1748, datë 26.05.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-2159 (325), datë 18.06.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-2822 (335), datë 01.07.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr. 00-2015-2852 (351), datë 15.07.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr.482/2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vendimi nr.2600, datë 02.11.2012 Nr. R.Th.2814 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vendimi nr.291, datë 20.02.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 4036, datë 05.05.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 605, datë 27.06.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. Nr. 6739, datë 16.07.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 7827, datë 17.09.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 8735, datë 15.10.08 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 9136, datë 26.10.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr.9908, datë 17.11.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 5525, datë 23.06. 2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 8610, datë 26.10.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimet nr.10030, datë 02.12.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 2949, datë 14.04.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr.4425, datë 25.05. 2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimin nr. 10054, datë 03.12.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 984, datë 02.02.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 2949, datë 14.04.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr.260, datë 20.01.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr.9685, datë 20.11.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 6431, datë 16.07.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr.5808, datë 30. 06.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr.10030, datë 02.12.2009 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi nr. 00-2014–895, datë 16.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi 811, datë14.05.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Vendimi nr. 2524, datë 25.09.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

b) E huaj:

- Vendime të GJEDNJ

Çështja De Wilde, Ooms and Versyp (“Vagrancy”) kundër Belgjikës, datë 10.03.1972 (Neni 50 i KEDNJ).

Çështja C.Grabenwarter,Brumărescu kundër Rumanisë, datë 23.01.2001.

Çështja Smith and Grady kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 25.07.2000.

Çështja Akkoç kundër Turqisë, datë 10.10.2000.

Çështja Guiso-Gallisay kundër Italisë, datë 25.07.2000.

Çështja Assanidze kundër Gjeorgjisë, datë 08.04.2004.

Çështja Ilaşcu dhe të tjerë kundër Moldavisë dhe Rusisë, datë 08.07.2004 (neni 41 KEDNJ).

Çështja Broniowski kundër Polonisë, datë 22.06.2004.

Çështja Hutten-Czapska kundër Polonisë, datë 19.06.2006.

Çështja Tierfabriken Schweiz kundër Zvicrës, datë 30.06.2009.

Çështja McCann dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 27.09.1995.

Çështja Paul and Audrey Edwards and Lewis kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 24.10.2004.

Çështja Podgolzina kundër Letonisë, datë 09.04.2002.

Çështja Balogh kundër Hungarisë, datë 11.03.2004.

Çështja Chevrol kundër Francës, datë 13.05.2003.

Çështja Caballero kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 29.02.2000.

Çështja Perreira Henriques kundër Luksemburgut, datë 09.05.2006.

Çështja E.S dhe të tjerë kundër Sllovakisë, datë 15.09.2009.

Çështja Z. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 10.05.2001.

Çështja Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 03.04.2001.

Çështja Kaya kundër Turqisë, datë 19.02.1998.

Çështja T.P dhe K.M kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 10.05.2001.

Çështja Keegan kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 18.07.2006.

Çështja Tsirlis dhe Kouloumpas kundër Greqisë, datë 29.05.1997.

Çështja A.S kundër Polonisë, datë 20.06.2006.

Çështja Wassink kundër Hollandës, datë 27.09.1990.

Çështja Francovich dhe Bonifaci dhe të tjerë kundër Italisë, datë 19.11.1991.

Çështja Iglesias Gil dhe A.U.I kundër Spanjës, datë 29.04.2003.

Çështja Sylvester kundër Austrisë, datë 24.04.2003.

Çështja Kyprianou kundër Qipros, datë 27.01.2004.

Çështja Pla and Puncernau kundër Andorës, datë 13.07.2004.

Çështja Doran kundër Irlandës, datë 31.07.2003.

Çështja Elsholz kundër Gjermanisë, datë 13.07.2000.

Çështja Colozza kundër Italisë, datë 12.02.1985.

Çështja Draon kundër Francës, datë 06.10.2005.

Çështjen Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 21.04.2005.

Çështja nr. 35582/97, Comingersoll s.a. kundër Portugalisë, datë 06.04.2000.

Vendimin datë 17 mars 2005, në rastin nr. 50196/99 Bubbin kundër Mbretërisë së Bashkuar.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr.184 të vitit 1986.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr.372 të vitit 1994.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, nr.6572, datë 24.03.2006.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, nr.26972/3/4/5, datë 11.11.2008.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, nr.3677, datë 16.02.2009.

Vendimi i Gjykatës së Milanos, nr.7713, datë 7 qershor 2000.

Vendimin datë 24 prill 1989 dhe vendimi datë 19 shkurt 1997e Dhomës së dytë Civile të

Pleniumit të Bashkuar të Gjykatës të Kasacionit të Francës.

Vendimi i Gjykatës së Kasacionit të Italisë, nr.15707, datë 21.06.2013.

Vendimi i Gjykatës së Kasacionit të Italisë, nr.21716, datë 23.09.2013.

Vendimi i Gjykatës së Paqes së Italisë, nr.26972/2008.

Vendimi i Gjykatës së Napolit, 27 nëntor 2002.

ADRESA TË BURIMEVE NGA INTERNETI

a) Institucione

Council of Europe <http://coe.int>.

European Commission ec.europa.eu/index.

European Center of Tort and Insurance Law (ECTIL) <http://www.ectil.org>.

European Group on Tort Law (EGTL) <http://www.egtl.org>.

European Institute for Transnational Legal Studies (METRO) <http://www.narcis.nl> .

Institute of European and Comparative Private Law of the University of Girona
<http://civil.udg.edu> .

World Tort Law Society <http://www.wtls.org> .

b) Institucione dhe organizma

Centre for European Private Law (CEP) <http://www.jura.uni-muenster.de> .

Cornell Legal Information Institute <http://www.law.cornell.edu> Swiss Institute of
Comparative Law <http://www.isdc.ch> .

Duke Center for International & Comparative Law <http://www.law.duke.edu> .

Max Planck Institute for Comparative Public Law and International Law <http://mpil.de>.

Max Planck Institute for Comparative and International Private Law <http://www.mpg.de>.

Linkliste Université de Genève <http://www.unige.ch> .

Tilburg Institute of Comparative and Transnational Law (TICOM)

<http://www.tilburguniversity.edu> .

c) **Revista shkencore juridike**

Journal of European Tort Law (JETL) <http://www.degruyter.com>.

Law Journal Index <http://washlaw.edu> .

Journal of Tort Law <http://www.degruyter.com> .

US Law Journals Index <http://tarlton.law.utexas.edu> .

International Law Journals Index <http://lawlib.wlu.edu> .

BePress Comparative Law <http://law.bepress.com>.

Global Legal Information Network <http://www.glinf.org> .

JURIST (Pittsburgh Law) <http://law.pitt.edu> .

Giustizia Civile <http://giustiziacivile.com>.

d) **Gjykata dhe Praktikë gjyqësore**

Corte Suprema di Cassazione d'Italia <http://www.cortedicassazione.it>.

Cour de Cassation de France <http://www.courdecassation.fr>.

Database of European cases on tort law <http://www.eurotort.org>.

European Court of human Rights <http://hudoc.echr.coe.int>.

Federal Court of Justice (BGH) Germany <http://bundesgerichtshof.de/EN>.

Gjykata e Lartë e R.së Shqipërisë www.gjykataelartë.gov.al .

InfoCuria -Case Law of the Court of Justice <http://curia.europa.eu>.

The Austrian Supreme Court (OGH) <http://www.ogh.gv.at/en> .

UK Supreme Court <http://www.supremecourt.uk>.

e) **Mjete kërkimi juridike**

Academic Search Premier <http://www.ebscohost.com>.

Academy of European Law <http://www.era.int> .

Academic Database Assessment Tool <http://adat.crl.edu/>.

Britanica Online <http://www.britannica.com>.

Cardiff Index to Legal Abbreviations <http://legalabbrevs.cardiff.ac.uk>.

Diffusioni Editoriali <http://www.dep.it>.

Diritto&Diritti <http://www.diritto.it> .

<http://www.filodiritti.it>.

Dokumenta ligjore nga Eur-Lex <http://www.europa.eu.int>.

Ebrary Academic International Collection <http://www.ebrary.com>.

École National de la Magistrature <http://www.enm.justice.fr>.

Edizioni Scientifiche Italiane <http://www.edizioniesi.it>.

European Center of Tort and Insurance Law <http://ectil.org> .

European Institute of Public Administration <http://www.eipa.nl>.

Emerald Insight <http://www.emeraldinsight.com> .

French Abbreviations <http://www.abbreviations.com>.

Fjalor i termave juridike <http://www.definitions.uslegal.com> .

Journal of European Tort Law <http://www.debgruyter.com>.

La mia Biblioteca <http://servizi.lamiabiblioteca.com/cluster/Detail.aspx?IdCluster=00127760>.

Norma ligjore në Itali <http://www.gazzetaufficiale.it>.

Persona e Danno <http://personaedanno.it> .

Portale giuridico OverLex <http://www.overlex.com>.

Professional Network ACADEMIA <http://www.academia.edu>.

Project MUSE <http://muse.jhu.edu/>.

ProQuest Central <http://www.proquest.com>.

Revista Elektronike e Aktualitetit Juridik (REAJ) <http://aktualitetijuridik.blogspot.al>.

Swiss Law Links <http://www.loc.gov>.

The British and Irish Legal Information Institute BAILI <http://www.bailii.org>.

The UK Statute Law Database <http://www.legislation.gov.uk>.

Oxford Reference Online (ORO) <http://www.oxfordreference.com>.

Oxford English Dictionary Online <http://oed.com> .

Oxford Scholarship Online <http://www.oxfordscholarship.com/oso/public/>.

Oxford Law Faculty OSCOLA <http://www.law.ox.ac.uk> .

Professionalità quotidiana <http://www.ipsoa.it> .